



KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

**Raport përfundimtar i auditimit të ushtruar në Institutin e Sigurimeve
Shoqërore (ISSH)**

RAPORT AUDITIMI

MBI

“AUDITIMIN FINANCIAR DHE PËRPUTHSHMËRISË”

TIRANË, KORRIK 2023

PËRMBAJTJA:

NR.	TITULLI	FAQE
I	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3-9
I.1	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit	3-3
I.2	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	3-5
I.3	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	5-9
II	HYRJA	9-13
II.1	Objektivat dhe qëllimi	9-9
II.2	Identifikimi i çështjes	9-10
II.3	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	10-10
II.4	Përgjegjësitë e audituesve	10-11
II.5	Kriteret e vlerësimit	11-12
II.6	Standardet e auditimit	12-12
II.7	Metodat e auditimit	12-12
II.8	Dokumentimi i auditimit	12-13
III	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	13-106
III.1	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim	13-14
III.2	Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit	14-106
III.2.1	Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.	14-18
III.2.2	Auditimi i administrimit të sigurimeve shoqërore dhe politikave të pensioneve, në drejtim të mbulimit të popullsisë me elemente të sigurimeve shoqërore.	18-24
III.2.3	Auditimi i planifikimit dhe realizimit të buxhetit të sigurimeve shoqërore, për vitin 2022.	24-52
III.2.4	Auditimi i funksionimit të strukturave të kontrollit, në drejtim të inspektimit të pensioneve.	52-57
III.2.5	Mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin buxhetit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore për vitin 2022.	57-64
III.2.6	Auditimi i menaxhimit dhe administrimit të burimeve njerëzore.	64-71
III.2.7	Opinion mbi pasqyrat financiare të konsoliduara të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, për vitin 2022.	71-76
III.2.8	Mbi procedurat e prokurimit me fonde publike dhe zbatimin e kontratave;	77-81
III.2.9	Auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin, si dhe auditin e brendshëm.	81-87
III.2.10	Mbi përputhshmërinë e procedurave të kryera në përlogaritjen dhe pagesat e pensioneve, në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë.	87-106
IV	GJETJET DHE REKOMANDIMET	106-113
V	ANEKSE	113-134

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.1. Përshkrim i shkurtër i Raportit të Auditimit:

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Mbi organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe bazuar në Programin e Auditimit nr. 13/1, datë 09.01.2023, miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Kontrolli i Lartë i Shtetit auditoi Institutin e Sigurimeve Shoqërore (ISSH). Në përfundim të auditimit, hartoi Projekt Raportin e Auditimit, bazuar në Letrat e punës, Akt Konstatimet, vërejtjet e bëra nga subjekti “Institutin e Sigurimeve Shoqërore”, etj., sipas drejtimeve të auditimit të përcaktuara në Programin e Auditimit. Projekt Raporti i Auditimit u dërgua në subjekt me shkresën nr. 13/4, datë 26.04.2023, njohja e të cilit është konfirmuar nga subjekti i audituar, me shkresën përcjellëse nr. 85/3, datë 20.06.2023, protokolluar në KLSH me nr.13/5, datë 26.06.2023. Mbi këtë bazë është hartuar Raporti Përfundimtar i Auditimit.

I.2. Përmbledhje e gjetjeve kryesore:

Nr.	Përmbledhje e gjetjes	Ref. në RPA	Rëndësia	Rekomandimi
1	<p>Nga auditimi mbi saktësinë e raportimit të planit dhe faktit të buxhetit të ISSH ka rezultuar se, sipas Ligjit nr. 115/2021 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2022”, me ndryshime plani i të ardhurave për ISSH, nga kontributet është në shumën 104,009 milionë lekë dhe përfaqëson të ardhura tatimore, të klasifikuara si të tilla edhe në Tabelën e Treguesve Fiskalë të Konsoliduar të Buxhetit të Shtetit.</p> <p>Nga ISSH, detajimi i planit të të ardhurave në shumën 104,009 milionë lekë, është kryer duke përfshirë në planifikim edhe të ardhura jo tatimore, ose “Të tjera DPT dhe ISSH”, të cilat janë në shumën 745,477 mijë lekë, në kundërshtim me Ligjin 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022” dhe “Treguesit fiskalë të konsoliduar të buxhetit të shtetit të vitit 2022”. Kjo ka sjellë që plani i të ardhurave nga kontributet sipas ISSH të jetë 745,477 mijë lekë më pak, se plani i miratuar me ligjin e buxhetit.</p>	<p>Pika III Faqe 24-52</p>	<p>Mesme</p>	<p>Titullari i ISSH, të marrë masa që në vijim, në detajimin e planit të të ardhurave nga kontributet të mos përfshihen të ardhurat jo tatimore, por të zbatohet klasifikimi i tyre, sipas Treguesve Fiskalë të Konsoliduar të Buxhetit të Shtetit, pjesë e ligjit dhe akteve normative.</p>

	<p>Gjithashtu, në analizat e kryera fakt/plan, ka rezultuar se të ardhurat tatimore nga derdhja e kontributeve janë në shumën 104,459,763 mijë lekë dhe jo në shumën 105,656,512 mijë lekë të raportuar nga ISSH, pasi këtu është përfshirë edhe realizimi i të ardhurave jo tatimore në shumën 1,196,749 mijë lekë. <i>Si përfundim të ardhurat nga kontributet janë realizuar në masën 100.4 % dhe jo në masën 101.6 % të raportuar nga ISSH dhe nga MFE në faktin e realizimit të të ardhurave nga kontributet.</i></p>			
2	<p>Nga auditimi mbi saktësinë e përlllogaritjes së masës së pensioneve, dhe zbatimin e afateve në dhënien e pensioneve, nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, ka rezultuar se nga auditimi i 148 dosjeve të pensionit, kanë rezultuar me mangësi në përlllogaritjen e masës së pensionit 56 dosje, ose 37.8 % e tyre, kjo për shkak përlllogaritjes së pa saktë të elementëve përbërës të pensionit, si pensioni bazë dhe shtesa e pensionit nga inspektorët përpunues të dosjeve. Gjithashtu, nga auditimi mbi respektimin e afatit 42 ditor në përpunimin e një dosje pensioni, referuar të dhënave në Fletë shoqërimit operacional, nga auditimi i 148 dosjeve, në 38 raste, ose në masën 25 % kundrejt totalit të dosjeve të audituara, nuk është respektuar afati i përpunimit të dosjes nga momenti i aplikimit deri në nënshkrimin nga Zyra e Financës për kryerjen e pagesës, si dhe shërbimin postar (tre ditë) në total 42 ditë afat.</p>	<p>Pika X Faqe 87-106</p>	<p>Mesme</p>	<p>Drejtori i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë dhe Sektori i Përfitimeve, të marrin masa të menjëhershme për shqyrtimin e mangësive të evidentuara dhe ri llogaritjen e pensioneve për 56 rastet (dosjet) e trajtuara në mënyrë të hollësishme rast pas rasti në Raportin Përfundimtar të Auditimit, si dhe për përpunimin e dosjeve të pensionit brenda afateve të përcaktuara.</p>

3	Nga auditimi u konstatua se përgjatë vitit 2022, ISSH ka funksionuar mbi bazën e Rregullores për Organizimin e Funksionimin e saj, e cila nuk përshtatet me strukturën organizative aktuale. Me urdhrin nr. 4385 prot., datë 22.06.2022, Titullari i Institucionit ka ngritur grupin e punës për një organizim të brendshëm të ISSH dhe ndryshim të strukturave organizative aktuale të Drejtorisë së Përgjithshme, DRSSH, DSSH dhe DAQ, i cili nuk ka paraqitur asnjë informacion apo dokumentacion mbi ecurinë e punës për hartimin e strukturës së re organizative.	Pika VI Faqe 64-71	Mesme	Drejtori i Përgjithshëm të nxjerrë përgjegjësitë në përshtetimin e procedurave për organizimin e brendshëm të Institucionit, si dhe të marrë masa për miratimin e Rregullores për Funksionimin dhe Organizimin e ISSH.
---	--	--------------------------	-------	--

I.3. KONKLUZIONI I PËRGJITHSHËM DHE OPINIONI I AUDITIMIT

I.3.1. Konkluzion i përgjithshëm:

Në përfundim të auditimit bazuar në ISSAI/IFPP 200 “Parimet themelore të auditimit financiar” dhe IFPP 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, si dhe standardet e auditimit financiar dhe të përputhshmërisë, të ushtruar në ISSH, për periudhën e veprimtarisë nga 01.01.2022 deri në 31.12.2022, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 13/1, datë 09.01.2023, miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Grupi i auditimit ka arritur në konkluzionin se, në përgjithësi subjekti i audituar ka vepruar në përputhje me kriteret e vlerësimit përsa i përket planifikimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe realizimit të tyre. Në vitin 2022, plani i të ardhurave rezulton me tejkalim dhe plani i shpenzimeve me mosrealizim duke sjellë një rezultat fiskal pozitiv për ISSH, në shumën 5,491,708 mijë lekë. Përsa i përket përputhshmërisë në zbatimin e procedurave të prokurimit publik, menaxhimin financiar dhe kontrollin; planifikimin dhe realizimin e buxhetit të brendshëm të ISSH; menaxhimin e burimeve njerëzore dhe hartimin e pasqyrave financiare të konsoliduara të vitit 2022, ISSH me përjashtim të disa rasteve të cilat nuk janë të përhapura dhe materiale, ka vepruar në përputhje me kriteret e vlerësimit. Në lidhje me auditimin e DRSSH Tiranë arrijmë në konkluzionin se, janë evidentuar gabime në përlllogaritjen e masës së pensionit në 56 raste nga 148 dosjet e audituara, si dhe në 38 raste të dosjeve të audituara, kishte tejkalim afati të përpunimit të tyre.

I.3.2. Opinioni i auditimit:

I. Opinion mbi auditimin e përputhshmërisë:

Ne kemi audituar zbatueshmërinë e akteve ligjore dhe nën ligjore (kriteret e paracaktuara të vlerësimit), për veprimtarinë ISSH mbi politikat e pensioneve në drejtim të mbulimit të popullsisë me elemente të sigurimeve shoqërore; planifikimit dhe realizimin e buxhetit të

sigurimeve shoqërore, për vitin 2022; funksionimin të strukturave të kontrollit, në drejtim të inspektimit të pensioneve; menaxhimin dhe administrimin e burimeve njerëzore; menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm; procedurat e prokurimit publik; si dhe përputhshmërinë e procedurave të kryera në përlllogaritjen dhe pagesat e pensioneve në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë.

Opinion i pa modifikuar, me theksim çështjeje:

Sipas opinionit tonë, përveç theksimit të çështjeve të cilësuar në paragrafin e “Theksimi i çështjes” subjekti i audituar, ISSH dhe DRSSH Tiranë, kanë vepruar në përputhje me kriteret e vlerësimit (Ligji nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshime; Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Rregullorja e miratuar me Urdhrin nr. 2115, datë 15.03.2018, të ISSH “Për organizimin dhe funksionimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore “Statuti i ISSH” miratuar me VKM nr.161, datë 11.04.1994 etj.) gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj.

Baza për opinionin e pa modifikuar, me theksim çështjeje:

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për përputhshmërinë.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të bazuar opinionin tonë. Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se, ISSH dhe DRSSH Tiranë, në përgjithësi kanë vepruar në përputhje me kriteret e vlerësimit. Mangësitë e evidentuara në disa çështje të audituara, nuk janë të përhapura dhe materiale dhe për këtë arsye nuk sjellin modifikim të situatës.

Theksimi i çështjes:

1. Nga auditimi i përputhshmërisë në përlllogaritjen e pensioneve nga DRSSH Tiranë, ka rezultuar se, nga 148 dosje pensionesh të audituara, në 56 prej tyre janë evidentuar pasaktësi në përlllogaritjen e pensioneve dhe në 38 raste janë evidentuar vonesa në afatin e përpunimit të dosjeve të pensionit.

2. Nga auditimi i planifikimit dhe realizimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të ISSH, si dhe rakordimit të tyre me strukturat përkatëse, ka rezultuar se nga ISSH, detajimi planit të të ardhurave dhe shpenzimeve më tej realizimit dhe analizimit të tyre (fakt/plan) është kryer duke përfshirë në këtë plan dhe fakt edhe të ardhurat jo tatimore, ose “Të tjera DPT dhe ISSH”. Nga ISSH, nuk është bërë një detajim i duhur i planit të të ardhurave, për rrjedhojë edhe faktit e realizimit të tyre. Në përfundim, realizimi i të ardhurave nga kontributet e mbledhura nga DPT dhe ISSH, kundrejt planit të miratuar nga MFE është në masën 100.4 % dhe jo në masën 101.6 % të raportuar nga ISSH, duke përfshirë në realizimin e tyre edhe të tjera të ardhura/jo tatimore në shumën 1,196,749 mijë lekë;

Përgjegjësitë e Drejtuesve të ISSH dhe DRSSH Tiranë:

Strukturat drejtuese të ISSH dhe DRSSH Tiranë, janë përgjegjëse për hartimin e politikave në fushën e pensioneve, realizimin e të ardhurave nga kontributet, si dhe mbulimin e popullsisë me elementë të sigurimeve shoqërore, përdorimin me efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet të fondeve publike, në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit).

Ato janë përgjegjëse për zbatimin e gjithë kuadrit rregullator në fushën e përlllogaritjes së pensioneve, menaxhimin e detyrimeve të lindura nga kontributet dhe përfitimet, etj. Gjithashtu, strukturat drejtuese të ISSH janë përgjegjëse për funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, hartimin e procedurave, aktiviteteve të kontrollit, gjurmës së auditimit për të aktivitet kryesorë të saj.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë:

Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.

Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me zbatueshmërinë e kriterëve të vlerësimit, kuadrin ligjor dhe rregullator nga ana e subjektit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. Opinioni i auditimit mbi pasqyrat financiare:

Ne kemi audituar Pasqyrat Financiare Vjetore të Konsoliduara të ISSH, për vitin ushtrimor nga 01.01.2022-31.12.2022, të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar, pasqyrën e performancës, pasqyrën e ndryshimeve në kapital, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë këto pasqyra. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Opinioni i pamodifikuar me theksim çështjeje:

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare të Konsoliduara të vitit 2022, paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare të subjektit më 31 dhjetor 2022, referuar kuadri rregullator (Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik; Standardet Kombëtare të Kontabilitetit; Ligji “Për kontabilitetin”; Ligji “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; Udhëzimet e MF mbi përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore etj.) mbi të cilat subjekti i audituar është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare.

Baza për opinionin:

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga ISSH në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë. (SNA-700).

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se, pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e flukseve e mjeteve monetare, si dhe shpjegimet janë përfshirë në deklaratat financiare, si dhe kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare nuk përmbajnë gabime materiale, por ka çështje për të cilat tërheqim vëmendjen e subjektit për të ardhmen.

Theksimi i çështjes

1. Nga verifikimi i pasqyrave financiare të konsoliduara rezultoi se, pasqyrat financiare të konsoliduara paraqesin informacion të sintetizuar për 12 DRSSH, Buxhetin e Përgjithshëm të ISSH, Buxhetit e Brendshëm dhe Drejtorinë e Arkivit Qendror (DAQ), por në pikën 1 të Kreut IV.C, të Rregullores Financiare të ISSH nr. 5, datë 25.05.2009 nuk parashikohet si qendër analizë DAQ, e cila është krijuar me anë të vendimit të Këshillit Administrativ nr.10, datë 04.07.2011;

2. Me anë të Urdhrit nr. 8338/2 datë 31.01.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm është urdhëruar të bëhet heqja e materialeve të vlerësuara të papërdorshme dhe efektet financiare të paraqiten në Pasqyrat Financiare të vitit 2022. Nga verifikimi i procedurës së inventarizimit dhe asgjësimit rezultoi se në lidhje me AAM e propozuara për asgjësim, nuk janë marrë masa për asgjësimin fizik të tyre. Për periudhën objekt auditimi nuk konstatohen të jenë asgjësuar aktivet materiale, ndërsa në kontabilitet janë kryer procedurat e çregjistrimit të tyre, të cilat paraqiten në pasqyrën F7 “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto);

3. Nga verifikimi i saktësisë së paraqitjes së elementëve në Pasqyrës Financiare rezultuan këto pasaktësi në pasqyrën e pozicionit Financiar të datës 31.12.2022:

Paraqitje e pasaktë e llogarisë 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” nga ana e DRSSH Durrës dhe Gjirokastrës.

Shuma 2% e sigurimit vullnetar, që paguhet për punonjësit e ISSH, bazuar në pikën 2 të VKA nr. 24, të datës 23.12.2014 është paraqitur në llogarinë 44 “Institucione të tjera publike” nga ana e DRSSH Shkodër, ndërsa po i njëjti zë nga DRSSH Berat, Durrës e Dibër është paraqitur në llogarinë 419 “Kreditorë, parapagime”.

Mungesë të shënimeve shpjeguese në lidhje me inventarët, për politikën e vlerësimit dhe elementë që kërkohen sipas përcaktimeve të paragrafit 34 të SKK 4.

Mangësitë e mësipërme nuk janë materiale dhe të përhapura, për rrjedhojë opinioni jonë, nuk sjell modifikim të pasqyrave financiare.

Përgjegjësia e strukturave drejtuese të Subjektit:

Strukturat drejtuese të ISSH, janë përgjegjëse për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e “Kudrit rregullator” dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafit drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit). Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar. Stafit drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi. Titullari i Institucionit, (në cilësinë e Nëpunësit Autorizues), është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar.

Përgjegjësia e audituesit të KLSH për auditimin e PFV

Përgjegjësia e audituesit të KLSH, është që të shprehë një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Përgjegjësia e audituesit të KLSH, lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomalitë materiale, për shkak të gabimit apo mashtrimit, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën e audituesit. Në gjithashtu:

Identifikojmë dhe vlerësojmë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë procedura auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si dhe marrim evidence auditimi të plota dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Gjatë vlerësimit të risqeve, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga subjekti, në mënyrë që të përcaktojë procedura auditimi që janë të përshtatshme për rrethanat e subjektit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontroleve të brendshme të subjektit. Auditimi përfshin edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave

kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përllogaritjeve kontabël të bëra nga subjekti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

II. HYRJA

II.1. Mbështetur në Ligjin 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 13/1, datë 09.01.2023, miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 11.01.2023 deri në datë 28.04.2023 në subjektin Drejtoria e Përgjithshme e Institutit të Sigurimeve Shoqërore (ISSH) dhe në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore (DRSSH) Tiranë, për periudhën e veprimtarisë së subjektit nga data 01.01.2022 deri në 31.12.2022, u krye auditimi “Mbi auditimin financiar dhe të përputhshmërisë nga Grupi i Auditimit me përbërje:

- B.Z., Përgjegjës Grupi
- E.B., Audituese e I-rë
- T.A., Auditues i I-rë
- M.V., Audituese e I-rë
- K.N, Audituese e II-të

Titulli: Auditim Financiar dhe Përputhshmërie

Marrësi: Instituti i Sigurimeve Shoqërore

II.2. Objektivat dhe qëllimi.

- Për auditimin financiar, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve, për të arritur objektivin e këtij auditimi, që është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitet 2022, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrit ligjor të raportimit financiar në fuqi.

- Për auditimin e përputhshmërisë, duhet të përcaktohet niveli i zbatimit të kriterëve të vlerësimit referuar kuadrit ligjor në fuqi si, Ligji 7703, datë datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në RSH”, me ndryshime, si dhe akteve të tjera ligjore dhe nënligjore të cilat rregullojnë fushën e sigurimeve shoqërore në RSH.

Qëllimi i auditimit do të realizohet vetëm pas analizës së implementimit të kërkesave të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, për të vlerësuar drejt nivelin e riskut në subjekt, me synim dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, lidhur me prokurimin e mallra/shërbime e investimeve.

Ky projekt auditimi do të shtrihet për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2022 deri në datë 31.12.2022, si dhe do të ketë si fushëveprimi zbatimin e planit të buxhetit të ISSH, realizimin e të ardhurave nga kontributet, zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore si dhe zbatimin e procedurave në përcaktimin e masës së pensioneve nga DRSSH Tiranë, vlerësimin e veprimtarisë së Drejtorisë së Inspektimit, Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, funksionimin e MFK, plotësimin e Pasqyrave Financiare, si dhe kryerjen e shpenzimeve në përputhje me kriteret e vlerësimit, zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm te KLSH , etj..

II.3. Identifikimi i çështjes.

Referuar analizës së riskut, në fazën e planifikimit dhe auditimit në terren, u identifikuan fushat me risk më të lartë. Gjithashtu, sigurojmë që vlerësimi fillestar i riskut në fazën e planifikimit

si dhe ai i aplikuar gjatë fazës së auditimit në terren, vijon të mbetet i vlefshëm, si dhe nuk ka rishikim të tij.

Sa më sipër, fushat me risk të lartë u përcaktuan si drejtimet e auditimit të miratuara me Programin e Auditimit nr. 13/1 prot., datë 09.01.2023, si më poshtë:

- Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme.
- Auditimi i administrimit të sigurimeve shoqërore dhe politikave të pensioneve, në drejtim të mbulimit të popullsisë me elemente të sigurimeve shoqërore.
- Auditimi i planifikimit dhe realizimit të buxhetit të sigurimeve shoqërore, për vitin 2022.
- Auditimi i funksionimit të strukturave të kontrollit, në drejtim të inspektimit të pensioneve.
- Mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin buxhetit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore për vitin 2022.
- Auditimi i menaxhimit dhe administrimit të burimeve njerëzore.
- Opinion mbi pasqyrat financiare të konsoliduara të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, për vitin 2022.
- Mbi procedurat e prokurimit me fonde publike dhe zbatimin e kontratave;
- Auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin, si dhe auditin e brendshëm.
- Mbi përputhshmërinë e procedurave të kryera në përllogaritjen dhe pagesat e pensioneve, në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë.

II.4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.

Strukturat drejtuese të ISSH, janë përgjegjëse për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare të Drejtorisë së Përgjithshme dhe ato të konsoliduara, në përputhje me kërkesat e ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare” dhe kërkesat e tjera në kuadrin e raportimit financiar në fuqi, si dhe funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet. Stafit drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit), për të fushat e veprimtarisë së ISSH në drejtim të mbledhjes së kontributeve dhe përcaktimit të masës së pensioneve për përfituesit. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar.

II.5. Përgjegjësitë e audituesve.

- Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme, nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, nëse veprimtaria e subjektit të audituar është zhvilluar në përputhje me kriteret e paracaktuara, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.
- Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale duke i përshkruar në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.
- Përgjegjësi e audituesit, lidhen me faktin e marrjes së sigurisë së arsyeshme, në dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e paracaktuara si: rregullat, ligjet, politikën, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kriterëve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregulloret, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që

përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet, etj., (ISSAI/IFPP-4900).

- Audituesit në të gjithë llojet e auditimit, kanë përgjegjësi që të zbatojnë parimet që lidhen me procesin e auditimit, të sanksionuara në ISSAI/IFPP-100 "Parimet themelore të auditimit të sektorit publik", paragrafi 44-51.

II.6. Kriteret e vlerësimit.

- Ligji nr.7703, datë 11.05.1993 "Për Sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar),
- Ligjin nr.8097, datë 21.03.1996 "Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit", i ndryshuar.
- Ligjin nr.10142, datë 15.05.2009 "Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.
- Ligjin nr.9361, datë 24.03.2005 "Për një trajtim të veçantë financiar të efektivave, oficerë dhe nënofficerë lundruar, të nëndetësve dhe polumbarëve të forcave detare në pension".
- Ligjin nr. 8607, datë 27.04.2000 "Statusi i Dëshmorit të Atdheut", i ndryshuar.
- Ligjin nr.9128, datë 29.7.2003 "Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues, në pension", i ndryshuar.
- Ligjin nr.8455, datë 4.2.1999 "Për një trajtim të veçantë të familjeve të pilotëve që humbasin jetën në përbushje të detyrës gjatë fluturimit", i ndryshuar.
- Ligjin nr.10139, datë 15.5.2009 "Për Pensionet Shtetërore Suplementare të Punonjësve të Universiteteve, të Shkollave të Larta, Qendrës së Studimeve Albanologjike, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha Institucioneve të tjera Kërkimore Publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë Tituj Shkencore".
- Ligjin nr.8685, datë 9.11.2000 "Për një trajtim të veçantë të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë", i ndryshuar.
- Ligjin nr.9179, datë 29.1.2004 "Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake", i ndryshuar.
- Ligji nr.29/2019 "Për sigurimet suplementare të punonjësve që kanë punuar në punë të vështira në nëntokë, në industrinë e naftës dhe në metalurgji".
- Vendime të Këshillit të Ministrave lidhur me sistemin e kompensimit të çmimit të energjisë elektrike, bukës, vajgurit etj.
- VKM nr.752, datë 01.12.2022 "Për shpërblimin e pensionistëve për festat e fund vitit 2022", efektet financiare në shumën 3,503,309 mijë lekë, nga e cila shuma prej 3,309 mijë lekë, do të mbulohen nga buxheti i ISSH i vitit 2022 dhe 3,500,000 mijë lekë financim nga Buxheti i Shtetit;
- VKM nr. 753, datë 01.12.2022 "Për kompensimin e të ardhurave të personave që përfitojnë pension invaliditeti për vitin 2022", efektet financiare në shumën 396,642 mijë lekë do të mbulohen nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit;
- VKM nr. 897, datë 29.12.2022 "Për mbështetje financiare të menjëhershme të pensionistëve për zbutjen e impaktit të krizës", efektet financiare në shumën 5,605,294 mijë lekë do të mbulohen nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit;
- VKM nr. 159, datë 12.03.2022 "Për mbështetjen financiare të disa kategorive të veçanta për zbutjen e efekteve të ndikuara nga lufta në Ukrainë", efekt financiar në shumën 5,187 milionë lekë do të mbulohen nga buxheti i ISSH, nga e cila shuma 4,071,402 mijë lekë për ISSH e ndarë në shumën 187,429 mijë lekë nga Buxheti i ISSH dhe 3,883,973 mijë lekë financim nga buxheti i shtetit.

- VKM nr. 188, datë 30.03.2022 “Për indeksimin e pensioneve dhe bazës së vlerësuar”, i cili do të mbulohet nga fondi për indeksimin e pensioneve përcaktuar me ligjin nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022” në shumën 3,300,000 mijë lekë, i cili është ndryshuar me AN nr. 19, datë 29.12.2022 në shumën 3,280,000 mijë lekë.
- VKM nr. 654, datë 10.10.2022 “Për një ndryshim në vendimin nr. 605, datë 14.09.2022 të Këshillit të Ministrave “Për indeksimin e pensioneve” në shumën 2,060,000 mijë lekë”;
- Marrëveshja midis DPT dhe ISSH, lidhur me procedurat dhe rregullat për dërgimin, apo transferimin në formë elektronike të informacionit për pagesat e kontributeve sipas subjekteve dhe individëve, komunikimin midis palëve të të dhënave statistikore dhe problematikave që dalin pas inspektimit nga ISSH të të dhënave të kontributeve të procesuara në llogaritë individuale;
- Vendimi Këshillit Administrativ (VKA) nr.9, datë 29.12.2021, mbi buxhetin e Sigurimeve Shoqërore gjatë vitit 2022.
- Rregullore nr. 1, datë 21.10.2008 “Për caktimin, administrimin dhe pagesën e pensioneve”, etj..

II.7. Standardet e auditimit të aplikuara në kryerjen e punës. Auditimi është kryer, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të INTOSAI-t (ISSAI), përkatësisht në: Nivelin e parë “Parimet INTOSAI-t” ku përfshihet: ISSAI-P-1 “Deklarata e Limës”, ISSAI-P-10 “Deklarata e Meksikos”; Nivelin e dytë “Standardet e INTOSAI-t” ku përfshihen: ISSAI 100 - Parimet bazë në auditimin e sektorit publik; ISSAI 200-299 “Parimet bazë të auditimit financiar”, ISSAI 400-499 “Parimet bazë të auditimit të përputhshmërisë”.

Gjithashtu janë zbatuar dhe aplikuar standardet si më poshtë:

ISSAI-140 “Sigurimin e cilësisë”

ISSA 130 “Kodin Etik”

ISSAI 2315 “Risku”

ISSAI 2320-2450 “Materialiteti”

ISSAI 2500 “Dokumentimi”

II.8. Metodatat e auditimit.

Përzgjedhja e metodave të përdorura, u mbështetet në vlerësimin e riskut, materialitetit, kostos dhe efikasitetit të auditimit, duke patur në fokus përmbushjen e qëllimit të procedurës së auditimit. Përsa i përket funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, zbatueshmërisë nga ana e subjektit të audituar të MFK-së, Grupi i auditimit ka kryer intervista verbale dhe teste kontrolli. Nga vlerësimi i riskut në fazën e planifikimit dhe në fazën e auditimit në terren, ka rezultuar se sistemi i kontrollit të brendshëm, ka funksionuar në mënyrën e duhur, si dhe është konsideruar me risk të ulët, për këtë arsye për dhënien e një vlerësimi sa më objektiv, profesional e të pavarur, të saktë, të plotë e të qartë për zbatimin e ligjshmërisë dhe korrektësisë (në auditimin e përputhshmërisë) nga ana e subjektit të audituar, janë aplikuar:

- a. Verifikimi i transaksioneve - është marrë informacioni për një rrethanë ose transaksion nga dy burime duke kryer krahasueshmërinë e tyre;
- b. Intervistimi - është përdorur intervistimi verbal i marrjes së informacionit nëpërmjet pyetjeve drejtuar personelit kyç të subjektit që auditohet.
- c. Raporte dhe informacione - janë shfrytëzuar raporte, analiza dhe informacione të cilat lidhen me objektivat e auditimit dhe problemet që lidhen me të.
- d. Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm - audituesi ka përdorur pyetësorin e vetëvlerësimit të subjektit duke verifikuar çdo raportim të tij në lidhje me 5 komponentët e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm të subjektit.
- e. Teknikat me ndihmën e kompjuterit - janë përdorur të dhënat në sistemet e ISSH, CMIS dhe PCAMS, për procedura të programuara, në lidhje me procedurat e ndjekura nga DRSSH Tiranë për mbledhjen e kontributeve dhe kryerjen e pagesave, etj..

I.9. Dokumentimi i auditimit, është mbështetur në kërkesat e manualeve të auditimit, në Manualin e Auditimit Financiar, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë si edhe në Rregulloren e Procedurave të Auditimit në KLSH. Grupi i auditimit ka dokumentuar punën audituese në të gjitha fazat e ezauruara (planifikim, auditim në terren dhe raportim). Nga Grupi i auditimit janë plotësuar të gjitha dokumentet standarde të auditimit, si dhe është dokumentuar gjurma e auditimit për të gjitha procedurat e kryera.

III. PËSHKRIMI AUDITIMIT

III.1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Instituti i Sigurimeve Shoqërore është një institucion publik i pavarur, organizimi dhe funksionimi i të cilit rregullohet me dispozitat e ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993, “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 25/2017, datë 09.03.2017; botuar në Fletoren Zyrtare nr. 58, datë 27.03.2017. Bazuar në nenin 71, të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Misioni i Institutit të Sigurimeve Shoqërore (ISSH) është administrimi i sigurimeve shoqërore në përgjithësi, dhe i politikave të pensioneve në veçanti, vendosja e personave të siguruar dhe përmirësimi i shërbimit ndaj tyre në qendër të veprimtarisë së këtij Institucioni, mbulimi i popullsisë me elementë të sigurimeve shoqërore në çdo vend dhe kohë kur lind kjo e drejtë, rritja e numrit të kontribuesve dhe grumbullimi i të ardhurave nga kontributet e fermerëve dhe të siguruarit vullnetarë, përmirësimi i eficiencës së menaxhimit të fondeve të sigurimeve shoqërore, i fondeve përkohësisht të lira dhe fondit rezervë.


Objektivat e përgjithshme të ISSH-së

- Vazhdimi të punës për implementimin e skemës së reformuar të pensioneve.
- Zbatim të politikave të Qeverisë për rritjen e të ardhurave të pensionistëve nëpërmjet rritjes së masës së pensioneve, nëpërmjet indeksimit të tyre.
- Përmirësimi të administrimit të buxhetit të ISSH-së dhe cilësisë së shërbimeve ndaj qytetarëve;
- Vazhdimi të punës për krijimin e një baze të plotë, të informatizuar të të dhënave, siç janë periudhat kontributive të personave, zbatimi i plotë i një sistemi të informatizuar të autorizimit dhe pagesave të pensioneve në mënyrë online, si për pagesat në zonat urbane ashtu dhe ato rurale;
- Përmirësimi rrënjësor të praktikave të punës së inspektimit dhe të kontrollit të brendshëm, fokusimin e tij në luftën kundër in formalitetit, duke zbatuar standardet e përcaktuara.

Instituti i Sigurimeve Shoqërore do të drejtohet nga:

- Këshilli Administrativ i Institutit të Sigurimeve Shoqërore
- Drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Këshilli Administrativ i Institutit të Sigurimeve Shoqërore është organi më i lart ekzekutiv. Ai përbëhet nga 12 anëtarë, të paraqitur në skemën e mëposhtme:



Skema e strukturës së Këshillit Administrativ

Në zbatim të pikës 1/a, të nenit 72, të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, funksionet e këtyre përfaqësuesve caktohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.

III.2. Rezultatet e auditimit sipas drejtimeve të auditimit:

III.2.1. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimet e mëparshme.

Dokumentacioni i shqyrtuar:

- Shkresa përcjellëse e KLSH nr. 17/10, datë 26.07.2022 drejtuar ISSH “Raporti Përfundimtar i Auditimit dhe Rekomandimet”;
- Shkresa përcjellëse e ISSH nr. 5009/2, datë 23.12.2022, drejtuar KLSH “Dërgohet programi i masave në zbatim të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dërguar me shkresën nr. 17/10, datë 26.07.2022 “Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për Auditimin e Përputhshmërisë në Institutin e Sigurimeve Shoqërore, Tiranë.

Nga auditimi i afateve të raportimit të subjektit mbi zbatimin e rekomandimeve në KLSH dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm ka rezultuar:

Titulli i gjetjes 1:

Situata:

Mbi raportimin në KLSH mbi zbatimin e rekomandimeve.

ISSH është audituar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, për periudhën nga data 01.01.2021 deri më 31.12.2021, sipas Programit të Auditimit nr. 17/1, datë 14.01.2022 “Mbi Përputhshmërinë e veprimtarisë”, i ndryshuar, për të cilin Raporti Përfundimtar dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjes i janë dërguar subjektit të audituar me shkresën nr. 17/10, datë 26.07.2022.

Për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, ISSH me shkresën nr. 5009/2 prot., datë 23.12.2022, i është drejtuar KLSH “Dërgohet programi i masave në zbatim të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit dërguar me shkresën nr. 17/10, datë 26.07.2022 “Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për Auditimin e Përputhshmërisë në Institutin e Sigurimeve Shoqërore, Tiranë”, bashkëlidhur planin e masave, ku ka informuar Kontrollin e Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve.

Sa më sipër, ISSH nuk ka zbatuar hapat mbi raportimin e zbatimit të rekomandimeve në KLSH të cilat janë të cilësuar në nenin 15 dhe 30 të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH-së”, konkretisht:

- neni 15 germa (j), ku cilësohet: *“të vendosë një afat kohor për zbatimin e rekomandimeve dhe të informohet nga subjektet e audituara ose institucionet më të larta rreth programeve të tyre, për të zbatuar rekomandimet e bëra sipas paragrafëve të mësipërm, brenda 20 ditëve nga data e marrjes së kërkesës”;*
- neni 30 pika 1 dhe 2, ku cilësohet: *“Në raportet e tij, Kontrolli i Lartë i Shtetit jep rekomandime në përputhje me nenin 15 të këtij ligji. Subjekti i audituar, brenda 6 muajve nga data e njoftimit të raportit të auditimit, i raporton Kontrollit të Lartë të Shtetit mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve të dhëna”.*

Kriteri:

Ligji 154/2014 “Për organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, germa (j) dhe neni 30 “Rekomandimet e KLSH-së dhe ecuria e zbatimit”, pika 1 dhe 2.

Manuali i Ndjekjes dhe Zbatimit të Rekomandimeve, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 67, datë 23.06.2020.

Shkaku: Mosveprim në afatin e duhur, nga ana e titullarit.

Ndikimi/pasoja: Ka ndikim në shqyrtimin dhe zbatimin e rekomandimeve në afatin e duhur nga strukturat përgjegjëse.

Rëndësia: E ulët

Rekomandimi 1: Titullari i ISSH, të marrë masa për respektimin e afateve të raportimit në KLSH, mbi hartimin e plan veprimit mbi zbatimin e rekomandimeve, brenda afatit 20 ditor dhe raportimin e nivelit të zbatimit të tyre brenda afatit 6 mujor, nga njohja me Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Nga grupi i auditimit u verifikua realizimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm dhe nga shqyrtimi i plan veprimit, përgjigjeve të subjektit në lidhje me masat e marra, dokumentacionit përkatës, ka rezultuar se niveli i pranimit është në masën 100 % dhe i realizimit në masën 54 %.

Tabela nr. II.2.1.1 “Statusi i zbatimit të rekomandimeve”

Lloji i masave	Masa të dhëna (numër)	Statusi i zbatimit të rekomandimeve				Pranuara
		Zbatuar plotësisht	Zbatuar Pjesërisht	Në proces Zbatimi	Pa zbatuara	
Masa organizative	12	6	2	4	-	12
Masa Shperblim Dëmi	1	1			-	1
Totali	13	7	2	4	-	13

Burimi i të dhënave ISSH, përpunoi Grupi i Auditimit të KLSH

Në mënyrë të detajuar rekomandimet e pazbatuara, zbatuar pjesërisht dhe në proces zbatimi, paraqitet si më poshtë:

A. Masa organizative

Rekomandimi 2.1: Instituti i Sigurimeve Shoqërore të mundësojë rritjen e të ardhurave e numrin e kontribuesve, uljen e deficitit të skemës së pensioneve, zvogëlimin e subvencionit të buxheti shtetit për skemën e pensioneve dhe përmirësimin e raportit kontribute me prodhimin e brendshëm bruto (PBB).

Nga auditimi ka rezultuar:

Me shkresën nr. 259 prot., datë 13.01.2022, Drejtoria e Kontributeve në ISSH, i është drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, si dhe për dijeni Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural “Lidhur me sigurimin shoqëror të fermerëve që aplikojnë për të përfituar nga fondi i programit për bujqësinë dhe zhvillimin rural”. Me shkresën nr. 3112 prot., datë 04.05.2022, Drejtoria e Kontributeve i është drejtuar INSTAT ku kërkohen të dhëna për evidentimin e popullsinë rurale. Me shkresën nr. 4860 prot., datë 08.07.2022, është miratuar nga Titullari i Institucioni, Program pune për realizimin e kontrolleve dhe monitorimit të punës pranë DRSSH-ve. Në datë 20.09.2022, është kryer trajnimi me specialistët e degëve të Kontributeve në DRSSH me tematikë “Rritja profesionale dhe përmirësimi i treguesve me fokus rritjen e të ardhurave dhe numrin e kontribuesve në skemën e të vetë punësuarve në bujqësi dhe sigurimit vullnetar.” Me shkresën nr. 7570 prot., datë 10.11.2022 drejtuar Ministrisë së Brendshme, është shprehur problematika e lëshimit të vërtetimeve nga organet e pushtetit vendor për të vetë punësuarit në bujqësi.

Statusi: Në proces zbatimi.

Rekomandimi 2.2: Instituti i Sigurimeve Shoqërore t'i bëjë prezent dhe të kërkojë që Ministria e Financave dhe Ekonomisë të ndërhyjë në zgjidhjen problematikave të mbartura në marrëdhëniet e saj me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për diferencat e kontributeve të derdhura nga subjektet privatë dhe shtetërorë për sigurimet shoqërore të cilat konstatohen në 103 mijë subjekte-debitorë, me vlerë rreth 15.8 miliard detyrime të prapambetura.

Nga auditimi ka rezultuar:

Drejtoria e Kontributeve në ISSH, i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe për dijeni, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 3727 prot., datë 30.05.2022, "Mbi subjektet me detyrime të prapambetura në përgjegjësi të organeve tatimore", duke shprehur ecurinë e problematikave të konstatuara që burojnë nga mos pagesat e kontributeve të sigurimeve shoqërore nga ana e subjekteve aktive, si dhe të vlerësojnë shqetësimin e krijuar nga rritja me ritme të larta e numrit të subjekteve me detyrime të prapambetura.

Me shkresën nr. 5891 prot., datë 26.08.2022, "Për problematikën në vazhdimësi në lidhje me rritjen e numrit të subjekteve me detyrime të prapambetura të kontributeve të sigurimeve shoqërore", Drejtoria e Kontributeve i është drejtuar përsëri Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe për dijeni, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë duke i dhënë informacion dhe bërë një panoramë më të detajuar situatës shqetësuese për rritje me ritme të larta të numrit të subjekteve me detyrime të prapambetura, si dhe vlera të larta të këtyre detyrimeve që mbartin këto subjekte.

Statusi: Zbatuar pjesërisht.

Rekomandimi 3.1: Drejtori i Përgjithshëm në bashkëpunim me Njësinë e Inspektimit të Përfitimeve, të hartojnë plan masash me afate, për të mundësuar certifikimin e 980 dosjesh përfitimesh të cilat kanë rezultuar me efekte debitorë dhe kreditorë, si dhe të marrë masa për inspektimin dhe certifikimin e të gjitha dosjeve të përfituesve brenda afatit 3-vjeçar.

Nga auditimi ka rezultuar:

Drejtoria e Inspektimit të Përfitimeve në procesin e certifikimit të dosjeve, gjatë kontrolleve të kryera për vitin 2021, si dhe rezultatet e gjetjeve të konstatuara, nga sektori i inspektimit të përfitimeve afatgjata, në 7 DRSSH dhe 1 DSSH ka certifikuar gjithsej, në përfundim të programit 40,927 dosje. Ndër to, të përfshira edhe 964 dosje të rishqyrtuara pas konstatimeve gjatë kontrollit. Ndërsa 13 dosje pas rishqyrtimit janë lënë pezull.

Me shkresën nr. 8022/4 prot., datë 25.08.2022 "Dërgohet Raporti Përfundimtar sipas Program Inspektimit nr. 8022 prot., datë 21.12.2021", Drejtoria e Inspektimit të Përfitimeve ka përcjellë në DRSSH Tiranë, Program Inspektimit e miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i ISSH, në të cilin janë përcaktuar afatet e konfirmimit dhe të evadimit të Raportit Përfundimtar.

- Programin nr. 1978/1 prot., datë 16.03.2022 për DRSSH Fier
- Programin nr. 4088 prot., datë 13.06.2022 për DRSSH Lezhë
- Programin nr. 5198 prot., datë 21.07.2022 për DRSSH Kukës
- Programin nr. 5199 prot., datë 21.07.2022 për DSSH Tropojë
- Programin nr. 5319 prot., datë 27.07.2022 për DRSSH Korçë, si dhe Programet e inspektimit në vazhdim sipas programit vjetor të rishikuar

Statusi: Në proces zbatimi.

Rekomandimi 4.1: Drejtori i Përgjithshëm, të plotësojë pozicionin në Drejtorinë e Auditit të Brendshëm, vakant në fushën e teknologjisë së informacionit, si dhe të marrë masa që të kryejë trajnime të punonjësve të kësaj drejtorie.

Nga auditimi ka rezultuar:

Nga Drejtori i Përgjithshëm nuk është plotësuar vendi vakant i audituesit. Me shkresën nr. 8037 prot., datë 01.12.2022, është miratuar nga titullari i institucionit, Program Trajnimi me temë "Trajnim për programin e burimeve njerëzore dhe për programet CMIS, PASH, Oracle",

me pjesëmarrjen e specialistëve të Drejtorisë së Auditit, Drejtorisë së Burimeve të Informacionit dhe të Drejtorisë së Administrimit të Përgjithshëm.

Statusi: Zbatuar pjesërisht.

Rekomandimi 8.1: Drejtori i Përgjithshëm të marrë masa për dërgimin dhe miratimin e “Rregullores së brendshme mbi organizimin dhe funksionimin e ISSH-së”, në përputhje me strukturën organizative aktuale, si dhe në bashkëpunim me Drejtorinë e Administrimit të sigurojë trajnimin dhe rishikimin e kohës dhe mënyrës së vlerësimit të duhur të punonjësve.

Nga auditimi ka rezultuar:

Me urdhrin nr. 4385 prot., datë 22.06.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të ISSH, është urdhëruar në funksion të zbatimit të dixhitalizimit të procesit së të dhënave të ISSH dhe të zbatimit të vendimit për mbylljen e sporteve, si dhe ofrimin e shërbimeve online, ngritja e grupit të punës për ndryshimin e strukturave organizative të Drejtorisë së Përgjithshme të ISSH, DRSSH, DSSH dhe DAQ. Si rrjedhojë, Rregullorja e Brendshme me organizimin dhe funksionimin e ISSH është në proces rishikimi.

Titullari i ISSH, ka nxjerrë udhëzimin nr. 1, datë 07.02.2023 “Për vlerësimin e performancës të punonjësve të ISSH”. Në zbatim të udhëzimit ka ndryshuar forma dhe mënyra e vlerësimit e punonjësve, një herë në vit, si dhe sipas një formulari tip.

Statusi: Në proces zbatimi.

Rekomandimi 10.1: Këshilli Administrativ të shqyrtojë dhe të analizojë në veçanti zbatimin e rekomandimeve të dhëna në auditimin e mëparshëm, duke nxjerrë përgjegjësitë për moszbatimin dhe/ose mosrealizimin në afat, si dhe të marrë masa që të sigurojë zbatimin e plotë të tyre.

Nga auditimi ka rezultuar:

Me urdhrin nr. 4385 prot., datë 22.06.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të ISSH, është urdhëruar ngritja e grupit të punës për ndryshimin e strukturave organizative të Drejtorisë së Përgjithshme të ISSH, DRSSH, DSSH dhe DAQ. Rregullorja e përshkrimeve të punës, e cila është miratuar me shkresë nr. 2115 prot., datë 15.03.2018, është në proces rishikimi duke u përshtatur sipas funksionit dhe përgjegjësi të reja të krijuara, kryesisht shërbimet online. Rregullorja e Brendshme për organizimin dhe funksionimin e ISSH është në proces rishikimi.

Statusi: Në proces zbatimi.

Titulli i gjetjes 2: Mbi nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Situata: Nga KLSH në auditimin e mëparshëm janë lënë për zbatim 13 rekomandime, nga të cilat janë pranuar të gjitha, si dhe janë zbatuar 7 rekomandime, janë në proces zbatimi 4 rekomandime dhe janë zbatuar pjesërisht 2 rekomandime.

- Nga 12 “Masa organizative” janë zbatuar 6, janë në proces zbatimi Rekomandimi nr. 2.1; Rekomandimi nr. 3.1; Rekomandimi nr. 8.1 dhe Rekomandimi nr. 10.1 si dhe është zbatuar pjesërisht Rekomandimi nr. 2.2 dhe 4.1.
- Nga auditimi i mëparshëm është lënë një masë shpërblim dëmi e cila rezulton të jetë zbatuar.

Nga auditimi ka rezultuar se nga strukturat e caktuara në programin e masave të miratuar nga titullari i ISSH, nr. 5009/2 prot., datë 23.12.2022, për zbatimin e rekomandimeve, nuk është vepruar në kohë dhe nuk janë marrë masat e duhura dhe për rrjedhojë një pjesë e tyre rezultojnë në proces zbatimi ose të realizuara pjesërisht.

Kriteri:	<ul style="list-style-type: none"> - Plan veprimi i Titullarit mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH; - Manuali i Ndjekjes dhe Zbatimit të Rekomandimeve, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 67, datë 23.06.2020.
Ndikimi/Efekti:	Mos zbatimi në kohë i rekomandimeve ndikon në mos korigjimin e mangësive në kohën e duhur dhe arritjen e objektivave.
Shkaku:	Mos vlerësim dhe mos veprim nga ana e strukturave të ngarkuara me zbatimin e rekomandimeve.
Rëndësia:	E ulët
Rekomandimi:	Nga ana e Titullarit të ISSH, të nxirren përgjegjësitë për mos vlerësim në masën e duhur, nga ana e strukturave të ngarkuara me zbatimin e rekomandimeve, si dhe të merren masa për zbatimin e 6 (gjashtë) rekomandimeve, të cilat kanë rezultuar të jenë të zbatuara pjesërisht, ose në proces zbatimi, si dhe të raportohet në KLSH, për nivelin e zbatimit të tyre.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, referuar shkresës “Observacione mbi PRA, për auditimin e ushtruar nga KLSH” protokolluar në KLSH me nr. 13/5, datë 26.06.2023, në lidhje me auditimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e mëparshëm, nuk janë paraqitur observacione.

II.2.2. Auditimi i administrimit të sigurimeve shoqërore dhe politikave të pensioneve, në drejtëm të mbulimit të popullsisë me elementë të sigurimeve shoqërore.

Për auditimin e të cilave u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Të ardhurat totale të ISSH (skema e detyrueshme dhe skemat suplementare);
- Shpenzimet totale të ISSH;
- Financimi nga Buxheti i Shtetit;
- Marrëveshjet e bashkëpunimit të ISSH me institucionet homologe përgjatë vitit 2022;
- Shpenzimet për programe të veçanta shtetërore;
- Investimi i Fondit Rezervë përgjatë 2022.

Nga auditimi ka rezultuar:

Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë, sipas nenit 71 të Ligjit Nr. 7703, datë 11.05.1993, “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar drejtohen dhe administrohen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore (ISSH, këtu e në vijim).

Misioni i ISSH, i përcaktuar në Rregulloren e miratuar më 15.03.2018, “Për Organizimin dhe Funksonimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore” është: “*Administrimi i sigurimeve shoqërore në përgjithësi dhe i politikave të pensioneve në veçanti, vendosja e personave të siguruar dhe përmirësimi i shërbimit ndaj tyre në qendër të veprimtarisë së këtij institucioni, mbulimi i popullsisë me elementë të sigurimeve shoqërore në çdo vend dhe kohë kur lind kjo e drejtë, rritja e numrit të kontribuuesve dhe grumbullimi i të ardhurave nga kontributet e fermerëve dhe të siguruarit vullnetar, përmirësimi i efikasitetit në menaxhimin e fondeve të sigurimeve shoqërore, i fondeve përkohësisht të lira dhe fondit rezervë*”.

Për të verifikuar administrimin e sigurimeve shoqërore dhe politikave të pensioneve, nga grupi i auditimit u verifikua si është realizuar objektivi i ISSH për të garantuar mbulimin sa më të plotë të popullsisë së vendit me elementë të sigurimeve shoqërore të detyrueshme. Sipas Rregullosës të miratuar, më 15.03.2018, “Për Organizimin dhe Funksonimin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore”, detyrat për realizimin e këtij objektivi janë:

- Zbatimi të një sistemi sigurimesh shoqërore, që i përgjigjet më mirë stadi të arritur në zhvillimin ekonomik e social të vendit;
- Përsosja e menaxhimit të skemës së sigurimeve shoqërore, sidomos të mbledhja e të ardhurave kontributive dhe shpërndarja sa më e drejtë e tyre në formën e përfitimeve, aty dhe atëherë kur lind e drejta;
- Përmirësimi i qëndrueshmërisë financiare të skemës së sigurimeve shoqërore, duke synuar rritjen graduale por më të shpejtë të kontributeve në krahasim me rritjen e përfitimeve si dhe duke minimizuar subvencionet buxhetore.

Nga grupi i auditimit janë verifikuar të gjithë elementët e mësipërm, nga ku rezultoi:

Politikat e pensioneve në drejtim të mbulimit të popullsisë me elementë të sigurimeve shoqërore.

Në kuadër të strategjive kombëtare në fushën e mbulimit social ISSH duhet në mënyrë të vazhdueshme të sigurojë ruajtjen dhe përmirësimin e standardeve të jetesës për pensionistët dhe të moshuarit nëpërmjet:

- Zbatimit të kuadrit rregullator për fondet e pensioneve, sipas indeksit të çmimeve të konsumit;
- Mbulimit me pensione sociale të personave mbi 70 vjeç, që nuk kanë mundur të kontribuojnë në skemën e pensioneve;
- Mbrojtjes së shtetasve shqiptarë dhe personave pa shtetësi, ish-shtetas shqiptarë, që janë jashtë shtetit, në përputhje me konventat, marrëveshjet dy palëshe dhe Rregulloren e Institutit të Sigurimeve Shoqërore;
- Zbatimit të kuadrit rregullator për zhvillimin e kompensimeve në varësi të ndryshimeve të çmimit të energjisë elektrike për pensionistët dhe kompensime të tjera të rregulluara me anë të VKM-ve.

Në lidhje me veprimtarinë e ISSH, në drejtim të zbatimit të pikave të mësipërme, në kuadër të realizimit të strategjisë Kombëtare në fushën e mbulimit social, përgjatë vitit 2022 ka rezultuar se:

Gjatë vitit 2022, të ardhurat e pensioneve janë indeksuar dy herë, në përgjigje të ndryshimit të indeksit të çmimit të shportës së mallrave dhe të shërbimeve (CPI) në rang vendi. Ndryshimet e të ardhurave, për të kompensuar nivelin minimal të pensioneve janë bërë me anë të VKM-ve të paraqitura më poshtë:

- Me anë të VKM nr.188, datë 30.03.2022 është bërë rritja e përfitimeve në masën 3.3% prej datës 01.04.2022 dhe,
- Me anë të VKM nr.605, datë 14.09.2022 është bërë rritja e përfitimeve në masën 6% duke filluar nga 01.10.2022.

Mbulimi me pension dhe me kompensime, të kategorive të veçanta të përfituesve, nga ana e ISSH.

Skema e sigurimeve shoqërore në Republikën e Shqipërisë ka karakter kontributiv, ku personat për të përfituar duhet të kenë kontribuar në skemën e sigurimeve shoqërore për periudha të caktuara kohe, siç parashikohen në Ligjin 7703/1993, por gjithashtu ISSH mbulon me përfitime sociale, jo vetëm ata individë që kanë kontribuar dhe kanë plotësuar periudhat e kontribuimit, por dhe individë, të cilët janë mbi moshën 70 vjeç e nuk plotësojnë kushtet për asnjë pension nga skema e detyrueshme apo kur të ardhurat e tyre janë më të pakta se sa pensioni social (kjo dhe në zbatim të Udhëzuesit për Koordinimin e Sigurimeve Shoqërore në Këshillin e Evropës, ku përcaktohet se personat duhet të mbulohen nga skema sociale për t'u siguruar mbrojtje nga një ose më shumë se një nga nëntë risqet sociale të parashikuara në Konventën nr.102 "Për sigurimet shoqërore", të Organizatës Ndërkombëtare të Punës), në këtë drejtim dhe Ligji

nr.7703/1993, i ndryshuar parashikon në nenin 5/1 të tij, përkufizimin e pensionit social, kush mund ta përfitojë dhe masën e tij. Për vitin 2022 rezulton se kanë përfituar pensione sociale 2,278 individë, ku shuma totale e të ardhurave të shpërndara për këtë kategori ka qenë 183 milionë lekë.

Skema e sigurimeve shoqërore, në përgjithësi, përfshirë dhe skemën në RSH, kryesisht kanë karakter territorial, rregullohen nga legjislacioni kombëtar, në rastin e RSH, nga Ligji nr.7703/1993, i ndryshuar, i cili përcakton shumën e përfitimeve, kushtet e dhënies së pensioneve dhe kohëzgjatja e derdhjes së kontributeve. Aspekti i territorialitetit të kufizuar, privon nga e drejta për të përfituar individët, që banojnë përtej territorit të vendit, por në lidhje me këto kategori, neni 7 i Ligjit nr.7703/1993, të ndryshuar përcakton se: *“Sigurimet shoqërore iu japin mbrojtje edhe:*

- *shtetasve shqiptarë dhe personave pa shtetësi, ish-shtetas shqiptarë, që janë jashtë shtetit, në përputhje me konventat, marrëveshjet dy palëshe dhe Rregulloren e Institutit të Sigurimeve Shoqërore;*
- *shtetasve të huaj dhe personave pa shtetësi, që punojnë në Shqipëri.”*

Në zbatim të nenit të sipërcituar dhe të pikës 1 dhe 2, të nenit 48 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, ku në pikën 1 përcaktohet vendosja e rregullave për bashkërendimin e sistemeve të sigurimeve shoqërore për punonjësit me nënshtetësi shqiptare, të punësuar ligjërisht në territorin e një Shteti Anëtar dhe për pjesëtarët e familjeve të tyre që janë ligjërisht rezidentë aty, dhe në pikën 2 është përcaktohet se: *“Shqipëria u akordon punonjësve të cilët janë shtetas të një Shteti Anëtar dhe ligjërisht të punësuar në territorin e saj, dhe pjesëtarëve të familjeve të tyre rezidentë të ligjshëm aty, të njëjtin trajtim siç specifikohet në pikën e dytë dhe të tretë të paragrafit 1...”* rezulton se nga ISSH gjatë vitit 2022 janë lidhur dhe kanë hyrë në fuqi tri marrëveshje bashkëpunimi (marrëveshja në fushën e Sigurimeve shoqërore me Republikën e Kosovës; Marrëveshja në fushën e mbrojtjes me Kanadanë dhe Marrëveshja me Konfederatën Zvicerane) si dhe janë zhvilluar 4 negociata për marrëveshje.

Marrëveshjet ndërkombëtare midis Republikës së Shqipërisë (RSH) dhe shteteve të tjera në fushën e mbrojtjes shoqërore u vinë në ndihmë dhe mbështetje qytetarëve shqiptarë, që kanë vite që jetojnë dhe punojnë në këto vende, por gjithashtu kanë edhe vite pune të realizuara në Republikën e Shqipërisë. Me nënshkrimin e këtyre marrëveshjeve bilaterale është bërë koordinimi i skemave të sigurimeve shoqërore, në mënyrë që shtetasit, subjekt i legjislacioneve të të dy vendeve të mos humbasin të drejtat gjatë zhvendosjes nga Shqipëria në vendin tjetër. Për vitin 2022 rezulton se, marrëveshjet e lidhura nuk kanë nisur ende të kenë efekt.(asnjë përfitues prej tyre).

ISSH, gjatë vitit 202 u ka siguruar mbrojtje shtresave në nevojë, duke kryer kompensime sipas VKM-ve përkatëse në lidhje me kompensimet për energjinë elektrike, për të ardhura, për ish të persekutuarit, invalidët e luftës, etj. në shumën totale 21,622 milionë lekë, ose 92.7% kundrejt atyre të planifikuara, ndërsa krahasuar me një vit më parë kjo kategori shpenzimesh është rritur me 71.5%, kjo për shkak të rritjes së shumës së kompensimeve, në zbatim të akteve nënligjore të nxjerra në 2022, rritjes së numrit të përfituesve, etj. Shpenzimet për programe të veçanta për vitin 2022 në mënyrë të detajuar paraqiten si në tabelën më poshtë:

Tabela nr.1 “Shpenzimet për kompensime të pensionisteve përgjatë vitit 2022”

Ref. E llogarisë	Përshkrimi	Plani 22	Fakt 22	Fakt 21	Në milionë lekë	
					% real. Fakt/plan 22	%Δ 22-21
	Shpenzime për programe të veçanta shtetërore	23,313	21,622	12,61	92.7%	71.5%
6.060.008	Kompensim suplementar për çmimin për pensionistet	5,170	5	5	89.7%	0.16%

60.600.081	Kompensim te ardhura për pensionet e shtetit	17,288	16	7	93.7%	126.00%
60.600.081	Kompensim te ardhura për pensionet e fshatit	395	425	454	107.6%	-6.44%
6.060.009	Pensione te veçanta shtetërore (Pensione te posaçme)	88	94	76	107.0%	23.23%
6.060.010	Kompensim suplementar për ish te persekutuuarit	198	183	180	92.0%	0.97%
6.060.011	Kompensim për veteranët dhe invalidët e luftës	79	50	67	63.4%	-25.91%
60.600.121	Shpërblim mujor shtesë mbi pensionin e invaliditetit	94	-		0.0%	-
60.600.122	Rimbursim i shpenz të invalidëve për karburant	-	33	32	n/a	4.98%

Burimi i të dhënave ISSH, përpunoi Grupi i auditimit KLSH

Nga tabela më sipër rezulton se, për vitin 2022 nuk janë parashikuar shpenzime në lidhje me rimbursimin e karburantit për invalidët, por në fakt ky zë ka rezultuar në masën 33,697 mijë lekë, kjo sepse me anë VKM nr. 885/2022 u bë rimbursimi i karburantit për kategori dhe masa e rimbursimit të tij u rrit nga 7,000 lekë në 10,000 lekë. Në të gjitha rastet e tjera mosrealizimet e planeve apo tejkallimet kanë ardhur si rezultat i rregullimeve të bëra përgjatë vitit 2022 me anë të VKM-ve të veçanta, të cilat kanë ofruar mbështetje në lidhje programet e posaçme të paraqitura në tabelën më sipër.

Veprimtaria e ISSH-së në drejtim të mbledhjes së të ardhurave nga kontributet e të vetpunësuarve në bujqësi dhe nga të siguruarit vullnetarë.

Misioni i ISSH-së, gjithashtu përfshin dhe; *“rritjen e numrit të kontribuesve dhe grumbullimi i të ardhurave nga kontributet e fermerëve dhe të siguruarit vullnetar”*.

Në lidhje me këto tregues, gjatë vitit 2022 ka rezultuar:

Grumbullimi i të ardhurave nga kontributet e fermerëve dhe të siguruarit vullnetar:

Të ardhurat kontributive mbledhen nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe vetë ISSH mbledh të ardhura nga kontributet e fermerëve (vetëpunësuar në bujqësi) dhe të të siguruarve vullnetar. Për vitin 2022, kontributet e mbledhura nga ISSH, të planifikuar dhe faktikë paraqiten si më poshtë:

Tabela nr.2 “Të ardhurat sipas llojeve të kontributit, të mbledhura nga ISSH”

Në mijë lekë

Përshkrimi	2022			2021			%Δ 22-21 Fakt
	Plan	Fakt	realiz	Plan	Fakt	realiz	
Të vetë punësuarit në Bujqësi							
Të ardhura nga kontributet e sigurimeve shoqërore	1,725	2,365	137%	1,725	2,185	127%	8.2%
Numri i kontribuesve	48,104	62,070	129%	48,126	58,091	121%	6.8%
Sigurimi Vullnetar							
Të ardhura nga kontributet e sigurimeve shoqërore	450	573	127%	450	501	111%	14.5%
Numri i kontribuesve	5,788	6,904	119%	5,788	6,437	111%	7.3%

Burimi i të dhënave ISSH, përpunoi Grupi i auditimit KLSH

Përgjatë vitit 2022 rezulton se kontributet e sigurimeve të mbledhura nga ISSH kanë tejkalluar planin me 37% për të vetë punësuarit në bujqësi dhe 27% për kontributet e sigurimeve vullnetare, ndërsa në krahasim me një vit më parë kontributet e sigurimeve shoqërore për të vetë punësuarit në bujqësi janë rritur me 8.2%, ndërsa për të siguruarit vullnetarë me 14.5%. Numri i kontribuesve për secilën kategori paraqitet në rritje, në krahasim me një vit më parë, konkretisht për vitin 2022 rezulton se, për të vetë punësuarit në bujqësi ka pasur një rritje me 6.8% krahasuar me 2021 dhe për kategorinë të siguruar vullnetarë rritja e numrit të kontribuesve krahasuar me një vit më parë ka qenë 7.3%. Rritja e kontributeve nga këto kategori ka ardhur dhe si rezultat i rritjes së pagës minimale, e cila shërben si bazë për llogaritjen e masës së këtyre kontributeve dhe numrit të kontribuesve. Në analizat e bëra nga ISSH në lidhje me këta dy tregues rezulton se, pavarësisht rritjes në numrin dhe shumën e kontributeve për të vetë punësuarit në bujqësi, situata nuk paraqitet pozitive, pasi vihet re

mosinteresim nga grup moshat e reja për të punuar pranë ekonomive të tyre fermerë dhe punësimi i përhershëm apo sezonal i tyre në sektorë të tjerë, po ashtu moshat mesatare e lartë e fermerëve dhe mungesa e pasardhësve të gatshëm për të vazhduar punën në bujqësi paraqet një kërcënim për fuqinë punëtore në të ardhmen e afërt. Varfëria në zonat rurale, kryesisht ato të thella malore, ose larg zonave urbane, nuk u mundëson kapacitetin financiar kësaj kategorie për të paguar sigurimet shoqërore. Në lidhje me këtë skemë është krijuar mentaliteti, si “skemë vullnetare” dhe jo si “skemë e detyrueshme”, ç’ka bërë që trendi i rritjes së treguesve në lidhje me të vetë punësuarit në bujqësi të bjerë.

Nga grupi i auditimit, për kontributet e mësipërme, që mblihen nga ISSH, është analizuar si ka ndikuar në shumën e kontributeve ndryshimi i pagës minimale dhe rritja e numrit të kontribuesve, konkretisht gjatë vitit 2022, niveli i pagës minimale ka ndryshuar, në rritje si më poshtë:

- për periudhën janar-mars 2022 ka qenë 30,000 lekë;
- prill-gusht 2022: 32,000 lekë dhe,
- nga 1 shtatori e në vijim 34,000 lekë.

Rritja e pagës minimale krahasuar me një vit më parë ka qenë 13% (krahasimi është bërë me pagën e fundit të vitit 2022), ndërsa në 2021 rritja e pagës minimale ka qenë 15%, po ashtu gjatë 2022 numri i kontribuesve, ka pësuar një rritje me 1.3% krahasuar me 2021, të dy këta tregues ndikojnë në masën e të ardhurave të ISSH-së nga kontributet e drejtpërdrejta të cilat krahasuar me një vit më parë janë rritur me 11.4%. Për të parë ndikimin e këtyre treguesve në të ardhurat kontributive është marrë në analizë masa mujore e kontributit për të vetë punësuarit dhe për sigurimin vullnetar të cilat, kanë ndikim të drejtpërdrejtë nga ndryshimi i pagës minimale, nga ku konstatohet se masa e kontributit si rezultat i rritjes së pagës minimale është rritur me 13.3% krahasuar me një vit më parë për të dy kategoritë, për pasojë rritja e numrit të kontribuesve ka ndikuar më tepër në rritjen e totalit të të ardhurave të drejtpërdrejta nga kontributet, në mënyrë të detajuar treguesit e mësipërm paraqiten si në tabelën në vijim:

Tabela nr. 3 “Treguesit e pagës minimale, numër kontribuesish dhe të ardhura të drejtpërdrejta nga kontributet e drejtpërdrejta në ISSH për periudhën 2021-2022”

Përshkrimi	2022	2021	%Δ 22-21
Paga minimale mesatare (lekë)	34,000	30,000	13.3%
Nr. Kontribuesve (individë)	801,480	790,835	1.3%
Të ardhurat nga kontributet shoqërore të drejtpërdrejta (mil. lekë)	105,657	94,804	11.4%
Masa mujore e kontributit për të vetë punësuarit	7,820	6,900	13.3%
Masa e kontributit për sigurimin vullnetar	7,344	6,480	13.3%

Burimi i të dhënave ISSH, përpunoi Grupi i auditimit KLSH

Nga tabela më sipër rezulton, se nga rritja e pagës minimale është rritur masa e kontributit njëjloj për të vetë punësuarit në bujqësi dhe për të siguruarit vullnetarë nga 6,900 lekë në 7,820 lekë, ose 13.3%. Të ardhurat e drejtpërdrejta të mbledhura nga ISSH për këto dy kategori, për vitin 2022 janë rritur me 11.4%, rritje e cila i atribuohet më shumë rritjes së numrit të kontribuesve, se sa pagës rritjes së pagës minimale.

Administrimi i skemës së pensioneve përgjatë vitit 2022, është analizuar bazuar në një set treguesish, të cilat paraqesin situatën e sigurimeve shoqërore përgjatë vitit 2022, të cilët paraqiten si më poshtë:

Tabela nr. 4 “Treguesit e situatës së sigurimeve shoqërore për vitin 2022”

Përshkrimi	2022	2021	%Δ 22-21
Nr. Pensionistëve(raste)	686,923	673,813	1.9%
Pensione te reja gjatë vitit(raste)	29,664	31,625	-6.2%
Pensione te mbyllura përgjatë vitit (raste)	15,309	19,323	-20.8%

Masa mesatare e pensioneve të reja (lekë)	15,125	14,652	3.2%
Shpenzimet për përfitime	131,864	126,126	4.5%
Koha mesatare e përpunim të kërkesës për pension(ditë)	25.2	27.5	-8.4%
% e pensioneve të lidhura para afatit ndaj totalit	95.80%	92.36	3.7%
Mosha mesatare e daljes në pension(vjeç)	63	63	0.0%
Koha mesatare e gëzimit të pension (vite)	22.9	22.4	2.2%
Norma e varësisë së sistemit	1.17	1.15	1.7%

Burimi i të dhënave ISSH, përpunoi Grupi i auditimit KLSH

Referuar të dhënave të tabelës së sipërme rezulton se:

- Numri i pensioneve përgjatë vitit 2022 ka pësuar një rritje me 1.9% krahasuar me një vit më parë, pensionet e reja (që kanë plotësuar kushtet për tu lidhur në vitin korrent) janë ulur me 6.2% dhe ato të mbyllurat janë ulur me 20.8% krahasuar me vitin 2021. Masa mesatare e pensioneve të reja është rritur me 3.2% krahasuar me 2021 kjo si rezultat i rritjes së periudhës kontributive në lidhje me këtë kategori dhe kontributeve të derdhura që sjellin një bazë të vlerësuar më të lartë, por dhe pensionet ekzistuese janë rritur si rezultat i indeksimit ç' ka sjellë shpenzime totale për përfitime më të larta në masën 4.5%, krahasuar me një vit më parë.
- ISSH përgjatë vitit 2022, ka përpunuar më shpejt kërkesat për pension, koha mesatare e përpunimit të kërkesës për pension nga 27.5 ditë që ishte në vitin 2021 ka rezultuar në 25.2 ditë, gjithashtu përqindja e pensioneve të lidhura para afatit, ndaj totalit të pensioneve të lidhura përgjatë vitit është rritur me 3.7%, ç' ka tregon se kërkesat për pension janë administruar më mirë përgjatë vitit 2022.
- Mosha mesatare e daljes nuk ka ndryshuar krahasuar me një vit më parë, koha mesatare e gëzimit të pensionit është rritur me 2.2%, kjo për shkak të rritjes së jetëgjatësisë mesatare (sipas INSTAT, mosha mesatare:74,4 vjeç për meshkujt dhe 78,7 vjeç për femrat) ç' ka nënkupton më shumë shpenzime për përfitime.
- Norma e varësisë së sistemit (numër mesatar i kontribuesve/numër mesatar i pensioneve) është rritur me 1.7% krahasuar me vitin 2021. Në 2022 për një pension nevojiten 1.17 kontribues, nga 1.15 që ishte më parë, kjo për shkak se rritja e numrit të përfituesve (1.9%) është më e lartë se rritja e numrit të kontribuesve (1.3%).
- Në nivel sistemi ISSH përgjatë vitit 2022, ka realizuar të ardhura nga kontributet në masën 105,657 milionë lekë ose 11% më shumë se një vit më parë, të ardhurat nga transferta e buxhetit të shtetit ka qenë 62,872 milionë lekë ose 9% më shumë se viti 2021, shpenzimet totale të ISSH, që përfshijnë shpenzime për përfitime, për paga dhe të tjera administrative të ISSH-së kanë rezultuar në masën 163,037 milionë lekë ose 10% më shumë se një vit më parë, ndërsa rezultati fiskal i vitit 2022 ka rezultuar 5,492 milionë lekë ose 18% më shumë se një vit më parë, në terma të treguesve financiarë situata e sigurimeve shoqërore paraqitet pozitive dhe me tregues financiarë në rritje. Në mënyrë të detajuar treguesit financiarë të performancës së ISSH-së paraqiten si më poshtë:

Tabela nr. 5 “Treguesit e situatës së sigurimeve shoqërore për vitin 2022”

Përshkrimi	2022	2021	%Δ 22-21
Të ardhurat nga kontributet e drejtpërdrejta (milionë lekë)	105,657	94,804	11%
Të ardhurat nga transferta e buxhetit të shtetit (milionë lekë)	62,872	57,894	9%
Shpenzimet e sigurimeve shoqërore (milionë lekë)	163,037	148,030	10%
Rezultati fiskal (milionë lekë)	5,492	4,667	18%

Burimi i të dhënave ISSH, përpunoi Grupi i auditimit KLSH

Sa më sipër arrihet në konkluzion:

ISSH përgjatë vitit 2022 ka vepruar në drejtim të përmbushjes së objektivave të përcaktuara në statutin e saj, është përmirësuar në drejtim të administrimit të kërkesave për pension dhe në

drejtim të treguesve financiare korrent, por nga analizimi i treguesve të sistemit të sigurimeve shoqërore rezultojnë se shpenzimet në rritje përgjatë vitit 2022, pritet të jenë të larta dhe në vijim për shkak të trendit rritës të: numrit të pensioneve, kohës mesatare të gëzimit të pensionit dhe treguesit të varësisë së sistemit. Këta tregues ndikohen dhe nga faktorët demografikë të popullsisë së Republikës së Shqipërisë, por nga ana e ISSH në kuadër të administrimit të sigurimeve shoqërore duhet të intensifikohen përpjekjet për të marrë masa për t'iu përgjigjur në kohë këtyre sfidave. Në drejtim të qëndrueshmërisë financiare të skemës së sigurimeve shoqërore situata nuk paraqitet pozitive, pasi për vitin 2022 nuk ka pasur rritje graduale, por më të shpejtë të kontributeve (siç përcaktohet në objektivat e paraqitura në Statutin e ISSH-së) në krahasim me rritjen e përfitimeve dhe norma e varësisë së sistemit është rritur me 2.7% krahasuar me një vit më parë.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, referuar shkresës “Observacione mbi PRA, për auditimin e ushtruar nga KLSH” protokolluar në KLSH me nr. 13/5, datë 26.06.2023, në lidhje me auditimin e administrimit të sigurimeve shoqërore dhe politikave të pensioneve, në drejtim të mbulimit të popullsisë me elemente të sigurimeve shoqërore, nuk janë paraqitur observacione.

II.2.3. Auditimi i planifikimit dhe realizimit të buxhetit të sigurimeve shoqërore, për vitin 2022.

Në zbatim të drejtimit të mësipërm u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Rakordimet me institucionet përkatëse;
- Pasqyrat financiare të ISSH-së;
- Raporte vjetore të ISSH-së;
- Raporte statistikore të ISSH-së dhe analiza statistikore;

Rezultati fiskal vjetor i ISSH për vitin 2022, sipas ISSH është si më poshtë:

Tabela nr. 3.1 “Të ardhura & shpenzime, plan/fakt 2022”

Nr.	Emërtimi	Gjithsej		Diferenca	Realizimi në %
		Plan	Fakt		
I	Te ardhurat	104,009,000	105,656,601	1,647,601	102
1	DPT te ardhura	101,514,000	102,034,645	520,645	100.5
2	ISSH_kontribute te tjera	-	46,250	46,250	
3	ISSH te ardhura	2,495,000	3,575,706	1,080,706	143.3
II	Financime nga buxheti	62,871,909	62,871,909	-	100.0
III	Totali te ardhurave (I+II)	166,880,909	168,528,510	1,647,601	102.1
	Shpenzimet				
I	Transferta për buxhetet familjare e individët	163,858,684	160,211,797	3,646,887	97.8
1	Shpenzime për përfitime	132,721,393	131,864,165	857,228	99.4
2	Shpenzime për programe te veçanta shtetërore	23,313,386	21,622,192	1,691,194	92.7
3	Shpenzime për programe e skema suplementare	7,823,905	6,725,441	1,098,464	86.0
II	Shpenzime administrative	3,022,290	2,824,916	197,374	93.5
	Totali (I+II)	166,880,974	163,036,713	3,844,261	97.7
	Rezultati fiskal		5,491,796		

Burimi i të dhënave ISSH, përpunoi Grupi i auditimit KLSH

Në mënyrë analitike të ardhurat dhe shpenzimet, plan dhe fakt miratuar me VKA nr. 4, datë 30.06.2023, protokolluar me nr. 5764/1, datë 30.06.2023, paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr. 3.2 “Të dhëna analitike të ardhura & shpenzime”

Në mijë lekë

TE ARDHURAT		Gjithsej		Diferenca	%
		Plan	Fakt		
	Gjithsej	104,009,070	105,656,512	1,647,422	101.6
A	DPT	101,514,070	102,034,556	520,486	100.5
1	Sigurim shoqëror i detyrueshëm	99,618,000	100,395,285	777,216	100.8
2	Suplementare	1,896,000	1,639,271	(256,729)	86.5
B	ISSH	2,495,000	3,621,956	1,126,956	145.2
	- Të vetëpunësuar bujqësi	1,725,000	2,364,956	639,956	137.1
	- Vullnetare	450,000	573,359	123,359	127.4
	- Kontribute nga burime të tjera		46,250	46,250	
	- Të ardhura tjera	320,000	637,391	317,391	199.2
C	Financime nga buxheti	62,871,909	62,871,909	0	100
	Totali te ardhurave (A+B+C)	166,880,979	168,528,421	1,647,422	
	SHPENZIMET	Plan	Fakt	Diferenca	%
A	Transferata për buxhetet familjare e individët (I+II+III)	163,858,684	160,211,797	(3,646,887)	97.8
I	Shpenzime për përfitime	132,721,393	131,864,165	(857,228)	99.4
1	Kompensim për paafësi të përkohshme për shkak të sëmundjes	538,261	589,436	51,175	109.5
2	Kompensim për leje lindje	4,475,929	4,444,795	(31,134)	99.3
3	Totali shpenzimeve për pensione	127,680,989	126,806,695	(874,294)	99.3
4	Kompensim për paafësi për shkak të dëmtimit në punë	26,213	23,239	(2,975)	88.7
II	Shpenzime për programe të veçanta shtetërore	23,313,386	21,622,192	(1,691,194)	92.7
III	Shpenzime për programe e skema suplementare	7,823,906	6,725,441	(1,098,465)	86.0
B	Shpenzime administrative	3,022,290	2,824,916	(197,374)	93.5
1	Paga, shpërblime, dhe shpenz. tjera personeli	1,105,572	1,075,597	(29,976)	97.3
2	Kontribute për sigurime shoqërore e shëndetësore	173,072	168,510	(4,562)	97.4
3	Mallra dhe shërbime të tjera	1,364,356	1,267,455	(96,901)	92.9
4	Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara	379,290	313,354	(65,936)	82.6
	Totali (A+B)	166,880,974	163,036,713	(3,844,261)	97.7
C	Rezultati fiskal (Fakt-Plan)		5,491,796		
D	Financimi i planifikuar dhe tërhequr	62,871,909			
E	Financimi i nevojshëm (D-C)		57,380,113		

Burimi i të dhënave ISSH, përpunoi Grupi i auditimit KLSH

Nga auditimi mbi saktësinë e treguesve të mësipërm ka rezultuar:

3.1. Planifikimi i të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe rakordimi i tyre:

Plani fillestar i të ardhurave dhe shpenzimeve nga kontributet dhe financimi nga buxheti i shtetit për ISSH është miratuar me Ligjin nr. 115/2021 “Mbi buxhetin e shtetit të vitit 2022”. Gjatë vitit 2022, janë bërë disa ndryshime me Akte Normative (AN) të Këshillit të Ministrave të cilat në raport me planin fillestar kanë efekt në rritjen e planit të të ardhurave nga kontributet me 7,994 milionë lekë, transfertës për indeksimin e pensioneve me 730 milionë lekë, si dhe uljes së transfertës nga buxheti i shtetit me 8,704 milionë lekë, paraqitur në Tabelën nr. 3.3.

Tabela nr. 3.3 “Plani i të ardhurave dhe shpenzimeve me ndryshime”

Në milionë lekë

Buxheti i Sigurimeve Shoqërore (Në milionë lekë)	Ligji nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022” Neni 4	AN nr. 3, datë 12.03.2022 Neni 4	AN nr. 12, datë 29.07.2022 Neni 4	AN nr. 17, datë 29.07.2022 Neni 4	AN nr. 19, datë 29.12.2022 Neni 2	Ndryshimet (Në vlerë) Plan fillest/ përfundimtar
I. Skema e sigurimit të detyrueshëm	147,203	147,203	147,203	147,203	147,203	0
Kontributet	94,119	94,119	98,899	100,629	102,113	7994
Transferimet nga buxheti i shtetit	47,194	46,484	41,704	39,974	38,490	(8704)
Transferata për indeksimin e pensioneve	2,390	3,100	3,100	3,100	3100	710
Bonusi i pensionistëve	3,500	3,500	3,500	3,500	3500	0
Shpenzimet gjithsej	147,203	147,203	147,203	147,203	147,203	0
II. Skema e sigurimit suplementar	7,732	7,732	7,732	7,732	7,732	0
Kontributet	1,896	1,896	1,896	1,896	1,896	0
Transferimet nga buxheti i shtetit	5,656	5,636	5,636	5,636	5,636	(20)
Transferata për indeksimin e pensioneve	180	200	200	200	200	20
Bonusi i pensionistëve						-

Shpenzime gjithsej	7,732	7,732	7,732	7,732	7,732	0
III. Totali (I+II)	154,935	154,935	154,935	154,935	154,935	0
Kontributet	96,015	96,015	100,795	102,525	104,009	7994
Transferimet nga buxheti i shtetit	52,850	52,120	47,340	45,610	44,126	(8704)
Transferta për indeksimin e pensioneve (VKM nr. 188, datë 30.03.2022)	2,570	3,300	3,300	3,300	3,300	730
Bonusi i pensionistëve (VKM nr. 752, datë 01.12.2022)	3,500	3,500	3,500	3,500	3,500	0
Totali sipas MFE	154,935	154,935	154,935	154,935	154,935	
Total alokime me VKM					11,946	
Nr. 654, datë 10.10.2022					2,060	
Nr. 159, datë 12.03.2022					3,884	
Nr. 897, datë 29.12.2022					5,605	
Nr. 753, datë 01.12.2022					397	
Të ardhura dhe Shpenzime gjithsej sipas ISSH					166,881	
Diferenca ISSH-MFE					11,946	

Burimi i të dhënave AN & VKM, përpunoi Grupi i auditimit KLSH

Ndryshimet e planit të të ardhurave tregojnë për një pritshmëri pozitive në realizimin e të ardhurave nga kontributet, e reflektuar në **uljen financimit nga buxheti shtetit në shumën 7,994 milionë lekë**, si diferencë midis pakësimit të transfertës së buxhetit për skemën e pensioneve dhe shtimit të transfertës për indeksimin e pensioneve (8,704-730=7,994).

Nga të dhënat e ISSH, rezulton se plani i të ardhurave dhe shpenzimeve për skemën e sigurimeve shoqërore është në shumën 166,881 milionë lekë. Në këtë plan janë përfshirë të ardhurat nga kontributet si dhe financimi nga buxheti i shtetit, akorduar me ligjin nr. 115/2021 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2021”, ndryshimet me AN si dhe me VKM për financimin e programeve të veçanta në shumën 11,946 milionë lekë, të paraqitur në tabelën nr. 3.4.

Tabela nr.3.4 “Financimet me VKM”

Në mijë lekë

Nr.	VKM	Shuma e financuar nga buxheti (VKM)
1	Nr. 159, datë 12.03.2022	3,884,000
2	Nr. 654, datë 10.10.2022	2,060,000
3	Nr. 753, datë 01.12.2022	396,642
4	Nr. 897, datë 29.12.2022	5,605,294
5	Totali	11,945,936

Burimi i të dhënave VKM, përpunoi Grupi i auditimit KLSH

Nga Grupi i auditimit u verifikua rakordimi i planit të të ardhurave dhe shpenzimeve të raportuara nga ISSH dhe të dhënave mbi planin e të ardhurave nga kontributet dhe planin e shpenzimeve, sipas Treguesve të Konsoliduar Fiskalë të Buxhetit të Shtetit, ku rezultoi se përsa i përket të ardhurave nga kontributet plani sipas ISSH dhe MFE është në shumën 104,009 milionë lekë, ndërsa plani për shpenzimet sipas ISSH është në shumën 166,881 milionë lekë dhe sipas MFE, është në shumën 154,935 milionë lekë, me një diferencë në shumën 11,946 milionë lekë.

Kjo diferencë i përket fondeve të alokuara ISSH, në zbatim të VKM-ve, të cituara në tabelën nr. 3.4, nga Ministra e Financave dhe Ekonomisë me shkresat si më poshtë:

- VKM nr. 159, datë 12.03.2022, në shumën 3,884 milionë lekë, sipas shkresës së MFE nr. 6419/1, datë 16.05.2022, protokolluar në ISSH me nr.3462, datë 17.05.2022, ku është prekur Fondi Rezervë i Këshillit të Ministrave;
- VKM nr. 654, datë 10.10.2022, në shumën 2,060 milionë lekë, sipas shkresës së MFE nr. 20385/4, datë 23.11.2022, protokolluar në ISSH me nr.7924, datë 24.11.2022, ku është prekur Fondi Rezervë i Këshillit të Ministrave;

- VKM nr. 753, datë 01.12.2022, në shumën 397 milionë lekë, sipas shkresës së MFE nr. 222241/3, datë 02.12.2022, protokolluar në ISSH me nr.8080/1, datë 12.12.2022, ku është prekur Fondi i Rezervë i Këshillit të Ministrave;
- VKM nr. 897, datë 29.12.2022, në shumën 5,605 milionë lekë, sipas shkresës së MFE nr. 24107/4, datë 25.01.2023, protokolluar në ISSH me nr.683, datë 26.01.2023, ku është dhënë mbështetje buxhetore nga Ministria e linjës (MFE);

Në lidhje me financimin nga buxheti i shtetit, ISSH ka rakorduar me Degën e Thesarit Tiranë për shumën 62,872 milionë lekë, sipas Akt rakordimit, ku në shkresën përcjellëse nr. 160, datë 09.01.2023 të Akt rakordimit është cilësuar: “Mbështetur në ligjin nr. 115/2021 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2022” dhe në vijim të Udhëzimit të MFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar bashkëlidhur shkresës dërgojmë akt rakordimin për financimin e Buxhetit të Shtetit sipas grupit, titullit, artikullit dhe llogarisë ekonomike për periudhën 12 mujore të vitit 2022”.

Konkluzion: Nga verifikimi i të dhënave mbi planin e të ardhurave dhe shpenzimeve për ISSH, në raport me treguesit fiskalë të konsoliduar të Buxhetit të Shtetit, të raportuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, është evidentuar se:

Nga krahasimi i planit përfundimtar të të ardhurave të ISSH (kontributet/të ardhura tatimore) dhe të dhënave të tabelës “Treguesit Fiskalë të Konsoliduar të Buxhetit të Shtetit”, Kapitulli II.3 “Të ardhurat nga fondet speciale”, rezulton se plani i të ardhurave është i rakorduar, për shumën 104,009 lekë.

Përsa i përket planit të shpenzimeve, **midis dy institucione ka një mos përputhje në shumën 11,946 milionë lekë.** Sipas të dhënave të ISSH dhe rakordimeve përkatëse, plani i shpenzimeve është në shumën 166,881 milionë lekë, ndërsa sipas MFE në “Treguesit Fiskalë të Konsoliduar të Buxhetit të Shtetit” Shpenzimet, Kapitulli I.5 “Shpenzime për fonde speciale” është raportuar në shumën 154,935 milionë lekë. **Diferenca në shumën 11,946 milionë lekë, ju përket shtesave në buxhetin e ISSH me VKM, në lidhje me financimin e programeve të veçanta, të cilat nuk janë pasqyruar nga MFE në planin e shpenzimeve të ISSH.**

3.2.Realizimi i të ardhurave dhe rakordimi i tyre:

Të ardhurat për llogari të ISSH, përbëhen nga dy grupe kryesore, të ardhura nga kontributet dhe financimi nga buxheti i shtetit. Realizimi i tyre për vitin 2022 paraqitet më poshtë:

Tabela nr.3.5 “Mbi planin dhe faktin e të ardhurave totale të ISSH”

Në milionë lekë

Nr.	Emërtimi	Gjithsej		Diferenca	Realizimi në %
		Plan	Fakt		
I	Te ardhurat	104,009,000	105,656,601	1,647,601	101.6
1	DPT te ardhura	101,514,000	102,034,645	520,645	100.5
	ISSH te ardhura	2,495,000	3,575,706	1,080,706	
	ISSH kontribute te tjera	-	46,250	46,250	
2	ISSH	2,495,000	3,621,956	1,126,956	145.2
II	Financime nga buxheti	62,871,909	62,871,909	-	100.0
III	Totali te ardhurave (I+II)	166,880,909	168,528,510	1,647,601	102.1

Burimi i të dhënave ISSH, përpunoi Grupi i auditimit KLSH

Për vlerësimin e realizimit të të ardhurave, janë trajtuar më poshtë të ardhurat e krijuara nga derdhja e kontributeve dhe të ardhura të tjera, të cilat sipas strukturës përgjegjëse për mbledhjen

e tyre ndahen në, të ardhura të realizuara nga derdhja e kontributeve që mbledhen nga DPT dhe të ardhura të mbledhura nga ISSH.

Realizimi i të ardhurave nga kontributet sipas ISSH, bazuar në rakordimin me DPT, MFE dhe llogarinë e të ardhurave të ISSH, për kontributet e derdhura në ISSH (të vetëpunësuar në bujqësi dhe sigurim vullnetar), paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr. 3.6 “Realizimi i të ardhurave nga kontributet 2022/2021 dhe P/F 2022”

Në mijë lekë

Nr.	Të ardhurat	Fakti 2021	VITI 2022			
			Plan	Fakt	Realizimi në %	
					2022/2021	F/P 2022
I	Sektori Publik	36,674,950	38,621,798	38,923,062	106	100.8
1	Buxhetore	31,729,089	33,117,292	33,375,606	105	100.8
2	Jo Buxhetore	4,945,861	5,504,506	5,547,456	112	100.8
II	Sektori privat	52,988,219	60,570,725	61,043,426	115	100.8
1	Biznesi i madh	49,774,168	57,188,821	57,635,135	116	100.8
2	Biznesi i Vogël	3,214,051	3,381,904	3,408,291	106	100.8
III	Sigurim Suplementar	1,489,319	1,896,000	1,639,271	110	86.5
IV	Të tjera DPT	381,020	425,477	428,797	113	100.7
	DPT (I+II+III+IV)	91,533,508	101,514,000	102,034,556	111	100.5
IV	Vullnetar	500,628	450,000	573,359	115	127.4
V	Të vet punësuar në bujqësi	2,184,970	1,725,000	2,364,956	108	137.1
	<i>Kontribute</i>			2,234,395		
	<i>Nga e cila penalitete sipas TSA</i>			130,561		
VI	Të tjera ISSH (jo tatimore)	480,386	320,000	637,391	133	199.2
VII	Derdh në llog e sig (tatimore)	104,016		46,250	44	-
	ISSH (IV+V+VI+VII)	3,270,000	2,495,000	3,621,956	111	145.2
	Gjithsej sigurime	94,803,508	104,009,000	105,656,512	111	101.6

Burimi i të dhënave ISSH, përpunoi Grupi i auditimit KLSH

Nga analiza e detajimit të planit dhe realizimit për vitin 2022, referuar të dhënave të paraqitura në tabelën e mësipërme, ka rezultuar se ISSH, në detajimin e planin të të ardhurave nga kontributet (të ardhura tatimore) në shumën 104,009 milionë lekë, të miratuar nga MFE për rrjedhje dhe faktit të të ardhurave ka përfshirë edhe “të ardhura të tjera” (ISSH dhe DPD) të cilat sipas klasifikimi buxhetor, janë të ardhura jo tatimore, respektivisht në shumat 745,477 mijë lekë në plan dhe 1,196 mijë lekë në fakt, analizuar në tabelën nr. 3.7.

Në detajimin e planit të të ardhurave:

Nga ISSH, është bërë planifikim i të ardhurave jo tatimore në shumën 746 milionë lekë, si pjesë e planit të miratuar nga MFE në shumën 104,009 milionë lekë, plan i cili përfaqëson të ardhura tatimore nga kontributet. ISSH ka detajuar planin në shumën 104,009 milionë lekë, në plan të ardhura nga kontributet në shumën 103,263 milionë lekë dhe nga të ardhura të tjera (jo tatimore) në shumën 746 milionë lekë.

Të ardhurat e planifikuara sipas detajimit të ISSH, referuar strukturave mbledhëse, janë ndarë në të ardhura nga kontributet e mbledhura nga DPT, që rezultojnë në shumën 101,088 milionë lekë dhe të ardhura nga kontributet ISSH në shumën 2,175 milionë lekë, në total 103,263 milionë lekë, ndërsa të ardhurat jo tatimore janë detajuar, nga DPT në shumën 426 milionë lekë dhe nga ISSH në shumën 320 milionë lekë, në total 746 milionë lekë.

Mbi realizimin faktik të të ardhurave dhe analizën e tyre ka rezultuar:

- Të ardhurat e mbledhura nga DPT, në shumën 102,034,645 mijë lekë, përbëhen nga, të ardhura nga derdhja e kontributeve (të ardhura tatimore) **në shumën 101,605,759 mijë lekë** dhe të ardhura të tjera (jo tatimore), nga gjoba dhe penalitete në shumën 428,797 mijë lekë, sipas rakordimit të ISSH me MFE.
- Kontribute të mbledhura nga vetë ISSH (të vetëpunësuar në bujqësi, vullnetarë dhe të tjera), në total janë paraqitur në shumën 3,621,956 mijë lekë, nga e cila 573,359 mijë lekë janë kontribute vullnetare; shuma 2,234,395 mijë lekë kontribute të vetëpunësuar në bujqësi,

shuma 46,250 mijë lekë kontribute të derdhura në llogarinë e ISSH, si dhe shuma 767,952 mijë lekë përbën të ardhura jo tatimore nga e cila 637,391 mijë lekë të ardhura të tjera dhe 130,561 penalitete (sipas *rakordimit të të ardhurave të ISSH, nga TSA është në shumën 2,234,395 mijë lekë, ndërsa raportuar sipas ISSH është në shumën 2,364,956 mijë lekë, diferenca në shumën 130,561 mijë lekë përbën të ardhur jo tatimore/penalitete (llogaria 7115500)*). Për rrjedhojë deklarimi i realizimit të të ardhurave nga kontributet (të ardhura tatimore nga ISSH) **janë në shumën 2,854,004 mijë lekë.**

Konkluzion: Nga analiza e planifikimit dhe realizimit të treguesve për vitin 2022, ka rezultuar se ISSH nuk ka kryer një detajim të drejtë të planit të të ardhurave dhe për rrjedhojë të realizimit dhe analizave përkatëse, pasi në faktin e realizimit të të ardhurave nga ISSH janë përfshirë dhe **të ardhurat jo tatimore në shumën 1,196 milionë lekë.** Të ardhurat tatimore të realizuara në vitin 2022, kundrejt planit në shumën 104,009 milionë lekë, janë në shumën 104,460 milionë lekë dhe të ardhura jo tatimore në shumën 1,196 milionë lekë. **Realizimi i të ardhurave nga kontributet referuar planit të miratuar nga MFE, nuk është në masën 101.6 %, por 100.4 %.**

Tabela nr.3.6 “Të ardhurat totale të ISSH, plan/fakt 2022”

					Në mijë lekë
Nr.	Përshkrimi	Plan	Fakt	Diferenca Fakt/Plan	Realizimi në % (F/P)
Sipas raportimit të ISSH					
I	Të ardhura nga kontributet	104,009,000	105,656,512	1,647,512	101.6
1	Të ardhura të mbledhura nga DPT	101,514,000	102,034,556	520,556	100.5
2	Të ardhura të mbledhura nga ISSH	2,495,000	3,621,956	1,126,956	145.2
Sipas KLSH					
II	Të ardhura nga kontributet	104,009,000	104,459,763	450,763	100.6
1	Të ardhura të mbledhura nga DPT	101,088,523	101,605,759	517,236	100.1
2	Të ardhura të mbledhura nga ISSH	2,175,000	2,854,004	679,004	119.6
		103,263,523			
	Diferenca në raportim (II-I)	745,477	1,196,749	1,196,749	

Burimi i të dhënave ISSH, përpunoi Grupi i auditimit KLSH

Titulli i gjetjes 1:

Situata:

Mbi detajimin e planit dhe faktit të të ardhurave dhe analizën e realizimit të tyre.

Referuar Ligjit nr. 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, si dhe AN për ndryshim të tij, ka rezultuar se MFE i ka dërguar ISSH, planin e të ardhurave dhe shpenzimeve. Plani i të ardhurave është i detajuar në të ardhura nga kontributet dhe transferta e buxhetit të shtetit.

Sipas Ligjit nr. 115/2021, me ndryshime plani i të ardhurave për ISSH, nga kontributet është në shumën 104,009 milionë lekë dhe përfaqëson të ardhura tatimore të klasifikuara si të tilla edhe në Tabelën e Treguesve Fiskalë të Konsoliduar të Buxhetit të Shtetit, pjesë e ligjit.

Nga ISSH, detajimi i këtij plani të ardhurash është kryer duke përfshirë në kundërshtim me Ligjin 115/2021 dhe “Treguesit fiskalë të konsoliduar të buxhetit të shtetit”, në këtë plan edhe të ardhurat jo tatimore, ose “Të tjera DPT dhe ISSH”, të cilat janë në shumën 745,477 mijë lekë.

Nga ISSH, nuk është bërë një detajim i duhur i planit të të ardhurave, për rrjedhojë faktit dhe realizimit të tyre. Detajimi dhe analizimi fakt/plan, duhet t’i referohej vetëm të ardhurave tatimore “nga kontributet” të cilat sipas rakordimeve më DPT, MFE, ISSH janë në shumën 101,605,759 mijë lekë nga DPT dhe në shumën 2,854,004 mijë lekë nga ISSH, në total në shumën 104,459,763 mijë lekë.

Sa më sipër, realizimi i të ardhurave nga kontributet e mbledhura nga DPT dhe ISSH, kundrejt planit të miratuar nga MFE në shumën 104,009,000 mijë lekë, është 100.4 %, ose me një tejkalim në shumën 486,324 mijë lekë.

ISSH ka planifikuar për të realizuar më pak të ardhura nga kontributet në shumën 745,477 mijë lekë, në raport me planin e buxhetit, si dhe i ka realizuar ato në masën 100.4 % dhe jo në masën 101.6 %, pasi ka përfshirë në mënyrë të gabuar në realizimin e tyre, të tjera të ardhura/jo tatimore në shumën 1,196,749 mijë lekë, konfirmuar edhe me aktrakordimet përkatëse. Ligji nr. 155/2021 “Për buxhetin e vitit 2021”

Kriteri:

Treguesit Fiskalë të Konsoliduar të Buxhetit të Shtetit, Të ardhura tatimore/ Të ardhura nga fondet speciale/ Të ardhura ISSH.

Shkaku:

Planifikim me rezervë i të ardhurave tatimore (nga kontributet), mos klasifikim i duhur.

Ndikimi/Pasoja:

Analiza e treguesve të realizimit të të ardhurave të ISSH në plan dhe fakt është e deformuar.

Rëndësia:

E mesme

Rekomandimi:

Titullari i ISSH, të marrë masa që në vitin 2023 e në vijim, detajimi i planit të të ardhurave nga kontributet dhe realizimi i tyre, të trajtohen sipas klasifikimit të bërë në ligjet për buxhetin vjetor përkatës dhe “Treguesit Fiskalë të Konsoliduar të Buxhetit të Shtetit”. Në detajimin e planit të të ardhurave nga kontributet, realizimin dhe analizat fakt/plan, nuk duhet të përfshihen të ardhurat jo tatimore (të tjera DPT dhe ISSH) por duhet t’i referoheni klasifikimit në të ardhura tatimore dhe jo tatimore, sipas Treguesve Fiskalë të Konsoliduar të Buxhetit të Shtetit, pjesë e ligjeve për zbatimin e buxhetit të shtetit.

Mbi rakordimin e të ardhurave të realizuara:

Të ardhurat e krijuara nga derdhja e kontributeve në DPT, sipas Akt rakordimit nr.1372/3 prot., datë 27.01.2023 të MFE dhe nr. 738/1, datë 27.01.2023 të ISSH, për periudhën 12 mujore 2022, të konfirmuara nga dy institucionet, paraqiten si më poshtë:

Tabela nr.3.8. “Rakordimi i të ardhurave të realizuara me MFE”

Në mijë lekë

Përshkrimi	ISSH	MFE
Gjendje në 01.01.2022	990,507	990,507
Tatimore (Klasa 7, llog 75)	101,605,759	101,605,759
Jo tatimore (Klasa 7, llog.711), gjoba	310,611	310,611
Jo tatimore (Klasa 7, llog.709), kamatëvonesa	118,186	118,186
Total të ardhura në total viti 2022	102,034,556	102,034,556
Transferuar nga TSA ¹ progresive	100,877,173	100,877,173
Gjendja më datë 31.12.2022	2,147,891	2,147,890

Burimi i të dhënave ISSH, përpunoi Grupi i auditimit KLSH

Tabela nr. 3.9. “Të ardhurat e realizuara nga ISSH dhe të rakorduara me thesarin”

Në mijë lekë

Përshkrimi	ISSH-Thesari	ISSH	Diferenca
Sigurime shoqërore fermerë (tatimore)	2,234,395	2,364,956	130,561
Sigurime shoqërore vullnetarë (tatimore)	573,359	573,359	0
Kontribute të derdhura nga subjekte të tjera (tatimore)	46,250	46,250	0
Të ardhura jo tatimore (penalitetet)	130,561		(130,561)

¹ Llogaria e thesarit “Depozitë qeverie”

Të ardhura të tjera jo tatimore	637,391	637,391	0
Total të ardhura	3,621,956	3,621,956	0

Burimi i të dhënave ISSH, përpunoi Grupi i auditimit KLSH

Rakordimi me Treguesit Fiskale të Konsoliduar të Buxhetit:

Referuar të dhënave të rakorduara të ISSH, sipas tabelave të mësipërme rezulton se, të ardhurat e realizuara nga ISSH në total janë në shumën 105,656 milionë lekë, ndërsa sipas Treguesve të konsoliduar të buxhetit të shtetit janë në shumën 105,640 milionë lekë.

Tabela nr.3.10 “Raportimi i realizimit të të ardhurave dhe ndryshimet/diferencat në raportim”

Në milionë lekë

Nr.	Përshkrimi	Të ardhura të realizuara
1	ISSH (Rakordimi me DPT dhe të ardhurat e ISSH)	105,656
2	ISSH-MFE (Treguesit fiskalë të konsoliduar të Buxhetit të Shtetit)	105,640
3	Diferenca në raportim	16

Burimi i të dhënave ISSH, përpunoi Grupi i auditimit KLSH

Konkluzion: Nga krahasimi i të ardhurave të realizuara nga ISSH (kontributet/të ardhura tatimore) dhe të dhënave të Tabelës së treguesve të konsoliduar të Buxhetit të Shtetit, Kapitulli II.3 “Të ardhurat nga fondet speciale”, rezulton se fakti i të ardhurave nuk përputhet. Sipas të dhënave të MFE fakti i të ardhurave nga fondet speciale (sigurimet shoqërore) paraqiten në vlerën 105,640 milionë lekë, nga ISSH sipas rakordimeve janë deklaruar 105,656 milionë lekë, ose 16 milionë lekë më shumë. **Në realizimin e të ardhurave të deklaruara nga ISSH në shumën 106,656 milionë lekë janë përfshirë të ardhura tatimore në shumën 104,459 milionë lekë dhe të ardhura jo tatimore në shumën 1,197 milionë lekë.**

3.3.Mbi financimin nga buxheti i shtetit:

Financimi i buxhetit të shtetit, për mbulimin e disa skemave të pensioneve, të cilat janë grande nga buxheti i shtetit për mbulimin e shpenzimeve të këtyre skemave dhe financime nga buxheti i shtetit për mbulimin e deficitit të skemës së pensioneve, që për vitin 2022 ka rezultuar **në shumën 62,871,909 mijë lekë.**

Tabela nr.3.11 “Të dhëna analitike mbi financimin nga buxheti viti 2021 dhe 2022”

Në lekë

Llog.	Përshkrimi	Viti 2021	Viti 2022	Diferenca 2022/2021
755	Kontribute te buxhetit per	4,925,957,204	4,411,815,254.00	-514,141,950
	Sig.shoq. Per ushtaret	-	-	-
	Sig.shoq.per te papunet	827,751,600	882,935,040	55,183,440
	Sig.shoq.per ushtarake ne reforme e pension te parakohshem	201,607,954	201,607,954	0
	Sig.shoq.per police ne ref dhe pension te parakohshem	289,399,370	289,399,370	0
	Sig.shoq.per ish-funksionaret	12,260,160	12,260,160	0
	Sig.shoq.per ushtarake ne reforme e pension te parakohshem	2,429,549,000	2,243,450,810	-186,098,190
	Sig. Shoq. Per gra te pensionuara	1,145,949,120	761,425,920	-384,523,200
	Sig.shoq.per punonj e industrise ushtarake+ minierave	19,440,000	20,736,000	1,296,000
720	Grant nga buxheti per pagesa te posacme	13,033,830,000	17,794,238,000.00	4,760,408,000
	Grande per komps e rritjes se pens + cmimit energj elek	5,108,019,000	17,593,745,000	12,485,726,000
	Rezistenca sociale prill		3,883,973,000	3,883,973,000
	Rezistenca sociale dhjetor		5,605,294,000	5,605,294,000
	Bonusi pensionisteve	3,500,000,000	3,500,000,000	0
	Bonusi invalideve		396,642,000	396,642,000
	Kompensim cmimesh dhe te ardhurash	4,165,463,000	4,207,836,000	42,373,000
	Grande per pensione shteterore te posacme	89,338,000	24,195,000	-65,143,000
	Grande per shitesa te parashikuara per veteranet	77,776,000	80,437,000	2,661,000
	Grande per shitesa te parashikuara per invalidet e punes	93,234,000	95,861,000	2,627,000
720	Grant nga buxheti per trajtime te vecanta	6,360,149,205	6,425,248,190.00	65,098,985
	Grande per shitesa te parashikuara per ushtarakeve te tjere	2,722,819,000	2,966,922,268	244,103,268
	Sigurim suplementar per ish-ushtaraket	-	-	-
	Perfitime per policine e shtetit	182,261,000	188,801,000	6,540,000
	Perfitime per ushtaraket e nendetseve ne pension.	12,514,000	12,918,822	404,822
	Grande per pagesa kalimtare e pensione te ish funks.	412,798,628	437,199,000	24,400,372

	Grande per pagesa per shtesa te parashikuara per deshmoret	29,990,000	29,943,000	-47,000
	Grande per pagesa per shtesa te parashikuara per minaret	2,347,092,359	2,019,828,000	-327,264,359
	Grande per pagesa per shtesa te parashikuara per pilotet	78,160,000	76,072,074	-2,087,926
	Grande per pagesa per shtesa te parashikuara per ind. Usht.	65,158,000	67,636,026	2,478,026
	Per shpenzime varrimi	169,383,000	265,603,000	96,220,000
	Perfitime per statusin e profesorit	139,837,218	158,460,000	18,622,782
	Pensione sociale	200,136,000	201,865,000	1,729,000
720	Grant nga buxheti per mbulimin e deficitit	33,573,812,591	34,240,607,556.00	666,794,965
	Diference kontributi per fermeret	2,276,672,810	3,275,997,182	999,324,372
	Grant per mbulim deficiti	31,297,139,781	30,964,610,374.00	-332,529,407
	Rezistenca sociale prill			0
	Totali	57,893,749,000	62,871,909,000	4,978,160,000

Burimi i të dhënave ISSH, përpunoi Grupi i auditimit KLSH

ISSH ka rakorduar me Degën e Thesarit Tiranë për fondet e alokuara nga buxheti i shtetit në shumën 62,872 milionë lekë, sipas akt rakordimit, ku në shkresën përcjellëse nr. 160, datë 09.01.2023 të akt rakordimit është cilësuar: “Mbështetur në ligjin nr. 115/2021 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2022” dhe në vijim të Udhëzimit të MFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar bashkëlidhur shkresës dërgojmë akt rakordimin për financimin e Buxhetit të Shtetit sipas grupit titullit, artikullit dhe llogarisë ekonomike për periudhën 12 mujore të vitit 2022”.

Në krahasim me vitin 2021, financimi nga buxheti i shtetit është rritur në shumën 4,978,160 mijë lekë, por në vitin 2022 për shkak të rezultatit fiskal pozitiv, nevoja për përdorimin e këtij financimi ka qenë në shumën 57,380,113 mijë lekë, ose 5,491,796 mijë lekë më pak se financimi i tërhequr.

3.4.Realizimi i të ardhurave, analizë treguesish mbi të ardhurat nga kontributet, realizimi i tyre sipas sektorëve dhe rajoneve.

Sipas ISSH, të ardhurat nga kontributet për vitin 2022, janë realizuar në shumën 105,656,601 mijë lekë, me tejkalim në shumën 1,647,601 mijë lekë, ose në masën 2 % më shumë se plani i tyre.

Tabela nr. 3.12. “Realizimi i të ardhurave në nivel ISSH për vitin 2022”

mijë lekë

Nr.	Emërtimi	Gjithsej		Diferenca	Realizimi në %
		Plan	Fakt		
I	Te ardhurat	104,009,000	105,656,601	1,647,601	102
1	DPT te ardhura	101,514,000	102,034,645	520,645	100.5
2	ISSH te ardhura	2,495,000	3,575,706	1,080,706	143.3
3	ISSH kontribute te tjera	-	46,250	46,250	
II	Financime nga buxheti	62,871,909	62,871,909	-	100.0
III	Totali te ardhurave (I+II)	166,880,909	168,528,510	1,647,601	102.1

Burimi i të dhënave ISSH, përpunoi Grupi i auditimit KLSH

- Kontribute të mbledhura nga DPT për llogari të ISSH, në shumën 102,034,645 mijë lekë, nga e cila **101,605,759 mijë lekë janë të ardhura nga derdhja e kontributeve** dhe 428,797 mijë lekë, janë të ardhura të tjera, nga gjoba dhe penalitete sipas rakordimit të ISSH me MFE.
- Kontribute të mbledhura nga vetë ISSH (të vetëpunësuar në bujqësi, vullnetarë dhe të tjera), në total janë paraqitur në shumën 3,621,956 mijë lekë, nga e cila **2,854,003 mijë lekë janë kontribute** (vullnetarë dhe të vetëpunësuar në bujqësi) dhe 767,952 janë të ardhura jo tatimore që përbëhen nga të ardhura të tjera në shumën 637,391 mijë lekë dhe të ardhura nga kamatëvonesat në shumën 130,561 mijë lekë, sipas rakordimit me TSA.
- Kontributet e tjera të pa planifikuara në shumën 46,250 mijë lekë, përfaqësojnë të ardhura nga ekzekutim Vendim gjykate kontribute në shumën 981,973 lekë; kontribute për gratë e

diplomatëve në shumën 5,107,167 lekë dhe kontribute për naftëtarët në shumën 40,161,133 lekë.

Tabela nr. 3.10 “Realizimi i te ardhurave nga kontributet 2022/2021 dhe P/F 2022”

Në mijë lekë

Nr.	Të ardhurat	Fakti 2021	VITI 2022			
			Plan	Fakt	Realizimi në %	
					2022/2021	F/P 2022
I	Sektori Publik	36,674,950	38,621,798	38,923,062	6.13	100.8
1	Buxhetore	31,729,089	33,117,292	33,375,606	5.19	100.8
2	Jo Buxhetore	4,945,861	5,504,506	5,547,456	12.16	100.8
II	Sektori privat	52,988,219	60,570,725	61,043,426	15.20	100.8
1	Biznesi i madh	49,774,168	57,188,821	57,635,135	15.79	100.8
2	Biznesi i Vogël	3,214,051	3,381,904	3,408,291	6.04	100.8
III	Sigurim Suplementar	1,489,319	1,896,000	1,639,271	10.07	86.5
IV	Të tjera DPT	381,020	425,477	428,797	12.54	100.7
	DPT (I+II+III+IV)	91,533,508	101,514,000	102,034,556	11.47	100.5
IV	Vullnetar	500,628	450,000	573,359	14.53	127.4
V	Të vet punësuar në bujqësi	2,184,970	1,725,000	2,364,956	8.24	137.1
VI	Të tjera ISSH	480,386	320,000	637,391	32.68	199.2
VII	Derdh në llog e sig	104,016		46,250	(55.54)	-
	ISSH (IV+V+VI+VII)	3,270,000	2,495,000	3,575,706	10.76	143.3
	Gjithsej Sigurime shoqërore	94,803,508	104,009,000	105,656,512	11.45	101.6

Burimi i të dhënave ISSH, përpunoi Grupi i auditimit KLSH

Midis të ardhurave të raportuara nga DPT dhe raportimit nga ISSH (sipas rakordimit me MFE) ka një mospërputhje në shumën 89 mijë lekë {102,034,645 (DPT)-102,034,556 (ISSH)=89}, për shkak të mos pasqyrimit nga DPT, të një ndryshimi të bërë nga MFE dhe që mbartet dhe në të ardhurat total të raportuara (105,656,601- 105,656,512 = 89).

Analizë mbi faktorët që kanë ndikuar në realizimin faktik të të ardhurave:

Në rritjen e të ardhurave nga kontributet për vitin 2022 në krahasim me vitin 2021, kanë ndikuar dy faktorë: rritja e pagës minimale, e cila ka efekt në kontributin mesatar për një kontributor dhe rritja e numrit të kontribuuesve, ku ndikimi i secilit është analizuar më poshtë:

Rritja e të ardhurave dhe numrit të kontribuuesve në krahasim me periudhën e mëparshme, për të ardhura të mbledhura nga DPT, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela 3.11. “Të ardhura (në milionë lekë) dhe kontribuues 2022/2021”

Përshkrimi	Të ardhura		Kontribuues		Diferenca 2022/2021		Ndryshimi në % 2022/2021	
	2021	2022	2021	2022	Të ardhura	Kontribuues	Të ardhura	Kontribuues
Ndërmarrje buxhetore	31,729	33,375	143,195	143,254	1,646	59	105.2	100.1
Institucione jo buxhetore	4,946	5,547	20,672	22,876	601	2,204	112.2	110.7
Firma private	49,774	57,635	373,918	385,412	7,861	11,494	115.8	103.1
Të vetëpunësuar	3,214	3,408	135,695	135,215	194	(480)	106.1	99.6
Totali	89,663	99,965	738,008	755,730	10,302	17,722	111.5	102.4

Burimi i të dhënave ISSH, përpunoi Grupi i auditimit KLSH

Në krahasim me vitin 2021, numri i kontributorëve është rritur me 17,722 raste dhe 10,302 milionë lekë. Duke u nisur nga kontributi mesatar vjetor për një kontribues në vitin 2021 dhe kontributi mesatar për një kontribues të vitit 2022, (Të ardhura/ numër kontribues), kemi një rritje të këtij treguesi në masën 5.2 %, ndërsa numri i kontribuuesve është rritur me 2.4 %.

Nga analizimi i këtyre treguesve, referuar tabelave nr. 3.12 dhe nr. 3.13, rezulton se, rritja e të ardhurave në shumën 10,302 milionë lekë, ka ardhur kryesisht nga rritja e kontributit mesatar për shumën 8,243 milionë lekë, ose në masën 80 % dhe nga rritja e numrit të kontribuuesve për shumën 2,059 milionë lekë, ose në masën 20 %.

Tabela nr. 3.12 “Ndikimi i treguesve në rritjen e të ardhurave 2022/2021”

Në lekë

Nr.	Numri i kontribuesve 2022	Të ardhurat Kontributi mesatar 2021	Të ardhurat Kontributi mesatar 2022	Diferenca për efekt të Δ kontributit mesatar
	a			
1	143,254	31,745	33,375	1,633
	22,876	5,473	5,547	74
	385,412	51,304	57,635	6,331
2	135,215	3,202	3,408	205
	755,730	91,722	99,965	8,243
Përlllogaritjet (Ndikimi)				
3	Diferenca nga efekti i Δ kontributit		(8,243)	
4	Rritja e të ardhurave total		10,302	
5	Nga rritja e numrit të kontribuesve		2,474	

Burimi i të dhënave ISSH, përpunoi Grupi i auditimit KLSH

Tabela nr. 3.13. “Kontributi mesatar vjetor dhe diferenca 2022/2021”

Në lekë

Kontribues 2022	Kontributi mesatar vjetor në lekë		Të ardhura		Diferenca
	2021	2022	Kontribues 2022*mesatare 2021	Kontribues 2022*mesatare 2022	Δ e kontributit mesatar
143,254	221,579	232,978	31,742,073,159	33,375,000,000	1,632,926,841
22,876	239,261	242,481	5,473,330,882	5,547,000,000	73,669,118
385,412	133,115	149,541	51,304,020,903	57,635,000,000	6,330,979,097
135,215	23,685	25,204	3,202,630,974	3,408,000,000	205,369,026
755,730	617,640	650,205	91,722,055,918	99,965,000,000	8,242,944,082

Burimi i të dhënave ISSH, përpunoi Grupi i auditimit KLSH

Nga grupi i auditimit në përlllogaritjen e ndikimit të treguesve në rritjen e të ardhurave është mbajtur i pandryshuar treguesi “numër kontribuesish” dhe treguesi i ndryshueshëm “kontributi mesatar vjetor për një kontribues”, duke nxjerrë efektin në rritjen e të ardhurave si rezultat i rritjes së kontributit mesatar 2022/2021.

Rakordimi i të ardhurave të mbledhura nga DPT, rakordimi, raportimi dhe kontabilizimi:

Në lidhje me realizimin e të ardhurave nga kontributet me shkresën nr. 290, datë 10.01.2023 të DPT, protokolluar në ISSH me nr. 254, datë 12.01.2023, janë dërguar treguesit e sigurimeve shoqërore për periudhën Janar-Dhjetor 2022, të cilët përputhen me Treguesit e Konsoliduar të Buxhetit të Shtetit² dhe që paraqiten si më poshtë:

- Kontribute ISSH, 101,605,848 mijë lekë (të ardhura tatimore);
- Gjoha dhe kamatëvonesa ISSH në shumën 428,797 mijë lekë (të ardhura jo tatimore)
- **Totali: 102,034,645 mijë lekë.**

Tabela nr.3.14 “Të ardhura të realizuara ISSH sipas DPT”

Në mijë lekë

Nr.	Përshkrimi	Treguesit sipas DPT
I	Kontribute shoqërore	
1	Spektori Buxhetor	33,375,695
2	Spektori jo buxhetor	5,547,456
3	Spektori Privat	57,635,135
4	Të vetë punësuarit	3,408,292

² Të dhëna të publikuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë

5	Kontributi suplementar	1,639,270
	Totali I = (1+2+3+4+5)	101,605,848
II	Kontribut kujdes shëndetësor	16,027,495
III	Totali kontribute III= (I+II)	117,633,343
IV	Të ardhura jo tatimore (shoqërore)	428,797
1	Gjoha sigurime shoqërore	310,611
2	Kamatëvonesa sigurime shoqërore	118,186
V	Totali kontribute sigurimesh V= (I+IV)	102,034,645
VI	Të ardhura jo tatimore (shëndetësore)	72,864
1	Gjoha sigurime shëndetësore	52,2894
2	Kamatëvonesa sigurime shëndetësore	20,5744
VII	Total gjoha & kamatëvonesa (IV+VI)	501,661
VIII	Totali VIII= (III+VI+VII)	118,135,003

Burimi i të dhënave MFE, përpunoi Grupi i auditimit KLSH

Tabela nr. 3.15 “Të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas rakordimeve”

Në mijë lekë

Nr.	Përshkrimi	Treguesit sipas DPT	Treguesit sipas ISSH	Treguesit e konsoliduar të Buxhetit të Shtetit	Diferenca
I	Kontribute shoqërore				
1	Spektori Buxhetor	33,375,695	33,375,606		89
2	Spektori jo buxhetor	5,547,456	5,547,456		0
3	Spektori Privat	57,635,135	57,635,135		0
4	Të vetë punësuarit	3,408,292	3,408,292		0
5	Kontributi suplementar	1,639,270	1,639,270		0
	Totali	101,605,848	101,605,759	101,605,759	89
IV	Të ardhura jo tatimore (shoqërore)	428,797	428,797	428,797	0
1	Gjoha sigurime shoqërore	310,611	310,611	310,611,031	0
2	Kamatëvonesa sigurime shoqërore	118,186	118,186	118,186,207	0
	Totali (I+IV)	102,034,645	102,034,556	102,034,556	89

Burimi i të dhënave ISSH, përpunoi Grupi i auditimit KLSH

Sipas shkresës së MFE nr. 738, datë 27.01.2023 “Mbi rakordimin e të ardhurave të realizuara nga kontributet për sigurimet Shoqërore nga DPT për vitin 2022” midis të dhënave të DPT dhe të dhënave të rakorduara midis ISSH me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë mbi të ardhurat nga kontributet për sigurimet rezultojn një diferencë në shumën 88,553 lekë, është pakësim i të ardhurave në debi të llog.75. Ky sistemim i rakorduar midis ISSH dhe MFE, nuk është reflektuar në të dhënat e DPT.

Sa më sipër, të ardhurat nga kontributet dhe të tjera jo tatimore, janë të rakorduara në shumën 102,034,556 mijë lekë.

Marrëdhëniet e Institutit të Sigurimeve Shoqërore me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve dhe marrëdhëniet e Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore me Drejtoritë Rajonale Tatimore janë ndërtuar dhe mbështeten në VKM nr.77, datë 28.01.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”. Ndër të tjera është përcaktuar se DPT dërgon në ISSH, të gjithë të dhënat statistikore dhe të kontributeve të paguara, bazuar në procedurën e komunikimit “on-line”, midis sistemeve informatike, të ngritura nga institucionet. Bazuar në këto dispozita, këtë vit janë zbatuar procedura më të plota bashkëpunimi institucional ndërmjet ISSH-së dhe DPT-së, të mbështetura në Marrëveshjen e Bashkëpunimit nr. 4473/1, datë 23.05.2017 dhe nr.11422, datë 19.05.2017.

Listë pagesat e formatit elektronik të periudhës 2012 e në vazhdim.

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve deri në datë 09.02.2023, për të gjithë periudhën 2012-2022 ka dërguar në ISSH, gjithsej 12,423,490 listë pagesa të formatit elektronik që i përkasin periudhës kohore 2012-2022. Nga këto:

- Për vitin 2012 kemi 713,418 listë pagesa (për periudhën janar - dhjetor);
- Për vitin 2013 kemi 818,318 listë pagesa (për periudhën janar - dhjetor);
- Për vitin 2014 kemi 909,599 listë pagesa (për periudhën janar - dhjetor);
- Për vitin 2015 kemi 1,098,263 listë pagesa (për periudhën janar - dhjetor);
- Për vitin 2016 kemi 1,267,765 listë pagesa (për periudhën janar - dhjetor);
- Për vitin 2017 kemi 1,236,633 listë pagesa (për periudhën janar - dhjetor);
- Për vitin 2018 kemi 1,257,731 listë pagesa (për periudhën janar - dhjetor);
- Për vitin 2019 kemi 1,259,504 listë pagesa (për periudhën janar - dhjetor);
- Për vitin 2020 kemi 1,267,106 listë pagesa (për periudhën janar - dhjetor);
- Për vitin 2021 kemi 1,298,420 listë pagesa (për periudhën janar - dhjetor);
- Për vitin 2022 kemi 1,287,733 listë pagesa (për periudhën janar - dhjetor);

Pavarësisht bashkëpunimit midis ISSH dhe DPT, referuar Kreu të II-të të Marrëveshjes së Bashkëpunimit nr. 4473/1, datë 23.05.2017 dhe nr.11422, datë 19.05.2017, sipas raportimit nga ISSH, ende evidentohen problematika në lidhje me transmetimin e listë pagesave, të evidentuara nga ISSH, si:

- Raste të evidentimit të vendosjes gabim të Numrit Personal NID, gjë e cila ka sjellë një problematikë, pasi pavarësisht rregullimit të gabimit pas konstatimit të tij dhe reflektimit për periudhat në vazhdim, ka mbetur problem i pazgjidhur reflektimi për periudhat përpara konstatimit të NID të gabuar.
- Në sistemin CMIS nuk shfaqen ende listë pagesat e periudhave të personave gjyq fitues.
- Në sistemin CMIS nuk shfaqen muaj të veçantë, për subjekte të ndryshme (raste të disa Drejtorive Arsimore Rajonale si DAR T., DAR E., DAR D. dhe DAR F.) dhe individë të ndryshëm, në vite të ndryshme, periudha të cilat ndërkohë shfaqen në sistemin tatimor.
- Lidhur me Bazën e të Dhënave të subjekteve për periudhën 2005-2012, për subjektet e mbyllura para vitit 2010, nuk është përcjellë asnjë e dhënë nga ana e organeve tatimore.
- Për subjekte të cilat kanë bërë pagesë me vonesë (jashtë afateve ligjore) apo për subjekte që janë me grafik të shlyerjes së debisë, për periudhat tatimore 2005-2012, nga ana e DPT nuk është përcjellë përditësimi i të dhënave përkatëse ndërkohë personat paraqiten në sigurimet shoqërore me urdhër pagesat dhe vërtetimin sipas periudhave përkatëse (kryesisht periudhat tatimore 2013-2014) nga organet tatimore të cilat gjenerohen nga sistemi i DPT-së.
- Në rastet kur subjektet kryejnë korrigjimin e deklaratës tatimore listë pagesat ESIG-25 në sistemin CMIS nuk shfaqet data kur është kryer korrigjimi, çka krijon probleme të mundshme lidhur me kushtet e përfitimeve afat shkurtra dhe afat gjata.
- Në rastet kur subjektet kryejnë pagesa pjesore dhe për punëmarrës të veçantë, të dhënat e kontributeve të paguara nuk shfaqen në sistemin CMIS.

Një nga problematikat më specifike në vitin 2022, lidhet me mangësitë në dërgimin e listë pagesave të periudhave të caktuara për Drejtoritë Arsimore Tiranë, Elbasan dhe Fier. ISSH i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me shkresat nr. 2542 prot., datë 11.04.2022, nr. 3727 prot., datë 30.05.2022 dhe nr. 5891 prot., datë 26.08.2022 me objekt problematikat në të dhënat e listë pagesave të Drejtorive Arsimore Rajonale si dhe detyrimeve të prapambetura përsa i përket kontributeve të sigurimeve shoqërore.

- Listë pagesat e munguara të formatit letër 2006-2012.

Në drejtim të administrimit të listë pagesave të subjekteve paguese, ISSH (Sektori i Marrëdhënieve me Tatimet dhe Administrimit të të Dhënave) ka trajtuar problemin e mungesave të listë pagesave, në formatin letër, për periudhat kohore 2006-2012.

Ndërkohë, Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, për tërheqjen e listë pagesave të munguara njoftojnë Drejtoritë Rajonale Tatimore.

Konkretisht, gjatë vitit 2022 janë marrë në dorëzim gjithsej 5,356 listë pagesa të munguara të subjekteve paguese që i përkasin periudhave tatimore 2006-2012 dhe konkretisht janë 95 listë pagesa të subjekteve publike (buxhetore dhe jo buxhetore); 1,668 listë pagesa të subjekteve juridike (firma) dhe 3,593 listë pagesa të subjekteve biznes i vogël.

Mungesa e listë pagesave të formatit letër për periudhën 2006-2012, pa përfshirë të dhënat e Biznesit të Vogël Tiranë paraqiten si më poshtë:

Liste pagesa gjithsej 253,941, nga këto;

- 3,610 janë mungesa në subjektet publike (buxhetorë dhe jo buxhetorë),
- 74,498 mungesa në subjektet juridike,
- 175,833 mungesa në subjektet e biznesit të vogël.

Në zbatim të shkresës nr.2835 prot., datë 13.04.2018, “Për grumbullimin e listë pagesave të munguara të formatit letër të subjekteve aktive buxhetore dhe jo buxhetore për periudhën tatimore Janar 1994 deri në Dhjetor 2012” e miratuar dhe nga GMS e ISSH-së, Drejtoria e Kontributeve dhe degët e kontributeve pranë DRSSH-ve kanë ndërtuar plan veprimin, për evidentimin dhe njoftimin e subjekteve buxhetore, lidhur me dorëzimin e listë pagesave të munguara në arkivat e sigurimeve shoqërore, sipas periudhave tatimore përkatëse, por mos rakordimi në kohë me degët e arkivit në rajone për vënie në dispozicion të listës së subjekteve me periudhat përkatëse të mungesave të listë pagesave ka vazhduar edhe në 2022 të jetë problematike.

Kryesisht, në pjesën më të madhe të rajoneve, mungesat e listë pagesave rrjedhin nga subjektet aktive, që do të thotë se nuk ka mungesa të shtuara artificialisht, pas kalimit në status pasiv të këtyre subjekteve. Kështu, pas verifikimeve përkatëse është kryer dhe përditësimi i gjendjes së mungesave të listë pagesave, proces i kryer nga ballafaqimi listës së subjekteve me status pasiv (subjekte pasive të periudhës 01.01.2006-31.12.2012) me listën e subjekteve me mungesa të listë pagesave përgjatë viteve 2006-2012.

Kontributet e sigurimeve shoqërore të mbledhura nga ISSH.

Për realizimin e të ardhurave në përgjegjësi të organeve të Sigurimeve Shoqërore (ISSH), evidentimin dhe kontabilizimin e tyre, janë të organizuara dhe të ndara:

- Kontribute të vet punësuarve në bujqësi;
- Kontribute të siguruarve vullnetarë;
- Të ardhura dhe kontribute të tjera.

Tabela nr.3.17 “Realizimi i të ardhurave të vitit 2022”

Në mijë lekë					
Nr.	Burimi	Plan	Fakt	Diferenca (F/PL)	Realizimi në %
I	Kontribute të vet punësuarve në bujqësi;	1,725,000	2,234,395	509,395	129.5
II	Kontribute të siguruarve vullnetarë;	450,000	573,359	123,359	127.4
II	Të ardhura dhe kontribute të tjera.	320,000	767,951	447,951	239.9
	Totali (ISSH)	2,495,000	3,575,706	1,080,706	143.3

Burimi i të dhënave ISSH, përpunoi Grupi i auditimit KLSH

Të ardhurat nga strukturat e sigurimeve shoqërore janë realizuar për 3,575,706 mijë lekë, kundrejt 2,495,000 mijë lekë të planifikuara, **me një tejkalim në shumën 1,080,706 mijë lekë**, ose me një realizim në masën 143 % e ndarë për:

-Të ardhurat nga të vetë punësuarit në bujqësi janë realizuar në shumën 2,234,395 mijë lekë nga 1,725,000 mijë lekë të planifikuara, pra realizuar në masën 129.5 %, **me një tejkalim në shumën 509,395 mijë lekë;**

- Të ardhurat nga sigurimi vullnetar janë realizuar në shumën 573,359 mijë lekë, nga 450,000 mijë lekë të planifikuara, pra realizuar në masën 127.4 %, **me një tejkalim në shumën 123,359 mijë lekë.**

- Të ardhura dhe kontribute të tjera janë realizuar në shumën 767,951 mijë lekë, nga 320,000 mijë lekë të planifikuar, pra realizuar në masën 240 %, **me një tejkalim në shumën 447,951 mijë lekë.**

Tabela nr.3.18 “Realizimi i të ardhurave nga kontributet të mbledhura nga ISSH sipas rajoneve”

Në mijë lekë				
Nr.	Rajoni	Plan	Fakt	%
1	B.	129,241	180,802	140
2	Di.	122,460	146,535	120
3	Du.	142,851	189,779	133
4	E.	243,395	333,351	137
5	F.	314,864	422,647	134
6	Gj.	116,179	144,733	125
7	Ko.	211,891	278,946	132
8	Ku.	53,388	63,464	119
9	L.	126,078	174,099	138
10	Sh.	160,556	222,609	139
11	T.	342,928	461,213	134
12	V.	211,169	326,657	155
	ISSH (të tjerë)	320,000	677,121	212
	Totali	2,495,000	3,621,956	145

Burimi i të dhënave ISSH, punuar nga grupi i KLSH

Referuar të dhënave të tabelës së mësipërme për vitin 2022, nga të gjitha rajonet kemi tejkalim të realizimit të të ardhurave nga kontributet e mbledhura nga ISSH, analizuar më poshtë.

Kontributet e të vetë punësuarve në bujqësi.

Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore kanë evidentuar, për çdo tremujor, numrin dhe detyrimet e debitorëve, të vetëpunësuar në bujqësi për vitin 2022, të krijuara në zbatim të VKM nr. 653, datë 22.07.2015.

Tabela nr.3.19 “Realizimi i të ardhurave nga të vetë punësuarit në bujqësi”

Në mijë lekë					
Nr.	Rajoni	Viti 2022			
		Plan	Fakt	Në %	Diferenca
1	B.	109,241	155,858	143	46,617
2	Di.	119,960	145,103	121	25,143
3	Du.	90,851	126,947	140	36,096
4	E.	223,395	305,435	137	82,040
5	F.	277,864	380,672	137	102,808
6	Gj.	97,179	128,130	132	30,951
7	Ko.	182,891	238,709	131	55,818
8	Ku.	52,388	62,310	119	9,922
9	L.	116,078	158,193	136	42,115
10	Sh.	143,556	200,914	140	57,358
11	T.	142,928	203,334	142	60,406
12	V.	168,669	259,351	154	90,682
	Totali	1,725,000	2,364,956	137	639,956

Burimi i të dhënave ISSH, përpunoi Grupi i auditimit KLSH

Sipas rakordimit të të ardhurave të realizuara dhe rakorduara me DRSSH ka rezultuar se, për vitin 2022, të ardhurat nga kontributet e të vetë punësuarve në bujqësi janë realizuar në shumën

2,364,956 mijë lekë, nga 1,725,000 mijë lekë të planifikuara, me një tejkalim në shumën 639,956 mijë lekë ose në masën 137 % kundrejt planit.

Tabela nr. 3.20 “Realizimi i të ardhurave të vetë punësuarve në bujqësi sipas rajoneve të ISSH”

Në mijë lekë

Nr.	Rajonet	Vlera e kontributeve nga të vetë punësuarit në bujqësi Realizimi (numër/vlerë për vitet 2022/2021)							
		2021		2022		Diferenca		Në %	
		Numër	Vlerë	Numër	Vlerë	Numër	Vlerë	Numër	Vlerë
1	B.	3,304	127,427	4,020	155,858	716	28,431	22	22
2	Di.	4,525	140,750	4,622	145,103	97	4,353	2	3
3	Du.	5,816	110,745	3,099	126,947	283	16,202	10	15
4	E.	817	287,136	8,456	305,435	339	18,299	4	6
5	F.	8,592	346,146	9,372	380,672	780	34,526	9	10
6	Gj.	3,216	119,059	3,479	128,130	263	9,071	8	8
7	Ko.	6,366	246,204	6,117	238,709	(249)	(7,495)	4	(3)
8	Ku.	1,939	59,900	1,992	62,310	53	2,410	3	4
9	L.	3,827	146,426	4,064	158,193	237	11,767	6	8
10	Sh.	4,778	175,187	5,446	200,914	668	25,727	14	15
11	T.	4,478	179,550	5,002	203,334	524	23,784	12	13
12	V.	6,133	246,440	6,401	259,351	268	12,911	4	5
	Totali	58,091	2,184,970	62,070	2,364,956	3,979	179,986	7	8

Burimi i të dhënave ISSH, përpunoi Grupi i auditimit KLSH

Në vitin 2022 treguesit e planit në nivel rajonal dhe total, **janë 21 % më pak se realizimi faktik në vitin 2021** (1,725,000 mijë lekë/plan 2022 dhe 2,184,000 mijë lekë/fakt 2021).

Sipas të dhënave të tabelës së mësipërme, të gjitha rajonet rezultojnë me tejkalim në realizimin e këtyre të ardhurave si në vlerë dhe në numër kontribuesish dhe në total me 137 % realizim, gjë e cila tregon një planifikim me rezervë të këtyre të ardhurave.

Në krahasim me vitin 2021, numri i kontributorëve është rritur me 3,979 raste dhe 179,986 mijë lekë më shumë. Duke u nisur nga kontributi mesatar vjetor për një kontribues në vitin 2021, i cili rezulton në shumën 37,610 lekë (2,184,970 mijë/58,091 kontribues) dhe kontributit mesatar për një kontribues të vitit 2022, i cili rezulton në shumën 38,100 lekë (2,364,956 mijë/62,070 kontribues), kemi me një rritje të kontributit mesatar/për kontribues në masën 1.3 %, ndërsa numri i kontribuesve është rritur me 7 %.

Sipas këtyre të dhënave rezultojnë se, rritja e të ardhurave në shumën 179,986 mijë lekë, ka ardhur kryesisht nga rritja e numrit të kontribuesve për shumën 149,572 mijë lekë, ose në masën 83 % dhe nga rritja e kontributit mesatar për shumën 30,414 mijë lekë, ose në masën 17 % (sipas përlllogaritjeve në tabelën nr. 3.21)

Tabela nr. 3.21 “Ndikimi i treguesve në realizimin e të ardhurave”

Në lekë

Nr.	Numri i kontribuesve 2022	Kontributi mesatar	Të ardhurat
	a	b	c (a*b)
1	62070	37,610 lekë -2021	2,334,452,700
2	62070	38,100 lekë -2022	2,364,867,000
	Përlllogaritjet (Ndikimi)		
3	Diferenca nga efekti i Δ kontributit		(30,414,300)
4	Rritja e të ardhurave total bujk		179,986,000
5	Nga rritja e numrit të kontribuesve		149,571,700

Burimi i të dhënave ISSH, punuar nga grupi i KLSH

Të ardhurat e kontributeve nga Sigurimi vullnetar.

Nga auditimi i realizimit së të ardhurave nga sigurimi vullnetar për vitin 2022, u konstatua se, administrata e ISSH në bashkëpunim me DRSSH, kanë mundur realizimin e të ardhurave të programuara në masën 127 % ose **me një tejkalim prej 123,359 mijë lekë**. Në tabelën e mëposhtme po paraqesim realizimin e të ardhurave nga sigurimi vullnetar, sipas DRSSH duke e krahasuar edhe me vitin 2021. Të dhënat për skemën e sigurimit vullnetar, janë regjistruar në programin informatik CMIS për gjithë periudhën 2022. Procedurat janë informatizuar dhe kryhen në kohë reale si pritja e dokumentacionit, përpunimi i të dhënave dhe pajisja e kontribuesve me dokumentet e parashikuara e të kërkuara prej tyre. Në të ardhurat e realizuara nga të vetë punësuarit në bujqësi përfshihen edhe pagesa për periudha të mëparshme.

Tabela nr.3.22 “Realizimi i të ardhurave nga kontributet vullnetare sipas rajoneve fakt/plan”

Në mijë lekë

Nr.	Rajoni	Viti 2022			
		Plan	Fakt	Në %	Diferenca
1	B.	20,000	24,925	125	4,925
2	Di.	2,500	1,413	57	(1,087)
3	Du.	52,000	62,816	121	10,816
4	E.	20,000	26,902	135	6,902
5	F.	37,000	41,938	113	4,938
6	Gj.	19,000	16,511	87	(2,489)
7	Ko.	29,000	40,120	138	11,120
8	Ku.	1,000	1,151	115	151
9	L.	10,000	15,891	159	5,891
10	Sh.	17,000	21,674	127	4,674
11	T.	200,000	252,749	126	52,749
12	V.	42,500	67,269	158	24,769
	Totali	450,000	573,359	127	123,359

Burimi i të dhënave ISSH, punuar nga grupi i KLSH

Tabela nr. 3.23 “Realizimi i të ardhurave nga kontributet vullnetare 2022/2021”

Në mijë lekë

Nr.	Rajonet	2021		2022		Diferenca	
		Numër	Vlerë	Numër	Vlerë	Numër	Vlerë
1	B.	284	22,058	283	24,925	(1)	2,867
2	Di.	37	2,910	16	1,413	(21)	(1,497)
3	Du.	732	56,914	713	62,816	(19)	5,902
4	E.	354	27,555	305	26,902	(49)	(653)
5	F.	497	38,608	476	41,938	(21)	3,330
6	Gj.	268	20,869	187	16,511	(81)	(4,358)
7	Ko.	413	32,131	455	40,120	42	7,989
8	Ku.	22	1,730	13	1,151	(9)	(579)
9	L.	165	12,839	180	15,891	15	3,052
10	Sh.	249	19,329	246	21,674	(3)	2,345
11	T.	2,753	214,084	2,868	252,749	115	38,665
12	V.	664	51,601	763	67,269	100	15,668
	Totali	6,438	500,628	6,506	573,359	68	72,731

Burimi i të dhënave ISSH, punuar nga grupi i KLSH

Të ardhura të tjera: Këto të ardhura për vitin 2022, janë realizuar në shumën 767,951 mijë lekë, nga 320,000 mijë lekë të planifikuara dhe përbëhen nga:

Tabela nr.3.24 “Të ardhura të tjera ISSH”

Në mijë lekë

Nr.	Përshkrimi	Shuma
1	Të ardhura nga interesat	344,339
2	Të ardhura nga gjoba	130,561
3	Të ardhura nga komisione për shërbime	346
4	Të ardhura dytësore	110
	Të ardhura nga qiraja	72
5	Të tjera të ardhura	292,523
6	Totali	767,951

Burimi i të dhënave ISSH, punuar nga grupi i KLSH

Të ardhurat e tjera të realizuara nga ISSH, përfshijnë të ardhurat nga interesat e depozitave në shumën 123,440 mijë lekë, të blerjes së titujve të qeverisë në shumën 220,899 mijë lekë, si dhe të ardhura të tjera jo tatimore.

Kontributet nga interesat dhe nga ankandet e titujve janë audituar mbështetur në:

- Udhëzimin nr.30, datë 26.12.2013 të Ministrisë së Financave “Për emetimin nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë të bonove të Thesarit në formë regjistrimi”;
- Marrëveshje për organizimin e ankandëve të titujve të shtetit shqiptar, shlyerjen e veprimeve, dhe mbajtjen e regjistrit të këtyre titujve, ndryshuar më datë 06.07.2018 me nr. 3632 prot. i BSH dhe nr.12981 prot. MFE.

Me shkresat e Bankës së Shqipërisë/Departamenti i Operacioneve Monetare, ka njoftuar ISSH për regjistrin e titujve dhe maturimin në datat e përcaktuara në portofolin bashkëlidhur shkresave. Procesi i kontabilizimit të këtyre vlerave ka ndjekur këtë rrugë:

- Njoftimin zyrtar të BOA për zhvillimin e ankandit;
- Shkresa e Drejtorit të Përgjithshëm/Drejtoria e Financës/Spektori i Buxhetit të Brendshëm, drejtuar BOA “Kërkesë për pjesëmarrje në titujt e qeverisë”;
- Vërtetimin për shpalljen e fituesit;
- Portofolin e BOA të nxjerrë për ISSH;
- Regjistrimin e tyre në ditarin e të ardhurave;
- Rakordimin periodik me BOA për gjendjen e llogarisë së fondit rezervë të ISSH.

U verifikuan dhe audituan gjithë lëvizjet e vitit 2022 dhe rezultoi e regjistruar brenda kuadrit rregullator. Sipas nxjerrjes së llogarive nga Banka e Shqipërisë dhe MFE, gjendja në fund të vitit 2022 rezulton në shumën 21,388,125 lekë, si dhe është e paraqitur në Pasqyrat financiare të ISSH në mënyrë të drejtë dhe të saktë.

Për vitin 2022 janë bërë 12 transferta nga Banka e Shqipërisë për pjesëmarrjen në blerjen e titujve të qeverisë, ku është investuar shuma 18,615,730 mijë lekë, nga 19,363,730 mijë lekë të investuara në total, duke përfutur një interes neto pas zbritjes së vlerës së tatimit mbi të ardhurat, në shumën 220,899 mijë lekë.

Gjendja e vlerës monetare dhe titujve në fund të periudhës është e konfirmuar sipas të dhënave nga sistemi Oracle për shumën 40,617,139 mijë lekë e pasqyruar në Pasqyrat Financiare të Konsoliduara të vitit 2022, nga e cila Bono Thesari në shumën 19,363,730 mijë lekë.

Të ardhurat e krijuara nga investimi i ISSH në blerjen e titujve financiarë (bono thesari dhe obligacione) përbëjnë fondin rezervë, në bazë të Rregullores Financiare të Institutit të Sigurimeve Shoqërore nr. 5 datë 25.05.2009, Kreu II, pika c.

Aktualisht fondi rezervë i ISSH është i plotësuar në normativën ligjore për mbulimin e pagesave të pensioneve për një muaj. I gjithë fondi rezervë është i investuar në kontrata “Qeveritare” pa risk, ashtu si është përcaktuar në Rregulloren Financiare të ISSH nr. 5/2008, Kreu II “Fondi rezervë i Sigurimeve Shoqërore”, ku ndër të tjera është përcaktuar; Statusi i Fondit rezervë, mënyra e krijimit, politikat e investimeve, personat që autorizojnë investimin e fondit.

Politikat e investimit të Fondit Rezervë të Sigurimeve Shoqërore janë bazuar mbi parimin e sigurisë dhe kujdesit. Asetet e këtij fondi janë investuar në instrumente financiare publike të cilët paraqesin siguri dhe kthim të përshtatshëm nga investimi duke ruajtur një raport optimal ndërmjet riskut të marrë përsipër dhe kthimit nga investimi.

Politika e investimit të Fondit Rezervë të Sigurimeve Shoqërore ka krijuar një strategji të shpërndarjes së aseteve të fondit duke krijuar një portofol investimesh të përbërë nga tituj shtetërorë të emetuara ose të garantuara nga Banka e Shqipërisë. Portofoli përbëhet nga:

- Bono Thesari me maturitet 3,6 dhe 12 muaj
- Obligacione me maturitet 2 dhe 3 vjeçare

Tabela 3.25. Portofoli i investimit të fondit rezerve të ISSH-së

Portofoli i investimit / mijë lekë			
Periudha	Bono Thesari	Obligacion	Totali
Vitet	12muaj	2Vjeçar	
2021	9,527,740	3,200,900	12,728,640
2022	13,662,830	5,700,900	19,363,730

Burimi i të dhënave ISSH, punuar nga grupi i KLSH

Portofoli i investuar i fondit rezervë ka pësuar ndryshime dhe rritje nga vitit 2021-2022. Këto ndryshime kanë ardhur si pasojë e ndryshimeve të ligjit të Sigurimeve Shoqërore, dhe rritjes së shpenzimeve të ISSH-së si rezultat i indeksimit të pensioneve çdo vit, gjë e cila ka sjellë rritjen e përvitshme të portofolit të investuar dhe të fondit rezervë.

Nga sa më sipër evidentohet se interesat neto të ardhura nga portofoli i investimit nga viti në vit ka pasur rritje, edhe në vitin 2022 krahasuar me vitin 2021. Kjo rritje ka ardhur si pasojë rritjes në vlerë të fondit Rezervë gjatë viteve si edhe për shkak të diversifikimit të investimit dhe afateve të maturimit.

2. Programimi dhe realizimi i shpenzimeve, në nivel ISSH dhe struktura rajonale:

Nga ana e ISSH, financimi i shpenzimeve të buxhetit të sigurimeve shoqërore për vitin 2022 është planifikuar të mbulohet nga kontributet e sigurimeve shoqërore në shumën 104,009 milionë lekë dhe nga buxheti të shtetit në shumën 62,872 milionë lekë, në total në shumën 166,881 milionë lekë. Për shkak se realizimi faktik i shpenzimeve për vitin 2022, është në shumën 163,037 milionë lekë, ose 3,844 milionë lekë më pak se plani dhe të ardhurat e realizuara janë në shumën 168,527 milionë lekë, ose 1,647 milionë lekë më shumë se plani, financimi i shpenzimeve është mbuluar në shumën 105,656 milionë lekë nga kontributet dhe 57,381 milionë lekë me financim nga buxheti i shtetit, **ose 5,492 milionë lekë më pak se planifikimi.**

Tabela nr. 3.26 “Plani dhe fakti i shpenzimeve për vitin 2022”

Nr.	Shpenzimet	Plan	Fakt	Mijë lekë	
				Diferenca	Në %
I	Transferta për buxhetet familjare e individët	163,858,684	160,211,797	3,646,887	97.8
1	Shpenzime për përfitime	132,721,393	131,864,165	857,228	99.4
2	Shpenzime për programe te veçanta shtetërore	23,313,386	21,622,192	1,691,194	92.7
3	Shpenzime për programe e skema suplementare	7,823,905	6,725,441	1,098,464	86.0
II	Shpenzime administrative	3,022,290	2,824,916	197,374	93.5
	Totali (I+II)	166,880,974	163,036,713	3,844,261	97.7

Burimi i të dhënave ISSH, punuar nga grupi i KLSH

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme ka rezultuar se gjatë vitit 2022, nuk është krijuar deficit nga skema, pasi referuar programeve nuk kemi tejkalim të shpenzimeve kundrejt fondeve të planifikuara, gjë e cila është reflektuar nga çdo rajon.

Nga rakordimi i planit dhe faktit të shpenzimeve me treguesit fiskalë të konsoliduar të buxhetit të shtetit dhe raportimit të ISSH, ka rezultuar se, **ka një diferencë në shumën 11,946 milionë**

lekë. ISSH ka rakorduar me Degën e Thesarit Tiranë për fondet e alokuara nga buxheti i shtetit në shumën 62,872 milionë lekë, sipas Aktrakordimit, ku në shkresën përcjellëse nr. 160, datë 09.01.2023 të Aktrakordimit është cilësuar: “Mbështetur në ligjin nr. 115/2021 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2022” dhe në vijim të Udhëzimit të MFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar bashkëlidhur shkresës dërgojmë akt rakordimin për financimin e Buxhetit të Shtetit sipas grupit, titullit, artikullit dhe llogarisë ekonomike për periudhën 12 mujore të vitit 2022”.

Tabela nr.3.27 “Plan/fakt shpenzime sipas MFE & ISSH”

Nr.	Përshkrimi	MFE		ISSH		Diferenca	
		Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt
I	Gjithsej	154,935	163,037	166,881	163,037	11,946	0
1	Të ardhura nga kontributet			104,009			
2	Financimi i buxhetit			62,872			
II	Diferenca sipas vendimeve					11,946	
1	VKM nr. 654, datë 10.10.2022					2,060	
2	VKM nr. 159, datë 12.03.2022					3,884	
3	VKM nr. 897, datë 29.12.2022					5,605	
4	VKM nr. 753, datë 01.12.2022					397	

Burimi i të dhënave ISSH, punuar nga grupi i KLSH

Konkluzion: Nga verifikimi i të dhënave mbi planin dhe faktin e shpenzimeve për ISSH, në raport me treguesit fiskalë të konsoliduar të Buxhetit të Shtetit, të raportuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, është evidentuar se:

-përsa i përket planit, **midis dy institucione ka një mos rakordim në shumën 11,946 milionë lekë.** Sipas të dhënave të ISSH, referuar gjithë akteve ligjore dhe nënligjore mbi alokimin e fondeve, plani i shpenzimeve është në shumën 166,881 milionë lekë referuar AN-ve dhe VKM-ve, ndërsa nga MFE është raportuar në shumën 154,935 milionë lekë, ku përfshihen fondet e alokuara me AN dhe dy VKM të përfshira në këto akte. **Kjo diferencë ju përket shtesave në buxhetin e ISSH me VKM, në lidhje me financimin e programeve të veçanta, të detajuar në tabelën e mësipërme.**

- përsa i përket faktit të shpenzimet e paraqitura nga ISSH, janë të rakorduara me të dhënat e MFE, referuar tabelës “Treguesit fiskalë të konsoliduar të Buxhetit të Shtetit”, për shumën 163,036,713 mijë lekë, me të dhënat e raportuara nga ISSH, si dhe me të dhënat e Pasqyrave Financiare të ISSH për vitin 2022, ku shpenzimet sipas Pasqyrës së Performancës Financiare, paraqiten në shumën 163,036,713 mijë lekë.

Tabela nr.3.28 “Realizimi i shpenzimeve analitikisht viti 2022”

		Në mijë lekë			
	SHPENZIMET	Plan	Fakt	Diferenca	%
A	Transferta për buxhetet familjare e individët (I+II+III)	163,858,684	160,211,797	(3,646,887)	97.8
I	Shpenzime për përfitime	132,721,393	131,864,165	(857,228)	99.4
1	Kompensim për paaftësi të përkohshme për shkak të sëmundjes	538,261	589,436	51,175	109.5
2	Kompensim për leje lindje	4,475,929	4,444,795	(31,134)	99.3
	- Barre lindje qytet	3,796,921	3,854,957		101.5
	- Barre lindje fshat	679,008	589,837		86.9
3	Totali shpenzimeve për pensione	127,680,989	126,806,695	(874,294)	99.3
	- Pensione qyteti	115,060,626	114,339,288	(721,338)	99.4
	- Pensione fshati	12,620,363	12,467,407	(152,956)	98.8
4	Kompensim për paaftësi për shkak të dëmtimit në punë	26,213	23,239	(2,975)	88.7
II	Shpenzime për programe të veçanta shtetërore	23,313,386	21,622,192	(1,691,194)	92.7
1	Kompensim supl. Për çmimet për pensionistët	22,853,608	21,261,544		93.0
	- Kompensim supl. Për çmimet për pensionistët qytet	21,982,297	20,435,629	(1,546,668)	92.9
	- Kompensim supl. Për çmimet për pensionistët fshat	871,311	825,915	(45,396)	94.8
2	Pensione të veçanta shtetërore	88,072	94,233	6,161	107.0
3	Pensione sociale (ishte-kompensim për ish të persektuarit)	198,432	182,593	(15,839)	92.0
4	Kompensim për veteranet e luftës	79,062	50,125	(28,937)	63.4
5	Kompensim suplementar për çmimin e karburantit	94,212	33,697	(60,515)	35.8
III	Shpenzime për programe e skema suplementare	7,823,906	6,725,441	(1,098,465)	86.0

1	Sigurim suplementar për ish-ushtaraket	4,024,084	3,729,845	(294,239)	92.7
2	Përfitime për policinë e shtetit		19,454	19,454	
3	Trajtime te veçanta për pilotet	73,018	78,397	5,379	107.4
4	Përfitime për ushtaraket e nëndetëseve ne pension.	12,528	11,617	(910)	92.7
5	Shpenzime për statusin e dëshmor i atdheut	28,662	30,070	1,408	104.9
6	Trajtime te veçanta për punonjësit e industrisë ushtarake	65,248	77,572	12,325	118.9
7	Transferata te tjera tek individët (shpenzime për statusin e profesorit)	213,056	189,795	(23,261)	89.1
8	Sigurim suplementar shtetëror për ish funksionaret	963,725	882,091	(81,634)	91.5
9	Pagesa te parakohshme për minatorët	1,273,609	959,456	(314,153)	75.3
10	Pagesa te parakohshme për naftëtarin	774,672	494,696	(279,976)	63.9
11	Pagesa te parakohshme për metalurgun	134,356	77,455	(56,901)	57.6
12	Transferata te tjera tek individët (shpenzime funerali)	260,948	174,991	(85,957)	67.1
B	Shpenzime administrative	3,022,290	2,824,916	(197,374)	93.5
1	Paga, shpërblime, dhe shpenzime të tjera personeli	1,105,572	1,075,597	(29,976)	97.3
2	Kontribute për sigurime shoqërore e shëndetësore	173,072	168,510	(4,562)	97.4
3	Mallra dhe shërbime te tjera	1,364,356	1,267,455	(96,901)	92.9
4	Shpenzime për rritjen e aktiveve te qëndrueshme te trupëzuara	379,290	313,354	(65,936)	82.6
	Totali (A+B)	166,880,974	163,036,713	(3,844,261)	97.7

Burimi i të dhënave ISSH, punuar nga grupi i KLSH

Analizë e treguesve të realizimit të shpenzimeve:

Tabela nr.29 “Realizimi i shpenzimeve F/P, 2022”

Në mijë lekë

Nr.	Shpenzimet	Plan	Fakt	Diferenca	Në %
I	Transferata për buxhetet familjare e individët	163,858,684	160,211,797	3,646,887	97.8
1	Shpenzime për përfitime	132,721,393	131,864,165	857,228	99.4
2	Shpenzime për programe te veçanta shtetërore	23,313,386	21,622,192	1,691,194	92.7
3	Shpenzime për programe e skema suplementare	7,823,905	6,725,441	1,098,464	86.0
II	Shpenzime administrative	3,022,290	2,824,916	197,374	93.5
	Totali (I+II)	166,880,974	163,036,713	3,844,261	97.7
	Rezultati fiskal		5,491,796		

Burimi i të dhënave ISSH, punuar nga grupi i KLSH

- **Transfertat në buxhetet familjare** janë planifikuar në shumën 163,859 milionë lekë dhe zënë 98.2 % të totalit të shpenzimeve. Realizimi i tyre në vitin 2022 është në masën 97.8 % kundrejt planit dhe për të tre programet, ndahet si më poshtë:
 - **Shpenzimet për përfitime** janë planifikuar në shumën 132,721 milionë lekë dhe zënë 81 % të totalit të transfertave në buxhetet familjare. Realizimi i tij në vitin 2022, është në shumën 131,864 milionë lekë, ose në masën 99.4 % kundrejt planit. Sigurimi i detyrueshëm financohet nga kontributet e drejtpërdrejta të personave juridik dhe fizikë që parashikohen si dhe nga financimet e shtetit për ushtarakët, asistentët e paraplegjikëve, diferenca e kontributit të fermerëve, periudha e njohur e sigurimit për gratë që kanë kryer shkollën e lartë, si dhe nga financimet për mbulimin e deficitit të degës së pensioneve.
 - **Shpenzimet për programet e veçanta shtetërore**, janë planifikuar në shumën 23,313 milionë lekë dhe zënë 14.2 % të totalit të transfertave në buxhetet familjare. Realizimi i tyre në vitin 2022 paraqitet në shumën 21,622 milionë lekë, ose në masën 92.7 % kundrejt planit. Financimi i tyre kryhet nga buxheti i shtetit.
 - **Sigurimi suplementar dhe trajtimet e veçanta** janë planifikuar në shumën 7,823 milionë lekë dhe zënë 4.8 % të totalit të transfertave në buxhetet familjare. Shpenzimet për skemat suplementare përgjithësisht financohen nga buxheti i shtetit dhe një pjesë e tyre nga kontributet suplementare të punonjësve të lartë të shtetit, personave që kryejnë funksione kushtetuese, ushtarakët, policia dhe struktura të tjera në varësi të Ministrisë së Brendshme.
- **Buxheti administrativ**, është planifikuar në shumën 3,020 milionë lekë dhe zë 1.8 % të totalit të shpenzimeve të ISSH. Realizimi i tyre paraqitet në shumën 2,825 milionë lekë, ose në masën 93.5 % kundrejt planit.

Administrimi i shpenzimeve për përfitime në vitin 2022 është realizuar në masën 99.4 % dhe i detajuar paraqitet më poshtë:

Tabela nr.3.30. “Shpenzimet për përfitime”

Në mijë lekë

Nr.	Përshkrimi	Plan	Fakt	Diferenca	Në %
I	Shpenzime për përfitime	132,721,393	131,864,165	(857,228)	99.4
1	Kompensim për paaftësi të përkohshme për shkak të sëmundjes	538,261	589,436	51,175	109.5
2	Kompensim për leje lindje	4,475,929	4,444,795	(31,134)	99.3
	- Barre lindje qytet	3,796,921	3,854,957	58,036	101.5
	- Barre lindje fshat	679,008	589,837	(89,171)	86.9
3	Totali shpenzimeve për pensione	127,680,989	126,806,695	(874,294)	99.3
	- Pensione qyteti	115,060,626	114,339,288	(721,338)	99.4
	- Pensione fshati	12,620,363	12,467,407	(152,956)	98.8
4	Kompensim për paaftësi, për shkak të dëmtimit në punë	26,213	23,239	(2,975)	88.7

Burimi i të dhënave ISSH, punuar nga grupi i KLSH

Administrimi i Përfitimeve dhe Transfertave në Buxhetet Familjeve (shpenzimet për përfitime) për vitin 2022, konsiston në pagesa për pensione, sëmundje, barrë lindje, aksidente, programeve të veçanta të qeverisë, etj. Administrimi i buxhetit dhe mbajtja e shpenzimeve në limitet e programuara ka qenë një nga detyrat e punës së administratës së ISSH. Nga të dhënat e tabelës së mësipërme rezultojnë se brenda zërave të shpenzimeve për përfitime kemi tejkalim të planit për shpenzime për kompensim për paaftësi të përkohshme për shkak të sëmundjes me 9.5 % më shumë se plani dhe të shpenzimeve për barrë lindje në qytet me 1.5 % më shumë se plani, ndërsa shpenzimet për pensione të cilat zënë dhe peshën specifike më të lartë kundrejt totalit të shpenzimeve për përfitime, janë realizuar në masën 99.3 % kundrejt planit.

Administrimi i shpenzimeve për programe të veçanta në vitin 2022 është realizuar në masën 92.7 % dhe i detajuar paraqitet më poshtë:

Tabela nr. 3.31. “Shpenzimet për programe të veçanta”

Në mijë lekë

Nr.	Përshkrimi	Plani	Fakti	Diferenca	Në %
II	Shpenzime për programe të veçanta shtetërore	23,313,386	21,622,192	(1,691,194)	92.7
1	Kompensim supl. Për çmimet për pensionistët	22,853,608	21,261,544		93.0
	- Kompensim supl. Për çmimet për pensionistët qytet	21,982,297	20,435,629	(1,546,668)	92.9
	- Kompensim supl. Për çmimet për pensionistët fshat	871,311	825,915	(45,396)	94.8
2	Pensione të veçanta shtetërore	88,072	94,233	6,161	107.0
3	Pensione sociale (ishte-kompensim për ish të persekutuariat)	198,432	182,593	(15,839)	92.0
4	Kompensim për veteranët e luftës	79,062	50,125	(28,937)	63.4
5	Kompensim suplementar për çmimin e karburantit	94,212	33,697	(60,515)	35.8

Burimi i të dhënave ISSH, punuar nga grupi i KLSH

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme rezultojnë se brenda zërave të shpenzimeve për programe të veçanta kemi tejkalim të planit për shpenzime për pensione të veçanta me 7 % më shumë se plani, ndërsa gjithë treguesit e tjerë janë nën shpenzimet e planifikuara. Një ndikim të konsiderueshëm në uljen e shpenzimeve ka patur zëri “Kompensim suplementar për çmimet për pensionistët në qytet, në shumën 1,691,194 mijë lekë më pak.

Administrimi i shpenzimeve për programe e skema suplementare në vitin 2022 është realizuar në masën 86 % dhe i detajuar paraqitet më poshtë:

Tabela nr. 3.32 “Shpenzimet për programe e skema suplementare”

Në mijë lekë

Nr.	Përshkrimi	Plani	Fakti	Diferenca	Në %
III	Shpenzime për programe e skema suplementare	7,823,906	6,725,441	(1,098,465)	86.0
1	Sigurim suplementar për ish-ushtarakët	4,024,084	3,729,845	(294,239)	92.7
2	Përfitime për policinë e shtetit		19,454	19,454	
3	Trajtime të veçanta për pilotët	73,018	78,397	5,379	107.4
4	Përfitime për ushtarakët e nëndetësve në pension.	12,528	11,617	(910)	92.7

5	Shpenzime për statusin e dëshmor i atdheut	28,662	30,070	1,408	104.9
6	Trajtime të veçanta për punonjësit e industrisë ushtarake	65,248	77,572	12,325	118.9
7	Transferta të tjera tek individët (shpenzime për statusin e profesorit)	213,056	189,795	(23,261)	89.1
8	Sigurim suplementar shtetëror për ish funksionaret	963,725	882,091	(81,634)	91.5
9	Pagesa të parakohshme për minatorët	1,273,609	959,456	(314,153)	75.3
10	Pagesa të parakohshme për naftëtarin	774,672	494,696	(279,976)	63.9
11	Pagesa të parakohshme për metalurgun	134,356	77,455	(56,901)	57.6
12	Transferta të tjera tek individët (shpenzime funerali)	260,948	174,991	(85,957)	67.1
B	Shpenzime administrative	3,022,290	2,824,916	(197,374)	93.5

Burimi i të dhënave ISSH, punuar nga grupi i KLSH

Nga të dhënat e tabelës së mësipërme rezulton se shpenzimet për këtë kategori janë realizuar në masën 86 % kundrejt planit, ose në shumën **1,098,465 mijë lekë më pak**. Brenda zërave të shpenzimeve për programe e skema suplementare në të gjithë zërat me peshë specifike më të lartë kundrejt totali nuk kemi tejkalim të shpenzimeve. Në këtë kategori të shpenzimeve rezultojnë me tejkalim zëri “Trajtime të veçanta për pilotët” me 7.4 %, shpenzime për statusin dëshmor i atdheut, me 4.9 % dhe trajtime të veçanta për punonjësit e industrisë ushtarake, me 18.9 %.

3. Rezultati fiskal vjetor, deficitit dhe mbulimi i tij:

Politikat buxhetore të sistemit të sigurimit shoqëror zbatohen nëpërmjet 3 (tre) programeve kryesore: “Sigurimi Shoqëror i Detyrueshëm” që zë 82.3% të fondit të përgjithshëm, “Sigurimi Suplementar” me 4.2% dhe “Programet Kompensuese të Shtetit dhe Trajtimet e Veçanta” që zënë 13.5% të fondit të përgjithshëm të sigurimit shoqëror, i cili për vitin 2022 ishte 163,036 milionë lekë.

Instituti i Sigurimeve Shoqërore, përveç administrimit të sistemit të sigurimit shoqëror të detyrueshëm, është i ngarkuar me ligj të administrojë edhe disa skema programore dhe suplementare të përcaktuara, buxheti vjetor i të cilave programohet dhe mbyllet çdo vit pa diferencë, nëpërmjet mbulimit të shpenzimeve me kontribute suplementare dhe financim me destinacion. Rezultati financiar i këtyre skemave sistemohet brenda bilancit vjetor të ISSH, sipas kompetencës së përcaktuar në nenin 4 të Ligjit “Për buxhetin e Shtetit të vitit 2022”.

Rezultati fiskal vjetor përlllogaritet si diferencë midis të ardhurave faktike dhe shpenzimeve faktike të vitit 2022 dhe rezulton në shumën 5,491,796 mijë lekë. Rezultati fiskal dhe deficitit për vitin 2022, paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. 3.33 “Rezultati fiskal”

Në mijë lekë					
	Shpenzimet	Plan	Fakt	Diferenca	%
A	Transferta për buxhetet familjare e individët	163,858,684	160,211,797	(3,646,887)	97.8
1	Shpenzime për përfitime	132,721,393	131,864,165	(857,228)	99.4
2	Shpenzime për programe të veçanta shtetërore	23,313,386	21,622,192	(1,691,194)	92.7
3	Shpenzime për programe e skema suplementare	7,823,906	6,725,441	(1,098,465)	86.0
B	Shpenzime administrative	3,022,290	2,824,916	(197,374)	93.5
	Totali (A+B)	166,880,974	163,036,713	(3,844,261)	97.7
C	Të ardhura në fakt	168,528,509			
D	Rezultati fiskal {C-A+B (fakt)}		5,491,796		
E	Financimi i planifikuar dhe tërhequr	62,871,909			
F	Financimi i nevojshëm (E-D)		57,380,113		

Burimi i të dhënave ISSH, punuar nga grupi i KLSH

- Nga tabela e mësipërme konstatojmë se, nevojat për financimin e shpenzimeve të vitit, janë ulur në vlerën **3,844 milionë lekë**. Gjatë vitit 2022 nuk ka rezultuar tejkalim i shpenzimeve sipas programeve, si dhe në total ato paraqiten me një realizim në masën 97.7 %.

- Gjithashtu gjatë vitit 2022, kemi tejkalim të realizimit të të ardhurave nga kontributet, të cilat ishin planifikuar në shumën 104,009 milionë lekë dhe u realizuan në shumën 105,656 milionë lekë, me një tejkalim në shumën **1,647 milionë lekë** më shumë.

Tejkalimi i realizimit të të ardhurave në shumën 1,647 milionë lekë dhe mosrealizimi i shpenzimeve në shumën 3,844 milionë lekë, japin rezultatin fiskal të sistemit për vitin 2022 në shumën 5,491 milionë lekë.

Titulli i gjetjes 2: Mbi rakordimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të ISSH me DPT dhe MFE.

Situata: Nga auditimi mbi saktësinë e raportimit të planit dhe faktit të të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe rezultatit fiskal të ISSH ka rezultuar se:

1. Nga krahasimi i të ardhurave të realizuara nga ISSH (kontributet/të ardhura tatimore) dhe të dhënave të Tabelës së treguesve fiskalë të konsoliduar të Buxhetit të Shtetit, Kapitulli II.3 “Të ardhurat nga fondet speciale”, **rezulton se fakti i të ardhurave nuk është i rakorduar.** Sipas të dhënave të MFE fakti i të ardhurave nga fondet speciale (sigurimet shoqërore) paraqiten në vlerën 105,640 milionë lekë, nga ISSH, janë deklaruar 105,656 milionë lekë, ose 16 milionë lekë më shumë.
2. Sipas shkresës së MFE nr. 738, datë 27.01.2023 “Mbi rakordimin e të ardhurave të realizuara nga kontributet për sigurimet Shoqërore nga DPT për vitin 2022” midis të dhënave të DPT dhe të dhënave të rakorduara midis ISSH me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë mbi të ardhurat nga kontributet për sigurimet rezulton një diferencë në shumën 88,553 lekë, është pakësim i të ardhurave në debi të llog.75. **Ky sistemim i rakorduar midis ISSH dhe MFE, nuk është reflektuar në të dhënat e DPT.** Të ardhurat nga kontributet janë në shumën 102,034,556 mijë lekë.
3. Nga verifikimi i të dhënave mbi planin dhe faktin e shpenzimeve për ISSH, në raport me treguesit fiskalë të konsoliduar të Buxhetit të Shtetit, të raportuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, është evidentuar se përse i përket planit, **midis dy institucione ka një mos rakordim në shumën 11,946 milionë lekë.** Sipas të dhënave të ISSH, referuar gjithë akteve ligjore dhe nënligjore mbi alokimin e fondeve, plani i shpenzimeve është në shumën 166,881 milionë lekë referuar AN-ve dhe VKM-ve, ndërsa nga MFE është raportuar në shumën 154,935 milionë lekë, ku përfshihen fondet e alokuara me AN dhe dy VKM të përfshira në këto akte. **Kjo diferencë ju përket shtesave në buxhetin e ISSH me VKM, në lidhje me financimin e programeve të veçanta.**

Kriteri:

- Ligji 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022” dhe VKM si më poshtë:
- Nr. 654, datë 10.10.2022
- Nr. 159, datë 12.03.2022
- Nr. 897, datë 29.12.2022
- Nr. 753, datë 01.12.2022

Shkaku: Aktrakordimi i thesarit mbi financimin nga buxheti i shtetit. Klasifikim i fondeve për programe të veçanta të alokuara ISSH, nga ana e MFE.

Ndikimi/pasoja: Mos rakordimi i faktit të të ardhurave dhe planit të shpenzimeve (për fondet si transfertë e buxhetit të shtetit për ISSH), me Tabelën e Treguesve Fiskalë të Konsoliduar të Buxhetit të Shtetit, nuk pasqyron shifrat reale dhe për rrjedhojë dhe analizat e treguesve fakt/plan.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Titullari i ISSH dhe Drejtoria e Financës, të marrin masa që në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të shqyrtojnë mospërputhjet me Treguesit e Fiskalë të Konsoliduar të Buxhetit të Shtetit, përsa i përket fondeve për ISSH, të raportuara në Kapitullin II “Të ardhurave tatimore”; II.3.1 “Të ardhura nga Fondet Speciale” (ISSH) dhe në Kapitullin I “Shpenzimet korente”, pika 5 “Shpenzimet për fondet speciale” (ISSH).

4. Detyrimet e papaguara

Detyrimet kundrejt ISSH krijohen nga detyrime të kontribuuesve, të cilët derdhin detyrimet në DPT dhe nga detyrime të kontribuuesve të cilët derdhin kontributet në ISSH, si dhe nga përfitime të marra më tepër.

4.1.Detyrimet e papaguara, nga sektorët sipas DPT.

Tabela nr.3.34 “Gjendja e debitorëve sipas sektorëve DPT”

Në lekë

Nr.	Përshkrimi	Viti 2021		Viti 2022		2022/2021 (Diferenca)	
		Numër	Vlerë	Numër	Vlerë	Numër	Vlerë
I	Sektori publik	663	790,560,124	668	772,684,988	5	17,875,136
1	Buxhetorë	384	341,464,009	370	382,592,470	14	41,128,461
2	Jo buxhetorë	279	449,096,115	298	390,092,518	19	59,003,597
II	Sektori privat	102,965	15,076,176,612	8,442	16,355,848,628	5,477	1,279,672,016
1	Biznes i madh	25,074	9,590,978,975	26,669	9,930,047,677	1,595	339,068,702
2	Biznes i vogël	77,891	5,485,197,637	81,773	6,425,800,951	3,882	940,603,314
III	Totali (I+II)	103,628	15,866,736,736	109,110	17,128,533,616	5,482	1,261,796,880

Burimi i të dhënave ISSH, punuar nga grupi i KLSH

Nga analiza e tabelës shihet se, ka një rritje të konsiderueshme të numrit të subjekteve debitorë, prej 5,482 subjektësh si dhe një rritje të detyrimeve të prapambetura me 1,261,797 mijë lekë nga 1,474,616 mijë lekë që janë rritur në vitin 2021 në krahasim me vitin 2020, duke rezultuar me një tren rënës të rritjes.

Në analizë të detyrimeve të prapambetura të subjekteve debitorë, në organet tatimore, vihet re numri i lartë i subjekteve debitorë dhe detyrime të mëdha, për kontribute të papaguara nga këto subjekte. Numri i tyre deri më 31.12.2022 është 109,110 subjekte debitorë dhe detyrimet kontributeve të prapambetura të tyre janë rreth 17,128,533 mijë lekë nga 15,866,737 mijë lekë në fund të vitit 2021.

Numri i lartë i subjekteve me detyrime të papaguara, përmban në vetvete dy risqe, atë financiar dhe social pasi:

- Detyrimet e papaguara nga subjektet debitorë në lidhje më shumë e papaguara të kontributeve, përfaqësojnë një numër i konsiderueshëm personash, të punësuar në këto subjekte, të cilët nuk mund të përfitojnë nga skema e sigurimeve shoqërore;
- Deri në 31.12.2022, fondit të sigurimeve shoqërore nuk i janë vënë në dispozicion rreth 17,128,533 mijë lekë detyrime të prapambetura që ju përkasin mbi 109,110 subjekteve debitorë.

Për të administruar sa më mirë sigurimet shoqërore duhet që të bëhet dhe mbledhja e detyrimeve që kanë subjektet për sigurimet shoqërore, duke qenë se kontributet e sigurimeve shoqërore, llogariten, deklarohen dhe paguhen brenda datës 20, të muajit pasardhës për të parë gjendjen e detyrimeve për sigurimet shoqërore, është marrë në analizë gjendja e tyre e 26.01.2023, e cila paraqitet si në tabelën më poshtë:

Tabela nr.3.35. “Detyrimet e sigurimeve shoqërore të papaguara, sipas njësive për vitin 2022

Nr.	Subjektet	Numri i subjekteve sipas NIPT-it	Detyrimi	Gjoha	Interesa	Debia	Në %
1	Buxhetoret	370	110,655,216	97,562,896	174,374,358	382,592,470	2%
2	Jo buxhetorët	298	277,387,165	78,238,378	34,466,975	390,092,518	2%
3	Subjekte juridike	26,669	8,316,489,314	1,082,324,337	531,234,026	9,930,047,677	58%
4	Biznes i Vogël	81,773	5,649,547,679	643,871,808	132,381,464	6,425,800,951	38%
	TOTAL	109,110	14,354,079,374	1,901,997,419	872,456,823	17,128,533,616	100%

Burimi i të dhënave ISSH, punuar nga grupi i KLSH

Nga tabela më sipër vihet re se shuma totale e debitorëve të ISSH rezulton të jetë 14,354,079,374 lekë dhe bashkë me interesa dhe gjoha totali shkon në 17,128,533,616 lekë, 58% e këtyre debitorëve janë subjekte juridikë dhe 38% bizneset e vogla.

Mbështetur në Ligjin nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, sipas përcaktimeve të nenit 3 “Përgjegjësia për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme” përcaktohet se: “Kontributet mbledhen nga organet tatimore për llogari të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve të tjera nënligjore” dhe në nenin 14 “Masat shtrënguese” përcaktohet se: “Nëse kontributet nuk paguhen në kohë, organi përkatës ka të drejtë të marrë masa shtrënguese, në përputhje me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

ISSH ka trajtuar në mënyrë analitike situatën lidhur me detyrimet e prapambetura të kontributeve të sigurimeve shoqërore shifër e konsiderueshme në numër debitorësh por dhe në shumë të debisë, në total për të katër kategoritë e biznesit dhe i është drejtuar gjatë vitit 2022, Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me shkresat nr. 2542 prot., datë 11.04.2022, nr. 3727 prot., datë 30.05.2022 dhe nr. 5891 prot., datë 26.08.2022 me objekt problematikat që lindin nga detyrimet e prapambetura përsa i përket kontributeve të sigurimeve shoqërore.

Në tabelat anekse nr. 3.36; 3.37, 3.38 dhe 3.39) është paraqitur në mënyrë më të detajuar situata e detyrimeve mbi subjektet me detyrime të papaguara referuar strukturës së borxhit (principal + gjoha + kamatëvonesa).

Referuar të dhënave të detajuara të tabelave anekse të cituara më lart rezulton se në të gjitha kategoritë e subjekteve kontribuese (në DPT), peshën specifike më të lartë kundrejt totalit të detyrimeve e kanë përgjithësisht DRSSH T., D., Sh., V. dhe K., më konkretisht:

- Detyrime të institucioneve buxhetore, DRSSH Tiranë zë 75.7 % dhe DRSSH K. zë 14.1 % ndaj totalit.
- Detyrime të institucioneve jo buxhetore, DRSSH V. me 16 %, Sh. me 15 %, T. me 14 % dhe K. me 13 % ndaj totalit të detyrimeve.
- Detyrime subjekte juridike, DRSSH T. zë 56.4 % dhe DRSSH D. 11.9 % të detyrimeve kundrejt totalit;
- Detyrime Biznes i Vogël, DRSSH T. 43.2 %, DRSSH D. 13.6 % dhe F. me 6.8% ndaj totalit të tyre.

4.2. Debitorët e krijuar nga të vetë punësuarit në bujqësi, të cilët derdhin kontribute në ISSH.

Nga të dhënat e ISSH gjendja e detyrimeve në 31.12.2022 është në shumën 6,067,420,272 lekë, kuadruar me Pasqyrat Financiare të Konsoliduara “Të tjera kërkesa debitorë” në shumën totale 6,067,420,272 lekë dhe që përbëhet nga:

- detyrime nga përfitimet në shumën 5,170,292,772 lekë;
- detyrime nga kontributet në shumën 897,127,501 lekë.

Lëvizja e detyrimeve gjatë vitit 2022 paraqitet më poshtë:

Tabela nr.3.40. “Debitorët për kontribute pranë ISSH”

Në lekë

Përshkrimi	Shuma
Gjendje në fillim te periudhës	6,081,846,440
Shtesa	643,922,095
Pakësimi	(658,348,263)
Gjendja në fund të vitit	6,067,420,272
Pakësimi	(14,426,168)

Burimi i të dhënave ISSH, punuar nga grupi i KLSH

Nga tabela më sipër rezulton se gjendja e debitorëve vijon të mbetet pothuajse në të njëjtat shifra. Nga informacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit rezulton se pakësimi i debitorëve në shumën 14,426,168 lekë ka ardhur si rezultat:

- Mbajtjes së debisë nga sistemi;
- Pakësuar me vendim gjykatë;
- Pakësuar me vendim të ISSH-së, Auditit dhe Kontrolleve;
- Arkëtimeve;
- Faljes nga Ligji (konkretisht në lidhje me këtë vijojnë të veprojnë: “Për faljen e detyrimeve ndaj fondit të sigurimeve shoqërore të personave në pension invaliditeti, sipas ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të personave në pension, sipas ligjit nr.150/2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë”, të krijuara për shkak të punësimit gjatë kohës së përfitimit të pensionit”; dhe Ligji 46/2017 “Për faljen e detyrimeve që kanë ish-ushtarakët në skemën e pensioneve suplementare, nga rillogaritja e pensioneve, në zbatim të ligjit nr.10142, datë 15.05.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të forcave të armatosura, të punonjësve të policisë së shtetit, të gardës së republikës, të shërbimit informativ të shtetit, të policisë së burgjeve, të policisë së mbrojtjes nga zjarri dhe të shpëtimit e të punonjësve të shërbimit të kontrollit të brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar”
- Sistemimeve nga financa;
- Rishqyrtimeve nga dega e përfitimeve;

Ndërsa shtesat e debitorëve kanë ardhur kryesisht nga:

- Rritja e numrit të punësuarve e shoqëruar me rritjen e rasteve të subjekteve të cilët nuk paguajnë kontributet;
- Rishqyrtim nga kontrollet e Auditit të Certifikimit, me efekt në rritjen e gjendjes kreditore të përfituesve.

Detyrimet si rezultat i përfitimeve dhe kontributeve në mënyrë të detajuar paraqiten më poshtë:

Tabela nr.41 “Të dhëna mbi gjendjen debitore në 31.12.2022, sipas llojit të përfitimeve”

Në lekë

Nr.	Lloji i Përfitimit	Gjendja ne fillim te vitit		Shtuar gjate vitit		Pakësuar gjate vitit		Gjendja ne fund te vitit	
		Nr.	Shuma	Nr.	Shuma	Nr.	Shuma	Nr.	Shuma
1	Pensione Pleqërie	6,322	3,964,720,758	1,264	203,231,943	1,135	305,506,040	6,451	3,862,446,661

2	Pensione Invaliditeti	928	159,005,330	214	24,776,738	210	23,099,673	932	160,682,395
3	Pensione familjare	1,042	312,246,976	282	38,830,638	270	29,722,766	1,054	321,354,848
4	Trajtime te vecanta	2,932	818,057,593	737	70,880,811	869	109,988,149	2,800	778,950,255
5	Kompensime	113	23,465,538	38	5,286,799	55	4,118,577	96	24,633,760
6	Te tjera	724	21,411,885	49	1,787,177	29	974,208	744	22,224,854
	Shuma	12,061	5,298,908,079	2,584	344,794,106	2,568	473,409,413	12,077	5,170,292,772

Detyrimet si rezultat i kontributeve

Në lekë

Nr.	Emërtimi	Gjendja progresive në 31.12.2022		Total
		Shuma e det. kontributiv	Shuma e k/vonesës	
1	B.	142,585,137	29,832,098	172,417,235
2	D.	12,921,792	851,088	13,772,880
3	D.	3,419,810	20,161	3,439,971
4	E.	121,148,616	1,215,711	122,364,327
5	F.	403,814,687	3,636,476	407,451,163
6	Gj.	6,197,683	237,385	6,435,068
7	K.	15,672,070	115,258	15,787,328
8	Ku.	638,850	6,870	645,720
9	L.	26,123,950	292,631	26,416,581
10	Sh.	15,336,000	127,366	15,463,366
11	T.	11,493,746	368,327	11,862,073
12	V.	99,926,613	1,145,176	101,071,789
	Totali	859,278,954	37,848,547	897,127,501

Burimi i të dhënave ISSH, punuar nga grupi i KLSH

Numri i subjekteve debitorë dhe detyrimet e të tyre të prapambetura, në vitin 2022 janë në shumën 897,128 mijë lekë, nga 782,938 mijë lekë që rezultojnë në vitin 2021, ose **me një rritje në shumën 114,749 mijë lekë më shumë detyrime.**

Konkluzion: Në vitin 2022, gjendja e debitorëve vijon të mbetet problematike, pasi në krahasim me vitin 2021, numri i debitorëve të krijuar nga subjektet buxhetore, jo buxhetore, biznesi i madh dhe të vetë punësuarit, të cilët derdhin kontributet e tyre në DPT, është rritur me 5,482 raste dhe në vlerën 1,261,797 mijë lekë. Në lidhje me mbledhjen e këtyre detyrimeve, ISSH pavarësisht se ka detyrë sipas statutit të saj, mbledhjen e të ardhurave nga kontributet e personave fizikë dhe juridikë, nuk ka tagër të plotë për të vepruar dhe ndërmarrë masa shtrënguese pasi menaxhimi i tyre kryhet nga DPT.

Gjithashtu, problematikë mbeten dhe detyrimet debitorë të cilat ndiqen nga ISSH, që në krahasim me një vit më parë detyrimet kontributive janë rritur në shumën 114,749 mijë lekë, për kontributet.

Për sa është trajtuar në lidhje me këtë pikë në PRA, është paraqitur observacioni nr. 85/3, datë 20.06.2023, protokolluar në KLSH me nnr. 13/5, datë 20.06.2023, për të cilin japim sqarimet si më poshtë.

Pretendimi i subjektit të audituar:

Nga subjekti i audituar nuk është pranuar fakti mbi detajimin e planit të të ardhurave nga kontributet në shumën 104,009 milionë lekë, në të ardhura tatimore dhe jo tatimore, si dhe të përfshirjes së realizimit të të ardhurave jo tatimore në faktin e të ardhurave nga kontributet (të ardhura tatimore).

Qëndrimi i Grupit të Auditimit:

Plani i të ardhurave i cili është i përcaktuar me ligj në shumën 104,009 milionë lekë, ju referohet të ardhurave të mbledhura nga kontributet, të cilat duhet të detajohen si plan referuar dy strukturave mbledhëse të tyre, DPT dhe ISSH. DPT nuk është planifikuese e të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore, por strukturë mbledhëse e këtyre të ardhurave për llogari të ISSH. Gjithashtu, planit të të ardhurave nga kontributet, duhet të krahasohet fakti i realizimit

të të ardhurave nga kontributet, të cilat kanë të bëjnë me të ardhura tatimore. Të ardhurat e tjera duhet të trajtohen veçmas si të ardhura jo tatimore.

Në detajimin e planit të të ardhurave:

- Nga ISSH, është bërë planifikim i të ardhurave jo tatimore në shumën 746 milionë lekë, si pjesë e planit të miratuar nga MFE në shumën 104,009 milionë lekë, plan i cili përfaqëson të ardhura tatimore nga kontributet. ISSH ka detajuar planin në shumën 104,009 milionë lekë, në plan të ardhura nga kontributet në shumën 103,263 milionë lekë dhe nga të ardhura të tjera (jo tatimore) në shumën 746 milionë lekë.
- Të ardhurat e planifikuara sipas detajimit të ISSH, referuar strukturave mbledhëse, janë ndarë në të ardhura nga kontributet e mbledhura nga DPT, që rezultojnë në shumën 101,088 milionë lekë dhe të ardhura nga kontributet ISSH në shumën 2,175 milionë lekë, në total 103,263 milionë lekë, ndërsa të ardhurat jo tatimore janë detajuar, nga DPT në shumën 426 milionë lekë dhe nga ISSH në shumën 320 milionë lekë, në total 746 milionë lekë.

Mbi realizimin faktik të të ardhurave dhe analizën e tyre ka rezultuar:

- Të ardhurat e mbledhura nga DPT, në shumën 102,034,645 mijë lekë, përbëhen nga, të ardhura nga derdhja e kontributeve (të ardhura tatimore) **në shumën 101,605,759 mijë lekë** dhe të ardhura të tjera (jo tatimore), nga gjoba dhe penalitete në shumën 428,797 mijë lekë, sipas rakordimit të ISSH me MFE.
- Kontribute të mbledhura nga vetë ISSH (të vetëpunësuar në bujqësi, vullnetarë dhe të tjera), në total janë paraqitur në shumën 3,621,956 mijë lekë, nga e cila 573,359 mijë lekë janë kontribute vullnetare; shuma 2,234,395 mijë lekë kontribute të vetëpunësuar në bujqësi, shuma 46,250 mijë lekë kontribute të derdhura në llog e ISSH, si dhe shuma 767,952 mijë lekë përbën të ardhura jo tatimore nga e cila 637,391 mijë lekë të ardhura të tjera dhe 130,561 penalitete (sipas *rakordimit të të ardhurave të ISSH, nga TSA është në shumën 2,234,395 mijë lekë, ndërsa raportuar sipas ISSH është në shumën 2,364,956 mijë lekë, diferenca në shumën 130,561 mijë lekë përbën të ardhur jo tatimore/penalitete (llogaria 7115500)*). Për rrjedhojë deklarimi i realizimit të të ardhurave nga kontributet (të ardhura tatimore nga ISSH) **janë në shumën 2,854,004 mijë lekë**. Observacioni nuk është marrë në konsideratë.

II.2.4. Auditimi i funksionimit të strukturave të kontrollit, në drejtim të inspektimit të pensioneve.

Për auditimin e kësaj çështjeje u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Evidenca dhe statistika të proceseve të inspektimit për vitin 2022;
- Dokumentet e punës të mbajtura nga Njësia e Inspektimit të Përfitimeve për inspektimet e kryera;
- Plani vjetor;
- Raporti vjetor (analiza vjetore).
- Rregulloret mbi të cilat funksionon Drejtoria e Inspektimit të Përfitimeve;

Njësia e Inspektimit të Përfitimeve e krijuar si strukturë e Institutit të Sigurimeve Shoqërore në zbatim të Vendimit të Këshillit Administrativ nr.6, datë 20.07.2010, si dhe Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm nr.146, datë 01.12.2010, është struktura që në fokus të punës së saj ka kontrollin e ligjshmërisë në caktimin e të gjitha përfitimeve që administrohen nga sistemi i sigurimeve shoqërore. Për vitin objekt auditimi kjo njësi ka funksionuar deri në korrik 2022, me numër punonjësish gjithsej 20, sipas strukturës së mëposhtme:

- Kryetari i Njesisë së Inspektimit;
- Përgjegjësi i sektorit të përfitimeve afatgjata me 15 specialistë;
- Përgjegjësi i sektorit të përfitimeve suplementare me 2 specialistë.

Me Vendimin nr.2, datë 18.03.2022 të Këshillit Administrativ të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Njësia e Inspektimit të Përfitimeve, ndryshoi emërtimin dhe u emërtua Drejtoria e Inspektimit të Përfitimeve (DIP). Gjithashtu, me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr.4540 prot., datë 30.06.2022, Drejtoria e Inspektimit të Përfitimeve Afatgjata u strukturua sipas tabelës më poshtë:

Tabela nr.4.1 “Struktura organizative e DIP”

Drejtoria e Inspektimit të Përfitimeve	
Drejtor Drejtorie	1
Spektori i Inspektimit të Pensioneve të Pleqërisë	13
Përgjegjës Sektori	1
Specialistë	12
Spektori i Inspektimit të Pensioneve të Invaliditetit, Familjare dhe Sociale	3
Përgjegjës Sektori	1
Specialistë	2
Spektori i Inspektimit të Përfitimeve Suplementare dhe Trajtimeve të Veçanta	3
Përgjegjës Sektori	1
Specialistë	2
Punonjës gjithsej	20

Burimi i të dhënave DIP në ISSH, përpunuar nga grupi i auditimit.

Sa më sipër, konstatohet se: gjatë vitit 2022, DIP ka funksionuar me strukturë jo të plotë, duke pasur tre vende vakante në pozicionin “Specialistë”, kjo jo në përputhje me strukturën organike, të miratuar. Mungesa në strukturën organizative të DIP sjell pasoja në performancën e njësisë, duke rrezikuar përmbushjen të objektivave të përcaktuara.

Bazuar në informacionin dhe të dhënat e vëna në dispozicion nga Drejtoria e Inspektimit të Përfitimeve, rezulton se, me Vendimin nr.5, datë 25.07.2022 të Këshillit Administrativ të ISSH-së është miratuar Rregullorja “Për përcaktimin e parimeve dhe rregullave bazë për funksionimin e Drejtorisë së Inspektimit të Përfitimeve”.

Deri në miratimin e kësaj Rregulloreje, procesi i inspektimit, i kryer nga Njësia/DIP është bazuar në Rregulloren nr.1/2, datë 04.03.2011 “Për një shtesë në Rregulloren nr.1, datë 21.10.2008 “Për Caktimin, Administrimin dhe Pagesën e Pensioneve”, të ndryshuar, Rregulloren nr.25/1, datë 04.03.2011 “Për një Shtesë në rregulloren nr.25/1, datë 03.09.1999 “Për Caktimin, Administrimin dhe Pagimin e Përfitimeve Suplementare të Ushtarakëve”, të ndryshuar, Rregulloren nr.3/1, datë 04.03.2011 “Për një shtesë në Rregulloren nr.3, datë 15.08.1996 “Për caktimin, administrimin dhe pagimin e përfitimeve shtetërore suplementare”, të ndryshuar, Rregulloren nr.23, datë 31.7.2019 “Për caktimin, administrimin dhe pagesën e trajtimit financiar, suplementar të punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës e të gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”, Vendimin nr.5 datë 25.07.2022 për miratimin e rregullore “Për përcaktimin e parimeve dhe rregullave bazë për funksionimin e Drejtorisë së Inspektimit të Përfitimeve”, si dhe standardeve të kontrollit të përcaktuara me ligj, të realizojë inspektimin e përfitimeve afatgjata të caktuara në zbatim të Ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe të përfitimeve suplementare të caktuara në zbatim të ligjeve të veçanta që rregullojnë marrëdhëniet në fushën e përfitimeve suplementare, nga Degët e Përfitimeve të DRSSH-ve dhe Degëve të sigurimeve shoqërore.

Për vitin 2022 planifikimi i programeve të inspektimit është bërë duke patur në vëmendje, rregullin tashmë të vendosur sipas të cilit çdo specialist inspektimi në çdo ditë pune të inspektojë 15 dosje përfitimi. Secili nga specialistët e njësisë, pasi bën kontrollin e dosjes së përfitimit, kushtet ligjore të përfitimit, dokumentacionin mbi të cilin është caktuar përfitimi, mënyrën e llogaritjes, bën edhe ballafaqimin me të dhënat e sistemit PCAMS për çdo dosje përfitimi, si dhe në rubrikën “Komente të auditit” bën komentin përkatës. Përfitimet të cilat rezultojnë të caktuara në përputhje me dispozitat ligjore, certifikohen, ndërsa për përfitimet, në

të cilat konstatohen gabime dhe moszbatim të dispozitave ligjore mban akt konstatimin për secilin rast.

▪ **Inspektimi i përfitimeve afatgjata nga skema e detyrueshme.**

Sektori i Inspektimit të Përfitimeve Afatgjata gjatë vitit 2022, përveç programeve të inspektimit të planifikuara për vitin 2022, ka përfunduar programin e inspektimit në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, inspektimi për të cilin është planifikuar në programin vjetor të vitit 2021 dhe afati i inspektimit ishte 23.12.2021-18.03.2022. Rezultatet e inspektimit për këtë DRSSH nuk janë raportuar në të dhënat e vitit 2021, prandaj bëhen pjesë e raportimeve për vitin 2022. Sipas programit vjetor, Drejtoria e Inspektimit të Përfitimeve, ka planifikuar/realizuar inspektimet në 7 DRSSH dhe DSSH, si vijon:

Tabela nr.4.2 “Planifikimi i programit vjetor”

Nr.	DRSSH/DSSH	Periudha kohore	Afati kontrollit	Programi nr./Datë
1	F.	01.01.2019-31.12.2020	28.03.2022-10.06.2022	1978/16.03.2022
2	L.	01.01.2019-31.12.2020	22.06.2022-22.07.2022	4088/13.06.2022
3	K.	01.01.2019-31.12.2020	28.07.2022-12.08.2022	5198/21.07.2022
4	T.	01.01.2019-31.12.2020	28.07.2022-12.08.2022	5199/21.07.2022
5	K.	01.01.2019-31.12.2020	18.08.2022-27.10.2022	5319/27.07.2022
6	Sh.	01.01.2019-31.12.2020	01.11.2022-03.02.2023	6983/19.10.2022
7	B.	01.01.2019-31.12.2020	01.11.2022-03.02.2023	6952/18.10.2022

Burimi i të dhënave DIP në ISSH, përpunuar nga grupi i auditimit.

Sipas programit vjetor është planifikuar edhe inspektimi i përfitimeve afatgjata të caktuara nga DRSSH Sh. dhe B., inspektim i cili ka filluar në datën 01.12.2022 dhe është planifikuar të përfundojë në datën 03.02.2023, rezultatet e të cilave do të paraqiten për vitin 2023.

Kontrollet e kryera për vitin 2022, si dhe rezultatet e gjetjeve të konstatuara, nga sektori i inspektimit të përfitimeve afatgjata, janë pasqyruar në tabelën 4.1 “Rezultatet e gjetjeve të konstatuara nga sektori i inspektimit të përfitimeve afatgjata” ndodhur në seksionin Aneks.

Sipas tabelës 4.1, në aneks, rezulton se dosje të kontrolluara gjatë vitit 2022 janë gjithsej 32,808 prej të cilave të certifikuara 30,008 dosje apo 91.4 % të dosjeve të kontrolluara. Janë evidentuar me probleme 1,862 dosje, ose 5,67% e totalit të dosjeve të inspektuara. Nga 1,862 dosje të evidentuara me problem, 732 dosje rezultojnë me efekte financiare, ose 39 % e totalit. Në total kanë rezultuar 160 dosje debitore, me efekt financiar në shumën 6,073,058 lekë dhe 572 dosje kreditore, me efekt financiar në shumën 14,835,364 lekë.

Gjithashtu, në programet e inspektimit, si pikë e veçantë e programit ka qenë edhe kontrolli i zbatimit të detyrave të lëna në programet e mëparshme. Nga 1587 dosje përfitimi të kontrolluara, ishin realizuar rekomandimet e lëna gjatë kontrolleve të mëparshme.

Nga dosjet e kontrolluara, për të cilat ishin zbatuar rekomandimet e paraqitura, për 398 prej tyre, si rezultat i rishqyrtimit kanë rezultuar me efekte financiare debitore dhe kreditore. Nga këto, 215 dosje përfitimi kanë rezultuar me efekt financiar debitor në shumën 16,661,708 lekë, ndërsa 183 dosje përfitimi kanë rezultuar me efekt financiar kreditor në shumën 8,292,686 lekë. Sipas të dhënave të administruara rezulton se në përfundim të vitit 2022 janë inspektuar 31,870 dosje të përfitimeve afatgjata, si dhe janë ri kontrolluar 1,587 dosje përfitimi, në total janë kontrolluar 33,457 dosje të përfitimeve afatgjata. Në krahasim me vitin 2021, janë kontrolluar më pak, pasi në vitin 2021 në total janë kontrolluar 43,285 ose 23% më shumë nga viti 2022.

Konstatim: nga ana e DIP (Sektori i përfitimeve afatgjata), nuk është përmbushur targeti i vendosur për çdo specialist, ku është parashikuar dhe vendosur një rregull që në çdo ditë pune të inspektojë 15 dosje përfitimi, nga 33,457 kontrolle të përfitimeve afatgjata dhe kontrolle të rekomandimeve të lëna, kjo në raport me numrin e ditëve efektive (209 ditë) dhe numrin e 11 specialistëve (pasi dy specialist janë larguar gjatë vitit), rezulton një mesatare prej 12.6 dosje përfitimi për specialist. Statistika vjetore e punës sipas 11 punonjësve të sektorit të përfitimeve

afatgjata janë pasqyruar në tabelën 4.4 “Rezultatet e gjetjeve të konstatuara nga sektori i inspektimit të përfitimeve afatgjata” ndodhur në seksionin Anekse.

▪ **Sektori i Inspektimit të Përfitimeve Suplementare dhe trajtimeve të veçanta.**

Sektori i Inspektimit të Përfitimeve Suplementare dhe trajtimeve të veçanta, bazuar në planin vjetor nr.394 prot., datë 19.01.2022, ndryshuar me nr.6907 prot., datë 17.10.2022, miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm, gjatë vitit 2022 ka kryer inspektimet e përfitimeve suplementare dhe trajtimeve të veçanta në Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, si më poshtë vijon:

Tabela nr.4.3 “Planifikimi i programit vjetor”

Nr.	DRSSH/DSSH	Periudha kohore	Afati kontrollit	Programi nr/Datë
1	T.	01.01.2019-30.06.2020	05.01.2022-20.07.2022	8213/29.12.2021
2	Gj.	01.01.2019-31.12.2020	01.08..2022-07.09.2022	5026/15.07.2022
3	K.	01.01.2019-31.12.2020	20.09.2022-10.02.2023	5198/21.07.2022

Burimi i të dhënave DIP në ISSH, përpunuar nga grupi i auditimit.

Sipas programit vjetor i ndryshuar, është planifikuar edhe inspektimi i përfitimeve afatgjata të caktuara nga DRSSH K., inspektim i cili është planifikuar të përfundojë në datën 10.02.2023, rezultatet e të cilit do të paraqiten për vitin 2023.

Sipas të dhënave nga DIP për sektorin, rezulton se për periudhën objekt auditimi kanë përfunduar dy programe inspektimi, në krahasim me 5 programe inspektimi të përfunduara në vitin 2021 ose 60% më pak.

Kontrollet e kryera për vitin 2022, si dhe rezultatet e gjetjeve të konstatuara sipas dy DRSSH, nga sektori i inspektimit të përfitimeve suplementare dhe trajtimeve të veçanta, janë pasqyruar në tabelën 4.2 “rezultatet e gjetjeve nga sektori i inspektimit të përfitimeve suplementare dhe trajtimeve të veçanta” ndodhur në seksionin Anekse.

Sipas të dhënave, nga 6362 dosje të inspektuara gjithsej janë certifikuar 5864 dosje ose 92% e totalit të dosjeve të inspektuara. Nga 6362 dosje të inspektuara vetëm 287 dosje rezultojnë me efekte financiare, ose 4.51 % e totalit të dosjeve të inspektuara nga të cilat 190 dosje kanë rezultuar debitore me efekt financiar në shumën 22,277,583 lekë dhe 97 dosje kreditore me efekt financiar në shumën 8,252,908 lekë.

Gjatë vitit 2022 kanë mbetur për rishqyrtim për plotësim dhe të pa certifikuar 143 dosje nga 252 dosjet të rishqyrtuara gjatë kontrollit, apo 56.7 % e tyre.

Në total për vitin 2022 nga Drejtoria e Inspektimit të Përfitimeve janë inspektuar 38,232 dosje, në krahasim me vitin 2021 (ku janë kryer 50,156), kjo drejtori ka kryer 11,924 inspektime më pak ose 34%. Nga këto në total ka rezultuar një efekt financiar debitor për vitin 2022 në shumën 28,350,631 lekë dhe një efekt financiar kreditor në shumën 23,087,272 lekë, në krahasim me vitin 2021 ku efekti financiar ka qenë më i ulët, konkretisht ka rezultuar një efekt financiar debitor në shumën 17,835,579 lekë dhe një efekt financiar kreditor në shumën 17,052,504 lekë. Gjatë vitit 2022 në total, kanë mbetur për rishqyrtim për plotësim dhe të pa certifikuar 1269 dosje nga 2411 dosje të rishqyrtuara gjatë kontrollit, apo 52.6 % e tyre.

Grupi i auditimit shqyrtoi për vlerësim, 5 dosje me zgjedhje të rastësishme nga 7 programe inspektimi të përfunduara në vitin 2022, ose 71%. Nga të cilat 3 praktika të përfunduara nga Sektori i Inspektimit të Përfitimeve Afatgjata nga 5 të realizuara, dhe 2 nga Sektori i Inspektimit të Përfitimeve Suplementare nga 2 të realizuara.

Nga Korriku i vitit 2022, kjo drejtori ka funksionuar bazuar në vendimin nr.5 të datës 05.07.2022, ku është miratuar Rregullorja “Për përcaktimin e parimeve dhe rregullave bazë për funksionimin e Drejtorisë së Inspektimit të Përfitimeve”. Ku ndër të tjera, në kreun 8 të kësaj rregullore përcaktohet dokumentacioni i cili administrohet në dosjen e inspektimit, të subjektit të inspektuar ku më pas arkivohet. Nga grupi i auditimit është konstatuar se praktikat janë të plotësuara me të gjithë dokumentacionin e përcaktuar në rregulloren e miratuar për

funksionimin e DIP, kreu VIII.

Auditimi i zbatimit të afateve në procedurat e inspektimit, bazuar në rregulloren e funksionimit të Drejtorisë së Inspektimit të Përfitimeve:

Sipas përcaktimeve të kreu 6 të rregullores përcaktohet qartë se:

- pas përfundimit të inspektimit përgatitet projekt raporti jo më vonë se 45 ditë;
- kopja e konfirmuar e projektit dërgohet në ISSH brenda 15 ditëve nga subjekti inspektuar;
- zhvillohet takimi ballafaques brenda 15 ditëve nga konfirmimi i projektit;
- pas takimit brenda afatit 14 ditor dërgohet raporti përfundimtar në subjekt;

(Në seksionin Anekse, paraqitet tabela nr.4.3 mbi “Të dhënat e programeve dhe afateve”)

Konstatim: Sipas të dhënave në tabelën 4.3 rezulton se afatet nga përfundimi i inspektimit në terren deri në mbajtjen e Raportit Paraprak, nuk janë të njëjta dhe variojnë nga 37 ditë deri në 65 ditë, ndërsa nga momenti i hartimit të Raportit Paraprak deri në dërgimin e Raportit Përfundimtar variojnë nga 14 ditë deri në 30 ditë, referuar rregullores së mëparshme, e cila nuk ka patur të përcaktuara afatet e evadimit të kontroleve. Subjektet e inspektuara me rregulloren e re të funksionimit të DIP i kanë zbatuar afatet sipas përcaktimeve në kreun VI të saj.

Titulli i gjetjes 1: Diferenca nga inspektimet e dosjeve të përfituesve, tejkalim afati për certifikimin e dosjeve të pensioneve.

Situata: Nga shqyrtimi i veprimtarisë së Drejtorisë së Inspektimit të Përfitimeve rezulton se:

Në total për vitin 2022 nga Drejtoria e Inspektimit të Përfitimeve janë inspektuar 38,232 dosje. Nga këto në total ka rezultuar një efekt financiar debitor në shumën 28,350,631 lekë dhe një efekt financiar kreditor në shumën 23,087,272 lekë.

Gjatë vitit 2022 në total, kanë mbetur për rishqyrtim për plotësim dhe të pa certifikuara 1269 dosje nga 2411 dosje të rishqyrtuara gjatë kontrollit, apo 52.6 % e tyre. Kjo vjen si rezultat i mangësive të konstatuara nga dokumentacioni i verifikuar në dosjet e përfituesve të cilat vijjnë prej llogaritjeve të gabuara të punonjësve në Degët e Përfitimeve referuar dokumentacionit të disponueshëm në dosjet e përfituesve, edhe pse këto konstatime janë hasur edhe në auditimet e mëparshme.

Nga auditimi konstatohet se për 7 Drejtori Rajonale programi i kontrollit konsiston për vitet 2019-2020, çka do të përbënte rrezik se për 1269 dosjet e pa certifikuara, duhen marrë masa me qëllim shmangien e efekteve financiare për ISSH dhe buxhetin e shtetit për shkak të tejkalimit të afatit ligjor 3 vjeçar për kërkimin e tepricave të përfituara padrejtësisht nga përfituesit.

Kriteri: Ligji nr.7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 62, pika 3.

Rregullore nr.1/2, datë 04.03.2011 “Për një shtesë në Rregulloren nr.1, datë 21.10.2008 “Për Caktimin, Administrimin dhe Pagesën e Pensioneve”.

Ndikimi/efekti: Ndikimi financiar për përfituesit e pensioneve në vlerën debitore 28,350,631 lekë dhe në vlerë kreditore 23,087,272 lekë. Efekte financiare nga tejkalimi mundshëm i afatit për certifikimet e dosjeve të përfituesve.

Shkaku: Mos certifikimi i 1269 dosjeve brenda afatit ligjor 3 vjeçar.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Drejtori i Përgjithshëm i ISSH dhe Drejtoria e Inspektimit të Përfitimeve, të hartojnë plan masash me afate, për të mundësuar certifikimin e 1,269 dosjeve të përfitimeve, të cilat kanë rezultuar me efekte debitore dhe kreditore, si dhe të marrë masa për inspektimin dhe certifikimin e të gjitha dosjeve të përfituesve brenda afatit 3-vjeçar.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, referuar shkresës “Observacione mbi PRA, për auditimin e ushtruar nga KLSH” protokolluar në KLSH me nr. 13/5, datë 26.06.2023, në lidhje me auditimin e Drejtorisë së Inspektimit, nuk janë paraqitur observacione.

2.2.5. Mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore për vitin 2022.

Bazuar në ligjin organik të buxhetit të shtetit, nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar; Ligjin 115/2021 “Për buxhetin e shtetit” të vitit 2022, si dhe aktet nënligjore, organike dhe vjetore mbi planifikimin, monitorimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit”, **u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:**

- Çelja e buxhetit të vitit 2022, si dhe detajimi i shpenzimeve administrative sipas programeve dhe produkteve.
- Shkresat për rishikimet e buxhetit (ri alokime, shtesa /pakësime) gjatë vitit 2022.
- Urdhri i titullarit për hartimin e projekt buxhetit për periudhën 01.01.2022-31.12.2022.
- Programi Buxhetor Afatmesëm i miratuar për periudhën 2022-2024, së bashku me ndryshimet përkatëse dhe shkresat përcjellëse për periudhën 01.01.2022-31.12.2022.
- Raportet periodike të monitorimit të zbatimit të buxhetit.
- Urdhrat për ngritjen e ekipit të menaxhimit të programeve buxhetore, etj..

5.1. Programimi nga ISSH i PBA 2022-2024 (faza e I & II), si dhe programimi i buxhetit të vitit 2022.

Programimi i buxhetit ka filluar me Programimin Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2022-2024, i cili është miratuar me VKM nr.190, datë 03.03.2021 “Për miratimin e tavaneve përgatitore të shpenzimeve të Programit Buxhetor Afatmesëm 2022 – 2024”, si dhe të udhëzimit të MFE nr. 8, datë 26.02.2021 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2022-2024”. Në bazë të tyre dhe tavaneve të programimit buxhetor afatmesëm për ISSH, shpenzimet për fondet speciale “Sigurime Shoqërore” dhe “Politika të reja pensionesh”, janë përcaktuar kuotat e shpenzimeve, të paraqitura në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 5.1 “Kuotat e shpenzimeve të PBA 2022-2024” Në milionë lekë

Nr.	Emërtimi	2022	2023	2024
I	Shpenzimet	149,065	156,565	165,298
II	Politika të reja pensionesh	2,500	3,020	3,453

Burimi i të dhënave, Drejtoria e Financës në ISSH, punuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Programimi i buxhetit afat mesëm 2022-2024 dhe programimi i vitit 2022, realizohet në 15 njësitë e sistemit për: 12 Drejtoritë Rajonale, Drejtoria Qendrore e Arkivit, Llogaria e shpenzimeve administrative të Aparatit të ISSH-së (Sektori i Buxhetit të Brendshëm); Sektori i Buxhetit të Përgjithshëm, ku realizohen transfertat nga Buxheti i Shtetit në buxhetin e ISSH-së dhe nga këtu në Drejtoritë Rajonale për pagesat e pensioneve, marrëdhëniet financiare me Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë dhe me Bankën e Shqipërisë.

Sipas të dhënave, konstatohet se përgatitja e buxhetit ka kaluar në dy faza:

- Faza I- strategjike
- Faza II- teknike

Faza e parë e PBA 2022-2024, për programimin e përgjithshëm të të ardhurave si dhe ngarkesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore të subjekteve të mbledhura nga DPT, është përcaktuar nga Drejtoria e Përgjithshme Makroekonomike në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe për rrjedhojë ISSH harton programimin brenda limitit të përcaktuar nga MFE. Faza e parë e PBA-së 2022-2024 është përgatitur dhe dërguar në Ministrinë e Financave dhe të Ekonomisë me shkresën nr. 2002/3, datë 26.04.2021.

Me shkresën nr.2002/2, datë 26.04.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm janë ngritur ekipet e menaxhimit të programeve buxhetore (EMP) sipas programit 10220 “Sigurimi Shoqëror” dhe 10270 “Sigurimet Supplementare të ushtarakëve”.

Nga hartimi i programit buxhetor të ISSH-së për periudhën 2022-2024, evidentohet se shpenzimet e programit “Sigurime Shoqërore” në variantin pasiv për vitet 2022, 2023, 2024, duke marrë parasysh edhe efektet mbetëse të rritjes së pensioneve për çdo vit në nivelet e inflacionit të vendosura nga qeveria nga data 1 prill për secilin vit, si për qytetin ashtu edhe për fshatin, janë si më poshtë:

Tabela nr. 5.2. “Shpenzimet e programit “Sigurime Shoqërore” në variantin pasiv” Në milionë lekë

Emërtimi	2021	2022	2023
Shpenzimet e Programit	143,465	150,465	159,065
Politika te reja pensionesh	2,620	3,120	3,120

Burimi i të dhënave, Drejtoria e Financës në ISSH, punuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Ndërkohë, tavanet e dërguara nga MFE në fazën strategjike, për shpenzimet e programit “Sigurime Shoqërore” janë përkatësisht si më poshtë:

Tabela nr. 5.3. “Tavanet e programit “Sigurime Shoqërore” dërguar nga MFE”

Në milionë lekë

Emërtimi	2022	2023	2024
Shpenzimet	149,065	156,565	165,298
Politika te reja pensionesh	2,500	3,020	3,453

Burimi i të dhënave, Drejtoria e Financës në ISSH, punuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Për sa më sipër në bazë të këtyre tabelave, konstatohet se në planifikimin strategjik të dhënat e dërguara nga MFE janë njësoj me ato të planifikuara nga ISSH, që tregon se planifikimi nuk është realizuar plotësisht në bazë të analizave dhe studimeve konkrete, por është një përshtatje shifrash midis institucioneve të cilat llogariten në bazë të eksperiencës dhe një trendi rritës madje mund të themi se shifrat e ISSH-së përshtaten njësoj me ato të MFE si organ epror.

Gjithashtu, evidentohet se faza e parë e hartimit të treguesve të buxhetit vjetor dhe atij afatmesëm kryhet e përqendruar në Drejtorinë e Përgjithshme, pasi sipas institucionit vëmendja kryesore në këtë fazë përqendrohet në drejtim të hartimit të treguesve të buxhetit të përgjithshëm të përfitimeve, të politikave të pensioneve, si dhe të politikave të zhvillimit të infrastrukturës. Për programimin në këtë fazë njësitë shpenzuese rajonale nuk kanë tregues të mjaftueshëm për të realizuar programimin pasi si regjistri i shtetasve ashtu edhe arkivat e periudhave të sigurimit dhe politikave të pensioneve janë çështje qendrore.

Faza II – Faza Teknike

Në vijim të shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 12424/3 datë 19.08.2021 “Dërgohet udhëzimi plotësues i PBA 2022-2024” dhe shkresës së ISSH-së nr 5314/1 datë 25.08.2021 “Dërgohet programi i shpenzimeve të sigurimeve shoqërore dhe i financimeve të sigurimeve shoqërore për vitet 2022-2024 (faza II)”, në këtë fazë është hartuar programimi

buxhetor i ISSH-së sipas formateve standarde të shpenzimeve të cilat janë reflektuar në variantin pasiv, pra pa efekt financiar vjetor të politikave të rritjes së pensioneve.

Konstatohet se, në këtë proces programimi janë përfshirë të gjitha strukturat dhe njësitë shpenzuese, është hartuar udhëzimi për procesin e programimit, grupet (ekipet) e programimit kanë shpërndarë dhe mbledhur nga të gjithë njësitë shpenzuese treguesit e programit të të ardhurave dhe shpenzimeve të vitit të ardhshëm.

Në përfundim të fazës së II, janë dërguar në MFE treguesit e programit buxhetor si dhe relacioni (komentari) lidhur me treguesit e programuar.

Nga hartimi i programit buxhetor të ISSH-së për periudhën 2022-2024 evidentohet se shpenzimet e programit “Sigurime Shoqërore” në variantin pasiv për vitet 2022, 2023, 2024, duke marrë parasysh edhe efektet mbetëse të rritjes së pensioneve për çdo vit në nivelet e inflacionit nga 1 prill për secilin vit, si për qytetin ashtu edhe për fshatin, janë si më poshtë:

Tabela nr. 5.4. Shpenzimet e programit Në milionë lekë

Përshkrimi	2022	2023	2024
Shpenzimet e Programit	149,065	156,565	165,298
Të ardhurat nga kontributet	91,614	98,019	104,214
Transferta nga Buxheti i Shtetit	57,451	58,546	61,083

Burimi i të dhënave, Drejtoria e Financës në ISSH, punuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Në vitin 2022 programi i buxhetit afatmesëm është realizuar edhe nëpërmjet sistemit AFMIS. Për pasojë, programimi në **fazën e tretë të PBA 2022-2024**, është hartuar në zbatim të shkresës së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë sipas shkresës nr. 22128 datë 10.12.2021 “Mbi përditësimin e të dhënave në sistemin AFMIS për fazën e tretë të PBA 2022-2024 si dhe detajimin e fondeve buxhetore të miratuara për vitet 2022 -2024” dhe ISSH me shkresën nr. 8094, datë 22.12.2021 janë përditësuar të dhënat e buxhetit afatmesëm të ISSH-së sipas ministrisë së linjës dhe në nivel artikulli dhe produkti.

Tavanet për shpenzimet e vitit 2022 në variantin aktiv janë në vlerë **154,935 milion lekë**, ndërsa totali i të ardhurave është ndarë:

Shuma e transfertës buxhetore (604), në vlerë **58,920 milion lekë**

- Transferte nga Buxheti 52,850 milion lekë
- Indeksi i pensioneve 2,570 milion lekë
- Shpërblimi i fund vitit 3,500 milion lekë
- Të ardhurat nga sigurimet shoqërore, në vlerë **96,015 milion lekë**.

Shqyrtimi dhe miratimi i PBA 2022-2024 në Këshillin Administrativ është detyrim ligjor dhe mbështetet në nenin 75 të ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në të cilin përcaktohet se Këshilli Administrativ “Miraton çdo vit raportin vjetor, bilancin vjetor, buxhetin vjetor dhe perspektivat 3-vjeçare financiare të skemës së sigurimeve shoqërore”. Në statutin e ISSH-së, neni 11, përcaktohet se ISSH përgatit raportin vjetor dhe programin e veprimtarisë së ardhshme financiare, të cilat miratohen nga Këshilli Administrativ i ISSH-së dhe i paraqiten çdo vit Këshillit të Ministrave. Gjithashtu, në projektbuxhetin e paraqitur për miratim, janë të pasqyruara në total efektet financiare që parashikohet si pasojë e shtesës së ritmit të numrit të përfituesve, krahasuar me vitet e mëparshme, për shkak të mbarimit të reformës së rritjes graduale të moshës së daljes në pension, të shtesës së numrit të përfituesve të pensioneve suplementare shtetërore, të pensioneve suplementare të ushtarakëve, të reduktimit të numrit të pensionisteve femra për shkak të rritjes graduale të moshës së pensionimit etj.

5.2. Shpenzimet administrative të ISSH-së dhe DRSSH-ve në rrethe

Më poshtë po paraqesim në mënyrë analitike çeljen, ndryshimet dhe realizimin e shpenzimeve administrative të ISSH-së, për periudhën Janar-Dhjetor 2022.

Konstatohet se të gjitha DRSSH-të kanë mbajtur nën kontroll kryerjen e shpenzimeve administrative, brenda kufijve të planifikuar (të ndryshuar) për vitin 2022.

Çelja e buxhetit

Buxheti administrativ, parashikohej të ishte në shumën 2,900 milionë lekë pra sa 1.9% e shpenzimeve gjithsej nga 5% të shpenzimeve që parashikohet si limit në Ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në RSH” i ndryshuar, neni 67, pika 3.

Në mënyrë të përmbledhur buxheti administrativ me ndryshimet sipas Ligjit nr. 115/2021 dhe akteve normative, paraqitet si më poshtë:

Tabela nr. 5.5. Çelja dhe ndryshimet e shpenzimeve administrative sipas zërave, viti 2022

Në mijë lekë

Analiza	Emërtimi	Plani Fillestar	Akti normativ 3 Datë 12.03.2022	Akti normativ 12 Datë 29.07.2022	Akti normativ 17 Datë 01.12.2022	Akti normativ 19 Datë 29.12.2022	Plani Përfundimtar
Shpenzime administrative		2,900,000	2,933,000	2,950,000	2,950,000	2,977,800	3,022,292
600	Paga, shpërblime dhe shp. të tjera personeli	1,085,948	1,085,948	1,102,626	1,102,626	1,102,626	1,105,572
601	Kontribute për sig. Shoqërore dhe shëndetësore	172,028	172,028	172,350	172,350	172,350	173,072
602	Mallra dhe shërbime të tjera	1,260,635	1,293,635	1,293,635	1,293,635	1,320,439	1,361,256
605	Shpenzime për organizatat ndërkomb. dhe të tjera	2,100	2,100	3,100	3,100	3,100	3,100
230	Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara	250,000	250,000	250,000	250,000	250,000	250,000
231	Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara	129,290	129,290	129,290	129,290	129,290	129,290

Burimi i të dhënave, Drejtoria e Financës në ISSH, punuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Vihet re që buxheti i shpenzimeve administrative ka pësuar ndryshime të herë pas herëshme në varësi të akteve normative dhe ndryshimeve të shpenzimeve totale të ISSH-së.

Sa më sipër në mënyrë të përmbledhur plani dhe fakti i realizimit të shpenzimeve paraqiten në tabelën në vijim:

Tabela nr. 5.6. Shpenzimet administrative për ISSH, viti 2022

Në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	Fakti 2021	Plani Fillestar	Plani Përfundimtar	Fakt	Ndryshimi	Në %
I.	Totali i Shpenzimeve Administrative	2,416,986	2,900,000	3,022,292	2,824,916	(197,376)	93
1	Paga, Shpërblime dhe Shpenzime të tjera personeli (600)	996,319	1,085,948	1,105,572	1,076,082	(29,490)	97
2	Kontribute për sigurimet shoqërore shëndetësore (601)	158,538	172,028	173,072	168,510	(4,562)	97
3	Mallra dhe shërbime të tjera (602)	1,220,953	1,262,735	1,364,358	1,266,969	(97,389)	93
	<i>nga këto - Komisionet të Pagesës së Përfitimeve</i>	1,774	865,545	960,181	900,283	(59,898)	94
4	Shpenzime për org. ndërkombëtare dhe të tjera (605)	-	2,100	3,100	1,828	(1,272)	59
6	Shpenzime për rritjen e AQ të trupëzuara (230)	38,175	250,000	250,000	238,118	(11,882)	95
5	Shpenzime për rritjen e AQ të trupëzuara (231)	-	129,290	129,290	75,237	(54,053)	58

Burimi i të dhënave, Drejtoria e Financës në ISSH, punuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga tabela e mësipërme evidentohet se çelja e planit fillestar për shpenzimet administrative është në vlerën 2,900,000 mijë lekë pra 483,014 mijë lekë më tepër se fakti i vitit 2021, ose 20% më tepër. Gjithashtu realizimi i vitit 2022 është 16.9% më tepër se realizimi i vitit 2021. Gjatë vitit 2022, janë bërë ndryshime (shtesa) në buxhet, në bazë të akteve normative, në vlerën prej 122,292 mijë lekë, ose shtuar në masën 4.2% të planit fillestar, si më poshtë:

- Paga e shtesa (600) për 19,625 mijë lekë, rritur me 1,8% të planit fillestar;

- Kontribute për sigurime shoqërore dhe shëndetësore (601) në vlerën prej 1,044 mijë lekë, rritur me 6% të planit fillestar;
- Mallra e shërbime të tjera (602), për 101,623 mijë lekë, rritur me 8% të planit fillestar;
- Për pjesëmarrje në organizata ndërkombëtare 1,000 mijë lekë, rritur me 48% të planit fillestar.

Konstatohet se ndryshimet në program nuk janë të studiuara mirë sepse referuar sa më sipër, ndryshimet (shitesat) në programin fillestar, nuk kanë qenë të nevojshme dhe të argumentuara, pasi rezulton se, për disa nga zërat e shpenzimeve realizimi është më i ulët edhe nga plani fillestar si:

- Rritja e fondit të pagave është e pa argumentuar, pasi ky zë shpenzimesh ka një mosrealizim nga plani i ndryshuar me 29,490 mijë lekë, si edhe 9,865 mijë lekë, nga plani fillestar. Me rritjen e fondit të pagave, duhet të ishte reflektuar rritja edhe për zërin “Kontribute për sigurime shoqërore e shëndetësore” me 16.7 % nga vlera e programuar në planin fillestar.
- Po kështu, e pa argumentuar është rritja për zërin “shpenzime për organizatat ndërkombëtare” i cili ka një mosrealizim nga plani i ndryshuar me 1,272 mijë lekë, si edhe 272 mijë lekë nga plani fillestar.

Shpenzimet për vitin 2022, janë realizuar më pak se plani i ndryshuar për 197,376 mijë lekë ose 7 % më pak. Megjithëse shpenzimet janë mbajtur nën kontroll, realizimi i tyre për 7% më pak nuk është real, pasi kjo diferencë vjen dhe nga ndryshimet që janë bërë në planin fillestar.

Zbatimi i Buxhetit

Ndërkohë sa i takon realizimit të shpenzimeve administrative sipas rajoneve, kjo paraqitet te tabela më poshtë:

Tabela nr. 5.7. Realizimi i shpenzimeve administrative sipas DRSSH-ve, viti 2022

Në mijë lekë							
Nr.	Emërtimi	Fakti 2021	Plani Fillestar	Plani Përfundimtar	Fakt	Ndryshimi FAKT-PP	Në %
	Totali ISSH	2,413,986	2,900,000	3,022,292	2,824,916	-197,376	93
1	B.	106,797	106,066	144,254	130,546	-13,708	90
2	D.	109,813	97,471	105,782	103,810	-1,972	98
3	D.	157,023	148,621	204,106	202,522	-1,584	99
4	E.	197,457	202,139	216,747	208,919	-7,828	96
5	F.	204,389	205,299	229,611	219,098	-10,513	95
6	Gj.	92,782	95,096	103,713	99,833	-3,880	96
7	Ko.	177,011	176,462	197,285	188,189	-9,096	95
8	Ku.	72,660	76,957	80,812	77,208	-3,604	96
9	L.	93,594	96,643	104,525	101,649	-2,875	97
10	Sh.	131,512	135,974	143,296	137,822	-5,474	96
11	T.	426,125	407,929	440,218	430,139	-10,079	98
12	V.	177,937	174,347	194,891	193,997	-894	100
13	DAQ	121,312	127,380	143,824	134,734	-9,090	94
14	Brendshëm	342,185	358,522	617,432	596,143	-21,289	97
15	Përgjithshme	3,389	491,094	95,796	307	-95,488	0

Burimi i të dhënave, Drejtoria e Financës në ISSH, punuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

ISSH ka mbajtur dhe ka ndjekur, shpenzimet administrative duke respektuar treguesit e programuar të shpenzimeve, me mosrealizim në vlerën 197,376 mijë lekë. Nga rajonet vihet re që rajoni i Beratit ka mosrealizimin më të lartë.

Aparati i ISSH-së

Hartimi i projekt programit, miratimi dhe ndjekja e realizimit të treguesve buxhetorë të Aparatit të ISSH është realizuar sipas strukturës së miratuar nga Këshilli Administrativ.

Projekt programi i vitit 2022, për Aparatin e ISSH-së, si njësi varësie e këtij institucioni është hartuar, duke respektuar dispozitat ligjore dhe nënligjore në hartimin e buxhetit dhe udhëzimit të Drejtorisë së Përgjithshme për hartimin e buxhetit të vitit 2022.

Programimi i zërave buxhetorë, bëhet nga Përgjegjësi i Sektorit të buxhetit të brendshëm, bazuar në realizimin faktit të shpenzimeve, duke iu referuar vitit paraardhës.

Për buxhetin e brendshëm të Aparatit, plani fillestar, ndryshimet gjatë vitit 2022, realizimi i zërave të shpenzimeve, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 5.8. Realizimi i shpenzimeve administrative të aparatit të ISSH, viti 2022

Në mijë lekë

Art	EMERTIMI	Fakti 2021	Plani Fillestar	Ndryshime të vitit	Plan Përfund.	Fakti	Ndryshimi Fakt-PP	Realizimi në %
Shpenzime administrative		342,185	358,522	258,910	617,432	596,143	(21,289)	97%
600	Paga, shpërblime, dhe shpenz.tjera personeli	160,272	167,750	3,810	171,560	168,718	(2,842)	98%
601	Kontribute për sigurime shoqërore e shëndetësore	24,858	28,014	(1,210)	26,804	26,028	(776)	97%
602	Mallra dhe shërbime të tjera	141,353	161,967	6,310	168,277	162,521	(5,756)	97%
605	Shpenzime për organizatat ndërkombëtare dhe të tjera	1,774	2,100	1,000	3,100	1,828	(1,272)	59%
230	Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara	-	-	250,000	250,000	238,118	(11,882)	95%
231	Shpenzime për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara	15,702	791	-	791	758	(33)	96%

Burimi i të dhënave, Drejtoria e Financës në ISSH, punuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Evidentohet të jetë bërë një rishpërndarje për buxhetin e çeljes midis buxhetit të brendshëm dhe buxhetit të përgjithshëm, për të cilën nuk ka evidencë shkresore. Konkretisht tek buxheti i dërguar me shkresën nr. 51 prot., datë 05.01.2022, vlera e shpenzimeve administrative akorduar për buxhetin e brendshëm është 350,931 mijë lekë dhe për buxhetin e përgjithshëm 498,685 mijë lekë. Ndërkohë sipas të dhënave nga financa këto vlera rezultojnë përkatësisht 358,522 mijë lekë dhe 491,094 mijë lekë. Pra nuk është ndjekur procedura për miratimin e shpërndarjes së fondeve në zbatim të pikës 75 të Udhëzimit nr.2, datë 06.01.2012 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit”.

Gjatë vitit 2022, janë bërë ndryshime (shtesa) në buxhetin e shpenzimeve administrative të aparatit të ISSH-së, me shkresa të Drejtorit të Përgjithshëm, në vlerën prej 258,910 mijë lekë, ose shtuar në masën 72% të planit fillestar, si më poshtë:

- Paga e shtesa (600), për 3,810 mijë lekë,
- Mallra e shërbime të tjera (602), për 6,310 mijë lekë,
- Për pjesëmarrje në organizata ndërkombëtare 1,000 mijë lekë;
- Për rritjen e aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara (230), edhe pse nuk është parashikuar asnjë fond në planin fillestar, ky zë është realizuar për vlerën 250,000 mijë lekë, si edhe pakësuar kontribute për sigurime shoqërore (601) për 1,210 mijë lekë.

Nga analiza dhe auditimi i planifikimit dhe realizimit të buxhetit të Aparatit rezultoi se, planifikimi fillestar i shpenzimeve për investime në aktive të patrupëzuara për vitin 2022, ishte zero, realizuar 250,000 mijë lekë. Gjithashtu zëri “shpenzime për organizatat ndërkombëtare” ka një mosrealizim nga plani i ndryshuar me 1,272 mijë lekë, si edhe 272 mijë lekë nga plani fillestar.

Monitorimi i Buxhetit

Sa i takon monitorimit të Buxhetit, njësia ka vepruar sipas Udhëzimit nr. 22 datë 17.11.2016 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qendrore”. ISSH ka hartuar tre raporte të monitorimit të performancës/produkteve të programit Sigurime Shoqërore. Raporti për 4 mujorin e parë i është përcjellë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 3527 prot. datë 18.05.2022, raporti për 8-mujorin 2022 është përcjellë me shkresën nr. 6260 prot. datë 16.09.2022 dhe raporti vjetor 2022 është përcjellë me shkresën nr. 1128 prot. datë 13.02.2023. Raportet janë dorëzuar brenda afateve të përcaktuara në udhëzim.

Për sa më sipër, arrihet në konkluzionin që me gjithë punën e bërë në përmbushje të detyrimeve ligjore në ISSH, për planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e buxhetit të shpenzimeve administrative të ISSH për vitin 2022, konstatohen disa problematika të cilat po i rendisim si më poshtë:

Titulli i gjetjes 1: Rishpërndarja e fondeve buxhetore në papajtueshmëri me udhëzimin përkatës

- Situata:**
- Tek buxheti i dërguar me shkresën nr. 51, prot., datë 05.01.2022, vlera e shpenzimeve administrative akorduar për buxhetin e brendshëm është 350,931 mijë lekë dhe për buxhetin e përgjithshëm 498,685 mijë lekë. Ndërkohë sipas të dhënave nga financa këto vlera rezultojnë përkatësisht 358,522 mijë lekë dhe 491,094 mijë lekë. Pra është bërë një rishpërndarje për buxhetin e çeljes midis buxhetit të brendshëm dhe buxhetit të përgjithshëm. Për këtë rishpërndarje nuk ka evidencë shkresore, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 9, datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit”, pika 72 sipas së cilës: *“Nëpunësi autorizues gjatë procesit të shqyrtimit të kërkesave mbështetet nga nëpunësi zbatues. Nëpunësi zbatues kontrollon nëse kërkesa është në përputhje me buxhetin e miratuar, përmbledh kërkesat e drejtuesve të programeve dhe procedon si vijon: a. Miraton rishpërndarjet e fondeve brenda të njëjtit program, kapitull dhe artikull të shpenzimeve korente, midis njësisë të ndryshme shpenzuese në vartësi të njësisë qendrore që mbulon. Fondet bëhen të vlefshëm për zbatim vetëm pasi regjistrohen në SIFQ nga struktura përgjegjëse për buxhetin”*.
 - Është konstatuar se **ka ndryshime të shpeshta në buxhetin** e shpenzimeve administrative të DRSSH-ve gjatë vitit ushtrimor, të cilësuar më lart, të cilat në disa raste kanë rezultuar të paargumentuara dhe të panevojshme.
- Krieret ligjore:**
- Udhëzimi nr. 9, datë 20.03.2018 “Për Procedurat Standarde të Zbatimit të Buxhetit”, pika 72.
- Ndikimi, pasoja:** Transferimet e shpeshta gjatë vitit buxhetor, tregojnë për paqëndrueshmëri në planifikim dhe ndikon në realizimin e shpenzimeve buxhetore në afatet e duhura.
- Shkaku:** Mungesë analizash të treguesve, nevojave dhe mos planifikimi i duhur i fondeve buxhetore.
- Rëndësia:** E mesme
- Rekomandimi:** Drejtoria e Financës të marrë masat e duhura për një planifikim sa më real të fondeve buxhetore në dispozicion, për të shmangur maksimalisht transferimet buxhetore, nga një njësi në tjetrën dhe nga një artikull në tjetrin.

Për sa është trajtuar në Projektraportin e Auditimit, referuar shkresës “Observacione mbi PRA, për auditimin e ushtruar nga KLSH” protokolluar në KLSH me nr. 13/5, datë 26.06.2023, në lidhje me auditimin e buxhetit të brendshëm të ISSH, nuk janë paraqitur observacione.

II.2.6. Auditimi i menaxhimit dhe administrimit të burimeve njerëzore.

Për auditimin e këtij drejtimi, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Struktura organike e Institutit të Sigurimeve Shoqërore;
- Rregullore për funksionimin dhe organizimin e ISSH;
- Rregullore për personelin e ISSH;
- Procedurat e emërimeve dhe largimeve në punë;
- Pozicionet e lira të punës;
- Procedurat e ngritjeve dhe uljeve në detyrë;
- Trajnimet e punonjësve;
- Dosjet personale;
- Vendimet gjyqësore për marrëdhëniet e punës;
- Marrëdhëniet e pagave.

Instituti i Sigurimeve Shoqërore drejtohet nga Këshilli Administrativ i tij dhe Drejtori i Përgjithshëm. Këshilli Administrativ i ISSH, zgjedh Drejtorin e Përgjithshëm.

6.1. Struktura organizative e ISSH

Me Vendim të Këshillit Administrativ nr. 2, datë 18.03.2022, numri i përgjithshëm i punonjësve të ISSH, është bërë 1,338, me një shtesë prej 1 punonjësi. Shtimi i pozicionit të punës “Koordinator kundër Korrupsionit” bëhet në strukturën organizative të Drejtorisë së Përgjithshme dhe numri i kësaj strukture shkon në 158. Nga auditimi u konstatua se, struktura është realizuar nga planifikimi, mesatarisht me 92.2 %, për vitin 2022.

-Me urdhrin nr. 4540 prot., datë 30.06.2022, të titullarit të institucionit, është bërë riorganizimi brenda numrit total prej 20 punonjës të strukturës së Drejtorisë së Inspektimit të Përfitimeve të ISSH. (drejtor 1 + përgjegjës sektori 3 + specialistë 16)

-Me urdhrin nr. 6714 prot., datë 07.10.2022, të titullarit të institucionit, është pakësuar 1 (një) vend pune, specialist në Sektorin e Përfitimeve Afatgjata, në Drejtorinë e Përfitimeve dhe është shtuar 1 (një) vend pune, specialist i menaxhimit të sistemit HRMIS, në Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve, në Drejtorinë e Administrimit të Përgjithshëm.

Rregullore për funksionimin dhe organizimin e ISSH.

Sipas pikave (b) dhe (ç) të nenit 75, të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Drejtori i Përgjithshëm miraton rregulloret për organizimin, administrimin, procedurat administrative, si dhe përcakton rregullat e brendshme të ISSH.

Titulli i Gjetjes 1: Mos miratimi i Rregullores së re, për funksionimin dhe organizimin e ISSH.

Situata: ISSH përgjatë vitit 2022, ka funksionuar mbi bazën e Rregullores për Organizimin e Funksionimin e ISSH, e cila nuk përshtatet me strukturën organizative aktuale. Titullari i Institucionit në kuadër të ndryshimeve ligjore lidhur me ofrimin e shërbimeve online, mbylljen e sporteleve, njëkohësisht dhe në ndryshimin e proceseve të punës, me urdhrin nr. 4385 prot., datë 22.06.2022, ka ngritur grupin e punës

	<p>pranë ISSH-së, për një organizim të brendshëm të ISSH-së dhe ndryshim të strukturave organizative aktuale të Drejtorisë së Përgjithshme, DRSSH, DSSH dhe DAQ,</p> <p>Në lidhje me ecurinë e punës për hartimin dhe miratimin e kësaj rregulloreje, përveç urdhrin nr. 4385 prot., datë 22.06.2022, nuk është paraqitur asnjë dokument tjetër.</p>
Kriteri:	Neni 75, i ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.
Ndikimi/Efekti:	Në Rregulloren aktuale nuk gjejnë zbatim detyrat dhe përgjegjësitë e punonjësve të ISSH.
Shkaku:	Mos përgjegjshmëri e grupit të punës në përshpejtimin e procedurave për miratimin e strukturës organizative të ISSH.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi:	Drejtori i Përgjithshëm të nxjerrë përgjegjësitë në përshpejtimin e procedurave për organizimin e brendshëm të Institucionit, si dhe të marrë masa për miratimin e Rregullores për funksionimin e ISSH.

6.2. Marrëdhëniet e punës në ISSH.

Procedura e rekrutimit në institucion, kryhet duke u mbështetur në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe në rregulloren për “Për personelin e ISSH”, ku përshkruhet mënyra e punësimit në ISSH, dokumentacioni i nevojshëm që duhet të paraqitet pranë institucionit, si dhe kriteret që duhet të plotësojnë kandidatët. Rekrutimi i punonjësve nëpërmjet konkurrimit të hapur është realizuar duke bërë publikimin elektronik së të gjithë informacionit, në faqen zyrtare të institucionit, për 31 pozicione pune të lira.

Nga auditimi rezultoi se, në Drejtorinë e Përgjithshme të ISSH janë emëruar 11 punonjës nga 13 pozicione pune të lira, që ka pasur gjatë vitit 2022.

Titulli i Gjetjes 2: Rekrutimi i pozicionit vakant të Zv. Drejtorit të Përgjithshëm Teknik, jashtë kriterëve të dispozitave ligjore.

Situata: Nga auditimi u konstatua se, procedura e rekrutimit për emërimin e Zv. Drejtorit të Përgjithshëm Teknik të ISSH, nuk është kryer në zbatim të rregullores për “Për personelin e ISSH”, e miratuar me VKA nr. 5, datë 14.08.2020, “Për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren nr. 3/2, datë 26.02.2008, “Për personelin e ISSH”.

1. Me urdhrin nr. 2998/1 prot., datë 20.07.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të ISSH, është shpallur procedura e rekrutimit nëpërmjet konkurrimit të hapur për pozicionin e Zv. Drejtorit të Përgjithshëm Teknik.

2. Me shkresën nr. 2998/2 prot., datë 20.07.2022 “Njoftim për shpallje konkurrimi”, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, bën shpalljen e vendit të lirë të punës, në faqen e saj zyrtare.

Nga auditimi u konstatua se “Njoftimi për shpallje konkurrimi”, në paragrafin “Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista”, kandidatët do të testohen në lidhje me njohuritë në fushën e sigurimeve shoqërore, rregulloren e përfitimeve, të kontributeve, ligjin për arkivat, kodi i punës i RSH, etika në administratën publike, etj.

Ndërsa, dokumenti “Vlerësimi i Kandidatëve” i vënë në dispozicion grupit të auditimit, është bërë në zbatim të rregullores “Për Personelin

e ISSH”, kapitulli 8, “Mënyra e Vlerësimit”, pika 8.14, që përcakton: “Për postet menaxheriale të ISSH (Zv. drejtor i përgjithshëm, drejtor drejtorie, drejtor rajonal), vlerësimi bëhet **nëpërmjet dosjes personale, total 40 pikë dhe intervistës me gojë në total 60 pikë. Kandidati quhet fitues nëse në vlerësimin total ka fituar mbi 70 pikë (70% e pikëve)”**”.

Kandidatët pjesëmarrës që kanë paraqitur kërkesat e tyre për pozicionin e Zv. Drejtorit të Përgjithshëm Teknik janë:

K.R., kërkesë nr. 5356/1 prot., datë 28.07.2022;

T.M., kërkesë nr. 5453/1 prot., datë 03.08.2022;

M.Z., kërkesë nr. 5452/2 prot., datë 03.08.2022.

Komisioni i Vlerësimit të Kandidaturave (KVK), i ngritur me urdhrin nr. 2998/1 prot, datë 20.07.2022, të Drejtorit të Përgjithshëm të ISSH, në Raportin Përfundimtar të datës 05.08.2022, ka klasifikuar fitues të pozicionit Zv. Drejtorit të Përgjithshëm Teknik në ISSH, znj. K. R. me 82 pikë në total, **në kundërshtim me kriteret që duhet të plotësojë kandidati** sipas “Njoftimit për shpallje konkurrimi”, të argumentuar si më poshtë, si dhe në Tabelën nr. 6.2.

Kriteri arsimor i kërkuar: Kandidatët duhet të zotërojnë diplomë të nivelit Master i Shkencave të Barasvlershme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë në Shkenca Ekonomike, Juridike.

Të 3 kandidatët e plotësojnë kriterin arsimor të kërkuar, pasi sipas rregullores “Për personelin e ISSH” Kapitulli I, pika 7 “Fazat e konkurrimit, nën-pika 7.3 përcakton: “Përfundimtar për kriterin arsimor përbëjnë rastet për punonjësit me përvojë të gjatë në sistemin e sigurimeve shoqërore, **mbi 5 vjet dhe me kualifikime të shumta në fushën e sigurimeve shoqërore, me përjashtim të punonjësve të Drejtorisë Juridike, Drejtorisë së Financës dhe Drejtorisë së IT-së**”.

Kriteri profesional i kërkuar: Sipas “Njoftimit për shpallje konkurrimi”, kandidatët duhet të kenë të paktën 10 vjet eksperiencë në fushën e administratës publike/shërbim civil dhe/ose në institucione private nga të cilat **minimum 6 vjet në nivel të lartë menaxherial**.

Të ketë eksperiencë pune mbi 3 vjet në nivel Drejtor Drejtorie për punonjësit brenda administratës së Sigurimeve Shoqërore, si dhe **ose jo më pak se 3 vjet në administratë publike/shërbim civil** të një kategorie të barasvlershme me kategorinë e Zv. Drejtorit të Përgjithshëm apo me kategorinë e Drejtorit të Drejtorisë, konkretisht:
-Kandidatja, K.R. ka 2.7 vite eksperiencë në nivel të lartë menaxherial;
-Kandidati, T.M. ka 5.4 vite eksperiencë në nivel të lartë menaxherial, si dhe jo më pak se 3 vjet në administratë publike të një kategorie të barasvlershme me kategorinë e Zv. Drejtorit të Përgjithshëm apo me kategorinë e Drejtorit të Drejtorisë;

-Kandidatja, M.Z. ka 8 vite eksperiencë në nivel të lartë menaxherial. Neni 19, “Punësimi” i ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar;

Kapitulli I, “Rekrutimi”, i Rregullores “Për Personelin e ISSH”, e ndryshuar, miratuar me VKA nr. 3/2, datë 26.02.2008.

Kriteri:

Ndikimi/Efekti:

Rekrutimi i punonjësve që nuk plotëson kriteret e veçanta të pozicionit të punës, situatë e cila ndikon në mbarëvajtjen dhe mirëfunksionimin e punës.

Shkaku: Mos respektimi i dispozitave ligjore në procedurën e rekrutimit të punonjësit.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm në ISSH, të përmirësojë formatin “Njoftim për shpallje konkurrimi”, për kandidatët të nivelit menaxherial, duke u bazuar në përcaktimet e “Rregullores së Personelit”, si dhe Komisioni i Vlerësimit të Kandidaturave (KVK), të marrë masa që rekrutimet në vijimësi, të bëhen të bazuara në përcaktimet e Rregullores “Për Personelin e ISSH”, mbi kriteret e pranimit.

Në rubrikën Aneks është paraqitur Tabela nr. 6.2 “Kandidatët konkurrues për pozicionin, zv. Drejtor i Përgjithshëm Teknik në ISSH”.

- Nga auditimi mbi procedurat e ndjekura për “Largimet nga puna”, plotësimin e “Vendeve të lira” dhe realizimin e trajnimeve për punonjësit në përgjithësi janë zbatuar procedurat dhe kriteret e përcaktuara, por janë evidentuar edhe mangësitë e mëposhtme:

Titulli i Gjetjes **Mbi rregullshmërinë e marrëdhënieve të punës në lidhje me largimet nga puna, plotësimin e vakancave dhe trajnimin e punonjësve.**

3:
Situata: 1. Për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022, i janë ndërprerë marrëdhëniet e punës për shkaqe të ndryshme, 15 punonjësve.

Tabela nr. 6.4. “Ndërprerja e marrëdhënieve të punës”

Arsyeja e ndërprerjes së marrëdhënies së punës	Nr. i punonjësve
Larguar me dëshirë	6 punonjës
Dalë në pension	7 punonjës
Larguar me masë disiplinore	2 punonjës
Totali	15 punonjës

Burimi i të dhënave, ISSH, përpunuar nga audituesit e KLSH

Nga auditimi i procedurave të ndjekura në ISSH, kur punonjësve u ndërpriten marrëdhëniet e punës, u konstatua se, punonjësit e larguar nuk kanë zbatuar plotësisht kushtet e vendosura në Kontratën e tyre të Punës. Te paragrafi “Përfundimi i kontratës” përcaktohet se: *Kur kontrata është pa afat, çdo palë mund ta përfundojë kontratën, duke njoftuar paraprakisht me shkrim, sipas afateve që parashikohen në Kodin e Punës, në nenin 143 “Afatet e njoftimit pas kohës së marrjes në prove”:*

1) *Pas kohës së marrjes në provë, për të zgjidhur kontratën me periudhë të pacaktuar, palët duhet të respektojnë një afat njoftimi prej një muaji, gjatë vitit të parë të punës, prej dy muajsh për dy deri në pesë vjet pune, prej tre muajsh për më shumë se pesë vjet pune.*

2) *Këto afate mund të ndryshohen me marrëveshje me shkrim ose në kontratën kolektive të punës. Kur punëmarrësi ka kryer deri në gjashtë muaj pune, afati i njoftimit nuk mund të jetë më pak se dy javë. Afati i njoftimit është jo më pak se 1 muaj kur punëmarrësi ka kryer më shumë se gjashtë muaj pune.*

4) *Kur njëra nga palët e zgjidh kontratën pa respektuar afatin e njoftimit, zgjidhja trajtohet si zgjidhje e kontratës me efekt të menjëhershëm.*

2. Për vitin 2022, rezultuan 13 vende vakante në Drejtorinë e Përgjithshme të ISSH, të cilët janë paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 6.5. "Vendet e lira gjatë vitit 2022"

Pozicioni në strukturën e ISSH	Nr. vakant i punonjësve
Koordinator kundër korrupsionit	1
Asistente e Drejtorit të Përgjithshëm	1
Përgjegjës Sektori, Drejtoria e Financës	1
Specialist, Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun	1
Specialist/mjek, Sektori i Ekzaminimit Mjekësor	1
Specialist, Sektori i Inspektimit të Përfitimeve të Pleqërisë	1
Specialist, Sektori i Inspektimit të Përfitimeve të Invalid, familjare, dhe sociale	2
Auditues, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm	3
Përgjegjës Sektori, Sektori i Reformave, Parashikimeve dhe Kërkimit Social	1
Specialist, Sektori i Reformave, Parashikimeve dhe Kërkimit Social	1
Totali	13

Burimi i të dhënave, ISSH, përpunuar nga audituesit e KLSH

Nga auditimi u konstatua se, në Sektorin e Inspektimit të Përfitimeve të Invaliditetit, Familjare, dhe Sociale, sektor i përbërë nga 1 përgjegjës dhe 2 specialistë (1+2), pozicionet e 2 specialistëve kanë qenë vakant duke bërë që, rregullat bazë dhe funksionimi i këtij sektori, të përcaktuar në Rregulloren e Drejtorisë së Inspektimit, të miratuar me VKA nr. 5 datë 25.07.2022, të mos jenë zbatuar.

3. Me nr. 262 prot., datë 14.01.2022, është miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm "Kalendari paraprak i aktiviteteve trajnuese për punonjësit e sistemit të sigurimeve shoqërore, përgjatë vitit 2022", i cili ka parashikuar 33 aktivitete trajnuese në total. Nga auditimi u konstatua se, përgjatë vitit janë ndjekur e realizuar 16 aktivitete trajnuese, në ambientet e ISSH dhe jashtë saj, me specialistë të degëve të ndryshme nga të gjitha DRSSH, sipas temave e grupeve të caktuara në planin vjetor të planifikuar për vitin 2022. Janë trajnuar rreth 432 punonjës të sistemit të sigurimeve shoqërore, duke përfshirë dhe të punësuarit e rinj.

Kriteri: Neni 143, i ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar;

Kreu III, "Komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit", të ligjit nr. 10296/2010 "Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuar;

VKA nr. 5, datë 25.07.2022, Për miratimin e rregullores "Për përcaktimin e parimeve dhe rregullave bazë për funksionimin e Drejtorisë së Inspektimit të Përfitimeve".

Ndikimi/Efekti: Mos njohje e mjaftueshme nga strukturat përgjegjëse të komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në ISSH.

Shkaku: Mungesa e rregullshmërisë së veprimeve nga personat përgjegjës në lidhje me marrëdhëniet e punës në ISSH.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i ISSH dhe Drejtori i Përgjithshëm Administrativ të marrin masa për plotësimin e pozicioneve vakante në Drejtorinë e Inspektimit të Përfitimeve dhe Drejtorinë e Auditit të Brendshëm, si dhe për hartimin e kalendarit të trajnimeve, referuar nevojave reale të stafit, për organizimin e trajnimeve në lidhje me njohjen dhe zbatimin e Ligjit "Mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin".

▪ Vendimet gjyqësore që ndiqen dhe ekzekutohen nga ISSH.

Nga auditimi i vendimeve gjyqësore për largimet nga puna, u konstatua se janë 29 raste që ndiqen nga ISSH për ish-punonjës të larguar. Për periudhën objekt auditimi, ISSH ka ekzekutuar 4 vendime gjyqësore me vlerë 7,424,001 lekë për ish-punonjësit e saj. Në këtë vlerë është përfshirë edhe shpenzimi përmbartimor 26,400 lekë kosto shtesë, shumë që konsiderohet

si shpenzim pa efektivitet për fondet e buxhetit të shtetit. Të detajuara paraqiten të dhënat në rubrikën Aneks, Tabela nr. 6.1: Vendimet gjyqësore me objekt "Dëmshpërblim page" për vitin 2022, pjesë e këtij Raporti përfundimtar.

6.3. Trajtimi dhe administrimi i pagave.

Në rregulloren “Për personelin e ISSH”, miratuar me vendimin nr. 3, datë 26.02.2008, të Këshillit Administrativ, është miratuar struktura organizative e ISSH, si dhe janë përcaktuar klasat e kategoritë e punës për personelin e Drejtorisë së Përgjithshme dhe për Drejtoritë Rajonale. Çdo punonjësi i është akorduar një klasë, e cila quhet *klasa personale e punonjësit, shkallët e karrierës dhe koeficientet*. Klasat e punonjësve janë paracaktuar në bazë të eksperiencës së punës, si dhe nivelit të arsimit, e cila i përcaktohet në kontratë ose në vendimin e emërimit të tij, të punës. Në bazë të kërkesave profesionale, kushteve të punës e përgjegjësisë së punës që punonjësi kryhen, përcaktohet edhe *kategoria përkatëse*. *Shkallët e karrierës* janë rezultat i vlerësimeve vjetore individuale që merr punonjësi dhe propozimet nga eprori i tij për rritje page.

Titulli i Gjetjes 4:

Situata:

Mbi rregullshmërinë e administrimit të pagës.

Nga auditimi u konstatua se formati i listë pagesës së pagave të ISSH, nuk rezulton të jetë plotësisht në përputhje me udhëzimin e përbashkët të MFE dhe DAP nr. 1, datë 21.05.2021, “Për formën, elementët dhe plotësimin e listë pagesës mujore të pagave dhe të urdhër shpenzimit për pagat në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, pasi në listë pagesat mujore të audituara, mungojnë kolona e “emërtesës së pozicionit sipas strukturës së miratuar”, “kategorisë” e “klasës” së punonjësve. Në kolonat e “shitesave” mbi pagë, rezultojnë të jenë detajuar arsyet për të cilat janë paguar këto shitesa, vetëm në listë pagesën e muajit dhjetor 2022, por përsëri konstatohet një kolonë e paspecifikuar, me emërtimin “shitesa të tjera”. E njëjta situatë është edhe për “ndalesat” e kryera.

Kriteri:

Neni 19, “Punësimi”, i ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar;
Pika 1, e lidhjes 1, të udhëzimit të përbashkët i MFE dhe DAP nr. 1, datë 21.05.2021, “Për formën, elementët dhe plotësimin e listë pagesës mujore të pagave dhe të urdhër shpenzimit për pagat në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”.

Ndikimi/Efekti:

Mos njohje e mjaftueshme nga strukturat përgjegjëse të rregullave mbi plotësimin e listë pagesave, të përcaktuara në udhëzimet përkatëse.

Shkaku:

Mungesa e rregullshmërisë së veprimeve nga personat përgjegjës në lidhje me marrëdhëniet e pagës në ISSH.

Rëndësia:

E ulët

Rekomandimi:

Drejtori i Administrimit të Përgjithshëm, të marrë masa për plotësimin e listë pagesave të punonjësve me të gjithë elementët e duhur, sipas kërkesave të përcaktuara në udhëzimin e përbashkët të MFE dhe DAP.

- Në lidhje me shitesat mbi pagë, për periudhën: Nga miratimi i tyre me VKA, në Rregulloren nr. 12, datë 20.03.1996 deri në muajin nëntor 2009.

Punonjësit e ISSH kanë përfituar shtesa mbi pagën në punë, sipas Rregullores nr. 12, datë 20.03.1996 “Për personelin e ISSH” me shtesa e ndryshime, pika nr. 8.7, “Shtesa e pagës” paguhet në lidhje me:

- a. punën jashtë orarit;
- b. punën në orët e natës;
- c. punën gjatë festave/pushimeve;
- d. shpërblime të tjera;
- e. **për vështirësi jepen shtesa mbi pagat bazë mujore si më poshtë:**
 - operatorë e programistë të Drejtorisë së IT të Zyrës Qendrore;
 - daktilografistë e magazinier i Sektorit të Administratës së Zyrës Qendrore në masën 5%;
 - për punonjësit e kontroll revizionit financiar, kontroll-revizorët 10% dhe drejtuesit e tyre në masën 5%, si në Zyrën Qendrore ashtu dhe në Drejtoritë Rajonale;
 - për punonjësit e Drejtorisë dhe Sektorëve të Kontributeve marrin shtesë sipas përqindjes së tejkalimit së të ardhurave të programuara deri në masën 10%, si në Zyrën Qendrore ashtu dhe në Drejtoritë Rajonale.

Titulli i Gjetjes 5: Në lidhje me mos detajimin e shtesave mbi pagë, për vështirësi në punë, në Rregulloren “Për personelin e ISSH”.

Situata: Me Vendimin e Këshillit Administrativ nr. 3, datë 26.02.2008, është miratuar struktura e re organizative e ISSH, e cila ka sjellë ndryshime në emërtimin e drejtorive dhe pozicioneve të punës. Me ndryshimet strukturore, Këshilli Administrativ me Vendimin nr. 3/2, datë 26.02.2008, ka miratuar Rregulloren “Për Personelin e ISSH” dhe në pikën nr. 2, të këtij Vendimi është përcaktuar shfuqizimi i Rregullores nr. 12, datë 20.03.1996, e ndryshuar. Në pikën nr. 3, ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Në Kapitullin IV “Kategoritë, klasat dhe pagat”, të Rregullores nr. 3/2, datë 26.02.2008, pika nr. 4, përcakton: “Shtesat mbi pagë janë sipas Aneksit 3/C, bashkëlidhur, çdo ndryshim bëhet me vendim të Këshillit Administrativ të ISSH”.

Në Aneksin 3/C, “Për shtesat mbi pagë në ISSH”, ka mungesë detajimi të shtesave dhe të përfituesve të tyre, të cilat konstatohen në vendimet e mëpasshme të marra nga KA. Këshilli Administrativ në vendimet për shtesa e ndryshme në vazhdim, është bazuar në Rregullores nr. 12, datë 20.03.1996, e ndryshuar.

- Me VKA nr. 3, datë 03.03.2009, “Për ndryshime në rregulloren nr. 12, datë 20.03.1996 “Për personelin e ISSH”, i ndryshuar, janë miratuar shtesa e ndryshime në kapitullin 8, “Pagat”.

- Me shkresën nr. 5318 prot., datë 06.11.2009, Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm në ISSH, ka përcjellë në DRSSH Fier:

- kopje të Rregullores së Personelit të ISSH, miratuar me VKA nr. 3/2, datë 26.02.2008;

- kopje të aneksit 1 (organigramë e Drejtorisë së Përgjithshme), aneksi 3/A (klasat dhe kategoritë e ISSH), aneksi 3/B (për pagat në ISSH), si dhe sqarojnë se, “aneksi 3/C “Për shtesat mbi pagë në ISSH” do të dërgohet në një moment të dytë dhe deri në atë moment do vazhdohet me shtesat që janë miratuar, rast pas rasti nga KA i ISSH”.

- kopje të VKA nr. 3, datë 03.03.2009 “Për disa ndryshime në Rregulloren nr.12, datë 20.03.1996, së Personelit të ISSH”.

Në vijim Këshilli Administrativ i ISSH, ka miratuar rritje page me VKA nr. 7, datë 12.04.2017 “Për disa ndryshime në rregulloren nr. 3/2, datë 26.02.2008 “Për Personelin e ISSH” dhe rritjen e pagave” referuar VKM nr. 187, datë 08.03.2017 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e presidentit, kuvendit, komisionit qendror të zgjedhjeve, gjykatën e lartë, prokurorinë e përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit”, si dhe në nivelin mesatar të rritjes së pagave, sipas politikave të rritjes së pagave në institucionet publike. Në pikën nr. 2/b të kësaj VKA, është përcaktuar se për punonjësit mbështetës në Drejtorinë e Përgjithshme dhe Drejtoritë Rajonale, për çdo vit pune të plotë, iu jepet shtesë page për vjetërsi pune në masën 1% mbi pagën, por jo më shumë se 25%.

- Kriteri:** Rregullore nr. 12, datë 20.03.1996 “Për personelin e ISSH” me shtesa e ndryshime;
Rregullore “Për Personelin e ISSH”, e ndryshuar, miratuar me VKA nr. 3/2, datë 26.02.2008.
- Ndikimi/Efekti:** Keqinterpretim mbi shtesat e pagave dhe jo motivim te punonjësit e ISSH.
- Shkaku:** Mungesë detajimi të shtesave në punë për përfituesit e ISSH, në Rregulloren për “Personelin e ISSH”.
- Rëndësia:** E lartë
- Rekomandimi:** Këshilli Administrativ në bashkëpunim me Drejtorin e Përgjithshëm të ISSH, të rishikojnë shtesat mbi pagë të punonjësve të ISSH, duke detajuar dhe përfituesit e tyre.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi: z. A.H., Drejtor i Përgjithshëm; z. F.F., Drejtor i Administrimit të Përgjithshëm dhe znj.L.Gj., Drejtor i Drejtorisë së Financës në ISSH.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, referuar shkresës “Observacione mbi PRA, për auditimin e ushtruar nga KLSH” protokolluar në KLSH me nr. 13/5, datë 26.06.2023, në lidhje me auditimin e menaxhimit të burimeve njerëzore, nuk janë paraqitur observacione.

II.2.7. Opinion mbi pasqyrat financiare të konsoliduara të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, për vitin 2022.

Për auditimin e PF, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Pasqyrat financiare të konsoliduara të vitit 2022.
- Dokumente kontabël.
- Të tjera dokumente mbështetëse.

Nga auditimi ka rezultuar:

Hartimi i pasqyrave financiare për vitin 2022. Nga verifikimi i pasqyrave financiare të konsoliduara rezultoi se paketa e pasqyrave financiare të konsoliduara paraqet në mënyrë të sintetizuar informacionin e pasqyrave individuale të 15 njësive të varësisë si më poshtë:

- 12 (dymbëdhjetë) Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore;

- Buxheti i Brendshëm ISSH;
- Buxheti i Përgjithshëm
- DAQ (e krijuar sipas VKA nr. 10 datë 04.07.2011)

Nga auditimi i pasqyrës së konsoliduar dhe pasqyrave të njësive shpenzuese në varësi të ISSH, u evidentua se në përgjithësi konsolidimi i tyre kryer në përputhje me Rregulloren financiare të ISSH, por u konstatua se kjo rregullore nuk është e përditësuar.

Titulli i gjetjes 1: Mbi Rregulloren Financiare të ISSH.

Situata:	Nga verifikimi i pasqyrave financiare të konsoliduara rezultoi se, pasqyrat financiare të konsoliduara paraqesin informacion të sintetizuar për 12 DRSSH-të, Buxhetin e Përgjithshëm të ISSH, Buxhetin e Brendshëm dhe DAQ, por pika 1 e Kreut IV.C, të Rregullores Financiare të ISSH nr. 5, datë 25.05.2009 nuk e parashikon Drejtorinë e Arkivit Qendror (DAQ), të krijuar me VKA nr.10, datë 04.07.2011 si qendër analize.
Kriteri:	Pika 1, e Kreut IV.C, e Rregullores Financiare të ISSH nr.5, datë 25.05.2009, ku përcaktohet se: <i>“Kontabiliteti dhe Llogaria vjetore e ISSH-së përpunohet në 14 qendra analize, të cilat janë 12 Drejtoritë Rajonale, llogaria e Drejtorisë e Qendrore të ISSH dhe Llogaria e Buxhetit të Përgjithshëm.”</i>
Ndikimi/Efekti:	Rregullorja financiare nuk i përgjigjet situatës aktuale të ISSH dhe mbetet e pazbatuar në tërë elementët e saj. DAQ përjashtohet nga parashikimet e kësaj rregulloreje.
Shkaku:	Rregullorja financiare e pa përditësuar.
Rëndësia:	E ulët
Rekomandime:	Drejtori i Përgjithshëm i ISSH-së dhe Drejtoria e Financës të marrin masa për përditësimin e Rregullores Financiare, me qëllim përfshirjen në raportimin financiar të të gjitha njësive shpenzuese në varësi të saj, të cilat kanë detyrim për raportim financiar.

Në përputhje me kërkesat e Udhëzimit MFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, janë përgatitur pasqyrat financiare, të përbëra si vijon:

- Format nr. 1 “Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar”
- Format nr. 2 “Pasqyra e konsoliduar performancës financiare”
- Format nr. 3 “Pasqyra e konsoliduar (Cash-Flow), sipas metodës direkte”
- Format nr. 4 “Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto”
- Format nr. 5 “Shënimet shpjeguese”

Pasqyrat statistikore:

- Format nr. 6 “Investimet dhe burimet e financimit”
- Format nr. 7/a “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve (kosto historike)”
- Format nr. 7/b “Gjendja dhe ndryshimi i aktiveve (vlera neto)”
- Format nr. 8 “Numri i punonjësve dhe fondi i pagave”

Nga verifikimi i formës së paraqitjes së informacionit financiar, rezultoi se ISSH ka përgatitur pasqyrat financiare, që kërkohen sipas pikës 21, të UMF nr. 5, datë 21.02.2022 dhe janë respektuar formatet e aneksit nr. 2, të Udhëzimit nr. 8 datë 09.03.2018.

Titullari i Institutit të Sigurimeve Shoqërore (ISSH), që është njëkohësisht NA i institucionit rezulton të ketë nënshkruar pasqyrat financiare të vitit 2022 dhe shkresën përcjellëse nr. 2771,

datë 31.03.2023 me të cilën i janë dërguar Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit pranë MFE, por nuk i janë përcjellë në Degës së Thesarit Tiranë, duke qenë se ky institucion menaxhon edhe fonde të alokuara nga buxheti i shtetit.

Titulli i gjetjes 2: Mos depozitim i Pasqyrave Financiare pranë Degës së Thesarit Tiranë.

Situata: Nga ISSH nuk janë dërguar në Degën e Thesarit Tiranë Pasqyrat Financiare të vitit 2022, kjo është në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në pikën 117, të UMFE nr. 8, datë 09.03.2018, nisur nga fakti që ISSH është një institucion i cili menaxhon fonde buxhetore, të cilat në vitin 2022 kanë qenë në shumën 62,872, ose sa 37.6 % e planit të të ardhurave.

Kriteri: Pika 117 të UMFE nr.8, datë 09.03.2018 “*Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme*” ku përcaktohet se: *Njësitë e qeverisjes qendrore janë të detyruara të depozitojnë pasqyrat financiare vjetore individuale të ushtrimit të mbyllur, brenda muajit mars të vitit pasardhës. Depozitimi duhet bërë duke dërguar një kopje në Degën e Thesarit të rrethit përkatës të juridiksionit dhe pas marrjes së konfirmimit nga kjo e fundit një kopje dërgohet në ministrinë apo institucionin qendror përkatës sipas varësisë dhe një kopje tjetër në zyrën e statistikës së rrethit”.*

Ndikimi/Efekti: Mos zbatimi i kriterëve ligjore në lidhje me raportimin e pasqyrave financiare.

Shkaku: Mosveprim nga ana e Nëpunësit Zbatues.

Rëndësia: E ulët

Rekomandime: Drejtoria e Financës, si përgjegjëse për raportimin financiar, të marrë masa për të depozituar një kopje të pasqyrave financiare pranë Degës së Thesarit, Tiranë dhe pas marrjes së konfirmimit nga kjo e fundit të vijojë me depozitimin pranë MFE-së.

Konkluzion: Me përjashtim të dy mangësive të cilësuar më lart, hartimi i pasqyrave financiare, është bazuar në legjislacionit në fuqi, në Ligjin nr. 25/2018 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare” Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin e sistemit financiar dhe kontrollin”, në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme”, me ndryshime, në Manualin Kontabël të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, të miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr. 738/2 datë 04.03.2004 dhe veçoritë e kontabilitetit në Institutin e Sigurimeve Shoqërore, të cilat rrjedhin nga zbatimi i ligjit nr. 7703 datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Rregulloren Financiare të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, etj.

Organizimi dhe mbajtja e kontabilitetit është bërë në zbatim të zbatimit të kërkesave të nenit 3, pika 1, të ligjit 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, VKM nr.783, datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël” pjesa e 73 “Rregulla të përgjithshme” Kapitulli i III-të “Mbajtja e kontabilitetit” dhe Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësisë të Qeverisjes së Përgjithshme”.

Rakordimi i llogarive të Aktiveve të Qëndrueshme dhe llogarive të Aktiveve Qarkulluese me rezultatet e inventarizimit fizik viti 2022:

Përpara hartimit të pasqyrave financiare, është kryer inventarizimi i aktiveve materiale afatgjata dhe afatshkurtra. Drejtori i Përgjithshëm i ISSH, ka nxjerrë Urdhrit e Inventarizimit nr. 25, datë 13.12.2022 “Mbi ngritjen e komisionit të inventarizimit të vlerave pasurisë së institucionit për vitin 2022”, për Sektorin e Buxhetit të Brendshëm, protokolluar me nr. 8338, datë 13.12.2022, për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 i përbërë nga 3 komisione dhe urdhrin nr. 26, datë 13.12.2022” Mbi ngritjen e komisionit të inventarizimit të vlerave pasurisë së institucionit për vitin 2022” për Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore dhe Drejtorinë e Arkivit Qendror protokolluar me nr. 8337, datë 13.12.2022, për periudhën 01.01.2022-31.12.2022.

Nga verifikimi i urdhrave të mësipërm rezultoi se komisioni i inventarizimit është ngritur në përputhje me pikën 82 të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011. “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”. Përbërja e komisioneve ka qenë me mbi tre anëtarë dhe asnjë prej tyre nuk ka pasur përgjegjësi materiale direkte.

Referuar urdhrave të inventarizimit, ka rezultuar se inventarizimi është kryer brenda afatit (25.01.2023 për mjetet, mallrat dhe materialet në magazinë dhe 31.01.2023 për mjetet dhe pajisjet në përdorim) të përcaktuar në urdhrat përkatëse. Me përjashtim të mangësisë së cilësuar më poshtë, ky proces është kryer në përputhje me kërkesat e UMF nr. 30/2011.

Titulli i gjetjes 3: Mos kryerja e procesit të asgjësimit, për aktivet e propozuara për asgjësim.

Situata: Në zbatim të urdhrin nr.26, për inventarizimin janë hartuar procesverbalet e inventarizimit, ku në atë të datës 27.01.2023 përcaktohet se: “...nga inventarizimi fizik i mjeteve, materialeve nëpër zyra dhe mjetet kryesore në përdorim të personelit u konstatua se nuk ka diferenca ndërmjet gjendjes fizike dhe gjendjes kontabile të tyre”. Gjithashtu në relacionin e inventarizimit, ka informacion se nga komisioni i inventarizimit janë konstatuar pajisje dhe materiale për t’u nxjerrë jashtë përdorimit si më poshtë:

Mjete në përdorim: 8 artikuj me VKN 84,734 lekë, konkretisht:

- Pajisje informatike dhe elektronike: 3 artikuj me VKN 39,393 lekë;
- Pajisje, mobilieri zyre: 5 artikuj me VKN 35,344 lekë.

Ky procesverbal është i firmosur nga të gjithë anëtarët e komisionit.

Në zbatim të nenit pikës 96 dhe 97 të Udhëzimit nr.30/2011 është ngritur një komision tjetër për verifikimin e aktiveve të cilësuar nga grupi i inventarizimit si të papërdorshme, ku me anë të shkresës 8338/1 datë 31.01.2023 është konfirmuar lista e aktiveve për të dalë nga përdorimi. Me anë të Urdhrin nr. 8338/2 datë 31.01.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm është urdhëruar të bëhet heqja e materialeve të vlerësuar të papërdorshme dhe efektet financiare të paraqiten në Bilancin e vitit 2022. Nga verifikimi i procedurës së inventarizimit dhe asgjësimit rezultoi se në lidhje me AAM e propozuara për asgjësim, nuk janë marrë masa për asgjësimin fizik të tyre. Për periudhën objekt auditimi nuk konstatohen të jenë asgjësuar aktivet materiale, ndërsa në kontabilitet janë kryer procedurat e çregjistrimit të tyre, të cilat paraqiten në pasqyrën F7 “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)”.

Kriteri: Urdhri i Inventarizimit nr. 26, datë 13.12.2022 “Mbi ngritjen e komisionit të inventarizimit të vlerave pasurisë së institucionit për vitin 2022”; Pika 96 dhe 97 të Udhëzimit nr.30/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” dhe Urdhri nr. 8338/2 datë 31.01.2023 i Drejtorit të Përgjithshëm të ISSH.

Shkaku:	Mos zbatim i urdhrimit të Drejtorit të Përgjithshëm.
Ndikimi/Efekti:	Mos menaxhim i hapësirës fizike të vendit të magazinimit.
Rëndësia:	E ulët
Rekomandime:	Nga Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm të merren masa për të realizuar, sa më parë procesin e asgjësimit fizik të aktiveve të propozuara për asgjësim.

Mbi verifikimin e informacionit kontabël të Pasqyrave Financiare të Konsoliduara.

Nga Grupi i auditimit është verifikuar saktësia, plotësia dhe vërtetësia e informacionit kontabël të pasqyruar në pasqyrat financiare, të llogarisë vjetore të konsoliduar të ISSH për vitin 2022 (Trajtuar në mënyrë analitike në “Aneksin nr. III.2.7”), ku ka rezultuar se, ato paraqesin në mënyrë të drejtë gjendjen financiare në 31.12.2022, me përjashtim të mangësive të mëposhtme:

Titulli i gjetjes 4: Pasaktësi dhe mos unifikim në paraqitjen e zërave në pasqyrat financiare të konsoliduara të vitit 2022.

Situata: Nga verifikimi i saktësisë së paraqitjes së elementëve në PF rezultoi se: Në pasqyrën e pozicionit Financiar të datës 31.12.2022:

- Gjendje inventari qarkullues. Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të konsoliduar të ISSH-së më 31.12.2021 paraqitet në vlerën 43,620,193lekë dhe përbëhet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 14,734,384lekë, nga llogaria “Mallra” në vlerën 28,885,809 lekë. Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën 774,421 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit”. Nga verifikimi i shënimeve shpjeguese për këto zëra, nuk ka të dhëna në lidhje me politikën që përdoren nga ana e subjekteve për vlerësimin e tyre. Mungesa e shënimeve shpjeguese në lidhje me inventarët, për politikën dhe metodat e vlerësimit të tyre është në kundërshtim me kërkesat e paragrafit 34, të SKK 4.
- Llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, në vlerën 3,922,829 lekë paraqet aktive në pasqyrat individuale të DRSSH D. në vlerën 1,450,482 lekë dhe DRSSH Gj. në vlerën 2,472,347 lekë. Kjo kategori paraqet një investim të bërë nga ana e DRSSH-ve të lartpërmendura për shtrimin e rrugës pranë ndërtesës. Kjo paraqitje nga ana e tyre nuk është e saktë pasi nuk përmbushen kushtet e përcaktuara në pikën 8, të SKK 5, në lidhje me kontrollin e aktivitetit. Nga DRSSH-të dhe pse është njohur një element i tillë, nuk është kryer veprim rregullues sipas përcaktimeve të bëra në udhëzimin e MFE nr. 30, datë 27.12.2011, në lidhje me amortizimin e kësaj klase llogarie, por rezulton që në dy vite kjo shumë paraqitet e njëjtë.
- Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, në fund të vitit 2022 është në vlerën 160,114 lekë, krahasuar me një vit më parë që është 0 lekë. Zëri “Shpenzime të periudhave të ardhme” paraqitet vetëm në pasqyrën individuale të DRSSH L. Nga informacioni i marrë nga DRSSH rezulton se, kjo shumë përfaqëson vlerën e karburantit gjendje në fund të vitit 2022, ky veprim nuk përputhet me kërkesat e paragrafit 13 të SKK 2, ku kërkohet që: “....emërtimet e zërave të bilancit duhet të respektohen...”.
- Shuma 2% e sigurimit vullnetar, që paguhet për punonjësit e ISSH, bazuar në pikën 2 të VKA nr.24, të datës 23.12.2014 është paraqitur

në llogarinë 44 “Institucione të tjera publike” nga ana e DRSSH Shkodër ndërsa po i njëjti zë nga DRSSH B., Du. e Di. është paraqitur në llogarinë 419 “Kreditorë, parapagime”, gjë e cila tregon mos unifikim të mënyrës së raportimit.

Në pasqyrën e Performacës Financiare të konsoliduar:

- Llogaria 6009 është paraqitur tek llogaria 6003 dhe anasjelltas.

Kriteri:

Paragrafi 34 i SKK 4 “Inventarët”;

Paragrafi 8 i SKK 5 “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale”;

Paragrafi 13 i SKK 2 “Paraqitja e Pasqyrave Financiare”

Paragrafi 61 i SKK 5 “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jo materiale”

Paragrafit 13, i SKK 2.

Ndikimi/Efekti:

Pasaktësia në paraqitjen e zërave në PF dhe mos unifikimi i llogarive që preken për veprime të njëjta, bën që informacioni i tyre të jetë i pakrahasueshëm mes njërive të ndryshme dhe me situatën financiare nga një vit në tjetrin.

Pasaktësi në paraqitjen e pasqyrës së konsoliduar të pozicionit financiar. Paraqitja e karburantit të papërdorur, si shpenzim i parapaguar sjell një mbivlerësim të drejtave të institucionit, shpenzimi në këtë rast nuk është e drejtë, pasi pagesa nuk është bërë para dorëzimit të mallit dhe kjo paraqitje sjell nënvlerësim të llogarisë “mallra/inventar”. Gjithashtu në bazë të kontabilitetit rritës, për llogarinë “Shpenzim i parapaguar” kur të “përdoret ” e drejta duhet të bëhet veprim rregullues, ç’ka do të sjellë mbivlerësim të shpenzimeve në periudhën në vijim.

Shkaku:

Mos unifikim i mënyrës së klasifikimit të disa veprimeve kontabël të së njëjtës natyrë. Klasifikim i gabuar i ngjarjeve ekonomike.

Rëndësia:

E mesme

Rekomandime:

Drejtoria e Financës, pranë ISSH të marrë masa për të përfshirë në Rregulloren Financiare të ISSH apo në Manualin Kontabël Publik, të ISSH-së detajime në lidhje me disa regjistrime standarde që kanë rezultuar të pasakta ndër vite. Nga Drejtoria e Financës të kërkohet, që DRSSH L. të bëjë korrigjim në lidhje me paraqitjen e saktë të zërit “shpenzime të periudhave të ardhme”, pasi ky klasifikim nuk përbën një shpenzim parapaguar.

Konkluzion: Mbyllja e pasqyrave financiare për vitin 2022 në përgjithësi është në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar, UMF nr.8, datë 09.03.2018, Urdhrit të Ministrit të Financave nr. 64, datë 22.07.2014 “Për Shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” dhe plotësimi i tij është bërë në mënyrë manuale, duke rakorduar me shumat përkatëse.

Veprimet për vitin 2022 janë kontabilizuar në ditarët, ku llogaritë në përgjithësi janë në pozicionin e duhur dhe në përputhje me kërkesat e Ligjit nr.9228, datë 29.04.2004, i ndryshuar e të UMF nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 me përjashtim të konstatimeve të sipërcituara.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, referuar shkresës “Observacione mbi PRA, për auditimin e ushtruar nga KLSH” protokolluar në KLSH me nr. 13/5, datë 26.06.2023, në lidhje me auditimin e Pasqyrave Financiare, nuk janë paraqitur observacione.

II.2.8. Mbi procedurat e prokurimit me fonde publike dhe zbatimin e kontratave.

Nga grupi i auditimit u shqyrtuan të dhënat dhe dokumentacioni i mëposhtëm:

- Dokumentacioni mbi programimin e nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve.
- Dosjet e procedurave të prokurimit;
- Informacioni dhe arkiva e SPE;
- Dokumentacioni mbi zbatimin e kontratave, likuidimi i tyre dokumentacioni përkatës;

Drejtoria e Përgjithshme e ISSH (DP), për vitin 2022, bazuar në të dhënat e Regjistrit të parashikimeve dhe Regjistrit të realizimit të ngarkuar në SPE dhe të miratuar nga Titullari, ka realizuar procedurat e prokurimit sipas Tabelës nr.8.1.

Tabela nr. 8.1 “Realizimi i prokurimeve për vitin 2022”

Lloji i procedurave	Parashikuar		Realizuar		Niveli i realizimit	
	Numër	Vlerë	Numër	Vlerë	Numër %	Vlerë %
Procedura mbi 1,000,000 lekë	3	16,800,000	1	7,750,000	33	46
Procedura nga 100,000-1,000,000 lekë	20	14,885,000	17	9,262,513	85	62
Sistemi dinamik, blerje bileta	1	2,000,000	1	1,215,980		61
Blerje deri në 100,000 lekë	9		7	497,274	78	

Burimi i të dhënave ISSH, përpunuar nga KLSH

Bazuar në analizën e riskut dhe mbulimit me auditim të popullatës “Procedurat e prokurimit publik të realizuara”, u përcaktuan për t’u audituar procedurat sipas Tabelës nr. 2.

Blerje mbi 1,000,000 lekë 1 procedurë, ose 100 % të fondit të prokuruar

Blerje nga 100,000-1,000,000 lekë 8 procedura, ose 61 % të fondeve të prokuruar

Tabela nr. 8.2 “Procedurat që do të auditohen (Kampionimi)”

Nr.	Procedura sipas Regjistrit të realizimit	Fondi limit pa TVSH	Vlera e kontratës pa TVSH	Diferenca	OE Pjesëmarrës	OE i kontraktuar
I	Procedura mbi 1,000,000 lekë					
1	Sigurimi i Aseteve të ISSH, DAQ-Lundër, Drejtorive Rajonale dhe Agjencive të Sigurimeve Shoqërore për vitin 2022	7,750,000	7,681,485	68,515	OE pjesëmarrës-1 OE të kualifikuar-1 OE të skualifikuar-0	I.V.I.GROUP
II	Procedura “Blerje të vogla”					
1	Blerje karburant	1,000,000	912,500	87,500	OE pjesëmarrës-4 OE të kualifikuar-4 OE të skualifikuar-0	E.D.A
2	Krijimi i ambienteve të reja të punës në ISSH	465,000	232,500	232,500	OE pjesëmarrës-23 OE të kualifikuar-20 OE të skualifikuar-3	A.K.
3	Shërbime të printimit, fotokopjimit Materiale publicitare (fletë palosje, postera)	575,250	488,000	87,250	OE pjesëmarrës-15 OE të kualifikuar-3 OE të skualifikuar-12	T.E.
4	F.V. rafte metalike për arkiva	724,000	390,000	334,000	OE pjesëmarrës-35 OE të kualifikuar-18 OE të skualifikuar-17	F.2000
5	Blerje kancelari.	595,000	329,167	265,833	OE pjesëmarrës-8 OE të kualifikuar-6 OE të skualifikuar-2	IT Gj.K.
6	Hartimi i Projekt/Preventivit për rikonstruksionin e godinës së ISSH-së	740,000	653,000	87,000	OE pjesëmarrës-13 OE të kualifikuar-7 OE të skualifikuar-6	Z&C
7	Furnizim/Vendosje ndriçues fluoreshent	922,227	889,400	32,827	OE pjesëmarrës-28 OE të kualifikuar-10 OE të skualifikuar-18	A.B.
8	Blerje materiale pastrimi. Mirëmbajtja e ndriçimit të jashtëm	683,000	589,900	93,100	OE pjesëmarrës-28 OE të kualifikuar-8 OE të skualifikuar-20	Xh.N

Burimi i të dhënave ISSH, përpunuar nga KLSH

Nga auditimi ka rezultuar:

1. Procedura e prokurimit “Sigurimi i Aseteve të ISSH, DAQ-Lundër, Drejtorive Rajonale dhe Agjencive të Sigurimeve Shoqërore për vitin 2022”, me fond limit 7,750,000 pa TVSH, është zhvilluar referuar Ligjit 162/2021, neni 49 “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, pika 1.

Të dhënat mbi procedurën:

Procedura e prokurimit me objekt: “Sigurimi i asetëve të ISSH”		
Urdhër Prokurimi nr. 2276, datë 30.03.2022	Hartuesit e DT, Njësia e prokurimit, sipas UP nr. 2276 datë 30.03.2022	KVO, Urdhri nr.2276/1, datë 31.03.2022
Lloji i Procedurës së prokurimit: E hapur e thjeshtuar	N.Ç., Jurist B.D., Anëtar E.P., Anëtar	F.F., Kryetar F.Sh., Anëtare E.D., Anëtare
Fondi limit pa TVSH: 7,750,000 lekë	Oferta fituese pa TVSH: 7,681,485 lekë	Diferenca me fondin limit pa TVSH: 68,515 lekë
Data e hapjes së procedurës: 21.04.2022, ora 11:00. ³⁰	Burimi i financimit: Buxheti i ISSH për vitin 2022	Operatorët ekonomikë a. Pjesëmarrës në tender: 1 (një) OE b. Kualifikuar: 1 (një) OE c. S'kualifikuar: -
Ankimime: S'ka	Përgjigje ankesës nga AK:	Përgjigje ankesës nga APP/KPP:

Burimi i të dhënave ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit të KLSH

Nga Grupi i auditimit janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- Mbi përlogaritjen e nevojave;
- Mbi përcaktimin e fondit limit dhe buxhetimin e tij;
- Mbi përcaktimin e kriterëve kualifikuese, hartimin dhe miratimin e DT;
- Mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit.
- Mbi zbatimin e kontratës.

1. Përlogaritja e nevojave: Nevoja për sigurimin e asetëve të ISSH cilësuar në dokumentin “Termat e referencës”, paragrafi “Qëllimi i shërbimit”, ku cilësohet: “*Menaxhimi i ISSH-së ka vendosur për sigurimin e asetëve për një periudhë 1 (një vjeçare). Termat e referencës kanë për qëllim përcaktimin e kërkesave dhe kriterëve që shoqëria përcakton për subjektet që do të konkurrojnë*”.

2. Përlogaritja e fondit limit, është kryer bazuar në inventarin e asetëve të ISSH të datës 31.12.2021, sipas të cilit vlera e asetëve në total paraqitet si më poshtë:

- Ndërtime konstruksione në shumën 620,558,192 lekë
- Instalime teknike, makineri, pajisje në shumën 159,362,270 lekë;
- Inventar ekonomik në shumën 47,825,771 lekë.
- Totali në shumën 827,746,232 lekë (si dhe në analitik për çdo zë të AQT-ve, sipas institucioneve përkatëse në varësi të ISSH).

Vlera totale në shumën 827,746,232 lekë, ka shërbyer si bazë për përlogaritjen e fondit limit, referuar nenit 34 “Përlogaritja e vlerës së parashikuar të prokurimit”, pika 10, germa a, ku cilësohet:

“Për kontratat publike të shërbimit, baza për përlogaritjen e vlerës së kontratës është si më poshtë, sipas rastit:

a) shërbime sigurimi: *primi që duhet paguar dhe çdo formë tjetër pagese*”.

Për përlogaritjen e fondit limit është mbajtur procesverbali datë 03.03.2022, bazuar në termat e referencës të përcaktuara në zbatim të Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm nr. 533, datë 26.01.2022 “Për krijimin e komisionit për hartimin e termave të referencës për tenderin me objekt “Sigurimi i asetëve”. Gjithashtu, në zbatim të VKM nr.285/2021, neni 13 “Studimi paraprak i tregut”, janë marrë oferta nga:

- S.në shumën 7,850,000 lekë;
- A. në shumën 7,750,000 lekë
- I. në shumën 7,800,000 lekë.

Njësia e prokurimit ka përcaktuar fondin limit duke ju referuar ofertës me vlerë më të ulët në shumën 7,750,000 lekë.

3. Përcaktimi i kriterëve kualifikuese: Kriteret e përgjithshme të kualifikimit dhe specifikimet teknike, hartimi dhe miratimi i DT.

Sipas të dhënave në SPE, nga AK janë hedhur DT, ku pjesë përbërëse janë:

- Kriteret e përgjithshme;
- Kriteret e veçanta (kapaciteti ekonomik financiar dhe kapaciteti teknik)
- Termat e referencës
- Kushtet dhe termat e kontratës
- Shtojcat, etj.

Përcaktimi i kriterëve kualifikuese është bërë në përputhje me llojin dhe madhësinë e objektit të prokurimit. Konkretisht:

- Kriteret e përgjithshme, sipas VKM nr. 285/2021, neni 25 “Kriteret e përgjithshme të kualifikimit/pjesëmarrjes” dhe neni 26 “Formulari përmbledhës i vetë deklaramit”
Janë vendosur kriteret të thjeshtuara në përputhje me nenin 55 “Procedura e hapur e thjeshtuar” e VKM nr. 285/2021, përse ju përket kriterëve të veçanta të kualifikimit.
- Kapaciteti financiar: Xhiro vjetore jo më shumë se 40 % e fondit limit dhe Pasqyrat financiare të vitit 2020 dhe 2021;
- Kapaciteti teknik profesional: Dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë sa 20% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate dhe OE duhet të jetë kompani sigurimesh e pajisur me leje të vlefshme për ushtrim të aktivitetit sigurime dhe/ose ri sigurime nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, ku të jenë specifikuar qartë grupet /klasat për sigurimet e kërkuara në këtë tender.
- Termat e Referencës Specifikimet Teknike janë hartuar nga grupi i punës i përbërë nga specialistë të fushave përkatëse në përputhje me natyrën dhe përmasat e kontratës, i caktuar me urdhër nga Drejtori i Përgjithshëm me nr.533 prot., datë 26.01.2022.
- Specifikimet teknike, janë vendosur në përputhje me nenin 36 “Specifikimet teknike”, pika 1 ku cilësohet: *“Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet”,* si dhe janë dokumentuar në proces verbalin e mbajtur më datë 31.03.2022 (SPE) “Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim”.

4. Vlerësimi i ofertave: Nga shqyrtimi i dokumentacionit të hedhur në SPE dhe ato të paraqitura pranë AK, nga OE “I.V.I. Group” i vetmi pjesëmarrës në garë, ka rezultuar se ka plotësuar të gjitha kriteret e kualifikimit, si ato të përgjithshme, kapacitetet financiare dhe kapacitetet teknike, të përcaktuara në DT, në përputhje me Ligjin nr.162/2021, neni 92 “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3 ku cilësohet: *“Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”.*

5. Zbatimi i kontratës: Nga titullari i AK, ka dalë Urdhri nr. 3355/1, datë 12.05.2022 për ngritjen e komisionit për ekzekutimin e kontratës me objekt “Sigurimi i aseteve të ISSH etj.”, për një periudhë 1 vjeçare, është hartuar dhe miratuar “Plani i zbatimit të kontratës” nr. 3355/2, datë 12.05.2022, si dhe është prerë “Polica e sigurimit” datë 11.05.2022 e vlefshme deri më

datë 11.05.2023, për primin në shumën 7,681,485 lekë, për sigurimin e vlerës neto të aseteve në shumën 827,746,232 lekë sipas listës bashkëngjitur (inventari i aseteve).

Titulli i gjetjes 1. Mbi modifikimin e dokumenteve të tenderit.

Situata: Nga AK, janë bërë modifikime në DT, të cilat janë hedhur në SPE, në rubrikën “Dokumentet e tenderit” Shtojca nr. 1 “Për një ndryshim të dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar”. Ndryshimet sipas kësaj shtojce nuk janë reflektuar në Rubrikën “Vlerësimi i ofertave”, llogaria e përdoruesit të KVO-së, në kundërshtim me nenin 74, pika 3.

Konkretisht:

- Paraqitja e PF të vitit 2020-2021 dhe jo 2019-2020;
- Paraqitja e licencës me specifikime klasa 8 dhe 9 dhe jo pa specifikuar klasat.

Sipas nenit 74 “Sqarimet dhe ndryshimi në dokumentet e tenderit”, pika 3 cilësohet: “Çdo shtojcë për ndryshim të dokumenteve të tenderit **komunikohet në të njëjtën mënyrë** që është bërë publikimi i njoftimit të procedurës” që do të thotë se në rast të modifikimit të DT, duhet të kryhen në sistem procedurat e mëposhtme të përcaktuara në manual në momentin e publikimit të njoftimit të procedurës, si më poshtë:

Udhëzimi nr. 7, datë 30.07.2021 “Manual teknik për mënyrën e zhvillimit të procedurave të prokurimit me mjete elektronike”, pika 2 “Detyrat dhe funksionalitetet për administratorin e Sistemit” për autoritetin/entin kontraktor, ku cilësohet:

Me anë të llogarisë së “Administratorit të Sistemit” mund të:

Krijohen llogaritë e përdoruesit për anëtarët e njësisë së prokurimit,

Krijohen llogaritë e përdoruesit të KVO, vlerësimi i ofertave, etj.

Kriteret: LPP, neni 74, pika 3

Udhëzimi nr. 7 “Manual teknik për mënyrën e zhvillimit të procedurave të prokurimit me mjete elektronike”, datë 30.07.2021.

Ndikimi/pasoja: Mos pasqyrimi i kriterëve përfundimtare të kualifikimit në rubrikën “Vlerësimi i ofertave”, sjell vlerësimin e tyre nga KVO në mënyrë jo të saktë.

Shkaku: Mosveprim nga Personi përgjegjës për prokurimet.

Rëndësia: E mesme

Rekomandimi: AK, Personi përgjegjës për prokurimet i përcaktuar me Urdhër të Titullarit të AK, duhet të marrë masa që në vazhdimësi të pasqyrojë në SPE, çdo ndryshim të DT, jo vetëm në rubrikën “Dokumente të tenderit”, ku bëhen me dije OE mbi modifikimin e DT, por dhe në rubrikën “Vlerësimi i ofertave”, nëpërmjet së cilës bëhen me dije anëtarët e KVO-së, me qëllim vlerësim të ofertave nga ana e tyre, referuar kriterëve përfundimtare të kualifikimit.

Konkluzion: AK, në lidhje me përllogaritjen e nevojave, përcaktimin e fondit limit, përcaktimin e specifikimeve teknike, hartimin e dokumenteve të tenderit, vlerësimin e ofertave, lidhjen dhe zbatimin e kontratës, ka vepruar në përputhje me kërkesat e ligjit dhe rregullave të prokurimit publik, me përjashtim të komunikimit të modifikimit të DT në SPE, të cilësuar më lart.

Blerjet në vlerë të vogël:

Titullari i Autoritetit Kontraktor (AK) me Urdhrin nr. 180, datë 11.01.2022 “Për krijimin e komisionit të prokurimit me vlera të vogla”, ka urdhëruar KP si më poshtë:

- E.P., Kryetar
- N.Ç., anëtare;
- B.D., anëtar.

Konkluzion: Nga Grupi i auditimit u audituan 8 procedura prokurimi në vlerë të vogël sipas tabelës nr. 8.2, në lidhje me (*Përlllogaritja e nevojave; Përlllogaritja e fondit limit; Vlerësimi i ofertave; Realizimi i kontratës*) ku ka rezultuar se, Komisioni i prokurimit ka zbatuar të gjitha kërkesat e përcaktuara në Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, VKM nr. 285/2021 dhe Udhëzimin nr. 5/2021. Për vlerësimin dhe klasifikimin e OE, KVO ka vepruar në përputhje me VKM 285/2021, neni 56 “Procedura e prokurimit me vlerë të vogël”, dhe Udhëzimin nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”. Gjithashtu, realizimi i kontratave referuara të dhënave analitike të tabelës nr. 8.3, është kryer brenda afateve të përcaktuara.

Tabela nr. 8.3. “Zbatimi i afateve të përcaktuara për realizimin e kontratave”

Nr.	Objekti	Kontraktori	Afati i përcaktuar	Realizimi
1	Krijimi i ambienteve të reja	A.	7 ditë nga shpallja fitues. 17.03.2022	Datë 24.03.2022, sipas procesverbalit të marrjes në dorëzim datë 24.03.2022.
2	Ndriçimi i godinës		7 ditë nga lidhja e kontratës 12.12.2022	Datë 20.12.2022, sipas procesverbalit të marrjes në dorëzim datë 20.12.2022.
3	Materiale pastrimi		7 ditë nga shpallja fitues. 22.09.2022	Datë 29.09.2022, sipas procesverbalit të marrjes në dorëzim datë 29.09.2022.
4	Blerje karburant		Nga lidhja e kontratës 03.10.2022	Në vazhdimësi deri në përfundim të sasisë
5	Blerje kancelari		3 ditë nga shpallja fitues 26.10.2011	Datë 28.10.2022, sipas procesverbalit të marrjes në dorëzim datë 28.10.2022.
6	Projekti			
7	Shërbim printimi	T.E.	Nga lidhja e kontratës 20.06.2022	Në vazhdimësi deri në përfundim të shërbimit
8	Rafte metalike		5 ditë nga shpallja fitues. 20.05.2022	Datë 25.05.2022, sipas procesverbalit të marrjes në dorëzim datë 25.05.2022

Burimi i të dhënave ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit të KLSH

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, referuar shkresës “Observacione mbi PRA, për auditimin e ushtruar nga KLSH” protokolluar në KLSH me nr. 13/5, datë 26.06.2023, në lidhje me auditimin e prokurimeve publike, nuk janë paraqitur observacione.

II.2.9. Auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin, si dhe auditin e brendshëm.

Nga grupi i auditimit për vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit sipas komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, **u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:**

- Procedura, procese pune, etapa raportimi;
- Kodi Etikës;
- Procedurat për te raportuar shkeljet e legjislacionit mbi etiken dhe për marrjen e masave për shkeljet e konstatuara;
- Plani strategjik;
- Struktura dhe organika e Institucionit;

- Rregulla të brendshme të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre;
- Vendimi për miratimin e strukturës organizative;
- Vlerësimet e punës të punonjësve të ISSH;
- Vendimi përsa i përket planifikimit të trajnimeve;

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, për vlerësimin e 5 komponentëve të MFK, konstatohet sa më poshtë vijon:

1. Vlerësimi i Mjedisit të Kontrollit

Mjedisi i kontrollit vlerësohet bazuar në komponentët si më poshtë:

1.1. Integritetin personal dhe etikën profesionale të nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të njësisë publike:

ISSH ka një Kod Etike të miratuar me vendimin nr.5 të datës 14.08.2020 si dhe ka procedurën për të raportuar shkeljet e legjislacionit mbi etikën dhe për marrjen e masave për shkeljet e konstatuara e cila është e bazuar në ligjin 153/2013 “Për nëpunësin civil” si dhe në rregulloren e brendshme të institucionit sipas përcaktimeve të nenit 20 “Mjedisi i kontrollit”, pika 2, germa “a” të Ligjit 10926 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” të ndryshuar dhe Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, të miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, në Kapitullin III, pika 3.1 ku përcaktohet se “Kadri i sjelljes së menaxherëve dhe stafit duhet të përcaktohen nga titullari i njësisë publike në një Kod të Brendshëm Etike, ose në një Kod Sjelljeje”. Gjithashtu, edhe në zbatim të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003, “Për rregullat e etikës në administratën publike”, institucionet duhet të hartojnë kod etike.

1.2. Politikat menaxheriale dhe stilin e punës:

Konstatohet se, ISSH ka hartuar një plan strategjik i cili përmban objektivat afatmesëm dhe vjetore prioritare të institucionit si dhe ka përgatitur planet e masave dhe veprimet në mënyrë që të monitorojë zbatimin e tyre, sipas përcaktimeve në ligjin nr.10296, datë 08.07.2010, neni 9 “Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues”, pika 4, germa “a” dhe Manualin për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Kap. IV “Zbatimi i MFK”, pika, 4.2.10 “Roli i nëpunësit autorizues të njësisë”, germa a.

ISSH ka miratuar Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS), është caktuar dhe Koordinatori Menaxhimit Financiar dhe kontrollit sipas Urdhrit nr.507/1 datë 08.02.2018, i cili e ka patur këtë funksion deri në daljen e Urdhrit me nr.3676/1 datë 30.05.2022 për ndryshimin e Koordinatorit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Punonjësit e ISSH, marrëdhëniet e punës me punëdhënësin i rregullojnë në bazë të Ligjit nr. 7961 të datës 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”.

Sa i përket delegimit të kompetencave, konstatohet se *ISSH ka rregulla të brendshme të miratuara nga titullari, të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre*, konkretisht shkresa me nr. 3676 datë 26.05.2022, sipas përcaktimeve në nenin 15 të ligjit Nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar si dhe Kap. III “Delegimi i Detyrave”, të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

1.3. Strukturën organizative, garantimin e ndarjes së detyrës, hierarkinë dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit;

ISSH mbështetur në nenin nr.74, shkronja b/1, të Ligjit 7703 datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, Vendimin nr.618 datë 20.10.2021 “Për krijimin, organizimin e funksionimin e rrjetit të Koordinatorëve kundër korrupsionit”, Këshilli Administrativ me anë të Vendimit nr.2051 datë 18.03.2022 ka vendosur Miratimin e Strukturës Organizative me numër të përgjithshëm të punonjësve prej 1338 (të detajuara sipas Aneksit nr.1 bashkëlidhur vendimit), me një shtesë prej një punonjësi në pozicionin “Koordinator kundër Korrupsionit”.

1.4. Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore;

Në rregulloren e brendshme të institucionit, ISSH ka përcaktuar rregullat e funksionimit të brendshëm lidhur me strukturën organike, të drejtat dhe detyrimet e punonjësve, marrëdhëniet ndërmjet strukturave të njësisë, shkeljet disiplinore, hyrjen dhe qëndrimin në mjediset e punës etj., sipas përcaktimeve në nenin 20, të Ligjit nr.10296 datë 08.07.2010. Nga institucioni rezulton të jetë bërë vlerësimi vjetor i punës për çdo punonjës, i cili është bashkëlidhur dosjeve personale të punonjësve. Konstatohet se për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve, në Institutin e Sigurimeve Shoqërore ka plan veprimi për trajnime për rritjen e kapaciteteve profesionale të punonjësve, të cilat realizohen sipas nevojave, konkretisht me shkresën nr.262 prot., të datës 14.01.2022.

2. Menaxhimi i riskut.

ISSH ka hartuar një strategji për menaxhimin e riskut, me anë të shkresës nr.643 datë 28.01.2022. Gjithashtu, konstatohet se njësia ka përcaktuar koordinatorin e riskut, me anë të Urdhrit nr.3676 datë 30.05.2022, sipas përcaktimeve në nenin 8, pika 8/a të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, të ndryshuar dhe nenin 21, pika 2 “Menaxhimi i riskut”.

3. Aktivitetet e kontrollit.

ISSH ka hartuar dhe miratuar gjurmën e auditimit, sipas përcaktimit në nenin 16, të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Detyrimi për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditit” dhe nenin 12 “Përgjegjshmëria menaxheriale e NZ”.

3. Informimi dhe komunikimi

Shkëmbimi i informacionit ndërmjet punonjësve të ISSH, si horizontalisht ashtu edhe vertikalisht kryhet kryesisht me anë të postës elektronike dhe në mënyrë verbale ndërsa, jashtë institucionit komunikohet kryesisht në formë shkresore zyrtare dhe ka korrespondencë të rregullt me subjektet kryesore të jashtme, pa përjashtuar komunikimin elektronik dhe atë telefonik.

Nga kërkimi i ndërveprimit të ISSH me qytetarët, konstatohet se institucioni ka një faqe web ku përmban edhe nën seksion ku pasqyrohet programi i transparencës, sipas përcaktimeve në Ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” ku në nenin 4 përcaktohet se “*Autoriteti publik, jo më vonë se 6 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji ose nga krijimi i tij, vë në zbatim një program institucional të transparencës, ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publike të këtij informacioni*”. Gjithashtu është i pasqyruar koordinatori për të drejtën e informimit.

5. Monitorimi

Për periudhën e audituar, konstatohet se ISSH ka plotësuar pyetësorët e vetëvlerësimit në zbatim të formatit të miratuar pjesë e Manualit për MFK si dhe ka një sistem monitorimi për vlerësimin e efektivitetit dhe progresit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm për arritjen e objektivave sipas përcaktimeve në nenin 24, të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010.

Konkluzion: nga auditimi rezulton se, menaxhimi financiar dhe sistemi i kontrollit brendshëm ka funksionuar në mënyrë të plotë në Institutin e Sigurimeve Shoqërore.

9.2. Mbi veprimtarinë e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm”.

Auditimi i funksionimit të strukturave të auditimit të brendshëm.

Misioni i Auditit të Brendshëm, mbështetur në nenin 5, të ligjit nr. 114, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, është të japë siguri të arsyeshme Titullarit të Institutit, në mënyrë të pavarur dhe objektive.

Objektivat e DAB.

- siguri dhënia objektive ndaj Titullarit të ISSH-së, zbatimi i proceseve të punës kryhet me

efikasitet, eficencë dhe ekonomikitet, në përmbushje të objektivave të përcaktuara;

- zhvillimi i një veprimtarie të disiplinuar dhe sistematike, për të vlerësuar e përmirësuar frytshmërinë e menaxhimit të riskut, si dhe proceset e kontrollit.

Për auditimin e veprimtarisë së Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, nga Grupi i auditimit, **u shqyrtuan çështjet e më poshtme:**

- Organizimi dhe funksionimi i Drejtorisë së Auditit të Brendshëm (DAB këtu, e më poshtë). Niveli profesional i audituesve, certifikimi i tyre dhe trajnimet e vijueshme;
- Bashkëpunimi me Drejtorinë e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm (DHAB) pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë (MFE), raportimi në këtë drejtori;
- Realizimi i planit vjetor të DAB;
- Auditim me zgjedhje mbi misionet e auditimeve të kryera nga DAB, zbatimi i kriterëve ligjore dhe nënligjore në fushën e auditimit të brendshëm, standardet dhe manualët të dala në zbatim të tyre;

▪ **Organizimi dhe funksionimi i DAB.**

Nga shqyrtimi i dokumentacioneve u konstatua se, krijimi i DAB në ISSH, është përcaktuar në nenin 12, të vendimit nr. 1022, datë 09.07.2008, për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 161, datë 11.4.1994, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e statutit të Institutit të Sigurimeve Shoqërore". DAB për periudhën objekt auditimi, ka funksionuar sipas përcaktimeve të ligjit nr. 114, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar.

Në bazë të nenit 29, të ligjit nr. 9377, datë 21.04.2005, për disa ndryshime e shtesa në ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 DAB në aspektin organizativ dhe funksional ka varësi të drejtpërdrejtë nga Drejtori i Përgjithshëm i ISSH, si dhe punonjësit e saj emërohen prej tij.

Me shkresën nr. 7376 prot., datë 07.09.2017, të Titullarit të ISSH, bazuar në pikën nr. 4, të vendimit nr. 5, datë 20.07.2010 "Për ndryshimin e strukturës organizative të ISSH-së", të Këshillit Administrativ, struktura e drejtorisë është organizuar me 9 punonjës (1+6+2), të ndarë në Degën e Auditimit Financiar (1+5) dhe në Sektorin e Raporteve dhe Menaxhimit të Riskut (2).

- Nga auditimi u konstatua se gjatë vitit 2022, DAB ka funksionuar me strukturë jo të plotë, duke pasur 3 vende vakante të lira, dy në pozicionin auditues, në Degën e Auditimit Financiar dhe një në pozicionin auditues, në Sektorin e Raporteve dhe Menaxhimit të Riskut, kjo jo në përputhje me strukturën organike, të miratuar me Vendimin e Këshillit Administrativ nr. 5, datë 20.07.2010 "Për ndryshimin e strukturës organizative të ISSH-së". Mungesa në strukturën organizative të kësaj drejtorie sjell pasoja në performancën e njesisë, duke rrezikuar përmbushjen të objektivave të përcaktuara.
- Nga auditimi u konstatua se, punonjësit e DAB kanë arsim bazë: 4 prej tyre profil ekonomik, 1 profil juridik, 1 prej tyre ka profil ekonomik dhe juridik si dhe janë të pajisur me certifikatën "Auditues i Brendshëm në sektorin publik". Gjithashtu, të gjithë kanë përvojë pune, mbi 5 vite si auditues të brendshëm. Pra, punësimi i tyre është bërë në përputhje me nenin 11, pika 2, germa a, të ligjit nr.114, datë 22.10.2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik".
- Punonjësit e DAB kanë kryer trajnimet e vijueshme të detyrueshme, 40 orë në vit dhe kanë marrë pjesë në të gjitha trajnimet që ka organizuar Njësia Qendrore e Auditit të Brendshëm (NJQAB), duke i zhvilluar ato nga data 17 Tetor-04 Nëntor 2022, sipas Tabelës anekse nr. 9.1 "Të dhëna për burimet njerëzore të auditit të brendshëm për vitin 2022" pjesë e këtij Projekt raporti.
- Nga auditimi rezulton se, nga ana e DAB është përgatitur relacioni për përditësimin e Rregullores, më 15.11.2021, në të cilin janë evidentuar çështjet që duhet ti shtohen Rregullores lidhur me përcaktimin e statusit organizativ të strukturës së DAB, detyrat, përgjegjësitë dhe kushtet e posaçme për punësim në njësinë e auditimit të brendshëm,

ndryshime të cilat janë miratuar me anë të Urdhrit nr.50 datë 05.01.2022.

Karta e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik:

NJAB në mbështetje të Urdhrit nr.100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave “Për miratimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” ka hartuar “Kartën e Auditimit të Brendshëm në sektorin publik” në ISSH dhe e ka përditësuar atë, gjë e cila është miratuar nga titullari me shkresën nr.7671, datë 12.11.2019.

Plani Strategjik 2022-2024 dhe Plani Vjetor:

Ne mbështetje të Manualit të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik është hartuar dhe miratuar plani strategjik dhe plani vjetor. Për periudhën objekt auditimi, DAB në ISSH ka hartuar planin strategjik dhe vjetor për vitet 2022-2024, ku është dërguar në Drejtorinë e Harmonizimit të Auditit të Brendshëm e shkresën nr.5602/1 prot., datë 16.10.2021, i miratuar nga Drejtori i Përgjithshëm i ISSH. Nga auditimi u konstatua se, planet janë dërguar brenda afatit (20 Tetor), të përcaktuara në pikën 3.2 “Plani vjetor i auditit të brendshëm” dhe pikën 3.3 “Afati i përgatitjes dhe dërgimit të planit vjetor dhe strategjik të auditit të brendshëm.

Me shkresën nr. 627/1 prot., datë 10.02.2022, i është dërguar Komitetit të Auditimit të Brendshëm në MFE, “Raporti i Veprimtarisë së DAB-së në ISSH për vitin 2022” duke i bashkëngjitur dhe “Pasqyrat Përmbledhëse 1-6” në formatin Excel.

▪ **Realizimi i angazhimeve sipas planeve vjetore:**

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm për vitin 2022 ka planifikuar 14 angazhime auditimi, në të cilat kryesisht do të auditohet përputhshmëria dhe rregullshmëria e aktivitetit ekonomik e financiar, dhe për sektorë të veçantë do të ketë auditime performance, sipas Tabelës anekse nr.9.2 “Planifikimi i angazhimeve të auditimit për vitin 2022” pjesë e këtij Projekt raporti.

Për 12 subjekte janë planifikuar të auditoohen gjithë veprimtaria organizative e funksionale, të gjitha fushat e sistemet e veprimtarisë së tyre (zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare) dhe në Drejtorinë Qendrore të ISSH-së janë planifikuar të kryhen 1 auditim financiar dhe 1 auditim performance. Gjithashtu është planifikuar një mision auditimi për të gjitha subjektet e audituara gjatë vitit 2021 për të vlerësuar statusin e zbatimit të rekomandimeve.

Nga auditimi rezultoi se, gjatë vitit 2022 nuk ka patur ndryshim plani të auditimeve, por ka një kërkesë nga Titullari i Institucionit, për program shtesë auditimi. Ku konkretisht me anë të Urdhrit nr.1741 Prot., datë 07.03.2022 nga ana e Titullarit është kërkuar Auditim Tematik në DRSSH Sh.. DAB ka realizuar planin e auditimit në masën 93.3 % për vitin 2022, duke ushtruar misionet e auditimit në 12 DRSSH me përjashtim të DRSSH E. e cila ishte planifikuar në Shtator 2022 dhe rezultoi e papërfunduar, në DAQ dhe në 2 drejtori të Drejtorisë së Përgjithshme të Sigurimeve Shoqërore. Realizimi i misioneve audituese për vitin 2022, paraqitet në Tabelën anekse nr.9.3 “Realizimi i misioneve të auditimit për vitin 2022” pjesë e këtij Projekt raporti.

Konstatim: Sa më sipër, vihet re se për vitin 2022, nuk është planifikuar dhe kryer asnjë auditim në sistemet e teknologjisë së informacionit në lidhje me ruajtjen e aseteve, integritetin e të dhënave dhe operimin në mënyrë efektive për të arritur qëllimet dhe objektivat e Institucionit, edhe pse vlerësimi i nivelit të riskut për vitin 2022 në lidhje me sistemet e teknologjisë së informacionit në DAQ është vlerësuar i lartë.

▪ **Gjetjet dhe rekomandimet e lëna nga AB.**

Nga angazhimet e realizuara për vitin 2022 janë evidentuar në total 101 gjetje dhe shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik në vlerën 31,849,000 lekë. Gjetjet si numër për vitin 2022 janë 15% më pak se gjetjet e vitit 2021. Gjetjet kryesore nga auditimet lidhen kryesisht me:

- Sistemin e proceseve organizative. Menaxhimi i burimeve njerëzore.
- Sistemin e programimit dhe zbatimit të buxhetit.
- Sistemin e programimit dhe realizimit të të ardhurave.

- Sistemin e caktimit të pagesave të përfitimeve afatgjata dhe afatshkurtra.
- Sistemin e menaxhimit të aktiveve.
- Sisteme të tjera sipas misionit dhe qëllimit të institucionit.

Për gjetjet e konstatuara nga DAB janë lënë 102 rekomandime, nga të cilat 11 rekomandime për përmirësime të sistemeve të kontrollit të brendshëm, 81 rekomandime me karakter organizativ, 8 rekomandime për masa zhdëmtimi dhe 2 rekomandime të tjera. Të 102 rekomandimet e dhëna rezultojnë të pranuar nga menaxhimi, zbatuar 64.7% e tyre dhe janë në proces zbatimi 35.3 % pasi janë lënë afate për realizim në vitin 2023. Në seksionin Anekse paraqitet tabela nr. 9.4 mbi “Gjetjet dhe rekomandimet për vitin 2022”.

▪ **Vlerësimi i procedurave dhe standardeve të kryerjes së auditimit të brendshëm, ruajtja dhe arkivimi i tyre:**

Grupi i auditimit shqyrtoi për vlerësim, 5 dosje me zgjedhje të rastësishme nga 14 dosje në total, të angazhimeve të kryera në vitin 2022, në të cilat u evidentua se grupet e auditimit kanë grumbulluar informacionet e nevojshëm për përgatitjen e Raporteve të Auditimit. Audituesit kanë analizuar të gjithë informacionet e grumbulluara nëpërmjet metodave dhe teknikave të përdorura të auditimit, që janë gjykuar më të përshtatshme dhe të besueshme për subjektin. Në dosjet e auditimit gjenden të administruara letrat e punës, evidencat e përshtatshme si dhe pyetësorët e dhënë nga grupet e auditimeve, të cilat lënë gjurmë dhe dëshmojnë mbi proceset e ndjekura për zbatimin e programit të auditimit të miratuar. Në seksionin Anekse paraqitet tabela nr. 9.5 mbi “Të dhëna mbi procedurat, numrin e programeve dhe zbatimin e afateve të auditimeve për vitin 2022”.

Konstatim: nga ana e grupit të auditimit vihet re se, në praktikën e auditimit të DRSSH K. dhe Berat, memot e përpiluara nga DAB nuk përmbajnë datë, sipas përcaktimeve në nenin 13 “Mbi normat tekniko profesionale për arkivat”, ku shprehet se: *“Dokumentet e brendshme si: Vendimet, urdhrat, udhëzimet, materialet e mbledhjeve të forumeve të subjektit shtetëror e jo shtetëror etj. kanë të gjithë elementët e dokumenteve që dalin”*;

-Në praktikën e auditimit të DRSSH D. në praktikën e auditimit nuk rezulton të jetë përpiluar memo për Titullarin si dhe mungon Reagimi (feedback) nga ana e subjektit të audituar në lidhje me Raportin Përfundimtar;

-Në praktikën e auditimit të DRSSH D. konstatohet se Projekt Raporti është dërguar me 13 ditë vonesë, kjo në kundërshtim me Manualin e Auditimit të Brendshëm pika 4.1.12;

-Në praktikën e auditimit të DRSSH K., Sh. dhe D. konstatohet se Raportet Përfundimtare janë dërguar me vonesë, kjo në kundërshtim me Manualin e Auditimit të Brendshëm pika 4.1.12; Gjithashtu rezultojnë 2 takime fillestar/përmbyllës të pa nënshkruara dhe në një rast deklarata e konfliktit të interesit e paplotësuar.

Titulli i Gjetjes 1: Mosplotësim i strukturave të auditimit të brendshëm, tejkalim të afateve si dhe mungesa të elementëve që përbëjnë dokumentin zyrtar.

Situata:

1. Me shkresën nr. 7376 prot., datë 07.09.2017, të Titullarit të ISSH, bazuar në pikën nr. 4, të vendimit nr. 5, datë 20.07.2010 “Për ndryshimin e strukturës organizative të ISSH-së”, të Këshillit Administrativ, struktura e drejtorisë është organizuar me 9 punonjës (1+6+2), të ndarë në Degën e Auditimit Financiar (1+5) dhe në Sektorin e Raporteve dhe Menaxhimit të Riskut (2). Nga auditimi u konstatua se gjatë vitit 2022, DAB ka funksionuar me strukturë jo të plotë, duke pasur 3 vende vakante, dy në pozicionin auditues, në Degën e Auditimit Financiar dhe një në pozicionin auditues, në Sektorin e Raporteve dhe Menaxhimit të Riskut, kjo jo në përputhje me strukturën organike, të miratuar me Vendimin

e Këshillit Administrativ nr. 5, datë 20.07.2010 “Për ndryshimin e strukturës organizative të ISSH-së” (Trajtuar në pikën 6.2)

2. Nuk është planifikuar dhe kryer asnjë auditim në sistemet e teknologjisë së informacionit në lidhje me ruajtjen e aseteve, integritetin e të dhënave dhe operimin në mënyrë efektive për të arritur qëllimet dhe objektivat e Institucionit, edhe pse vlerësimi i nivelit të riskut për vitin 2022 në lidhje me sistemet e teknologjisë së informacionit në DAQ është vlerësuar i lartë.
3. Në praktikën e auditimit të DRSSH K. dhe B. Memot e përpiluara nga DAB nuk përmbajnë datë, sipas përcaktimeve në nenin 13 “Mbi normat tekniko profesionale për arkivat”.
4. Në praktikën e auditimit të DRSSH D. konstatohet se Projekt Raporti është dërguar me 13 ditë vonesë si dhe në praktikën e auditimit të DRSSH K., Sh. dhe D. konstatohet se Raportet Përfundimtare janë dërguar me vonesë, kjo në kundërshtim me Manualin e Auditimit të Brendshëm pika 4.1.12.

Kriteri:	Ligji 7961 datë 12.07.1995 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”; Ligji nr. 114, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”; Vendimi i KA nr.5, datë 20.07.2010 “Për ndryshimin e strukturës organizative të ISSH-së”, Nenin 13 “Mbi normat tekniko profesionale për arkivat” Manualin e Auditimit të Brendshëm pika 4.1.12.
Ndikimi/efekti:	Mungesa në strukturën organizative të kësaj drejtorie sjell pasoja në performancën e njësisë, duke rrezikuar përmbushjen të objektivave të përcaktuara.
Shkaku:	Mungesa e audituesve dhe i një audituesi me profil arsimit në fushën e IT.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandim:	DAB të marrë masa për bulimin me auditimit të sistemeve IT, për evadimin në kohë të raporteve të auditimit sipas përcaktimeve në Manualin e Auditimit të Brendshëm pika 4.1.12., si dhe hartimin e shkresave/dokumenteve me të gjithë elementët që përbëjnë dokumentin zyrtar.

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e Auditimit, referuar shkresës “Observacione mbi PRA, për auditimin e ushtruar nga KLSH” protokolluar në KLSH me nr. 13/5, datë 26.06.2023, në lidhje me auditimin e MFK dhe AB, nuk janë paraqitur observacione.

II.2.10. Mbi përputhshmërinë e procedurave të kryera në përlogaritjen dhe pagesat e pensioneve, në Drejtorinë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë.

Për auditimin e kësaj çështjeje u morën në shqyrtim:

- Dosjet e pensioneve;
- Të dhënat në sistemin CMIS dhe PCMAS;

Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore Tiranë, gjatë vitit 2022 ka realizuar përlogaritjen e pensioneve si më poshtë:

Nr.	Të dhëna		
	Lloji	Numër	Vlerë
1	Pension pleqërie:		
	Nënlojet:		
	- I plotë	8,401	141,422,323
	- I reduktuar	12	262,485
	- I plote i ardhur	814	13,811,945
	- I reduktuar i ardhur	1	15,071
2	Pensionet e invaliditetit:		
	Nënlojet:		
	- I plotë	113	2,336,732
	- I plotë me kujdestari	3	124,253
	- I pjesshëm	21	269,891
	- I plote/reduktuar	456	5,753,816
	- I plot/reduktua/kujdestari	11	218,669
	- I plote-ardhur	53	997,582
	- I plote me kujdestari ardhur	1	19,728
	- I pjesshëm-ardhur	4	54,293
	- I plote/reduktuar -ardhur	12	185,710
3	Pensione familjare	649	6,523,567
	Pension Familjar ardhur	88	900,691
4	Pa aftësi nga sëmundjet	8,324	303,785
5	Barrë lindja	15,331	2,411,911
6	Aksidentet	103	11,376
7	Të tjera pens sociale te rinj	40	

Burimi i të dhënave ISSH, përpunoi Grupi i auditimit

Të dhëna të tjera:

- Numër aplikimesh gjatë vitit 2022;
- 12,514 aplikime për pension për herë të parë,
- 16,104 kërkesa për rishikim të pensioneve të caktuara dhe
- 6,115 ri komisionime invaliditeti
- Aplikime të shqyrtuara gjatë vitit 2022;
- 11,705 aplikime për pension për herë të parë
- 360 kërkesa për rishikim të pensioneve të caktuara
- Ditë mesatare për shqyrtimin e një aplikimi/dosje, mesatarisht 30 ditë për aplikimet për herë të parë
- Numër aplikimesh të bëra gjatë vitit 2021 dhe të përfunduara në vitin 2022;
- Për Pensionet e reja 664 aplikime;
- Për Pensionet e ardhur 62 aplikime;
- Numër aplikimesh të vitit 2022 të pa përfunduara dhe të mbartura në vitin 2023;
- 809 aplikime për pension për herë të parë dhe,
- 360 kërkesa për rishikim të pensioneve të caktuara
- Numër aplikimesh që nuk kanë përmbushur kriteret; 1571 aplikime për pension për herë të parë;
- Numër ankesash gjatë vitit 2022, gjithsej 3947 ankesa që kanë kërkuar rishqyrtim të pensionit, nga të cilat:
- 3542 ankesa të shqyrtuara;
- 1532 ankesa të pranuar;
- 2010 ankesa të papranuar.

Referuar të dhënave të mësipërme, DRSSH Tiranë gjatë vitit 2022 ka përlllogaritur 9,228 pensione pleqërie, 674 pensione invaliditeti, 737 pensione familjare dhe 23,798 të tjera ku 15,331 i përkasin barrë lindjes.

Nga grupi i auditimit bazuar në të dhënat e mësipërme u përzgjedhën për auditim 148 dosje pensionesh duke përfshirë tre llojet kryesore të pensioneve (pleqëri, invaliditet dhe familjar), **nga auditimi i të cilave ka rezultuar:**

10.1. Rregullshmëria e dokumentacionit që duhet të plotësohet nga përfituesit e pensioneve:

Nga auditimi mbi rregullshmërinë e dosjeve të pensioneve ka rezultuar se në përgjithësi në dosje ndodheshin të gjithë dokumentacioni i kërkuar i cituar në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr. 10.2 “Dokumentacioni i dosjes”

	Dokumentacioni i detyrueshëm	Institucioni
1	Aplikim në E-Albania (pa dokumente të bashkëngjitura)	Personi
2	Fotokopje e kartës së identitetit	Personi
3	Certifikatë familjare	E-Albania
4	Certifikatë martese (kur ka ndryshim mbiemri)	ZGJC
5	Deklaratë për vitet e punës	Personi
6	Librezë pune	Personi
7	Librezë kontributesh	Personi
8	Vendim për caktim pensioni nr. 29529, datë 26.05.2022	DRSSH
9	Kartelë identifikuese	DRSSH
10	Kartelë financiare pensioni	DRSSH
11	Akt verifikimi mbi vjetërsinë në punë	DRSSH-Qendra e punës
12	Vërtetim mbi bazën e vlerësueshme	Qendra e punës
13	Vërtetim për sigurimin vullnetar	DRSSH
14	Fletë përlllogaritje për periudhën e sigurimit	DRSSH
15	Kërkesë e DRSSH për plotësim page	Arkivi Qendror

Burimi i të dhënave ISSH, përpunoi Grupi i auditimit

10.2. Respektimi i afateve në përlllogaritjen dhe pagesën e pensioneve:

Nga auditimi mbi respektimin e afatit 42 ditor në përpunimin e një dosje pensioni, referuar të dhënave në Fletë shoqërimi operacional, të detajuar më poshtë ka rezultuar se, nga auditimi i 148 dosjeve, **në 38 raste, ose në masën 25 % kundrejt totalit të dosjeve të audituara** (Tabela anekse nr. 10.2.1) **nuk është respektuar afati i përpunimit të dosjes** nga momenti i aplikimit deri në nënshkrimin nga Zyra e Financës për kryerjen e pagesës, si dhe shërbimin postar (tre ditë) në total 42 ditë afat.

Tabela nr. 3 “Rrjedha e punës sipas “Fletë shoqërimi operacionale” dhe afatet”

Nr.	Struktura pritëse	Data
1	ALSSH	
2	Përgjegjësi i ALSSH	
3	Koordinatori	
4	Kryetari i Degës së Përfitimeve	
5	Inspektori përpunues	
6	Kryetari i Degës së Përfitimeve	
7	Kryetari i Degës së Financës	
8	Drejtori	
9	Arkiva	
	Totali	42 ditë

Burimi i të dhënave ISSH, përpunoi Grupi i auditimit

U evidentuan rastet e mëposhtme, ku nuk ishte nënshkruar “Fletë shoqërimi operacional të lidhjes së pensionit”, nga të gjithë përgjegjësit sipas procedurave të përcaktuara, konkretisht:

Dosje nr. 303864, pension pleqërie i pjesshëm, inspektori përpunues znj. D.T..

Fletë shoqërimi operacionale e lidhjes së pensionit nuk është nënshkruar nga K/Degës së Financës, si dhe Kartela financiare nuk është e nënshkruar nga K/Degës së Përfitimeve dhe K/Degës së Financës.

Dosje nr. P6146, pension pleqërie i pjesshëm, inspektori përpunues znj. M.P..

Kartela financiare e pensionit, nuk është nënshkruar nga K/Degës së Përfitimeve dhe K/Degës së Financës.

Dosje nr. P2565, pension pleqërie i pjesshëm, inspektori përpunues znj. A.R.

Fletë shoqërimi operacionale e lidhjes së pensionit, nuk është nënshkruar nga K/Degës Financës dhe Kartela financiare nuk është nënshkruar nga Inspektori përpunues.

Dosje nr. 306177, pension pleqërie i plotë, inspektori përpunues znj. I.A..

Në lidhje me respektimin e afatit prej 42 ditësh, nuk mund ta vlerësojmë për arsye se nuk është në dosje fleta e inventarit të ndjekjes së hapave nga strukturat përkatëse të përpunimit të dosjes së pensionit.

Dosja nr. P4816 pension pleqëri e reduktuar, inspektori përpunues I.A..

Në dosje mungon “Fletë shoqërimi operacionale e lidhjes së pensionit” të respektimit të afateve në procesin e caktimit të pensionit, për këtë arsye nuk mund japim konkluzionin nëse procesi i caktimit të pensionin në çdo hallkë, është caktuar në afat apo jo.

Dosje nr. 307607, pension pleqërie, inspektori përpunues D.Z..

Në lidhje me respektimin e afatit prej 42 ditësh për përpunimin e dosjes, prej aplikimit deri në dërgimin e dosjes në Zyrën e Financës, evidentohet se ky afat nuk mund të përcaktohet pasi fleta e shoqërimit nuk është firmosur nga inspektori përpunues, kryetari i degës së përfitimeve, kryetari i degës së financës dhe drejtori. Ky veprim është në kundërshtim me Kapitullin I.A.b, pika 20, Rregullore nr. 1, datë 21.10.2008 “Për caktimin, administrimin dhe pagesën e pensioneve”.

Dosje nr. P3448 pension pleqërie, inspektori përpunues I.A.:

Në fletën e shoqërimit mungon nënshkrimi nga Kryetari i Degës së Financës, në kundërshtim kjo me Rregulloren nr.1 datë 21.10.2008, I.A.b pika 20 ku citon: “*Kryetari i degës së financës dhe në mungesë të tij, personi i ngarkuar me të drejtë firme, pasi bën kontrollin sipas rregullave financiare në fuqi, nënshkruan vendimin e caktimit të pensionit, kontrollon të dhënat në kartelën financiare nëse janë të sakta dhe të njëjta me urdhër pagesën dhe i nënshkruan ato. Dosja i dorëzohet kryetarit të degës së informatikës kundrejt nënshkrimit dhe duke vendosur datën e dorëzimit në fletën shoqëruese të dosjes së pensionit*”.

Dosje nr. P3648, pension pleqërie i plotë, inspektori përpunues A.G.

- Janë bërë 2 kërkesa në e-albania, për këtë arsye në dosje ka 2 fletë shoqërimi operacionale.
- Dosja nuk është firmosur nga përgjegjësi i ALSSH-së.

Dosje nr. P1908, pension pleqërie i pjesshëm, inspektori përpunues H.Sh.

Dosja nuk është firmosur nga përgjegjësi i ALSSH-së dhe drejtori.

Dosje nr. 308055, pension pleqërie i pjesshëm, inspektori përpunues znj. A.N..

- Nga DRSSH janë marrë vendimet e mëposhtme për pensionin e pleqërisë, sipas;
 - a. Vendimit nr. 4586, datë 27.05.2022, në shumën 33910 lekë, dhe më datë 01.04.2022 në shumën 35,029 lekë, vjetërsia në punë 32.4 vjet;
 - b. Vendimit nr. 4586/1, datë 20.06.2022, në shumën 35,277 lekë, dhe më datë 01.04.2022 në shumën 36,441 lekë, vjetërsia në punë 34.2 vjet;
 - c. Vendimit nr. 4586, datë 15.07.2022, në shumën 35,494 lekë, dhe më datë 01.04.2022 në shumën 36,665 lekë, vjetërsia në punë 34.5 vjet.

Nisur nga tre vendimet e mësipërme rezulton se, **nuk është zbatuar Rregullorja nr. 1/2008, Kapitulli VIII.A “Ndryshimi i pensionit” pika 2, ku cilësohet: “Vendimi për ndryshimin e pensionit merr numrin e vendimit fillestar me fraksion, duke filluar nga numri**

1, p.sh. 1275/1, 1275/2 etj., ndërsa si datë shënohet data e kryerjes së veprimit. Vendimi plotësohet me të gjitha të dhënat që përmban formati. 3.”

Dosje nr. 307269 pension pleqërie, inspektori përpunues znj. D.Z..

Në dosje rezultojnë dy vendime me të njëjtin numër vendimi dhe të njëjtën datë, kjo në kundërshtim me Rregulloren nr.1/2008, kapitulli VIII/A, pika 2: “Vendimi për ndryshimin e pensionit merr numrin e vendimit fillestar me fraksion, duke filluar nga numri 1, p.sh. 1275/1, 1275/2 etj., ndërsa si datë shënohet data e kryerjes së veprimit”.

10.3. Nga auditimi i dosjeve përsa i përket përlllogaritjes së pensionit ka rezultuar se:

1. Dosje nr. 308137, pension pleqërie i reduktuar, insp.përpunues znj. D.K..

Përlllogaritja e shtesës për pension është kryer referuar bazës së vlerësuar sipas të dhënave dhe verifikimeve të kryera nga inspektori përpunues. Nga verifikimi i të dhënave ka rezultuar se paga mbi të cilën është përlllogaritur kontributi sipas Vërtetimit nr. 3855, datë 11.05.2022 të DAQ, në muajin Mars 2004 është në shumën 17,107 lekë, ndërkohë që në sistem është në shumën 117,107 lekë, me një diferencë prej 100,000 lekë më shumë.

2. Dosje nr. P0001510, pension pleqërie i reduktuar, insp. përpunues znj. D.T..

Për përlllogaritjen e masës së pensionit të reduktuar inspektori përpunues, është mbështetur në Ligjin nr. 7703/1993, neni 31/1. Pensioni ka rezultuar se nuk është përlllogaritur saktë. Paga bazë referuese për vitet e punës para vitit 1994, sipas Tabelës nr. 3 “Paga referuese para datës 01.01.1994, është aplikuar sipas kodit c33 “punëtorë të tjerë” për periudhën Shtator-Dhjetor 1978 dhe vitet 1979-1980 (detyrimi ushtarak), me pagë referuese 2,685 lekë. Për periudhën tjetër i janë referuar kodit c17 “këpucë-konfeksione” me pagë referuese 2,795 lekë. Referuar të dhënave, edhe për periudhën Shator-Dhjetor 1978, ku aplikanti ka punuar këpucar, duhet të aplikohet paga bazë referuese e kodit c17 “këpucë, konfeksione”, në shumën 2,795 lekë dhe jo kodi c33 “punëtorë të tjerë”, me pagë referuese 2,685 lekë.

3. Dosje nr. 304498, pension pleqërie i pjesshëm, insp.përpunues znj. A.V..

Përlllogaritja e shtesës për pension referuar bazës së vlerësuar dhe të dhënave dhe verifikimeve të kryera nga inspektori përpunues, rezulton se nuk është përcaktuar saktë.

Sipas vërtetimeve mbi vjetërsinë në punë për efekt pensioni për periudhën e punësimit 1975-1993, referuar të dhënave të librezës së punës rezultojnë 17 vite e 22 ditë, ndërsa nga inspektori përpunues është përlllogaritur 1975-1993, 17 vite e 2 muaj e 28 ditë.

Ditë	Periudha		Vit
	Muaj		
3	12		1975
3	5		1984
0	-7		9
10	7		1984
1	3		1992
-9	-4		8
1	3		1992
1	3		1993
			1
-8	-11		18
22			17

4. Dosje nr. 307700, pension pleqërie i pjesshëm, insp.përpunues znj. M.P.

Përlllogaritja e shtesës për pension referuar bazës së vlerësuar dhe të dhënave dhe verifikimeve të kryera nga inspektori përpunues (DRSSH Gj.), rezulton se nuk është përcaktuar saktë në vitin 2016 dhe për këtë arsye është ankimuar nga përfituesi i pensionit për mos përlllogaritjes të saktë të vjetërsisë në punë. Sa më sipër në lidhje me këtë pension janë marrë vendimet e mëposhtme:

Nr.	Vendimet	Vendimet për rishqyrtim	Periudhë sigurimi	Masa e pensionit
1	271, datë 26.02.2016		31.8	12,363
3		271/1, datë 26.04.2018	32	13,206
4		271/2, datë 19.09.2018	33.6	14,001
5		271/3, datë 12.05.2022	35.6	15,121
6	271/3, datë 19.09.2018	Datë 22.07.2022	35.6	17,232

Përsa i përket marrjes së vendimeve për rishikim pensioni nuk është vepruar në përputhje me Rregulloren nr. 1/2008, Kapitulli VIII.A “Ndryshimi i pensionit”, pika 2, ku cilësohet: *“Vendimi për ndryshimin e pensionit merr numrin e vendimit fillestar me fraksion, duke filluar nga numri 1, p.sh. 1275/1, 1275/2 etj., ndërsa si datë shënohet data e kryerjes së veprimit. Vendimi plotësohet me të gjitha të dhënat që përmban formati. 3.”*

Nga ana e inspektorit përpunues, nuk ka rregullsi në hedhjen e të dhënave në sistem, referuar dokumentacionit vërtetues.

Periudha	Sipas vërtetimeve punë në kooperativë (ditë)	Të dhëna për bazën e vlerësuar	Sipas vërtetimeve punë në kooperativë (muaj)	Ushtri vërtetimi	Diferenca
1967	297	5	12		-7
1968	244	12	10		+2
1969	282	12	12		
1970	83	0	3	4	-3
1971				12	
1972				12	
1973	141	12	6		+6
1974	261	12	11		+1
1975	238	12	10		+2
1976	412	12	12		
1977	353	12	12		
1978	312	12	12		
1979	315	12	12		
1980	348	12	12		
1981	411	12	12		
1982	561	12	12		
1983	383	12	12		
					+1

Sipas të dhënave të tabelës së mësipërme të dhënat nuk janë hedhur saktë.

5. Dosje nr. P6146, pension pleqërie i pjesshëm, insp. përpunues znj. M.P..

Përlllogaritja e shtesës për pension referuar bazës së vlerësuar, të dhënave dhe verifikimeve të kryera nga inspektori përpunues i DRSSH L., rezulton se nuk është përcaktuar saktë, për këtë arsye është bërë kërkesë për rishqyrtim. Kjo kërkesë për shkak të transferimit të dosjes së pensionit në DRSSH Tiranë me vendimin për mbyllje pensioni nr. 1499/1, datë 13.01.2023, është shqyrtuar nga kjo e fundit, e cila ka marrë vendimin numër s’ka, datë 24.01.2023.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ndodhur në dosje dhe të përcjellë nga DRSSH L. ka rezultuar se, sipas të dhënave të vërtetimit nr. 1117, datë 06.09.2022 në datë 30.08.1992 ka punuar në minierë me pagë 3,891 lekë (kodi c.2.1 “miniera të tjera nën tokë”), me të cilën duhet të përlllogaritet dhe asistenca. Referuar bazës së vlerësuar rezulton se periudha e asistencës e cila është menjëherë pas daljes nga puna, është plotësuar në mënyrë të gabuar në shumën 2,685 lekë sipas kodit c33 “punëtorë të tjerë”.

6. Dosje nr. P1392, pension pleqërie i pjesshëm, insp.përpunues znj. Sh.D..

Përlllogaritja e shtesës për pension referuar bazës së vlerësuar dhe të dhënave dhe verifikimeve të kryera nga inspektori përpunues, rezulton se nuk është përcaktuar saktë. Sipas vërtetimeve për vjetërsinë në punë për efekt pensioni, rezulton se nuk është përfshirë muaji dhjetor 2006, paga kontributive në shumën 14,000 lekë, sipas vërtetimit nr. 5495, datë 17.06.2022.

7. Dosje nr. P2565, pension pleqërie i pjesshëm, inspektori përpunues znj. A.R..

Përlllogaritja e shumës bazë është kryer bazuar në pensionin social të përcaktuar me VKM nr. 167/2019 në shumën 7,465 lekë, nga 7,674 lekë që duhej të ishte. Referenca për pensionin social nuk është e saktë, pasi sipas VKM nr. 263, datë 30.03.2020 “Për indeksimin e pensioneve”, pika 9 cilësohet se: *“Shuma bazë e pensionit, e përcaktuar sipas pikës 2, të nenit*

nr.32, të ligjit nr.7703, datë 11.05.1993, të ndryshuar, duke filluar nga data 01.04.2020 e në vazhdim të jetë 7,674 (shtatë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 01.04.2020”.

8. Dosje nr. P022, pension pleqërie i pjesshëm, inspektori përpunues znj. H.Sh..

Përlllogaritja e shumës bazë është kryer bazuar në pensionin social në shumën 7,637 lekë nga 7,674 lekë që duhej të ishte. Referenca për pensionin social nuk është e saktë, pasi sipas VKM nr. 263, datë 30.03.2020 “Për indeksimin e pensioneve”, pika 9 cilësohet se: “Shuma bazë e pensionit, e përcaktuar sipas pikës 2, të nenit nr.32, të ligjit nr.7703, datë 11.05.1993, të ndryshuar, duke filluar nga data 01.04.2020 e në vazhdim të jetë 7,674 (shtatë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 01.04.2020”. Për rrjedhojë dhe përlllogaritja e pensionit nuk është e saktë.

9. Dosje nr. 306177, pension pleqërie i plotë, inspektori përpunues znj. I.A..

Sipas vendimit nr. 979, datë 28.03.2022, e drejta për pension fillon më datë 28.03.2021, referuar mbushjes së moshës së pensionit 65 vjeç, referuar Ligjit nr. 7703/1993, neni 31, pika 1. Përlllogaritja e shumës bazë është kryer bazuar në pensionin social në shumën 7,637 lekë nga 7,674 lekë që duhej të ishte. Referenca për pensionin social nuk është e saktë, pasi sipas VKM nr. 263, datë 30.03.2020 “Për indeksimin e pensioneve”, pika 9 cilësohet se: “Shuma bazë e pensionit, e përcaktuar sipas pikës 2, të nenit nr.32, të ligjit nr.7703, datë 11.05.1993, të ndryshuar, duke filluar nga data 01.04.2020 e në vazhdim të jetë 7,674 (shtatë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e katër) lekë. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 01.04.2020”. Për rrjedhojë dhe përlllogaritja e pensionit nuk është e saktë.

10. Dosje nr. 304357, pension pleqërie i plotë, inspektori përpunues znj. I.A..

Përlllogaritja e shtesës është kryer referuar bazës së vlerësuar, të dhënave dhe verifikimeve të kryera nga inspektori verifikues, ka rezultuar e saktë, me përjashtim të indeksimit të pagës kontributive të muajit mars 2001.

Paga sipas vërtetimit në shumën 2,030 lekë me koeficient 9.56=19,406 lekë, ndërsa paga e indeksuar sipas bazës së vlerësuar=11,842 lekë . Për rrjedhojë dhe përlllogaritja e pensionit nuk është e saktë.

11. Dosja nr. I0000110, pension inval. i reduktuar, inspektori përpunues z. B.Ç..

Nga dokumentacioni që nevojitet, për të përfutuar pensionin e invaliditetit, në dosje mungon kërkesa për pension invaliditeti, fotokopje e kartës së identitetit dhe certifikata familjare e përfituesit. Nga verifikimi rezultoi se, në librezën e punës është shënuar se përfituesi, më datë 30.09.1987 shkon ushtar. Në dosje mungon Vërtetimi nga Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura, Qendra e Personel Rekrutimit, për periudhën e kryerjes së shërbimit të detyrueshëm ushtarak, kjo periudhë nuk është llogaritur si periudhë sigurimi. Sipas formulës së llogaritjes së periudhës së sigurimit të detyrueshëm, përfituesi ka 25.7 vite, ndërsa llogaritjet për shumën bazë, janë kryer me 24.9 vite;

12. Dosja nr. 306854, pension inval. i pjesshëm, inspektori përpunues znj. E.A..

Përlllogaritja e shumës bazë nuk është kryer në bazë të pensionit social, të përcaktuar me VKM nr. 188, datë 30.03.2022, në shumën 8,102 lekë, por është llogaritur në bazë të VKM nr. 196, datë 31.03.2021 në shumën 7,843 lekë;

13. Dosja nr. 307775, pension inval. i pjesshëm, inspektori përpunues znj. D.Q..

Nga verifikimi i dokumentit për llogaritjen e pensionit, “Vërtetim për bazën e vlerësuar” i datës 20.04.2022, printuar nga sistemi i kontributeve CMIS në DRSSH T., u konstatua se kontributet e muajit maj 2014, nuk janë derdhur. Për pasojë, përfituesit nuk i është konsideruar muaji maj 2014, në llogaritjen e periudhës së siguruar. Ndërsa nga printimi i këtij dokumenti nga grupi i auditimit të KLSH, nga sistemi CMIS, Dega Arkivë, më datë 13.03.2023, rezultojnë kontribute të derdhura për muajin maj 2014;

14. Dosja nr. I121, pension invaliditeti i pjesshëm, inspektori përpunues znj. E.A..

Në dosjen e përfituesit mungon vetëm certifikata familjare.

Vendimi i KMCAJ nr. 210, datë 29.04.2022, ka vendosur se:

- nga data 20.01.2022 deri më 06.04.2022, personi ka përfitur raport paaftësie të përkohshme, data e fillimit të invaliditetit është 06.04.2022,
- aplikuesi i pensionit të invaliditetit ka humbur aftësinë për punë në masë të pjesshme, prej datës 06.04.2022 deri më 01.04.2023;

Sipas të dhënave të regjistruara në librezën e punës, në periudhën 09.05.1993 – 15.09.1993, përfituesi ka qenë në asistencë. Me shkresën nr. prot,14-10-63149, datë 13.06.2022, Drejtoria Rajonale Tiranë, Dega e Përfitimeve, i ka kërkuar Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive Tiranë (AKPA), vërtetim asistence për të interesuarin. *Ky vërtetim mungon në dosje dhe në shkresë, është vendosur shënimi me dorë: nuk punon e-albania, datë 20.07.2022. Për pasojë kjo periudhë nuk i është llogaritur përfituesit, si vjetërsi;*

Paga bazë referuese për periudhën 01.04.1989-31.01.1992, që përfituesi ka qenë punëtor në “Uzinën gozhdë-bullona”, është përlllogaritur sipas tabelës nr. 3, kodi c12, “mekanike, elektrike”, në shumën 2,795 lekë, më pas, përfituesi ka kryer shërbimin e detyrueshëm ushtarak, në periudhën 10.02.1992-08.05.1993, i cili është paguar sipas tabelës nr. 3, kodi c33, “punëtorë të tjerë” në shumën 2,685 lekë, në kundërshtim me ligjin 7703/1993, i ndryshuar, neni 9 “*Llojet e kontributeve për t’u paguar*”, paragrafi i fundit, i cili citon: “*Shteti paguan kontribute në varësi të veprimtarisë ekonomike, të zhvilluar më parë, për kohën që shtetasi kryen shërbimin e detyrueshëm ushtarak, si dhe për të gjithë kategoritë e personave të përcaktuar me Ligje dhe me Vendime të Këshillit të Ministrave*”.

Nga data 15.09.1993 e në vazhdim, përfituesi ka punuar mësues në shkollë 8-vjeçare, sipas të dhënave të regjistruara në librezën e tij të punës, si dhe vërtetimit për vjetërsinë e punës të datës 14.04.2022, lëshuar nga Zyra Vendore Arsimore Kavajë. Nga verifikimi i të dhënave të regjistruara nga inspektori përpunues, në sistemin PCAMS, në llogaritjen e bazës së vlerësuar, për periudhën 15 shtator – dhjetor 1993, paga bazë referuese është llogaritur sipas tabelës nr. 2, kodi b6, “specialist i mesëm”, administrata e ndërmarrjes, në shumën 3,288 lekë, ndërkohë paga bazë referuese në këtë rast duhet të ishte sipas tabelës nr. 2, kodit b11, “specialist i mesëm”, institucione të tjera lokale, në shumën 3,507 lekë;

15. Dosja nr. P3868 pension pleqëri e reduktuar, inspektori përpunues znj. A.V..

Aplikuesi ka bërë kërkesën për pension pleqërie të reduktuar, më datë 01.09.2022,

Data e lindjes së të drejtës për pension pleqërie të plotë, i lind më datë 15.05.2024, datë në të cilën mbush moshën e caktuar 65 vite, sipas nenit 31 /1 dhe 92, të ligjit 7730, datë 11.05.1993 “*Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë*”, i ndryshuar”;

Sipas nenit 31/1, të ligjit 7703/1993, i ndryshuar, i cili përcakton: “*Personat e siguruar kanë të drejtë për pension pleqërie të reduktuar, deri tre vjet para mbushjes së moshës së daljes në pension të përcaktuar në nenin 92 të këtij ligji*”, aplikuesi e përfiton pensionin e reduktuar;

Nga verifikimi i përlllogaritjeve të bazës së vlerësuar nga grupi i auditimit, rezultoi se mungon paga e muajit shtator 2006, si dhe janë regjistruar gabim shumat në gusht-shtator 2007, mars 2008;

16. Dosja nr. 305361 pension pleqëri e reduktuar, inspektori përpunues znj. D.K..

Nga verifikimi i përlllogaritjeve të periudhës së sigurimit të përfituesit, si dhe të përlllogaritjes së bazës së vlerësuar, inspektori përpunues nuk ka llogaritur periudhën e punës në Firmën A. SHPK, nga 16 nëntor 1993 - 31 dhjetor 1993, vërtetuar në librezën e punës, pasi nga verifikimet e DAQ, subjekti privat nuk ka derdhur kontribute për këtë periudhë;

Përlllogaritja e bazës së vlerësuar është kryer referuar të dhënave “Pagat bazë referuese deri para datës 01.01.1994”, në periudhën shtator 1980-maj 1985, përfituesi ka kryer studimet e larta në universitet dhe është paguar sipas tabelës nr. 3, kodi c33, “punëtorë të tjerë” në shumën 2,685 lekë, në periudha nëntor 1986-korrik 1992, përfituesi ka punuar teknologe, në Uzinën e

L. (Reparti Ushtarak X) Tiranë dhe është paguar sipas tabelës nr. 2, kodi b10, “specialist i lartë”, Institucione të tjera lokale në shumën 4,110 lekë, por duke qenë se Uzina e L. është ndërmarrje, atëherë përfituesi duhet të ishte paguar sipas kodit b5, “specialist i lartë”, Administrata e Ndërmarrjes, në shumën 4,192 lekë;

Nga verifikimi i përlllogaritjeve të bazës së vlerësuar nga grupi i auditimit, rezultoi se janë regjistruar gabim nga inspektori përpunues shumat në muajin tetor 2003, prill-maj 2005;

17. Dosja nr. P4816 pension pleqëri e reduktuar, insp. përpunues znj. I.A..

Nga verifikimi i regjistrimit të bazës së vlerësuar në sistemin PCAMS nga grupi i auditimit, rezultoi se janë regjistruar gabim nga inspektori përpunues, shumat në muajin nëntor 2003, shtator-dhjetor 2007;

18. Dosja nr. P4638, pension pleqëri e plotë, inspektori përpunues znj. V.G.

Nga verifikimi i kryer nga grupi i auditimit rezultoi se, në librezën e punës së përfituesit dhe të vërtetimit për vjetërsi pune për efekt pensioni, i DRSSH Gj. datë 15.02.2022, përfituesi ka punuar punëtoore në periudhën 01.07.1990-12.01.1991, pra 6 muaj, në Ndërmarrjen Komunale Banesa T., ndërsa nga inspektori përpunues nuk është llogaritur kjo periudhë;

Në përlllogaritjen e periudhës së siguruar nga inspektori përpunues, nuk është llogaritur periudha 12.01.1991-31.12.1993, periudhë invaliditeti, ku sipas shkresës nr. 4792/1 prot, datë 22.06.2022, të DRSSH Gj., “Aplikuesi nuk figuron i regjistruar si përfitues i asnjë lloj pensioni”.

Në zbatim të ligjit nr. 7730, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 31, pika 1 citon: “Personat e siguruar, që kanë plotësuar jo më pak se 15 vite sigurim shoqëror, kanë të drejtë për pension pleqërie, kur të arrijnë moshën e përcaktuar në nenin 92, të këtij ligji”. Për si më sipër, përfituesi ka kryer pagesë sigurimi vullnetar, për të plotësuar periudhën e duhur;

19. Dosja nr. P1131 pension pleqëri e plotë, inspektori përpunues znj. A.R..

Në sistemin PCAMS nuk është regjistruar saktë përlllogaritja e bazës së vlerësuar nga inspektori përpunues, për periudhën korrik-dhjetor 2007, si dhe muaji prill 2008;

Sipas vërtetimit nr. 5497 prot., datë 20.06.2022, të DAQ, për periudhën 01.01.2004-30.09.2004, përfituesit nuk i është llogaritur periudhë sigurimi, pasi nuk i rezulton emri në listë pagesën e subjektit në të cilin ka qenë i punësuar;

20. Dosja nr. P4061 pension pleqëri e plotë, inspektori përpunues znj. A.R..

Në llogaritjen e periudhës së sigurimit të përfituesit nga vitet e punës, i dalin 17 vite, 3 muaj e 25 ditë. Në përlllogaritjen e shumës bazë nga inspektori përpunues, kjo periudhë është kthyer në 17.1 vite, e jo në 17.2 vite që duhet në këtë rast;

Sipas vërtetimit nr. 8869 prot., datë.05.10.2022 të DAQ, për periudhën 01.11.2010-30.03.2011, përfituesit nuk i është llogaritur periudhë sigurimi, pasi nuk i rezulton emri në listë pagesën e subjektit në të cilin ka qenë e punësuar.

21. Dosja nr. P0000086 pension pleqëri e plotë, inspektori përpunues znj. M.T.

Për periudhën janar 1980-janar 1994, që përfituesi ka punuar në Ndërmarrjen e Ndërtimit P., të dhëna të cilat janë regjistruar në librezën e punës së përfituesit, nga DRSSH T. është kërkuar verifikim i të dhënave në arkivën e DRSSH Sh.. Akt verifikimi i datës 04.05.2022, vërteton periudhën janar 1980-dhjetor 1991. Në kartelën identifikuese është vendosur shënimi: *Periudha e punës janar 1992-janar 1994, është në proces verifikimi*, pra nuk i është llogaritur si periudhë sigurimi;

Në zbatim të nenit 33, “Shtesë pensioni për shtyrje të datës së daljes në pension”, “Kur i siguruari, i cili ka plotësuar kushtet për pension pleqërie, sipas nenit 92, të këtij ligji, merr shtesë në masën 0,5 për qind të pensionit për çdo muaj që shtyn datën e daljes në pension dhe vazhdon të paguajë kontribute”, në këtë rast përfituesi ka përfituar shtesë 298 lekë në muaj, për periudhën janar-shkurt 2022;

Sipas vërtetimit nr. 107 prot., datë 11.04.2022, të Gjykatës së Rrethit P., paga bruto e muajit nëntor 1994, është 4,664 lekë, ndërkohë në sistemin PCAMS është regjistruar 42,920 lekë;

22. Dosja nr. 305291 pension pleqëri e plotë, inspektori përpunues znj. A.V..

Për periudhën 03.01.1978-03.01.1980, që përfituesi ka kryer shërbimin e detyrueshëm ushtarak, përllogaritjet janë bërë sipas tabelës nr. 3, kodi c33, “punëtorë të tjerë” në shumën 2,685 lekë, në kundërshtim me ligjin 7703/1993, i ndryshuar, neni 9 “Llojet e kontributeve për t’u paguar”, paragrafi i fundit, i cili citon: “Shteti paguan kontribute në varësi të veprimtarisë ekonomike, të zhvilluar më parë, për kohën që shtetasi kryen shërbimin e detyrueshëm ushtarak, si dhe për të gjithë kategoritë e personave të përcaktuar me Ligje dhe me Vendime të Këshillit të Ministrave”, në këtë rast, përllogaritjet duhet të ishin kryer sipas tabelës nr. 2, kodi b11, “specialist i mesëm” në shumën 3,507 lekë, pagë me të cilën është paguar në periudhën 12.11.1976-30.12.1977, si mësues. Kjo periudhë është shtuar kur është kryer rishqyrtimi i përfitimit të pensionit;

Nga verifikimi i përllogaritjeve të bazës së vlerësuar nga grupi i auditimit, rezultoi se janë regjistruar gabim nga inspektori përpunues shumat në muajt mars 1998, janar 2000, tetor 2008, si dhe maj 2009;

23. Dosje nr. 160, pension invaliditeti i plotë, inspektori përpunues: znj.D.Q.

Për këtë dosje rezultoi paraqitje jo e saktë e pagave të hedhura në sistemin PCAMS pas periudhës 01.01.1994, nuk janë respektuar pagat minimale dhe maksimale për efekt të llogaritjes së pensionit për periudhat si më poshtë:

- Në vitin 2018, paga e hedhur në PCAMS është 22,000 lekë dhe jo 24,000 lekë.
- Në vitin 2019, paga e hedhur në PCAMS është 22,000 lekë dhe jo 26,000 lekë.
- Në vitin 2020, paga e hedhur në PCAMS është 30,000 lekë dhe jo 26,000 lekë.

24. Dosje nr. 306056, pension invaliditeti i plotë, inspektor përpunues znj. E.A.

Dokumentacioni, pjesë e dosjes së pensionit, që duhet të plotësohet nga aplikanti nuk përmban certifikatën familjare.

Periudha e sigurimit nuk është e llogaritur saktë. Në vitin 1980, ku ka punuar pranë ish-kooperativës bujqësore, sipas vërtetimit nr. 435, datë 12.02.2008 të DRSSH Berat, ditët faktike të punës janë 244, të cilat sipas përllogaritjeve të bëra nga grupi i auditimit bazuar në Rregulloren nr. 1, datë 28.09.2021, duhet të njihen si periudhë sigurimi 10 muaj e 14 ditë, nga inspektori përpunues janë njohur 11 muaj të plotë. Për rrjedhojë dhe përllogaritja e pensionit nuk është e saktë.

25. Dosje nr. I311, pension invaliditeti i pjesshëm, insp. përpunues znj. D.Sh..

Periudha e sigurimit e llogaritur sipas inspektorit përpunues është 36.1 vite, nga verifikimi i bërë nga grupi i auditimit rezulton se periudha e njohur si periudhë sigurimi për periudhën e punës pranë ish kooperativës bujqësore duhet të ishte 7 vite e 9 muaj, ndërsa në llogaritjet e bëra nga inspektori përpunues janë 7 vite e 7 muaj. Në sistemin PCAMS rezultojnë, që diferencat paraqiten si më poshtë:

Në vitin 1985 sipas vërtetimit nr. 9755, datë 18.12.2018 ditët e punës faktike pranë kooperativës bujqësore janë 74. Periudha e sigurimit e llogaritur sipas Rregullores nr. 1, datë 28.09.2021 duhet të ishte 3 muaj e 5 ditë, ndërsa në sistem nga ana e inspektorit përpunues, për këtë vit është njohur si periudhë sigurimi 1 muaj e 22 ditë.

26. Dosje nr. 307279, pension invaliditeti i plotë, inspektor përpunues znj. R.K..

Nga verifikimi i pagave dhe periudhës së sigurimit në sistemin PCAMS rezultoi se: për periudhën 07.09.1984-08.10.1986, ku sipas librezës së punës ka punuar si punëtor, në sistemin PCAMS rezulton se periudha e sigurimit për muajin shtator 1984 është shënuar 31 ditë, kur në fakt duhet të jetë 23 ditë.

27. Dosje nr. 308151, pension pleqërie pjesshëm, inspektor përpunues znj. A.G.

Nga verifikimi i të dhënave të hedhura në sistemin PCAMPS rezultoi se, sipas vërtetimit nr. 826, datë 27.04.2022 të DRSSH K., në vitin 1977 ka punuar 218 ditë faktike pranë ish

kooperativës bujqësore, të cilat llogaritur nga grupi i auditimit sipas Rregullores nr.1, datë 28.09.2021 janë 11 muaj e 9 ditë, ndërsa nga ana e inspektorit përpunues janë hedhur në sistemin PCAMS si 11 muaj e 12 ditë.

28. Dosje nr. P4916, pension pleqërie i plotë , inspektor përpunues znj. M.I.

Nga grupi i auditimit të KLSH-së u bënë verifikimet e periudhës së sigurimit bazuar në dokumentacionin, që disponon dosja fizike, ku rezultoi se:

Sipas Vërtetimit nr. 4379, datë 07.12.2007 në vitin 1978 janë realizuar 199 ditë faktike pune, dhe sipas përllogaritjeve bazuar në pikën b të nenit 4 të Rregullores nr. 1 datë 28.09.2021, “*Për procedurat e funksionimit të komisioneve të veprimit administrative për njohjen si periudhë sigurimi për efekt përfitimi nga sigurimet shoqërore të kohës së punësimit në ish- kooperativat Bujqësore*” duhet të ishte njohur si periudhë sigurimi 10 muaj e 9 ditë, ndërsa nga inspektori përpunues janë njohur 11 muaj të plotë.

Në sistemin PCAMS mungojnë ë dhënat në lidhje me pagat dhe periudhat e sigurimit për periudhën tetor-dhjetor 1993, ku sipas Vërtetimit të DRRSH, K., të datës 27.09.2022 janë paguar kontribute vullnetare. Për rrjedhojë, përllogaritja e pensionit nuk është e saktë.

29. Dosje nr. 306532, pension pleqërie i pjesshëm, inspektor përpunues znj. D.Z.

Nga verifikimi i dokumentacionit fizik , pjesë e dosjes rezultoi se:

Periudha sigurimit e llogaritur nga ana e inspektorit përpunues të dosjes është 15.8 vite, por nga verifikimi i kryer rezultoi se:

Sipas librezës së punës gjatë periudhës: 26.09.1978-30.09.1996 aplikanti ka punuar pranë Uzinës së Ferrokromit, B., kjo periudhë në llogaritjen e bërë nga ana e inspektorit përpunues është njohur vetëm për periudhën: 26.09.1978-30.10.1984, pjesa tjetër jo. Në lidhje me vitet e punës pranë kësaj ndërmarrje nga ana e Degës së Përfitimeve T. janë nisur dy shkresa Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore D. konkretisht si më poshtë:

Shkresa, datë 03.02.2020 për verifikimin e periudhës 01.01.1994-30.09.1996

Shkresa e datës 06.04.2022 për verifikimin e periudhës 01.11.1978-31.12.1993

Në dosje nuk është përgjigja e DRSSH D. në lidhje me këtë verifikim, por jepen vetëm periudhat gjatë të cilës aplikanti ka përfutuar asistencë sociale, por në këto kushte duhet të ishte njohur periudha e sigurimit deri më 31.12.1993, kjo sipas pikës 1 të nenit 91, të Ligjit nr. 7703/1993, të ndryshuar. Pra duhet të ishin njohur dhe periudha nga 30.10.1984-31.12.1993. Ndryshimi i periudhës së sigurimit do të ndikojë në llogaritjen e pensionit bazë dhe shtesës së pensionit.

30. Dosje nr. 305472 pension pleqërie i reduk., inspektor përpunues znj. M.T

Sipas përllogaritjeve të grupit të auditimit, bazuar në librezën e punës dhe dokumentacionin vërtetues rezultoi se periudha e sigurimit duhet të ishte 38 muaj, 10 muaj e 26 ditë dhe jo 39 vite e 5 muaj e 20 ditë sipas fletës së përllogaritjeve të inspektorit, pjesë e dosjes, ndërsa në përllogaritje është marrë 38.9 po kaq është dhe në sistemin PCAMS.

Nga verifikimi i të dhënave të hedhura në sistemin PCAMS rezultuan këto parregullsi:

Në muajin qershor 2020, paga është vendosur sipas vërtetimit për bazën vlerësuar 5, 909 lekë, por ditë e punës janë shënuar të plota.

Në shtator të vitit 1973, sipas Librezës së punës ka nisur punë më 18.09.1973 dhe në sistemin PCAMS janë shënuar 30 ditë në muajin shtator, nga 13 që duhet të ishin. Për rrjedhojë përllogaritja e pensionit nuk është e saktë.

31. Dosje nr. 307407 pension pleqërie i reduktuar, inspektor përpunues znj. I.A.

Nga verifikimi i të dhënave në sistemin PCAMS, rezultoi se:

Për periudhën korrik-dhjetor 2002, paga në sistemin PCAMS rezultoi të jetë: 45,468 lekë/muaj, kurse sipas “*Vërtetimit për bazën e vlerësueshme dhe pagën mesatare neto*” është 59,754 lekë/muaj, pagë e cila nuk rezultoi të jetë hedhur saktë, pasi paga maksimale, duke qenë se pagat sipas vërtetimeve, duke u indeksuar me koeficientët përkatës, tejkalojnë kufijtë e pagës maksimale të datës së lindjes të së drejtës, për llogaritje konsiderohet një listë më pagat

maksimale dhe minimale(këtu e më poshtë pagat maksimale dhe minimale), ku bazuar në këtë të fundit paga se duhet të ishte 47,015 lekë.

Për periudhën korrik-dhjetor 2003, paga në sistemin PCAMS rezulton të jetë 50,694 lekë/muaj, kur në fakt referuar pagave minimale dhe maksimale për këtë periudhë duhet të ishte 51,715 lekë.

Për periudhën korrik-dhjetor 2004, paga në sistemin PCAMS rezulton të jetë 55,828 lekë/muaj, kur në fakt referuar pagave minimale dhe maksimale për këtë periudhë duhet të ishte 55,863 lekë.

Për periudhën qershor-dhjetor 2005, paga në sistemin PCAMS rezulton të jetë 61,540 lekë/muaj, kur në fakt referuar pagave minimale dhe maksimale për këtë periudhë duhet të ishte 61,524 lekë.

Paraqitjet e mësipërme nuk kanë efekt në masën e pensionit, por thjesht paraqitja nuk është e saktë nga ana e inspektorit përpunues.

Gjithashtu, nga verifikimi i periudhës së sigurimit të hedhur në sistemin PCAMS rezultoi se në qershor të vitit 1982, janë shënuar 15 ditë pune, ku sipas vërtetimit nr...14, datë 09.08.2019(numri i vërtetimit nuk është i lexueshëm plotësisht) në lidhje me vjetërsinë, rezulton se në muajin qershor nuk rezulton të ketë shkëputje, po është ndryshuar kategoria, në mënyrë të detajuar informacioni paraqitet si më poshtë:

“Të dhënat në lidhje me vjetërsinë në punë sipas Vërtetimit”

Pozicioni I punës	Fillon	Mbaron
Komandat grupi njësia katër në Gardë Togër	16.06.1982	16.06.1987
Oficer drejtimi në Drejtorinë e Kuadrit MB K/Komisar	16.06.1987	01.03.1991

Periudha e sigurimit e njohur nga ana e inspektorit nuk ka 15 ditë të muajit qershor 1982.

32. Dosje nr. 307624-25, pension familjar, inspektor përpunues znj. E.Sh.

Sipas vendimit nr. 590, datë 13.05.2022, pensioni fillon efektet më datë 03.05.2021, referuar datës së ndarjes nga jeta të personit, sipas Ligjit nr. 7703/1993, neni 40, pika 1.

Përlllogaritja e shumës bazë të pensionit është kryer bazuar në pension social të përcaktuar me VKM nr. 196 datë 31.03.2021 në vlerën 7,843 lekë.

Në përlllogaritjen e masës së pensionit, shuma bazë rezulton në vlerën 2,914 lekë dhe shtesa në vlerën 2,044 lekë, pra totali 4,958 lekë. Masa e pensionit është caktuar saktë në vlerën 19,980 lekë, në përputhje me nenin 36, pika 2, ku citohet: “*Shuma e përgjithshme e pensionit nuk mund të jetë më e vogël se 75 për qind e pagës minimale neto në shkallë vendi.*” Në maj 2021 kur ka lindur e drejta e përfitimit të pensionit paga minimale rezulton 30,000 lekë (neto 26,640 lekë). Por mbi masën e pensionit që do i takonte të ndjerit, nuk është aplikuar 50% për jetimin, sipas nenit 41, pika 1, germa (b).

33. Dosje nr. 307330-31, pension familjar, inspektor përpunues znj. E.Sh.

Te përlllogaritja e masës së pensionit, shuma bazë rezulton në vlerën 1,707 lekë dhe shtesa në vlerën 1,235 lekë, pra totali 2,942 lekë.

Ndërkohë masa e pensionit nuk është caktuar saktë në vlerën 21,312 lekë. Në fakt duhet të ishte 19,980 lekë në zbatim të nenit 36, pika 2. Në mars 2022 kur ka lindur e drejta e përfitimit të pensionit paga minimale rezulton 30,000 lekë (neto 26,640 lekë).

Sa i takon përlllogaritjes së masës së pensionit, rezulton se është përcaktuar saktë si 50% e pensionit të të ndjerit, në përputhje me nenin 41, pika 1, germa b, por duke qenë se aplikimi i kriterit më sipër nuk është caktuar saktë, vlera rezulton gabim.

34. Dosje nr. 307633-34, pension familjar, inspektor përpunues znj. A.V.

Në lidhje më këtë dosje rezultoi se përlllogaritja e masës së pensionit për të ndjerin, nuk është bërë saktë pasi në të dhënat për bazën e vlerësuar në vitin 2012 sipas sistemit CMIS, i ndjeri rezulton i dy punësuar, ndërkohë që për bazë është marrë vetëm paga kontributive nga Komuna F. në vlerën 30,000 lekë.

Për përllogaritjen e masës së pensionit nuk është llogaritur saktë paga neto referencë për vitin 2013. Gjithashtu sipas mënyrës së llogaritjes pensioni duhet të rezultonte në vlerën 18,810 lekë dhe jo 18,737 lekë.

Gjithashtu fleta e shoqërimit nuk është firmosur nga drejtori.

35. Dosje nr. F324, pension familjar, inspektor përpunues znj. I.A.

Në lidhje me këtë dosje kanë rezultuar këto pasaktësi: Sipas dokumenteve të dorëzuara në dosje, me ndarjen nga jeta të personit, është bërë kërkesë nr. 5286 datë 28.10.2022 për caktim pensioni familjar për dy fëmijët të ngelur jetimë.

Sipas vendimit nr. 6285 datë 14.11.2022, pensioni fillon efektet më datë 24.07.2022, por që nuk përputhet me datën e ndarjes, sipas Ligjit nr. 7703/1993, neni 40, pika 1. Kjo mospërputhje vjen nga fakti se e ndjera është trajtuar me pagë dhe 2 muaj pas ndarjes nga jeta.

Sa i takon përllogaritjes së bazës së vlerësuar, nuk është llogaritur saktë. Konkretisht Qershor 2010 vendosur vlera 78,000 lekë, sipas vërtetimit rezulton vlera 80,000 lekë;

Dhjetor 2013 vendosur vlera 25,945 lekë, sipas vërtetimit rezulton se ka qenë me raport 16 ditë, duhej marrë vlera e plotë 95,130 lekë;

Gjithashtu fleta e shoqërimit nuk është firmosur nga përgjegjësi i ALSSH-së.

36. Dosje nr. F374, pension familjar, inspektor përpunues z. E.B.

Nga verifikimi i kësaj dosje rezultoi se, masa e pensionit nuk është caktuar saktë në vlerën 21,312 lekë. Në fakt duhet të ishte 19,980 lekë në zbatim të nenit 36, pika 2. Në nëntor 2021 kur ka lindur e drejta e përfitimit të pensionit paga minimale rezulton 30,000 lekë (neto 26,640 lekë).

Sa i takon përllogaritjes së masës së pensionit familjar, rezulton se është përcaktuar saktë si 50% e pensionit të të ndjerit, në përputhje me nenin 41, pika 1, germa b, por duke qenë se sipas kriterit më lart ka pasaktësi, llogaritja rezulton gabim.

37. Dosje nr. P2924, pension pleqërie i plotë, inspektor përpunues znj.I.A.

Nga verifikimi i kësaj dosje rezultoi se:

Përllogaritja e shtesës për pension referuar bazës së vlerësuar, të dhënave dhe verifikimeve të kryera, rezulton se nuk është përcaktuar saktë, pasi evidentohet se në vitin 2015, kur personi ka paguar për sigurime vullnetare për 5 muaj është marrë si pagë referencë vlera 30,000 lekë kur paga minimale në këtë periudhë ka rezultuar 22,000 lekë)

38. Dosje nr. 307102, pension pleqërie i plotë, inspektor përpunues znj.S.D.

Përllogaritja e shtesës për pension referuar bazës së vlerësuar, të dhënave dhe verifikimeve të kryera, rezulton se **nuk është përcaktuar saktë**, pasi evidentohet se disa prej pagave të vendosura nuk janë në përputhje me pagat sipas vërtetimit. Konkretisht:

Viti	Paga kontributive	Koeficienti	Baza e vlerësuar e indeksuar	Paga e plotësuar nga inspektori	Diferenca
	1	2	$3=(1) \times (2)$	4	$5=(3)-(4)$
2000					
Dhjetor	0	3.69	0	70,147	(70,147)
2006					
Shkurt	29,030	1.95	56,608.5	37,109	19,499.5
Shtator	97,272	1.95	189,680	0	189,680
Nëntor	10,841	1.95	21,140	0	21,140
2012					
Janar	15,659	1.34	20,983	41,966	(20,983)

Përsa i përket vjetërsisë në punë sipas përllogaritjeve rezultojnë 29 vite dhe jo 29.1 vite që janë marrë si referencë.

Përllogaritja e shtesës për pension referuar bazës së vlerësuar, të dhënave dhe verifikimeve të kryera, rezulton se nuk është përcaktuar saktë, pasi evidentohet se disa prej pagave të vendosura nuk janë në përputhje me pagat sipas vërtetimit. Për rrjedhojë dhe përllogaritja e pensionit nuk është e saktë.

39. Dosje nr. 307301, pension pleqërie i pjesshëm, inspektori përpunues znj.H.Sh.

Përlllogaritja e shtesës për pension referuar bazës së vlerësuar, të dhënave dhe verifikimeve të kryera, rezulton se nuk është përcaktuar saktë, pasi evidentohet se një prej pagave të vendosura nuk është në përputhje me pagat sipas vërtetimi. Konkretisht:

Dhjetor 2013 vendosur vlera 44,020 lekë, sipas vërtetimit rezulton vlera 45,020 lekë;

Paga bazë referuese është përcaktuar në masën 2,795 lekë për përkrahimin e punë “punëtor në uzinën metalike” sipas vërtetimit përkatës deri në gusht 1967. Për periudhën e stazhit 18.08.1980-15.03.1981 në shumën 3,288 lekë te kategoria b6 “specialist i mesëm”, për periudhën Shtator 1981- Gusht 1993 është përcaktuar sipas kodit b5 “specialist i lartë” në shumën 4,192 lekë sipas tabelës nr. III.

40. Dosje nr. 307488, pension pleqërie i pjessh., insp. përpunues znj.M.D.

Përlllogaritja e shtesës për pension referuar bazës së vlerësuar, të dhënave dhe verifikimeve të kryera, rezulton se nuk është përcaktuar saktë, pasi evidentohet se një prej pagave të vendosura nuk është në përputhje me pagat sipas vërtetimit. Konkretisht:

Korrik 2008 vendosur vlera 13,140 lekë, sipas vërtetimit rezulton vlera 14,830 lekë, dhe sa i takon pagës minimale referencë nga 01.07.2008, rezulton 14,830 lekë.

Ndërkohë masa e pensionit rezulton në vlerën 14,458 lekë.

Përsa i takon vjetërsisë sipas përlllogaritjeve rezulton 30 vite e 11 muaj e 13 ditë, ndërkohë që tek përcaktimi i masës së pensionit është marrë 31.1 vite pune, pra një diferencë prej 2 muaj më tepër.

Përlllogaritja e shtesës për pension referuar bazës së vlerësuar, të dhënave dhe verifikimeve të kryera, rezulton se nuk është përcaktuar saktë, pasi evidentohet se një prej pagave të vendosura nuk është në përputhje me pagat sipas vërtetimit. Konkretisht, Korrik 2008 vendosur vlera 13,140 lekë, sipas vërtetimit rezulton vlera 14,830 lekë; Dhe sa i takon pagës minimale referencë nga 01.07.2008, rezulton 14,830 lekë.

41. Dosje nr. 307607, pension pleqërie i plotë, inspektori përpunues znj. D.Z.

Përlllogaritja e shtesës për pension referuar bazës së vlerësuar, të dhënave dhe verifikimeve të kryera, rezulton se nuk është përcaktuar saktë, pasi evidentohet se disa prej pagave të vendosura nuk janë në përputhje me pagat sipas vërtetimit. Konkretisht:

Për muajin Mars 1995 është vendosur vlera 5,114 lekë, ndërkohë sipas vërtetimit kjo vlera rezulton 5,144 lekë;

Për muajt maj, qershor, gusht, shtator, tetor 1997 është marrë si pagë maksimale vlera 12,300 lekë, ndërkohë nga 01.01.1997 paga maksimale rezulton 14,730 lekë; (Sipas vërtetimit pagat respektive 14,634; 13,550; 14,092; 14,092; 14,092 lekë)

Maj- Qershor 2000 vendosur vlera 8,000 lekë, sipas vërtetimit rezulton vlera 7,000 lekë.

Paga bazë referuese për periudhën Korrik 1973 - Qershor 1976 është përcaktuar në masën 3,348 lekë kategoria c4 “nafta” sipas tabelës nr. III, për vitet e shërbimit ushtarak Janar 1977- Janar 1980 vlera 2,685 lekë, për periudhën Prill 1980- Dhjetor 1993 në masën 3,063 lekë. Më pas për vitet 1994-2022 sipas vërtetimeve përkatëse.

Përsa i takon vjetërsisë sipas përlllogaritjeve rezultojnë 43 vite e 6 ditë pune.

42. Dosje nr. P2100, pension pleqërie i pjesshëm, inspektori përpunues znj.A.G.

Përlllogaritja e shtesës për pension referuar bazës së vlerësuar, të dhënave dhe verifikimeve të kryera, rezulton se nuk është përcaktuar saktë, pasi evidentohet se disa prej pagave të vendosura nuk janë në përputhje me pagat sipas vërtetimit. Konkretisht:

Për muajin Prill 1980 është vendosur vlera 2,838 lekë dhe është përfshirë e plotë, ndërkohë që sipas librezës, zonja është larguar nga puna në 10 prill 1980. Gjithashtu për muajin maj 1980 është vendosur vlera 2,833 lekë, ndërkohë që zonja nuk ka qenë në marrëdhënie pune;

Paga bazë referuese për periudhën Korrik 1975 - Maj 1980 është përcaktuar në masën 2,833 lekë kategoria c20 “bujqësi, pyjet” për periudhën Gusht 1980- Shtator 1981 në masën 2,707 lekë kategoria c16 “ushqimore”, për periudhën Prill 1982-Dhjetor 1993 në masën 2,965 lekë kategoria c15 “tekstil, trikotazh” sipas tabelës nr. III.

Përsa i takon vjetërsisë, përllogaritja nuk është bërë saktë pasi për vitin 1980 është shënuar deri në 20 maj, ndërkohë sipas librezës ka ndërprerë marrëdhënien e punës në datë 10 prill 1980. Pra rezultojnë 17 vite e 10 muaj e 4 ditë pune. Është vendosur 1 muaj dhe 4 ditë më tepër. Dosja nuk është firmosur nga përgjegjësi i ALSSH-së dhe drejtori.

43. Dosje nr. P3648, pension pleqërie i plotë, inspektori përpunues znj. A.G.

Sa i takon përllogaritjes së bazës së vlerësuar, rezulton se nuk është përcaktuar saktë, pasi evidentohet se disa prej pagave të vendosura nuk janë në përputhje me pagat sipas vërtetimit. Konkretisht si më poshtë:

Viti	Paga kontributive	Koeficienti	Baza e vlerësuar e indeksuar	Paga e plotësuar nga inspektori	Diferenca
	1	2	$3=(1)\times(2)$	4	$5=(3)-(4)$
1999			-		-
Gusht	14,335	4.2	60,207	63,218	(3,011)
Dhjetor	0	4.2	0	27,909	(27,909)
2001			-		-
Korrik	18,796	3.27	61,463	55,119	6,344
Gusht	18,796	3.27	61,463	55,119	6,344
Shtator	18,796	3.27	61,463	55,119	6,344
Tetor	18,796	3.27	61,463	55,119	6,344
Nëntor	18,796	3.27	61,463	55,119	6,344
Dhjetor	18,796	3.27	61,463	55,119	6,344
2002			-		-
Dhjetor	41,700	3.02	125,934	95,734	30,200

Paga bazë referuese për periudhën e studimeve Shtator 1980 -Korrik 1984 është përcaktuar në masën 2,685 lekë, për periudhën Dhjetor 1986- Shtator 1992 në masën 4,384 lekë kategoria a13 “specialist i lartë në ministri dhe institucione të tjera qendrore”, për periudhën Tetor 1992- Dhjetor 1993 në masën 4,110 lekë kategoria a28 “specialist me arsim të lartë në Këshilla” sipas tabelës nr. III. Për periudhën në vijim 1994-2022 sipas vërtetimeve të dorëzuara.

44. Dosje nr. P1974, pension pleqërie i plotë, inspektori përpunues znj.A.N.

Për këtë pension ka 2 vendime caktimi pensioni, pasi te vendimi i parë nuk është marrë në llogaritje periudha e asistencës e periudhës Nëntor 2000- Nëntor 2001. Ndërsa sipas vendimit të fundit nr. 72476/1, datë 20.09.2022, pensioni fillon efektet më datë 09.05.2022, referuar mbushjes së moshës së pensionit 61 vjeç e 4 muaj, sipas Ligjit nr. 7703/1993, neni 31, pika 1. Sa i takon përllogaritjes së bazës së vlerësuar, rezulton se nuk është përcaktuar saktë, pasi evidentohet se disa prej pagave të vendosura nuk janë në përputhje me pagat sipas vërtetimit. Konkretisht si më poshtë:

Viti	Paga kontributive	Koeficienti	Baza e vlerësuar e indeksuar	Paga e plotësuar nga inspektori	Diferenca
	1	2	$3=(1)\times(2)$	4	$5=(3)-(4)$
1998					
Janar	7,538	5.17	38,972	96,000	(57,028)

45. Dosje nr. P1908, pension pleqërie i pjesshëm, insp. përpunues znj.H.Sh..

Nga verifikimi i dosjes rezultoi se llogaritja e bazës së vlerësuar, se nuk është përcaktuar saktë, pasi evidentohet se nuk është përcaktuar saktë kategoria e punës. Aplikati ka punuar si traktorist në SMT për periudhën 01.07.1985-30.06.1989, ndërkohë kategoria është vendosur c20 “bujqësi, pyjet” në vlerën 2,833 lekë. Ndërkohë masa e pensionit rezulton në vlerën 8,136 lekë.

Sa i takon viteve të vjetërsisë, ato janë përcaktuar saktë duke marrë në përllogaritje librezën dhe vërtetimet për vjetërsinë në punë. Nuk janë përfshirë vitet 1969-1970 në kooperativën bujqësore B., pasi personi ka qenë nën moshën 14 vjeç dhe gjithashtu për periudhën 1989-1993 për SMT T., DAQ nuk disponon bordero.

46. Dosje nr. P1689 pension pleqërie, inspektori përpunues znj. A.V.:

Nga ana e grupit të auditimit është konstatuar se për rastin e shqyrtuar nuk është përllogaritur vjetërsia e punësimit sipas dokumentacionit të ndodhur në dosje (librezës së punës). Nga ana e inspektorit përpunues periudha e sigurimit ka filluar që nga Shtatori i vitit 1977, ndërkohë që

sipas librezës me numër regjistri themeltar 3906 rezulton që përfituesi të ketë qenë i punësuar që nga Shtatori i vitit 1975. Pra nuk është njohur një periudhë sigurimi për 2 vite.

47. Dosje nr. 308079 pension pleqërie, inspektori përpunues znj. K.G.:

Nga ana e grupit të auditimit është konstatuar se për rastin e shqyrtuar nuk është përlllogaritur vjetërsia e punësimit sipas dokumentacionit të ndodhur në dosje (librezës së punës). Nga ana e inspektorit përpunues nuk është përlllogaritur periudha e sigurimit nga data 16.06.1972-25.09.1976, sipas librezës me numër regjistri themeltar 51, lëshuar nga N.Sh Elektrike K. më datë 16.06.1972, kjo në kundërshtim me Nenin 91, të Ligjit 7703 datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

48. Dosje nr. P5570 pension pleqërie, inspektori përpunues znj. A.G.:

Sipas Vërtetimit mbi bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare të datës 22.11.2022, rezulton se paga për periudhën Tetor - Dhjetor të jetë 5200 Lekë (shofer), por referuar Tabelës së pagave referuese para datës 01.01.1994 duhet të ishte përzgjedhur kategoria c27 me vlerë 3,233 lekë, ndërkohë nga ana e inspektorit përpunues është përzgjedhur vlera 4,719 lekë, vlerë e cila nuk i referohet asnjë kategorie të tabelës së pagave.

49. Dosje nr. P6054 pension pleqërie, inspektor përpunues znj. S.D.:

Sa i përket zbatimit të afateve të përpunimit të dosjes së pensionit është evidentuar se ka një vonesë prej 17 ditë, nga inspektori pritës në ALSSH tek K/Degës së Financës, veprim në kundërshtim me Rregulloren nr.1 datë 21.10.2008. Sipas Vërtetimit mbi bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare të datës 23.09.2019, rezulton të ketë qenë e siguruar Tetor - Dhjetor 1993, në subjektin A.Sh LTD. Për këtë periudhë nga ana e inspektorit përpunues **nuk** është njohur si periudhë sigurimi në përlllogaritjet e kryera mbi bazën e vlerësuar. Pensioni në këtë dosje ka dalë bazuar në Ligjin nr. 14/2018 “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës Së Austrisë për mbrojtjen shoqërore”.

50. Dosje nr. P5794 pension pleqërie, inspektori përpunues znj. A.G.:

Nga ana e grupit të auditimit është konstatuar se për rastin e shqyrtuar nuk është përlllogaritur vjetërsia e punësimit sipas dokumentacionit të ndodhur në dosje (librezës së punës si dhe vërtetimit për të vetë punësuarit në bujqësi). Nga ana e inspektorit përpunues nuk është përlllogaritur periudha e sigurimit për Tetor - Dhjetor 1993, kjo në kundërshtim me Nenin 91, të Ligjit 7703 datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

51. Dosje nr. P5285 pension pleqërie, inspektori përpunues znj. D.K.:

Nga ana e grupit konstatohet se për periudhën Janar-Shtator 1980 në dosje **nuk ka asnjë** dokumentacion që të vërtetojë punësim, ndërkohë që nga ana e inspektorit përpunues kjo periudhë është hedhur në programin e llogaritjes së pensionit dhe për rrjedhojë është marrë për bazë në llogaritjen e përfitimit. Edhe nga vetë deklarimi i përfituesit citon se në Dhjetor 1979 ka përfunduar ushtrinë dhe në 21.09.1980 ka filluar punë në “shtypshkronja e re Tiranë”.

52. Dosje nr. 304720 pension pleqërie, inspektori përpunues znj. E.Sh.:

Nga grupi auditimit konstatohet se për periudhën Shtator 1976-Janar 1977, inspektori përpunues përfituesin e ka caktuar me kategorinë c33 “Punëtorë të tjerë” me pagë 2,685 lekë, ndërkohë që në dokumentacionin ndodhur në dosje për këtë periudhë përshkruhet “Punëtor ndërtimi”, të cilës i përket kategorisë së pagës c25 “Ndërtim” me pagë 3,063 lekë.

53. Dosje nr. 306424 pension pleqërie, inspektori përpunues znj. Sh.D.:

Nga auditimi rezulton se për periudhën Janar-Nëntor 1980, sipas vërtetimit për vjetërsinë në punë i datës 07.03.2022 përfituesi ka qenë i punësuar në Sizmografi si shofer, nga ana e inspektorit përpunues periudha Mars -Qershor 1980 nuk është marrë në përlllogaritje. Kjo pasi në librezë ka shënim se më datë 29.02.1980 përfituesit i është hequr patentja, por kjo nuk do të thotë se nuk ka kryer një funksion tjetër i cili mund të përfshihet në kategorinë c33.

Gjithashtu, nga dokumentacioni në dosje rezulton se përfituesi ka filluar punë në 29.03.1972-31.12.1972 në ND. Rrugë Bazament, ndërkohë nga ana e inspektorit përpunues në llogaritjen

mbi bazën e vlerësuar në sistemin PCAMS është llogaritur për periudhën Maj 1972 (3 ditë pune) deri në fund të 1972.

54. Dosje nr. 305011 pension pleqërie, inspektori përpunues znj. A.V.:

Nga auditimi konstatohet se në librezën e punës për vitet 1992 dhe 1993 përfituesi ka përfituar asistencë, nga ana e inspektorit përpunues kjo periudhë nuk është marrë parasysh bazuar në vërtetimin e Degës së Fondit Arkivor të kontributeve, kjo bie në kundërshtim me Nenin 91, të Ligjit 7703 datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Gjithashtu, konstatohet se referuar vërtetimit për bazën e vlerësuar për muajin Dhjetor 2000 rezulton se përfituesi të jetë paguar në vlerën 21,349 lekë, ndërkohë nga ana e inspektorit përpunues është llogaritur me vlerën 23,319 lekë, vlerë e cila nuk përkon me atë të vërtetimit të sipërcituar.

55. Dosje nr.P2459 pension pleqërie, inspektori përpunues znj. D.Z.:

Nga ana e grupit të auditimit është konstatuar se për rastin e shqyrtuar nuk është përlllogaritur e plotë asistencë sipas dokumentacionit të ndodhur në dosje (librezës së punës). Nga ana e inspektorit përpunues nuk është përlllogaritur periudha e asistencës për Gusht 1992-Gusht 1993, por është përlllogaritur sipas vërtetimit të DRAKP të datës 25.07.2022, kjo në kundërshtim me Nenin 91, të Ligjit 7703 datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

56. Dosje nr.P2020 pension pleqërie, inspektori përpunues znj. L. Q.:

Nga ana e grupit të auditimit është konstatuar se për periudhën Janar-Dhjetor 1977, në dosje ndodhet vetëm një akt verifikimi i mbajtur nga ana e DRSSH Dibër e datës 25.07.2022, që vërteton se përfituesi ka vetëm 75 ditë pune, ndërsa nga ana e inspektorit përpunues kjo periudhë është marrë e plotë si periudhë sigurimi.

Në mënyrë të përmbledhur më poshtë janë trajtuar rastet dhe mangësitë mbi saktësinë e përlllogaritjes së pensioneve.

Titulli i Gjetjes 1: Mangësi me efekte në përlllogaritjen e masës së pensionit.

- Nga auditimi i 148 dosjeve të pensionit, kanë rezultuar me mangësi në përlllogaritjen e masës së pensionit 56 dosje, ose 37.8 % e tyre, kjo për shkak të mangësisë së pa saktë të elementëve përbërës të pensionit, si pensioni bazë dhe shtesa e pensionit. Konkretisht, sipas llojit të pensioneve, mangësitë janë evidentuar në rastet e mëposhtme të cilat në mënyrë të detajuar rast pas rasti janë trajtuar në pikën II.2.10 të PRA.

Nga auditimi rezultoi se 56 dosjet e evidentuara me mangësi i përkasin llojeve të mëposhtme të pensioneve.

- Pension pleqërie i reduktuar në 7 raste (Dosjet nr. 308137; P0001510; P3868; 305361; P4816; 305472 dhe 307407);
- Pension pleqërie i pjesshëm në 12 raste (Dosjet nr. 307498; 307700; P6146; P1392; P2565; P022; 308151; 306532; 307301; 307488; P2100 dhe P1908);
- Pension pleqërie i plotë 24 raste (Dosjet nr. 306177; 304357; P4638; P1131; P4061; P000086; 305291; P4916; P2924; 307102; 307607; P3648; P1974; P1689; 308079; P5570; P6054; P5794; P5285; 304720; 306424; 305011; P2459 dhe P2020);
- Pension invaliditet i reduktuar 1 rast Dosja nr. I0000110;
- Pension invaliditet i pjesshëm 4 raste (Dosjet nr. 306854; 307775; I121 dhe I311);

- Pension invaliditet i plotë 3 raste (Dosjet nr. I60; 306056 dhe 307279);
- Pension familjar 5 raste (Dosjet nr. 307624-25; 307330-31; 307633-34; F324 dhe F374).

Situata:

Mangësitë e evidentuara sipas tipologjisë paraqiten më poshtë:

1. Nga ana e inspektorëve përpunues të dosjeve nuk është hedhur saktë në CMIS paga kontributive, referuar të dhënave sipas vërtetimeve të lëshuara nga punëdhënësi dhe Drejtoria e Arkivit Qendror (DAQ);
2. Nga ana e inspektorëve përpunues të dosjeve paga bazë referuese (para vitit 1994) nuk është përcaktuar saktë, sipas kodeve përkatëse të profesioneve të përcaktuara në tabelat bashkëngjitur VKM nr. 561, datë 12.03.2005 “Për përcaktimin e pagave referuese për llogaritjen e pensioneve”;
3. Nga ana e inspektorëve përpunues të dosjeve, nuk është përcaktuar saktë vjetërsia në punë për efekt pensioni, në kundërshtim me kriteret e përcaktuar si vite vjetërsie në punë deri në tetor 1994 sipas librezës së punës dhe/ose vërtetime; nga 1994 deri në vitin 2011 sipas vërtetimeve dhe pas vitit 2011 e në vazhdim sipas CMIS, referuar Ligjit 7703/1993 i ndryshuar, nenit 91 “Periudhat e quajtura si periudha sigurimi”.
4. Nga ana e inspektorëve përpunues të dosjeve, nuk është përlllogaritur saktë pensioni bazë, pasi nuk është përcaktuar saktë referenca për pensionin social, element përbërës i pensionit bazë, bazuar në Ligjin nr. 7703/1993, neni 32 “Masa e pensionit”, pika 1 dhe 2;
5. Nga ana e inspektorëve përpunues të dosjeve nuk është përcaktuar saktë shtesa e pensionit, si një element i masës së pensionit bazuar në Ligjin nr. 7703/1993, Pensionet e pleqërisë, neni 32 “Masa e pensionit”, pika 1 dhe 2; Pensionet e invaliditetit neni 36, pika 2 dhe Pensionet familjare, neni 41 “Shuma e pensionit”.
6. Nga ana e inspektorëve përpunues të dosjeve, nuk është përcaktuar saktë pensioni familjar për shkak të pasaktësisë në përlllogaritjen apo referencat e elementëve përbërës të tij, si shtesa e përfitimit për fëmijët jetimë paga neto minimale referuese, etj.

Kriteret:

Ligi nr. 7703/1993 “Për Sigurimet Shoqërore në RSH” i ndryshuar, nenet:

Neni 32 “Masa e pensionit”, pika 1 dhe 2;

“1. Pensioni mujor i pleqërisë përbëhet nga një shumë bazë dhe nga një shtesë.

2. Shuma bazë llogaritet si raport i periudhës së sigurimit, që ka realizuar personi, me periudhën e sigurimit të kërkuar, sipas nenit 92, shumëzuar me pensionin social;

Neni 36 “Shuma e pensionit” (invaliditeti) ku cilësohet:

“1. Shuma e pensionit të invaliditetit të plotë llogaritet në të njëjtën mënyrë si pensioni i pleqërisë;

2. Shuma e përgjithshme e pensionit nuk mund të jetë më e vogël se 75 për qind e pagës minimale neto në shkallë vendi”.

Neni 41 “Shuma e pensionit” (familjari), ku cilësohet:

“1. Pensioni familjar është pjesë e pensionit që kishte ose i takonte të ndjerit. Pensioni, që do t’i takonte të ndjerit, llogaritet sipas rregullave për pensionet e invaliditetit. Pensioni familjar jepet në masën:”.

a) 50 për qind për personin e ve dhe

b) 25 për qind për çdo jetim ose persona të tjerë që përfitojnë.

Kur nuk merret pension i parashikuar nga shkronja “a” e këtij neni, masa e pensionit për jetimin është 50 për qind, kur ai është ose mbetet vetëm pjesëtar në pension. Kur pjesëtare në pension janë më shumë se një jetim, masa e pensionit familjar për secilin prej tyre është 25 për qind.

Shuma e një pensioni familjar nuk duhet të kalojë masën e pensionit që merrte ose do të merrte personi që vdes.

2. Jetimi ka të drejtën e një pensioni familjar edhe nëqoftëse prindi që jeton është i punësuar, është ekonomikisht aktiv ose merr një pension si të drejtë të tij. Në këtë rast masa e pensionit për çdo jetim ose person tjetër që përfiton është 25 për qind e pensionit që i takonte të ndjerit, por jo më tepër se 50 për qind e tij;

3. Jetimi që humbet të dy prindërit, do të marrë një pension jetimi për secilin prej tyre”.

Neni 91 “Periudhat e quajtura si periudha sigurimi”, ku cilësohet:

“1. Të gjitha periudhat e punësimit para hyrjes në fuqi të këtij ligji, të njohura si vjetërsi pune, të vlefshme për sistemin e sigurimit shoqëror të kaluar, do të quhen si periudha sigurimi edhe për këtë ligj;

2. Periudhat, në të cilat nuk është punuar, por të njohura si vjetërsi pune për sigurimet shoqërore përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të njihen si periudha të sigurimit edhe për këtë ligj;

3. Koha pas hyrjes në fuqi të këtij ligji njihet si periudhë e sigurimit shoqëror vetëm kur është derdhur kontribut, sipas këtij ligji;

4. Periudha e kryerjes së studimeve në shkollën e lartë, me shkëputje nga puna për gruan, duke filluar nga data 01.09.2000 dhe deri më 31.12.2032, pavarësisht nga vendi se ku janë kryer studimet dhe për jo më shumë se 6 vjet, njihet periudhë sigurimi vetëm për efekt pensioni pleqërie. Në kuptim të këtij neni, viti shkollor është me 12 muaj”.

VKM nr. 188, datë 30.03.2022 “Për indeksimin e pensioneve dhe bazës së vlerësuar”;

VKM nr. 196, datë 16.09.2022 “Për indeksimin e pensioneve dhe bazës së vlerësuar”;

VKM nr. 561, datë 12.08.2005 “Për përcaktimin e pagave referuese për përlllogaritjen e pensioneve” me ndryshime, etj..

Rregullore nr. 1, datë 21.10.2008 “Për caktimin, administrimin dhe pagesën e pensioneve”;

Ndikimi/efekti:

Pasaktësitë e mësipërme ndikojnë në përlllogaritjen gabim të pagës mbi të cilën përlllogaritet masa e pensionit, gjë e cila cenon përfituesit e pensioneve.

- Shkak:** Pakujdesi nga inspektorët përpunues në hedhjen e të dhënave në sistemin CMIS, në vlerësimin e periudhës së siguruar referuar dokumenteve vërtetuese, si dhe të pagave kontributive.
- Rëndësia:** E lartë
- Rekomandim 1:** Drejtori i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë, Sektori i Përfitimeve të marrin masa të menjëhershme për shqyrtimin e mangësive të evidentuara dhe ri llogaritjen e pensioneve për 56 rastet e trajtuara në mënyrë të hollësishme në faqet 103-141 të Projekt raportit të Auditimit.
- Rekomandimi 2:** Drejtori i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë të marrë masa për shmangien e vonesave në përpunimin e dosjeve të pensioneve dhe përpunimin e tyre brenda afateve të përcaktuara.

Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më mëposhtë:

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET:

A. MASA ORGANIZATIVE:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi saktësinë e raportimit të planit dhe faktit të buxhetit të ISSH ka rezultuar se, sipas Ligjit nr. 115/2021 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2022”, me ndryshime plani i të ardhurave për ISSH, nga kontributet është në shumën 104,009 milionë lekë dhe **përfaqëson të ardhura tatimore**, të klasifikuara si të tilla edhe në Tabelën e Treguesve Fiskalë të Konsoliduar të Buxhetit të Shtetit.

Nga ISSH, detajimi i planit të të ardhurave në shumën 104,009 milionë lekë, është kryer duke përfshirë në planifikim edhe të ardhura jo tatimore, ose “Të tjera DPT dhe ISSH”, të cilat janë në shumën 745,477 mijë lekë, në kundërshtim me Ligjin 115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022” dhe “Treguesit fiskalë të konsoliduar të buxhetit të shtetit të vitit 2022”. Kjo ka sjellë që plani i të ardhurave nga kontributet sipas ISSH të jetë 745,477 mijë lekë më pak, se plani i miratuar me ligjin e buxhetit.

Gjithashtu, në analizat e kryera fakt/plan, ka rezultuar se të ardhurat tatimore nga derdhja e kontributeve janë në shumën 104,459,763 mijë lekë dhe jo në shumën 105,656,512 mijë lekë të raportuar nga ISSH, pasi këtu është përfshirë edhe realizimi i të ardhurave jo tatimore në shumën 1,196,749 mijë lekë. Si përfundim të ardhurat nga kontributet janë realizuar në masën 100.4 % dhe jo në masën 101.6 % të raportuar nga ISSH dhe nga MFE në faktin e realizimit të të ardhurave nga kontributet.

(Më hollësisht trajtuar në pikën II.2.3, faqe 24-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

1.1. Rekomandimi: Titullari i ISSH, të marrë masa që në vijim, në detajimin e planit të të ardhurave nga kontributet të mos përfshihen të ardhurat jo tatimore, por të zbatohet klasifikimi i tyre, sipas Treguesve Fiskalë të Konsoliduar të Buxhetit të Shtetit, pjesë e ligjit dhe akteve normative.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi saktësinë e raportimit të planit dhe faktit të të ardhurave dhe shpenzimeve, si dhe rezultatit fiskal të ISSH kanë rezultuar mospërputhje midis të dhënave të rakorduara dhe raportuara nga ISSH dhe të dhënave të raportuara nga MFE, në Tabelën e Treguesve të Konsoliduar të Buxhetit të Shtetit, për faktin e të ardhurave dhe planin e shpenzimeve.

- Nga krahasimi i të ardhurave të realizuara nga ISSH (kontributet/të ardhura tatimore) dhe të dhënave të Tabelës së Treguesve Fiskalë të Konsoliduar të Buxhetit të Shtetit, Kapitulli II.3 “Të ardhurat nga fondet speciale”, **rezulton se fakti i të ardhurave ka mos përputhje për shumën 16 milionë lekë**. Sipas të dhënave të MFE fakti i të ardhurave nga fondet speciale (sigurimet shoqërore) paraqiten në vlerën 105,640 milionë lekë, nga ISSH, janë deklaruar 105,656 milionë lekë.

- Nga verifikimi i të dhënave mbi planin dhe faktin e shpenzimeve për ISSH, në raport me Treguesit Fiskalë të Konsoliduar të Buxhetit të Shtetit, të raportuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, është evidentuar se për sa i përket planit të shpenzimeve, **midis dy institucione ka një mos përputhje në shumën 11,946 milionë lekë**. Sipas të dhënave të ISSH, referuar Ligjit nr.115/2021 “Për buxhetin e vitit 2022”, akteve normative për ndryshim të tij, si dhe VKM-ve për alokim të fondeve për programe të veçanta, dërguar nga MFE, plani i shpenzimeve është në shumën 166,881 milionë lekë ndërsa në “Treguesit Fiskalë të Konsoliduar të Buxhetit të Shtetit” është raportuar në shumën 154,935 milionë lekë, me një diferencë në shumën 11,946 milionë lekë. Kjo diferencë ju përket shtesave në buxhetin e ISSH me VKM, në lidhje me financimin e programeve të veçanta, për të cilat MFE ka përdorur Fondin Rezervë të KM dhe Kontigjencën.

(Më hollësisht trajtuar në pikën II.2.3, faqe 24-52 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

2.1. Rekomandimi Titullari i ISSH dhe Drejtorja e Financës, të marrin masa që në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë të shqyrtojnë mospërputhjet me Treguesit e Fiskalë të Konsoliduar të Buxhetit të Shtetit, për sa i përket fondeve për ISSH, të raportuara në Kapitullin II “Të ardhurave tatimore”; II.3.1 “Të ardhura nga Fondet Speciale” (ISSH) dhe në Kapitullin I “Shpenzimet korrente”, pika 5 “Shpenzimet për fondet speciale” (ISSH).

Menjëherë

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi saktësinë e përllogaritjes së masës së pensioneve, dhe zbatimin e afateve në dhënien e pensioneve, nga Drejtorja Rajonale e Sigurimeve Shoqërore T., ka rezultuar se **nga auditimi i 148 dosjeve të pensionit, kanë rezultuar me mangësi në përllogaritjen e masës së pensionit 56 dosje, ose 37.8 % e tyre**, kjo për shkak përllogaritjes së pa saktë të elementëve përbërës të pensionit, si pensioni bazë dhe shtesa e pensionit nga inspektorëve përpunues të dosjeve:

- nuk është hedhur saktë në CMIS paga kontributive, referuar të dhënave sipas vërtetimeve të lëshuara nga punëdhënësi dhe Drejtorja e Arkivit Qendror (DAQ);
- paga bazë referuese (para vitit 1994) nuk është përcaktuar saktë, sipas kodeve përkatëse të profesioneve të përcaktuara në tabelat bashkëngjitur VKM nr. 561, datë 12.03.2005 “Për përcaktimin e pagave referuese për llogaritjen e pensioneve”, me ndryshime;
- nuk është përcaktuar saktë vjetërsia në punë për efekt pensioni, në kundërshtim me kriteret e përcaktuar si vite vjetërsie në punë deri në tetor 1994 sipas librezës së punës dhe/ose vërtetime; nga 1994 deri në vitin 2011 sipas vërtetimeve dhe pas vitit 2011 e në vazhdim sipas CMIS, referuar Ligjit 7703/1993 i ndryshuar, nenit 91 “Periudhat e quajtura si periudha sigurimi”;
- nuk është përllogaritur saktë pensioni bazë, pasi nuk është përcaktuar saktë referenca për pensionin social, element përbërës i pensionit bazë, bazuar në Ligjin nr. 7703/1993, neni 32 “Masa e pensionit”, pika 1 dhe 2;
- nuk është përcaktuar saktë shtesa e pensionit, si një element i masës së pensionit bazuar në Ligjin nr. 7703/1993, Pensionet e pleqërisë, neni 32 “Masa e pensionit”, pika 1 dhe 2; Pensionet e invaliditetit neni 36, pika 2 dhe Pensionet familjare, neni 41 “Shuma e pensionit”;

- nuk është përcaktuar saktë pensioni familjar për shkak të pasaktësisë në përlogaritjen apo referencat e elementëve përbërës të tij, si shtesa e përfitimit për fëmijët jetimë apo paga neto minimale referuese.

Nga auditimi mbi respektimin e afatit 42 ditor në përpunimin e një dosje pensioni, referuar të dhënave në Fletë shoqërimit operacional, nga auditimi i 148 dosjeve, në 38 raste, ose në masën 25 % kundrejt totalit të dosjeve të audituara (Tabela anekse nr. II.2.10.2.1 e RPA) nuk është respektuar afati i përpunimit të dosjes nga momenti i aplikimit deri në nënshkrimin nga Zyra e Financës për kryerjen e pagesës, si dhe shërbimin postar (tre ditë) në total 42 ditë afat.

(Më hollësisht trajtuar në pikën II.2.10, faqe 87-106 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

3.1. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Tiranë dhe Sektori i Përfitimeve, të marrin masa të menjëhershme për shqyrtimin e mangësive të evidentuara dhe ri llogaritjen e pensioneve për 56 rastet (dosjet) e trajtuara në mënyrë të hollësishme rast pas rasti në Raportin Përfundimtar të Auditimit, si dhe për përpunimin e dosjeve të pensionit brenda afateve të përcaktuara.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Drejtorja e Inspektimit të Përfitimeve për vitin 2022 ka inspektuar 38,232 dosje. Gjatë vitit 2022 në total, kanë mbetur për rishqyrtim për plotësim dhe të pa certifikuar 1,269 dosje nga 2,411 dosje të rishqyrtuara gjatë kontrollit, apo 52.6 % e tyre. Mos certifikimi brenda afatit 3 vjeçar, për vitet e pa certifikuar (2019-2020), përbën risk me efekt financiar për ISSH dhe buxhetin e shtetit, pasi sjell parashkrimin e tepricave të përfituara padrejtësisht nga përfituesit për këtë periudhë.

(Më hollësisht trajtuar në pikën II.2.4, faqe 52-57 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

4.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm në bashkëpunim me Njësinë e Inspektimit të Përfitimeve, të hartojnë plan masash me afate, për të mundësuar certifikimin e 1,269 dosjesh përfitimesh të cilat kanë rezultuar me efekte debitorë dhe kreditorë, si dhe të marrë masa për inspektimin dhe certifikimin e të gjitha dosjeve të përfituesve brenda afatit 3-vjeçar.

Menjëherë

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi veprimtarinë e Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, ka rezultuar se:

- nuk ka planifikuar dhe kryer asnjë auditim në sistemet e teknologjisë së informacionit në lidhje me ruajtjen e aseteve, integritetin e të dhënave dhe operimin në mënyrë efektive për të arritur qëllimet dhe objektivat e Institucionit, edhe pse vlerësimi i nivelit të riskut për vitin 2022 në lidhje me sistemet e teknologjisë së informacionit në DAQ është vlerësuar i lartë;

- në praktikën e auditimit të DRSSH Durrës konstatohet se Projekt Raporti është dërguar me vonesë si dhe në praktikën e auditimit të DRSSH Korçë, Shkodër dhe Durrës konstatohet se Raportet Përfundimtare janë dërguar me vonesë, kjo në kundërshtim me Manualin e Auditimit të Brendshëm pika 4.1.12

(Më hollësisht trajtuar në pikën II.2.9, faqe 81-87 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

5.1. Rekomandimi: Drejtori i Drejtorisë së Auditit të Brendshëm, të marrë masa për planifikimin e auditimit të sistemeve IT, si dhe të zbatojë afatet e evadimit të auditimeve, sipas përcaktimeve në Manualin e Auditimit të Brendshëm pika 4.1.12.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i pasqyrave financiare të konsoliduara rezultoi se, pasqyrat financiare të konsoliduara paraqesin informacion të sintetizuar për 12 Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, Buxhetin e Përgjithshëm të ISSH, Buxhetin e Brendshëm dhe Drejtorinë e Arkivit Qendror (DAQ), por në pikën 1 të Kreut IV.C, të Rregullores

Financiare të ISSH nr. 5, datë 25.05.2009 nuk parashikohet si qendër analizë DAQ, e cila është krijuar me anë të vendimit të Këshillit Administrativ nr.10, datë 04.07.2011.

(Më hollësisht trajtuar në pikën II.2.7, faqe 71-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

6.1. Rekomandimi: Drejtoria e Përgjithshëm i ISSH-së dhe Drejtoria e Financës të marrin masa për përditësimin e Rregullores Financiare, me qëllim përfshirjen në raportimin të të gjitha njësive shpenzuese në varësi të saj, të cilat kanë detyrim për raportim financiar.

Menjëherë

7. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i rregullshmërisë së raportimit rezultoi se nga ISSH, si një institucion që menaxhon fonde të financuara nga buxheti i shtetit, të cilat në vitin 2022 kanë qenë në shumën 62,872 milionë lekë, ose sa 37.6 % e planit të të ardhurave, nuk janë dërguar në Degën e Thesarit Tiranë Pasqyrat Financiare të vitit 2022, kjo në kundërshtim me kërkesat e përcaktuara në pikën 117, të UMFE nr. 8, datë 09.03.2018.

(Më hollësisht trajtuar në pikën II.2.7, faqe 71-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

7.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës, si përgjegjëse për raportimin financiar, të marrë masa për të depozituar një kopje të pasqyrave financiare pranë Degës së Thesarit, Tiranë dhe pas marrjes së konfirmimit nga kjo e fundit të vijojë me depozitimin pranë MFE-së.

Mars 2024

8. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procesit të inventarizimit të aktiveve të qëndrueshme dhe atyre qarkulluese rezultoi se nga komisioni i inventarizimit, të ngritur me anë të urdhrit nr.26, datë 13.12.2022, janë konstatuar pajisje dhe materiale për t'u nxjerrë jashtë përdorimit si më poshtë:

- Mjete në përdorim: 8 artikuj me Vlerë Kontabël Neto (VKN) 84,734 lekë, konkretisht:
- Pajisje informatike dhe elektronike: 3 artikuj me VKN 39,393 lekë;
- Pajisje, mobilieri zyre: 5 artikuj me VKN 35,344 lekë.

Në zbatim të nenit pikës 96 dhe 97 të Udhëzimit nr.30/2011 është ngritur një komision tjetër për verifikimin e aktiveve të cilësuar nga grupi i inventarizimit “si të papërdorshme”, ku me anë të shkresës nr. 8338/1 datë 31.01.2023 është konfirmuar lista e aktiveve për të dalë nga përdorimi. Me anë të Urdhrit nr. 8338/2 datë 31.01.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm është urdhëruar të bëhet heqja e materialeve të vlerësuar të papërdorshme dhe efektet financiare të paraqiten në Bilancin e vitit 2022. Nga verifikimi i procedurës së inventarizimit dhe asgjësimit rezultoi se në lidhje me AAM e propozuara për asgjësim, nuk janë marrë masa për asgjësimin fizik të tyre. Për periudhën objekt auditimi nuk konstatohen të jenë asgjësuar aktivet materiale, ndërsa në kontabilitet janë kryer procedurat e çregjistrimit të tyre, të cilat paraqiten në pasqyrën F7 “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto)

(Më hollësisht trajtuar në pikën II.2.7, faqe 71-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

8.1. Rekomandimi: Nga Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm të merren masa për të realizuar, sa më parë procesin e asgjësimit fizik të aktiveve të propozuara për asgjësim, të reflektuar paraprakisht në kontabilitet, me qëllim përpunimin e gjendjes kontabël me atë fizike.

Menjëherë

9. Gjetje nga auditimi: Nga verifikimi i saktësisë së paraqitjes së elementëve në Pasqyrat Financiare rezultoi se:

- Gjendja e inventarit qarkullues (llogaritë e Klasës 3), sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të konsoliduar të ISSH-së më 31.12.2021 paraqitet në vlerën 43,620,193lekë dhe përbëhet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 14,734,384lekë, nga llogaria “Mallra” në vlerën 28,885,809 lekë. Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën 774,421 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit”. Nga verifikimi i shënimeve shpjeguese për këto zëra, nuk ka të dhëna në lidhje me politikat

që përdoren nga ana e subjekteve për vlerësimin e tyre. Mungesa e shënimeve shpjeguese në lidhje me inventarët, për politikat dhe metodat e vlerësimit të tyre është në kundërshtim me kërkesat e paragrafit 34, të SKK 4.

- Llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, në vlerën 3,922,829 lekë paraqet aktive në pasqyrat individuale të DRSSH D.në vlerën 1,450,482 lekë dhe DRSSH Gj. në vlerën 2,472,347 lekë. Kjo kategori paraqet, një investim të bërë nga ana e DRSSH-ve të lartpërmendura për shtrimin e rrugës pranë ndërtesës. Kjo paraqitje e tyre nuk është e saktë, pasi nuk përmbushen kushtet e përcaktuara në pikën 8, të SKK 5, në lidhje me kontrollin e aktivitetit. Nga DRSSH-të dhe pse është njohur një element i tillë (si aktiv), nuk është kryer veprim rregullues sipas përcaktimeve të bëra në udhëzimin e MFE nr. 30, datë 27.12.2011, në lidhje me amortizimin e kësaj klase llogarie, por rezulton që në dy vite kjo shumë paraqitet e njëjtë.
- Llogaria 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”, në fund të vitit 2022 është në vlerën 160,114 lekë, një vit më parë ky zë ka qenë në shumën 0 lekë. Zëri “Shpenzime të periudhave të ardhme” paraqitet vetëm në pasqyrën individuale të DRSSH L.. Nga informacioni i marrë prej DRSSH-së rezulton se, kjo shumë përfaqëson vlerën e karburantit gjendje në fund të vitit 2022, ky veprim nuk përputhet me kërkesat e paragrafit 13 të SKK 2, ku kërkohet që: “...emërtimet e zërave të bilancit duhet të respektohen...”.
- Shuma 2% e sigurimit vullnetar, që paguhet për punonjësit e ISSH, bazuar në pikën 2 të VKA nr.24, të datës 23.12.2014 është paraqitur në llogarinë 44 “Institucione të tjera publike” nga ana e DRSSH Sh.ndërsa po i njëjti zë nga DRSSH B., Du. e Di. është paraqitur në llogarinë 419 “Kreditorë, parapagime”, gjë e cila tregon mos unifikim të mënyrës së raportimit.

(Më hollësisht trajtuar në pikën II.2.7, faqe 71-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

9.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës, pranë ISSH të marrë masa për të përfshirë në Rregulloren Financiare të ISSH apo në Manualin Kontabël Publik, të ISSH-së detajime në lidhje me disa regjistrime standarde që kanë rezultuar të pasakta ndër vite, prej DRSSH-ve. Nga Drejtoria e Financës të kërkohet, që DRSSH L. të bëjë korrigjim në lidhje me paraqitjen e saktë të zërit “shpenzime të periudhave të ardhme”, pasi ky klasifikim nuk përbën një shpenzim parapaguar.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi zbatimin e rekomandimeve dhe raportimin në KLSH, ka rezultuar se, ISSH është audituar nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, për periudhën nga data 01.01.2021 deri më 31.12.2021, sipas Programit të Auditimit nr. 17/1 prot., datë 14.01.2022 “Mbi Përputhshmërinë e veprimtarisë”, i ndryshuar.

Nga ana e ISSH nuk është raportuar në lidhje me hartimin e planin të masave për zbatimin e rekomandimeve, në kundërshtim me nenin 15 dhe 30, pika nr.1 dhe nr. 2, të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Për sa i përket nivelit të zbatimit të rekomandimeve ka rezultuar se nga 13 rekomandime, të lëna për zbatim janë pranuar të gjitha, si dhe janë zbatuar 7 rekomandime, janë në proces zbatimi 3 rekomandime dhe janë zbatuar pjesërisht 3 rekomandime (rekomandimi nr. 2.2, 4.1 dhe 8.1), të cilat ju përkasin masave organizative.

(Më hollësisht trajtuar në pikën II.2.1, faqe 14-18 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

10.1. Rekomandimi: Titullari i ISSH, të nxjerrë përgjegjësitë dhe të marrë masa për zbatimin e 6 (gjashtë) rekomandimeve që rezultuan të zbatuara pjesërisht dhe ato në proces zbatimi, si dhe të marrë masa për respektimin e afateve të raportimit në KLSH, mbi hartimin e planit veprimtarë mbi zbatimin e rekomandimeve, brenda afatit 20 ditor dhe raportimin e nivelit të zbatimit të tyre brenda afatit 6 mujor, nga njohja me Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi planifikimin dhe transferimin e fondeve buxhetore gjatë vitit 2022, dërguar me shkresën nr. 51 prot., datë 05.01.2022, vlera e shpenzimeve administrative akorduar për buxhetin e brendshëm është 350,931 mijë lekë dhe për buxhetin e përgjithshëm 498,685 mijë lekë. Ndërkohë sipas të dhënave nga financa këto vlera rezultojnë përkatësisht 358,522 mijë lekë dhe 491,094 mijë lekë. Për këtë ndryshim në planin e shpenzimeve nuk ka evidencë shkresore. Gjithashtu, është konstatuar se, ka ndryshime të shpeshta në buxhetin e shpenzimeve administrative të DRSSH-ve gjatë vitit ushtrimor, të cilësuar më lart, të cilat në disa raste kanë rezultuar të paargumentuara dhe të panevojshme.

(Më hollësisht trajtuar në pikën II.2.5, faqe 57-64 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

11.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës të marrë masat e duhura për një planifikim sa më real të fondeve buxhetore në dispozicion, si dhe uljen e transferimeve buxhetore, nga një njësi në tjetrën dhe nga një artikull në tjetrin.

Në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se përgjatë vitit 2022, ISSH ka funksionuar mbi bazën e Rregullores për Organizimin e Funksionimit e saj, e cila nuk përshtatet me strukturën organizative aktuale. Me urdhrin nr. 4385 prot., datë 22.06.2022, Titullari i Institucionit ka ngritur grupin e punës për një organizim të brendshëm të ISSH dhe ndryshim të strukturave organizative aktuale të Drejtorisë së Përgjithshme, DRSSH, DSSH dhe DAQ, i cili nuk ka paraqitur asnjë informacion apo dokumentacion mbi ecurinë e punës për hartimin e strukturës së re organizative.

(Më hollësisht trajtuar në pikën II.2.6, faqe 64-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

12.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm të nxjerrë përgjegjësitë në përsheptimin e procedurave për organizimin e brendshëm të Institucionit, si dhe të marrë masa për miratimin e Rregullores për Funksionimin dhe Organizimin e ISSH.

Deri më 31.10.2023

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se, në formatin “Njoftimi për shpallje konkurrimi”, për postet menaxheriale të ISSH (Zv. Drejtor i Përgjithshëm, Drejtor Drejtorie, Drejtor Rajonal), mënyra e testimit dhe e vlerësimit të kandidatit e përcaktuar në paragrafin “Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista”, nuk është në përputhje me pikën 8.14, kapitulli 8, “Mënyra e Vlerësimit”, të Rregullores “Për Personelin e ISSH”.

- Nga auditimi u konstatua se, Komisioni i Vlerësimit të Kandidaturave (KVK), në Raportin Përfundimtar të datës 05.08.2022, ka klasifikuar fitues të pozicionit Zv. Drejtor të Përgjithshëm Teknik në ISSH, pa plotësuar kriterin profesional të kërkuar sipas “Njoftimit për shpallje konkurrimi”, veprim ky në kundërshtim me ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar; si dhe me Kapitullin I “Rekrutimi”, i Rregullores “Për Personelin e ISSH”, e ndryshuar, miratuar me VKA nr. 3/2, datë 26.02.2008.

(Më hollësisht trajtuar në pikën II.2.6, faqe 64-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

13.1. Rekomandimi: Drejtoria e Administrimit të Përgjithshëm në ISSH, të përmirësojë formatin “Njoftimi për shpallje konkurrimi”, për kandidatët të nivelit menaxherial, duke u bazuar në përcaktimet e Rregullores “Për Personelin e ISSH”, si dhe Komisioni i Vlerësimit të Kandidaturave (KVK), të marrë masa që rekrutimet të bëhen të bazuara mbi kriteret e pranimit të përcaktuara në Rregulloren “Për Personelin e ISSH”.

Menjëherë

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të ndjekura për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës gjatë vitit 2022, u konstatua se, punonjësit e larguar nuk kanë zbatuar

plotësisht kushtet e vendosura në Kontratën e tyre të Punës, duke mos njoftuar paraprakisht me shkrim punëdhënësin, veprime këto në kundërshtim me nenin 143, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar.

- Nga auditimi u konstatua se, në Sektorin e Inspektimit të Përfitimeve të Invaliditetit, Familjare, dhe Sociale, sektor i përbërë nga 1 përgjegjës dhe 2 specialistë (1+2), pozicionet e 2 specialistëve kanë qenë vakant në 5 mujorin e dytë të vitit 2022, veprim në kundërshtim VKA nr. 5, datë 25.07.2022, Për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e parimeve dhe rregullave bazë për funksionimin e Drejtorisë së Inspektimit të Përfitimeve”.

- Nga auditimi u konstatua se, në “Kalendarin paraprak të aktiviteteve trajnuese për punonjësit e sistemit të sigurimeve shoqërore, përgjatë vitit 2022”, janë parashikuar 33 aktivitete trajnuese, ndërkohë gjatë vitit janë realizuar 16 aktivitete trajnuese.

- Nga auditimi u konstatua se në formatin e listës së pagave të ISSH, mungojnë kolona e “emërtesës së pozicionit sipas strukturës së miratuar”, “kategorisë” e “klasës” së punonjësve, në kundërshtim me pikën nr. 1, dhe lidhja 1, e Udhëzimit të përbashkët të MFE dhe DAP nr. 1, datë 21.05.2021, “Për formën, elementët dhe plotësimin e listë pagesës mujore të pagave dhe të urdhër shpenzimit për pagat në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën II.2.6, faqe 64-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

14.1. Rekomandimi: Drejtori i Përgjithshëm i ISSH dhe Drejtori i Përgjithshëm Administrativ të marrin masa për plotësimin e pozicioneve vakante në Drejtorinë e Inspektimit të Përfitimeve dhe Drejtorinë e Auditit të Brendshëm, si dhe për hartimin e kalendarit të trajnimeve, referuar nevojave reale të stafit, për organizimin e trajnimeve në lidhje me njohjen dhe zbatimin e Ligjit “Mbi Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

Menjëherë dhe në vijimësi

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi u konstatua se në Rregulloren e Personelit të ISSH, miratuar me VKA nr. 20, datë 26.02.2008, nuk është bërë detajimi për shtesat mbi pagë (Aneksi 3/C), përfshirë nivelin dhe përfituesit e tyre. Kjo mangësi ka sjellë që në vijim, për trajtimin e shtesave është përdorur si referencë përcaktimi i tyre në Rregulloren nr. 12, datë 20.03.1996 “Për personelin e ISSH”, e cila është e shfuqizuar.

(Më hollësisht trajtuar në pikën II.2.6, faqe 64-71 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

15.1. Rekomandimi: Këshilli Administrativ në bashkëpunim me Drejtorin e Përgjithshëm të ISSH, të rishikojnë Rregulloren e Personelit të ISSH, për shtesat mbi pagë të punonjësve të ISSH, duke detajuar nivelin dhe përfituesit e tyre.

Deri më 31.12.2023

16. Gjetje nga auditimi: Nga AK, janë bërë modifikime në DT, të cilat janë hedhur në SPE, në rubrikën “Dokumentet e tenderit” Shtojca nr. 1 “Për një ndryshim të dokumenteve të tenderit për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar mbi sigurimin e aktiveve të ISSH”. Ndryshimet sipas kësaj shtojce, konkretisht Paraqitja e PF të vitit 2020-2021 dhe jo 2019-2020 dhe Paraqitja e licencës me specifikime klasa 8 dhe 9 dhe jo pa specifikuar klasat, nuk janë reflektuar në Rubrikën “Vlerësimi i ofertave”, llogaria e përdoruesit të KVO-së, në kundërshtim me nenin 74, pika 3 dhe Udhëzimin nr. 7, datë 30.07.2021 “Manual teknik për mënyrën e zhvillimit të procedurave të prokurimit me mjete elektronike”, pika 2 “Detyrat dhe funksionalitetet për administratorin e Sistemit”.

(Më hollësisht trajtuar në pikën II.2.8, faqe 77-81 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)

16.1. Rekomandimi: Personi përgjegjës për prokurimet të marrë masa që në vazhdimësi të pasqyrojë në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, çdo ndryshim të Dokumenteve të Tenderit (DT), për të siguruar në vijimësi zbatimin rigoroz të kuadrit ligjor dhe rregullator të prokurimeve publike.

Në vijimësi

V. ANEKSE

Drejtimi i auditimit nr. III.2.3

Mbi debitorët:

Tabela nr. 3.36 “Të dhënat progresive për detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore të papaguara në afat për çdo subjekt, për drejtorinë rajonale tatimore (subjekte buxhetore)”

në lekë

Nr.	Rajonet	Nr. i subjekteve sipas NIPT-it	Detyrimi	Gjoha	Interesa	Debia
1	B.	10	124,888	161,794	20,067	306,749
2	Di.	27	747,333	594,567	562,877	1,904,777
3	Du.	19	410,444	517,777	660,071	1,588,292
4	E.	24	3,798,182	1,119,004	2,442,263	7,359,449
5	F.	10	3,486,574	1,135,532	3,063,529	7,685,635
6	Gj.	16	1,168,789	4,250,705	3,683,233	9,102,727
7	K.	16	91,728	100,455	21,614	213,797
8	L.	12	4,242,714	162,946	75,069	4,480,729
9	S.	5	304,782	195,877	219,762	720,421
10	Sh.	21	827,349	117,745	77,068	1,022,162
11	T.	149	76,704,609	76,538,728	136,399,895	289,643,232
12	V.	10	48,285	55,000	22,203	125,488
13	Ka.	10	146,683	73,300	19,018	239,001
14	Ku.	35	18,530,617	12,078,718	23,304,567	53,913,902
	Shuma	364	110,632,977	97,102,148	170,571,236	378,306,361
15	VIP-AT	6	22,239	460,748	3,803,122	4,286,109
	TOTALI	370	110,655,216	97,562,896	174,374,358	382,592,470

Tabela nr. 3.37 “Të dhënat progresive për detyrimet për kontributet e sigurimeve shoqërore të papaguara në afat për çdo subjekt, për DRT (subjekte jo buxhetore)”

Në lekë

Nr.	Rajonet	Nr. i subjekteve sipas NIPT-it	Detyrimi	Gjoha	Interesa	Debia
1	B.	13	19,632,752	4,041,921	1,499,750	25,174,423
2	Di.	14	1,261,541	1,708,665	1,387,260	4,357,466
3	Du.	16	3,205,782	2,546,004	373,915	6,125,701
4	E.	25	26,312,396	3,179,168	1,119,275	30,610,839
5	F.	24	6,252,148	17,247,849	4,557,857	28,057,854
6	Gj.	16	12,287,867	529,622	203,612	13,021,101
7	K.	22	30,166,422	817,718	214,438	31,198,578
8	L.	11	2,808,259	5,492,517	1,591,895	9,892,671
9	S.	5	2,896	26,499	63	29,458
10	Sh.	25	39,195,233	11,653,543	7,719,143	58,567,919
11	T.	93	35,138,658	12,049,199	7,997,649	55,185,506
12	V.	11	54,856,204	5,317,462	2,205,407	62,379,073
13	Ka.	5	41,673,229	8,293,885	2,851,746	52,818,860
14	Ku.	16	4,593,777	5,322,136	2,741,625	12,657,538
	Shuma	296	277,387,164	78,226,188	34,463,635	390,076,987
15	VIP-AT	2	1	12,190	3,340	15,531
	TOTALI	298	277,387,165	78,238,378	34,466,975	390,092,518

Tabela nr. 3.38 “Të dhënat progresive për detyrimet e kontributeve të sigurimeve shoqërore të papaguara në afat për çdo subjekt, për drejtorinë rajonale tatimore (subjekte juridike)”

Në lekë

Nr.	Rajonet	Nr. i subjekteve sipas NIPT-it	Detyrimi	Gjoha	Interesa	Debia
-----	---------	--------------------------------	----------	-------	----------	-------

1	B.	453	102,405,696	9,965,746	5,770,399	118,141,841
2	Di.	441	199,794,942	28,070,172	10,713,537	238,578,651
3	Du.	3,981	938,939,454	147,732,458	92,186,445	1,178,858,357
4	E.	961	240,626,702	30,805,177	13,080,812	284,512,691
5	F.	1,319	353,379,598	39,725,304	20,680,121	413,785,023
6	Gj.	392	86,164,610	15,859,848	10,738,347	112,762,805
7	K.	780	190,198,327	22,227,552	17,888,047	230,313,926
8	L.	708	230,831,643	23,172,819	14,633,995	268,638,457
9	S.	352	47,222,195	7,349,259	4,295,436	58,866,890
10	Sh.	1,175	369,338,709	76,219,093	31,903,137	477,460,939
11	T.	13,709	4,763,680,794	584,404,654	252,873,300	5,600,958,748
12	V.	1,156	322,082,743	49,341,234	38,852,026	410,276,003
13	Ka.	774	115,921,397	13,104,019	6,135,196	135,160,612
14	Ku.	306	93,007,919	9,527,669	5,081,799	107,617,387
	Shuma	26,507	8,053,594,729	1,057,505,004	524,832,597	9,635,932,330
15	VIP-AT	162	262,894,585	24,819,333	6,401,429	294,115,347
	TOTALI	26,669	8,316,489,314	1,082,324,337	531,234,026	9,930,047,677

Tabela nr. 3.39 “Të dhënat progresive për detyrimet e kontributeve të sigurimeve shoqërore të papaguara në afat për çdo subjekt, për drejtorinë rajonale tatimore (subjekte biznesi i vogël)”

Në lekë

Nr.	Rajonet	Nr. i subjekteve sipas NIPT-it	Detyrimi	Gjoha	Interesa	Debia
1	B.	2,338	119,444,212	13,225,820	4,406,596	137,076,628
2	Di.	1,656	69,233,335	17,057,067	6,085,661	92,376,063
3	Du.	8,158	770,789,508	83,699,952	21,496,667	875,986,127
4	E.	4,819	355,924,922	33,774,305	6,942,549	396,641,776
5	F.	5,897	390,012,750	42,060,251	9,154,220	441,227,221
6	Gj.	1,372	64,448,054	11,005,535	2,173,938	77,627,527
7	K.	4,856	282,202,168	43,662,761	15,848,451	341,713,380
8	L.	3,069	208,563,118	18,338,035	8,224,028	235,125,181
9	S.	2,311	115,514,682	14,015,732	4,964,790	134,495,204
10	Sh.	5,201	285,269,182	35,415,381	5,922,929	326,607,492
11	T.	34,424	2,472,148,899	271,234,337	30,719,844	2,774,103,080
12	V.	5,423	347,820,852	42,116,062	10,897,560	400,834,474
13	Ka.	1,542	129,283,814	12,624,475	4,702,626	146,610,915
14	Ku.	707	38,892,183	5,642,095	841,605	45,375,883
	Shuma	81,773	5,649,547,679	643,871,808	132,381,464	6,425,800,951

Drejtimi i auditimit nr. II.2.4.

Tabela nr.4.1: rezultatet e gjetjeve të konstatuara nga sektori i inspektimit të përfitimeve afatgjata;

Rajonet	DRSSH T.	DRSSH F.	DRSSH L.	DRSSH K.	DSSH TR.	DRSSH K.	TOTALI
Perjudha e kontrolluar	01.01.2019 - 31.12.2019	01.01.2019 - 31.12.2020	01.01.2019 - 31.12.2020	01.01.2019 - 31.12.2020	01.01.2019 - 31.12.2020	01.01.2019 - 31.12.2020	
Afati i kontrollit	23.12.2021 - 18.03.2022	28.03.2022 - 10.06.2022	22.06.2022 - 22.07.2022	28.07.2022 - 12.08.2022	28.07.2022 - 12.08.2022	18.08.2022 - 27.10.2022	
Dosje për kontroll	10,993	9,339	3,325	993	359	7,799	32,808
Dosje të paraqitura	10,314	9,253	3,296	971	350	7,686	31,870

Dosje të munguara	679	86	29	22	9	113	938
nga këto (KMCAP Epror + KQA)						11	11
(transferuar, mbyllur, kal.pens.tje)	587	49	23	20	8	96	783
Aktive në sistem (pa arsye)	92	37	6	2	1	6	144
Dosje të certifikuara	9,616	8,751	3,046	889	317	7,389	30,008
Dosje me problematikë	698	502	250	82	33	297	1,862
% e dosjeve me problematikë	6.77%	5.43%	7.58%	8.44%	9.43%	3.86%	0
Konstatime të kontrollit							0
Pezullime	2		1	2			5
Rishqyrtime	573	445	185	44	20	243	1,510
Rishqyrtuar gjatë kontrollit	181	248	68	24		210	731
Mbeten detyrë për rishqyrtim	392	197	117	20	20	33	779
Mbeten detyrë për plotësim	86	39	53	14	5	8	205
Dosje me probleme mjekësore	37	18	11	22	8	46	142
Gjithsej/detyra	515	254	181	56	33	87	1,126
Dosje të rezultuara debi/pezul(llogaritur)	1			1			2
Lekë	777,457			255,368			1,032,825
Dosje të rezultuara debit/rishqyrtime	42	44	23	11		38	158
Lekë	1,624,934	1,723,935	221,058	401,900		1,068,406	5,040,233
Debitorë (rishq+pez)							0
Nr.dosje	43	44	23	12		38	160
Lekë	2,402,391	1,723,935	221,058	657,268		1,068,406	6,073,058
Kreditorë							0
Dosje të rezultuara kreditorë	139	204	44	13		172	572
Lekë	4,288,918	5,105,762	1,462,012	396,341		3,582,331	14,835,364
Nr. dosjeve të cert. në përfundim të programit	9,797	8,999	3,114	913	317	7,599	30,739
% e dosjeve të certifikuara në përfundim	95%	97.25%	94.48%	94.03%	90.57%	98.87%	95.03%
Nr.dosjeve me efekte	182	248	67	25		210	732

Burimi: të dhëna nga DIP në ISSH.

Tabela nr.4.2: rezultatet e gjetjeve nga sektori i inspektimit të përfitimeve suplementare dhe trajtimeve të veçanta;

Rajonet	DRSSH T.	DRSSH Gj.	Totali
<i>Perjudha e kontrolluar</i>	01.07.2018 - 30.06.2020	01.01.2019- 31.12.2020	
<i>Afati i kontrollit</i>	20.01.2021 - 31.03.2021	01.08.2022- 07.09.2022	

Dosje për kontroll	5,198	1,182	6,380
Dosje të paraqitura	5,194	1,168	6,362
Dosje të rregullta	4,732	1,081	5,813
Dosje me problematike	462	87	549
% e dosjeve me prob.	8.89%	7.45%	0
Të plotësuara dhe rishq. Gjatë kontrollit	319	51	370
Të pezulluara	33	3	36
Të rreg.ne fund	5,051	1,132	6,183
Mbeten detyra	110	33	143
Konstatime të kontrollit			0
Pezullime	32	3	35
Plotesime/rishqyrtime	462	84	546
Rishqy.gjatë kontrollit/efekte	214	38	252
Plotësuar me dokumentacion	106	13	119
Mbeten detyre për rishq./plot.	110	33	143
Dosje me probleme të tjera.			0
Dosje të rezultuara debitore/pezullime/llogaritur	33	3	36
Lekë	10,476,767	425,200	10,901,967
Dosje të rezultuara debitorë/rishqyrtime	130	24	154
Lekë	10,492,435	883,181	11,375,616
Debitore			0
Nr.dosje	163	27	190
Lekë	20,969,202	1,308,381	22,277,583
Dosje të rezultuara kreditore	83	14	97
Lekë	7,753,154	499,754	8,252,908
Nr. Dosjeve të certifikuara në përfundim të programit	4,732	1,132	5,864
% e dosjeve të certifikuara në përfundim	91,11%	96.92%	92.17%
Dosje të mbetura për plotësim apo rishqyrtim	462	33	495
Dosje të pezulluara	33	3	36
% dosjeve rishqyrtuara/pezulluara me efekte	4.74%	3.51%	4.51%

Burimi: të dhëna nga DIP në ISSH, përpunuar nga grupi auditimit.

Tabela nr.4.3: Të dhëna mbi programet dhe afatet:

Dosjet e auditimit sipas subjekteve	Programi nr/datë	Afati i Inspektimit	Projekt raporti nr/datë	Kthimi i observacioneve pas PRA	Takimi ballafaques	Raportit Përfundimtar nr/datë	Afati nga mbajtja e aktit në terren deri në dërgimin e Projektit	Afati nga takimi ballafaques në dërgimin e Raportit Përfundimtar
SEKTORI I INSPEKTIMIT TE PERFITIMEVE AFATGJATA								
DRSSH K.	Nr. 5319; Datë 27.07.2022;	18.08.2022- 27.10.2022	Nr. 5319/2 Datë 21.11.2022	Datë 01.12.2022	Datë 13.12.2022	Nr. 5319/4 Datë 28.12.2022	25 ditë kalendarike	14 ditë kalendarike
	Nr. 1978; 1978/2 Datë 16.03.2022; 27.05.2022		28.03.2022- 17.06.2022	Nr. 1978/3 25.07.2022	Datë 08.08.2022	Datë 26.09.2022	Nr. 1978/6 Datë 10.10.2022	37 ditë kalendarike
DRSSH T.	Nr. 8022; Datë 21.12.2021	23.12.2021- 18.03.2022		Nr. 8022/2 Datë 23.05.2022	Datë 22.06.2022	Datë 26.07.2022	Nr. 8022/4 Datë 25.08.2022	65 ditë kalendarike
	SEKTORI I INSPEKTIMIT TE PERFITIMEVE SUPLEMENTARE DHE TRAJTIMEVE TE VECANTA							
DRSSH T.	Nr. 8213 8213/2 Datë 29.12.2021 13.06.2022	05.01.2022- 20.07.2022	Nr. 8213/3 Datë 19.09.2022	Datë 06.10.2022	Nuk ka	Nr. 8213/5 Datë 03.11.2022	59 ditë kalendarike	27 ditë kalendarike

DRSSH Gj.	Nr. 5026;	01.08.2022- 07.09.2022	Nr. 5026/1	Datë 27.10.2022	Nuk ka	Nr. 5026/3 Datë 10.11.2022	35 ditë kalendarike	14 ditë kalendarike
	Datë 15.07.2022;		Datë 12.10.2022					

Burimi: DIP në ISSH, përpunuar nga grupi i auditimit.

Drejtimi i auditimit nr.II.2.6.

Tabela nr. 6.1. "Vendimet gjyqësore me objekt "Dëmshpërblim page" për vitin 2022"

Në lekë

Nr	Emër/Mbiemër	Pozicioni	Paga e fituar në Shkallë të I	Gjykata e apelit	Likujdime të kryera	Vendimi	Komente
1	Y.Xh.	Specialist verifikues		Proces			
2	B.B.	Inspektor Bujku/Shishtavec	Rrëzuar padia	Proces			
3	R.Gj.	K/Dege Arkives	Rrëzuar padia	Proces			
4	M.H.	Drejtor i DRSSH Berat	12	Proces			
5	F.K.	Pergjegjes i ALSSH Skrapar	12	Proces			
6	K.R.	Arkiviste	Ka vendosur rikthim ne pune	Proces			
7	D.R.	Specialist Arkive Agjencia Kruje	11	Proces			
8	Gj.N.	Specialist/vetpunesuarit ne bujqesi	29	Proces			
9	R.K.	Inspektor Vetepun. Bujqesi	PROCES				
10	H.M.	Inspektor Vetepun. Bujqesi	14	Proces			
11	E.K.	Specialiste	13	Proces			
12	I.M.	Pergjegjes Agjencia Lokale	15.5	Proces			
13	I.K.	Kryetare Dege Finances	17	Proces			
14	V.H.	Pergjegjese Agjensise Lokale	9	Proces			
15	S.L.	Drejtor i Auditit	10	Proces			
16	E.N.	Drejtor i Administrimit të Përgjithshëm	17	Proces			
17	A.D.	Drejtor I DAQ Lunder	12	Proces			
18	A.B.	Drejtor Drejtorie ISSH	25	Proces	3,299,737	Vendim nr. 8444 dt.28.12.21 Gjykata e Rrethit Tirane	Ekzekutim i perkohshëm, vullnetarisht.
19	A.A.	Drejtor Drejtorie ISSH	25.3	Proces	3,285,879	Vendim Nr 231, dt 17.05.2022, Gjykata e Shkalles se Pare	Ekzekutim i perkohshëm, vullnetarisht
20	A.R.	Specialiste te BNJ	PROCES				
21	D.M.	Drejtor DAQ Lunder	13.5	Proces			
22	L.D.	Kryetare Dege DAQ	18	Proces			
23	M.Gj.	Inspektor Bujku	Rrëzim (viti 2018)	Proces			
24	V.B.	Specialiste e Ekspertizes Mjekesore	18 (viti 2019)	Proces			
25	V.L.	Specialist perpunues Dege e Perfitimeve	5	Proces			
26	H.Sh.	Titullar	14 (Viti 2018)	Proces			
27	M.D.	Shefe Kabineti	17	Proces			
28	U.K.	Inspekt. Vetepunesimi bujqesi, Elbasan	11	11	267,000	Vendim Nr.101 date 24.02.2022 , Gjykata e Apelit	Ekzekutim vullnetarisht
29	H.L.	Inspekt. Vetepunesimi bujqesi, Elbasan	3	15	571,385	Vendim Nr.112 date 27.04.2022 , Gjykata e Apelit	Kundershtim veprimesh perbarimore per shkak te percaktimit te pages baze.
	Totali				7,424,001		

Burimi: Drejtoria Juridike në ISSH, përpunuar nga audituesi.

Tabela nr. 6.2. "Kandidatët konkurrues për pozicionin, zv. Drejtor i Përgjithshëm Teknik në ISSH"

Nr	ISSH	Kriteri arsimor i kërkuar	Arsimi i kryer nga kandidati	Kriteri profesional i kërkuar	Ekspierenca profesionale e kandidatit (sipas librezës së punës)	Vlerësimi i kandidatit ve (në pikë)
1	2	3	4	5	6	7

1	K.R.	Kandidatët duhet të zotërojnë diplomë të nivelit Master i Shkencave të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë në Shkenca Ekonomike, Juridike	UET, Fakulteti Shkencave Sociale, Dega Marrëdhënie Publike Komunikim, Universiteti K., Fak. Drejtësisë- Master Shkencor ne Administrim Publi , UT, Fakulteti Ekonomik- Master Profesional në Administrim Publik/ UT/Fak. Ekonomik -MSC ne Statistika Zyrtare	Të kenë të paktën 10 vjet eksperiencë në fushën e administratës publike/shërbim civil dhe/ose në institucione private nga të cilat minimum 6 vjet në nivel të lartë menaxherial . Të ketë eksperiencë pune mbi 3 vjet në nivel Drejtor Drejtorie për punonjësit brenda administratës së Sigurimeve Shoqërore, si dhe ose jo më pak se 3 vjet në administratë publike/shërbim civil të një kategorie të barazvlefshme me kategorinë e Zv.Drejtorit të Përgjithshëm apo me kategorinë e Drejtorit të Drejtorisë.	10 vite e 9 muaj- nga këto: Gusht 2019 -Mars 2021 Këshilltar kabinetit në DPT, Mars 2021-Mars 2022, Përgjegjës Sektori në DPT, në total 2.7 vite në nivel të lartë menaxherial.	82
2	T.M.	Kandidatët duhet të zotërojnë diplomë të nivelit Master i Shkencave të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë në Shkenca Ekonomike, Juridike	Diplomë Cikli i Parë Drejtësi, Universiteti Kristal+Master Shkencor në Drejtësi, "E Drejtë Private dhe e Biznesit". Universiteti "Luigj Gurakuqi", Shkoder	Të kenë të paktën 10 vjet eksperiencë në fushën e administratës publike/shërbim civil dhe/ose në institucione private nga të cilat minimum 6 vjet në nivel të lartë menaxherial. Të ketë eksperiencë pune mbi 3 vjet në nivel Drejtor Drejtorie për punonjësit brenda administratës së Sigurimeve Shoqërore, si dhe ose jo më pak se 3 vjet në administratë publike/shërbim civil të një kategorie të barazvlefshme me kategorinë e Zv.Drejtorit të Përgjithshëm apo me kategorinë e Drejtorit të Drejtorisë.	Drejtor i DRSSH Lezhë. 19 vite - nga këto 5 vjet e 4 muaj, pozicion pune nivel i lartë menaxherial.	77
3	M.Z.	Kandidatët duhet të zotërojnë diplomë të nivelit Master i Shkencave të barazvlefshme me to sipas legjislacionit të arsimit të lartë në Shkenca Ekonomike, Juridike	Diplomë "Gjuhë Letërsi" për mësuese e Gjuhës dhe Letërsisë, për shkollën e mesme (sistem i vjetër)	Të kenë të paktën 10 vjet eksperiencë në fushën e administratës publike/shërbim civil dhe/ose në institucione private nga të cilat minimum 6 vjet në nivel të lartë menaxherial. Të ketë experience pune mbi 3 vjet në nivel Drejtor Drejtorie për punonjësit brenda administratës së Sigurimeve Shoqërore, si dhe ose jo më pak se 3 vjet në administratë publike/shërbim civil të një kategorie të barazvlefshme me kategorinë e Zv.Drejtorit të Përgjithshëm apo me kategorinë e Drejtorit të Drejtorisë.	Përgjegjëse Sektori në Drejtorinë e Marrëdhënieve me Publikun në ISSH. 33 vite - nga këto 8 vite eksperiencë në nivel të lartë menaxherial.	73

Burimi: Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve në ISSH, përpunuar nga audituesi.

Drejtimi III.2.8. "Verifikimi i Pasqyrave Financiare të Konsoliduara"

Pasqyra e Pozicionit Financiar

Pasqyra e Pozicionit Financiar paraqet informacionin mbi pozicionin financiar në lidhje me gjendjet e llogarive të ISSH-së në fund të periudhës kontabël, më datë 31.12.2022.

Kjo pasqyrë është ndërtuar nga tre pjesë:

- *Aktivët, Pasivët dhe Aktivët/fondet neto.*

Klasifikimi i elementeve të mësipërme në nëngrupe dhe paraqitja e pasqyrës së pozicionit financiar është bërë bazuar në parimin e materialitetit, për të siguruar një pamje të sinqertë dhe të vërtetë të situatës financiare të subjektit.

A. AKTIVET

I. Aktivët afatshkurtra.

Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre.

Në këtë zë përfshihen kryesisht aktivet monetare në arkë dhe bankë, llogari rrjedhëse, investimet në tregun e parasë dhe tregje të tjera shumë likuide, si edhe investime në letra me vlerë, që plotësojnë kushtin ekuivalentëve të mjeteve monetare, të cilat në mënyrë të detajuar paraqiten si më poshtë:

Tabela nr.1: "Mjetet monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare"

Referenca e Llogarive	Emërtimi	Viti	Viti	Diferenca
		2022	2021	
A	A K T I V E T	62,626,776,191	49,502,420,107	13,124,356,083
	I. Aktivët Afat shkurtra	61,164,254,348	48,263,164,581	12,901,089,768
	1.Mjete monetare dhe ekuivalent te tyre	40,617,139,583	30,827,609,857	9,789,529,727
531	Mjete monetare ne Arke	140,973	196,643	-55,670
512,56	Mjete monetare ne Banke	20,482,249,997	17,227,970,098	3,254,279,899
520	Disponibilitete ne Thesar	-	-	0
50	Letra me vlere	19,363,730,000	11,939,240,000	7,424,490,000
532	Vlera te tjera	21,388,125	832,650,791	-811,262,665
54	Akreditiva dhe paradhënie (POSTA SHQIPTARE)	749,630,487	827,552,324	-77,921,837

Burimi i të dhënave ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare më datë 31.12.2022 paraqiten në vlerën 40,617,139,583 lekë dhe përbëhen nga:

- *Llogaria nr.531 “Mjetet monetare në arkë”* në shumën 140,973 lekë, paraqet shumën e mjeteve monetare që ka vetëm Drejtoria e Administrimit, në pasqyrat e tjera individuale ky zë paraqitet në shumën 0 lekë.
- *Llogaria nr. 512, 26 “Mjete monetare në bankë”* në shumën 20,482,249,997 lekë, e cila përputhet me shumatoren aritmetike të vlerave të kësaj llogarie të paraqitur në pasqyrat individuale. Për verifikimin e saktësisë së paraqitjes së kësaj shume janë verifikuar gjendjet e mjeteve monetare, sipas statement bankar të bankave të ndryshme të dy njëjive: Buxheti i Përgjithshëm dhe Buxheti i Brendshëm ISSH (duke qenë së zënë peshën më të madhe në këtë zë), konkretisht; Buxheti i Përgjithshëm rezulton me gjendje 18,308,527,561.73 lekë dhe Buxheti i Brendshëm ISSH me gjendje 16,346,099.28 lekë, aq sa paraqiten dhe në pasqyrat individuale, pjesë të formatit të konsoliduar.
- *Llogaria nr. 50 “Letra me vlerë”* në shumën 19,363,730,000 lekë, paraqet investimin në letra me vlerë (Bono Thesari me afat 12 mujor dhe Obligacione me afat 2-3 vjeçar). Ky zë del paraqitet vetëm në pasqyrën individuale të Buxhetit të Përgjithshëm. Në krahasim më një vit më parë investimi në letrat me vlerë është rritur me 7,424,490,000 lekë.
- *Llogaria nr. 532 “Vlera të tjera”* paraqitet në shumën 21,388,125 lekë. Ky zë përfaqëson gjendjen e llogarisë së fondit rezervë e çelur në Bankën e Shqipërisë, e cila krijohet nga interesat e investimeve të fondit rezervë. Në krahasim me një vit më parë ky zë është zvogëluar në shumën 811,262,665 lekë(kjo sepse në këtë llogari kalojnë titujt financiarë që maturohen sipas afateve, dhe vitin kaluar ka pasur një titull financiar konkretisht Bono Thesari, që është maturuar në fund të muajit dhjetor. Kjo shumë konfirmohet me anë të shkresës nr. 161, datë 05.01.2023 të Drejtorisë së Operacioneve me Thesarin, pranë MFE
- *Llogaria nr. 54 “Akreditiva dhe paradhënie (POSTA SHQIPTARE”* paraqitet në shumën 749,630,487 lekë dhe përfaqëson gjendjen e paradhënies në Postën Shqiptare, për shërbimin e ofruar për pagimin e pensioneve, shërbim ky referuar marrëveshjes nr. 4537/1932 datë 21.08.2008 midis ISSH dhe Postës. Në krahasim me një vit më parë ky zë është zvogëluar në shumën 77,921,837 lekë. Kjo shumë është sa shumatorja aritmetike e këtij zëri në pasqyrat individuale të 12 DRSH-ve, konfirmuar kjo me akt rakordimin e datës 10.01.2023, të konfirmuar nga të dy titullarët e institucioneve.

Gjendje Inventari qarkullues. Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të konsoliduar të ISSH-së më 31.12.2021 paraqitet në vlerën 43,620,193lekë dhe përbëhet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në vlerën 14,734,384lekë, nga llogaria “Mallra” në vlerën 28,885,809lekë .

Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën 774,421 lekë e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit”.

Tabela nr.2: “Inventari qarkullues”

Referenca e llog	EMËRTIMI	Lekë		
		Viti 2022	Viti 2021	Diferenca (22-21)
	2.Gjendje Inventari qarkullues	43,620,193	42,845,771	774,421
31	Materiale	14,734,384	13,987,520	746,864
35	Mallra	28,885,809	28,858,251	27,557

Burimi i të dhënave ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit

Llogaria 31 “Materiale”, ka vlerën 14,734,384 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2022 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.3: “Lëvizjet e llogarisë Materiale”

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2022	13,987,520
Blerjet gjatë vitit 2022	7,869,550
Dalje nga magazina gjatë vitit 2022	7,122,685
Gjendja në 31.12.2022	14,734,385

Burimi i të dhënave ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit

Llogaria 35 “Mallra”, ka vlerën 28,885,809 lekë dhe lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2022 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.4: “Lëvizjet e llogarisë Mallra”

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendje në 01.01.2022	28,858,252
Blerjet gjatë vitit 2022	27,557
Dalje nga magazina gjatë vitit 2022	
Gjendja në 31.12.2022	28,885,809

Burimi i të dhënave ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” & “Të tjera aktive afatshkurtra” përbëhet nga:

Tabela nr.5: “Llogari të arkëtueshme ”

Referenca e Llogarive	EMËRTIMI	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca
				(2022-2021)
	3.Llogari te Arketueshme	20,503,334,457	17,392,708,952	3,110,625,505
411	Kliente e llogari te ngjashme	17,102,469	19,434,828	-2,332,359
423,429	Personeli, paradhënie, deficite, gjoba	2,478,446	2,622,345	-143,899
44	Institucione te tjera publike(B.Shqipërisë)	2,423,385,806	1,267,676,190	1,155,709,616
468	Debitorë te ndryshëm	29,288,900	13,111,145	16,177,755
Tjera kl.4	Të tjera kërkesa debitorë (Deb Kontr + Deb Përfitimesh)	6,067,420,273	6,081,846,440	-14,426,168
471	Përfitime për t'u paguar	11,963,658,562	10,008,018,003	1,955,640,559

Burimi i të dhënave ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit

Llogaria 411 “Klientë dhe Llogari të ngjashme”, në fund të vitit 2022 është në vlerën 2,478,446 lekë dhe përfaqëson përfaqëson shumën e detyrimit për t’u arkëtuar për librezat e Sigurimeve Shoqërore që ISSH u ka dhënë DRSSH.

Llogaria 423,429 “Personeli, paradhënie, deficite, gjoba”, në fund të vitit 2022 është në vlerën 17,102,469 lekë. Kjo shumë ka pësuar një rënie më 143,899 lekë, krahasuar me një vit më parë.

Llogaria 44 “Institucione të tjera publike (B. Shqipërisë), në fund të vitit 2022 është në vlerën 2,423,385,806 lekë dhe përfaqëson gjendjen e të ardhurave kontributive të skemës së sigurimeve shoqërore të akumuluar në llogarie të Unifikuar të Thesarit (TSA) në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë deri më 31.12.2022, e cila në janar të vitit 2023 transferohet në shumën 1,147,890,534.04 lekë dhe detyrimin që MFE ka ndaj ISSH-së për fondin e sigurimit shëndetësor shumën 275,495,272 lekë (detyrim i mbartur i llogaritur ndaj FSDKSH-së për shkak të transfertës së munguar nga Thesari i Ministrisë së Financës në llogari të ISSH-së). Krahasuar me një vit më parë kjo vlerë është rritur në masën 1,155,709,616 lekë. Kjo llogari shfaqet vetëm pasqyrën individuale të Buxhetit të Përgjithshëm konfirmuar kjo me aktrakordimin e datës 26.01.2023 ndërmjet MFE-ISSH për gjendjen e TSA dhe FSDKSH-së)

Llogaria 468 “Debitorë të ndryshëm”, në fund të vitit 2022 është në vlerën 29,288,900 lekë dhe përfaqëson shumën e debitorëve me postë, raporte, shpenzime gjyqësore të tjera, etj. Ky zë krahasuar me një vit më parë ka pësuar rritje në shumën 16,177,755 lekë. Kjo vlerë i takon Rajonit Sh.. Nga grupi i auditimit u verifikua llogaria analitike e kësaj llogarie për DRSSH Sh.,

nga ku konfirmohet gjendja e saj më 31.12.2022 e cila është siç paraqitet në Pasqyrën e Pozicionit Financiar Individuale të kësaj DRSSH-je.

Llogaria të tjera klasa 4 “Të tjera kërkesa debitore (Deb Kontr + Deb Përfitimesh), në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 6,067,420,273 lekë dhe përbëhet nga gjendjet më 31.12.2022 të debitorëve për kontribute e kamatat, si dhe debitorët për përfitime. Nga grupi i auditimit u bë verifikimi i tabelave përmbledhëse të dy formularëve përkatësisht formularit “e” *Gjendja e debitorëve për kontribute dhe kamatëvonesa* dhe formulari “f” *Gjendja e përfitimeve të pa tërhequra në fund të vitit*, nga ku rezultoi si më poshtë:

Tabela nr.6“Gjendja e debitorëve për kontribute dhe kamat vonesa”

Llogaria" "	Shuma	Paraqitur në PPF	Dif
Debitorë për Kontribute	747,059,067		
Kamatëvonesa	35,879,295		
Debitorë përfitimesh	5,298,908,079		
Vlera totale ne Fillim te periudhës 31.12.21	6,081,846,440	6,081,846,440	0
shtesat	643,922,095		
Kontribute	295,626,161		
Kamatëvonesa	3,501,828		
Debitorë përfitimesh	344,794,106		
Pakësime	658,348,263		
Kontribute	183,406,274		
Kamatëvonesa	1,532,576		
Debitorë përfitimesh	473,409,413		
Gjendja ne fund të periudhës 31.12.22	6,067,420,273	6,067,420,273	0

Burimi i të dhënave ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit

Nga sa më sipër rezultoi se gjendja e kësaj llogarie është paraqitur saktë dhe rakordon me formularët “f” dhe “e”

Llogaria 471 “Përfitime për t’u paguar”, në fund të vitit 2022 është në vlerën 11,963,658,562 lekë dhe paraqet shumën e detyrimit të MFE-së nga ISSH-së për përfitimet e papaguara në vite.

Krahasuar me një vit më parë kjo shumë është rritur me 1,955,640,559 lekë, për shkak të rritjes së numrit të përfitimeve dhe masës mesatare të përfitimeve.

Të tjera aktive afatshkurtra

Llogaria 486 “Shpenzime te periudhave te ardhshme”, në fund të vitit 2022 është në vlerën 160,114 lekë, në pasqyrën e pozicionit financiar paraqitet si më poshtë, krahasuar me një vit më parë:

Tabela nr.7 “Klasa 4: “Të tjera AASH”

Ref. e Llogarive	Emërtimi	Viti	Viti	Diferenca (2022-2021)
		2022	2021	
	4.Te tjera aktive afatshkurtra	160,114	-	
486	Shpenzime te periudhave te ardhshme	160,114	-	160,114

Burimi i të dhënave ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit

II. Aktivet Afatgjata

Aktivët Afatgjata jo materiale (AAJM),

Tabela nr.8: “AAJM”

Ref e llogarisë	Emërtimi	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca (22-21)
	1.Aktive Afatgjata jo materiale	253,015,620	17,969,187	235,046,433.05
201	Prime te emisionit dhe Rimbursimit te huave	-	-	
202	Studime dhe kërkime	-	-	
203	Koncesione,Patenta,Licenca e te ngjashme	253,015,620	17,969,187	235,046,433.05

Burimi i të dhënave ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit

Në llogaritë e klasës 20, paraqitet vetëm llogaria 203 “Koncesione, Patenta, Licenca e të ngjashme”, që i përketin njësisë së DAQ dhe Drejtorisë së Administrimit.

Ky zë përfaqëson investimin e kryer për Upgrade e sistemit: FMS, PCAMS, CMIS, DMAIS në shumën 238,117,836 lekë. Shuma e paraqitur më 31.12.2022 rezulton të jetë e saktë.

Aktivët e afatgjatave materiale (AAM)

Llogaritë e Klasës 21 “Aktivët Afatgjatave Materiale”, sipas të dhënave të pasqyruara në pasqyrën e pozicionit Financiar të mbyllur më 31.12.2022 paraqiten me vlerën kontabël neto 1,209,506,222 lekë.

Tabela nr.9: “AAM”

ref e llogarisë	Emërtimi	Lekë		
		Viti 2022	Viti 2021	Diferenca 22-21)
	2.Aktive Afatgjatave materiale	1,209,506,222	1,221,286,340	(11,780,117)
210	Toka, Troje, Terrene	29,151,123	29,151,123	-
212	Ndërtesa e Konstruksione	807,038,768	793,120,855	13,917,913
213	Rruge, rrjete, vepra ujore	3,096,248	3,096,248	-
214	Instalime teknike, makineri e pajisje	229,715,422	229,318,297	397,125
215	Mjete Transporti	10,773,560	13,353,848	(2,580,288)
218	Inventar ekonomik	129,731,101	153,245,969	(23,514,867)

Burimi i të dhënave ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit

Në lidhje me këtë kategori të AAM **nuk ka informacion, në shënimet shpjeguese siç parashikohet në kërkesat e SKK 5.**

Llogaria 210 “Toka, Troje, Terrene” paraqitet në të dy vitet në shumën 29,151,123 lekë, e cila përbëhet nga vlera: 22,010,000 për DRSSH K. dhe vlera 7,141,123 lekë për DAQ. Nuk ka pasuar shtime as pakësime të këtij zëri përgjatë vitit 2022, duke qenë se ky grup aktivesh i përket kategorisë “AAM jo objekt konsumi”. Në lidhje me këtë llogari, nga grupi i auditimit u kërkuan dhe u verifikuan dhe titujt e pronësisë të këtyre elementëve, për t’u siguruar në lidhje me kushtin e aktiveve, që është zotërimi ekonomik i tyre. Konkretisht këto konfirmohen si më poshtë:

- Për shumën e paraqitur në pasqyrën individuale të DRSSH K.: Certifikata për vërtetim pronësie nr. 214047, të lëshuar nga ZRPP K.;
- Për shumën e paraqitur në pasqyrën individuale të DAQ: Certifikata për vërtetim pronësie nr. 096280, të lëshuar nga ZRPP T.

Llogaria 212 “Ndërtime konstruksione” paraqitet në vlerë kontabël në shumën 807,038,768 lekë, në vitin paraardhës 2021, vlera totale e tyre paraqitet në shumën 793,120,855 lekë. Për vitin 2022 janë bërë shtesa në shumën 51,320,111 lekë, përkatësisht nga:

- DRSSH B.21,882,445 lekë;
- DRSSH D. 25,965,344 lekë dhe
- DAQ në shumën 3,472,322 lekë

Pakësimet janë për vlerën e Amortizimit (me normën 5%) në vlerën 37,402,198 lekë.

Llogaria 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” në vlerën 3,922,829 lekë paraqet aktive në pasqyrat individuale të DRSSH D. në vlerën 1,450,482 lekë dhe DRSSH Gj. në vlerën 2,472,347 lekë. Kjo kategori paraqet një investim të bërë nga ana e DRSSH-ve të lartpërmendura për shtrimin e rrugës pranë ndërtesës. Kjo paraqitje nga ana e tyre nuk është e saktë pasi nuk përmbushen kushtet e përcaktuara në pikën 8 të SKK 5, në lidhje me kontrollin e aktivitetit. Nga DRSSH-të dhe pse është njohur një element i tillë, nuk është kryer veprim rregullues sipas përcaktimeve të bëra në udhëzimin e MFE nr. 30, datë 27.12.2011 në lidhje me amortizimin e kësaj klase llogarie, por rezulton që në dy vite kjo shumë paraqitet e njëjtë

Llogaria 214 “Instalime teknike, makineri pajisje, vegla pune” paraqitet në vlerën kontabël 229,715,422 lekë. Në vitin paraardhës 2021, vlera kontabël e tyre ka qenë 229,318,297 lekë,

pra rezulton një rritje prej 397,125 leke. Ky zë paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar të DRSSH Sh.. Në lidhje me këtë kategori aktivi rezulton se është përdorur norma e amortizimit 20%, kjo në përputhje me kërkesat e pikës 86 të UMFE Nr.30, datë 27.12.2011. Në mënyrë analitike lëvizjet e kësaj llogarie paraqiten si më poshtë:

Tabela nr.10 “Ndryshimet në llogarinë 214”

Lekë

Emërtimi	Aktivet				Amortizimi				Vlera Mbetur
	Vlera fillestare Gjendje 01.01.2022	Shtesa	Pakësime	Gjendja 31.12.2022	Deri 31.12.2021	2022	Pakësim 2022	31.12.2022	
Mak. e paisje	321,360,920	14,394,310	333,786	335,421,445	92,042,623	13,912,802	249,402	105,706,022	229,715,422

Burimi i të dhënave ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit

Llogaria 215 “Mjete transporti” paraqitet në për vlerën kontabël 10,773,560 lekë dhe krahasuar me një vit më parë ka pësuar një rënie në masën 2,580,288 lekë. Për çdo element të kësaj llogarie është përdorur norma e amortizimit 20%, mbi vlerën e mbetur, në përputhje me kërkesat e Udhëzimit nr.8, datë 09.03.2018. Llogaria 215 është e zbërthyer në mënyrë analitike dhe e rakorduar me inventarët e kryer.

Llogaria 218 “Inventar ekonomik” paraqitet me vlerën kontabël 129,731,101 lekë, krahasuar me një vit më parë kjo llogaria është ulur në masën 23,514,867 lekë ku ndryshimet e kësaj llogarie në mënyrë të përmbledhur përgjatë vitit 2022 paraqitet si më poshtë:

Tabela nr.11 “Ndryshimet në llogarinë 218”

Lekë

Emërtimi	Vlera fillestare Gjendje 01.01.2022	Shtesa	Pakësime	Gjendja 31.12.2022	Amortizimi				Vlera Mbetur
					Deri 31.12.2021	Viti 2022	Pakësime 2022	Datë 31.12.2022	
Inventar ekonomik	671,313,552	9,066,175	15,733,959	664,645,768	518,066,033	33,456,367	16,777,734	534,744,666	129,731,101

Burimi i të dhënave ISSH, Pasqyrat Financiare të Vitit 2022

PASIVET (DETYRIMET)

Pasivet Afatshkurtra

Tabela nr.12: “Pasivet Afat shkurtra”

Lekë

ref e llogarisë	Emërtimi	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca 22-21
		I.Pasivet Afat shkurtra	18,253,216,192	7,408,635,004
	1. Llogari te Pagueshme	25,500,649,245	16,498,615,108	9,002,034,137
401-408	Furnitorë e llogari te lidhura me to	18,142,477	20,888,929	(2,746,452)
42	Detyrime ndaj personelit	6,697,228	69,390,552	(62,693,324)
16,17,18	Hua Afatshkurtra	-	133,307	(133,307)
431	Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa	7,836,211	6,364,125	1,472,086
435	Sigurime Shoqërore	22,893,060	21,887,164	1,005,896
436	Sigurime Shëndetësore	1,034,869	949,845	85,024
44	Institucione te tjera publike	126,322	123,150	3,172
470	Të ardhura për t'u marrë (Deb .për kontribute dhe për përfitime)	6,067,420,273	6,081,846,440	(14,426,168)
464	Detyrime (Kreditore për përfitime të pa tërhequra)	19,064,157,092	10,008,018,003	9,056,139,089
466	Kreditore për mjete ne ruajtje (FSKDSH)	223,493,214	221,606,762	1,886,453

Burimi i të dhënave ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit

Llogaritë 401-408, “Furnitorë dhe llogari të lidhura e to”, paraqet detyrimet që kanë DRSSH në lidhje mallra dhe shërbimet e marra nga ISSH. Vlera e tyre në Bilancin Kontabël të datës 31.12.2022 paraqitet 18,142,477 lekë dhe krahasuar më një vit më parë kjo vlerë ka rënë më 2,746,452 lekë. Në këtë zë paraqiten të ardhurat e mbledhura nga shitja e librezave, që do të derdhen në Drejtorisë se Përgjithshme (Buxhetit te Brendshëm) për librezat pensionesh.

Llogaria 42 “Detyrime ndaj personelit” përfaqëson përfaqëson detyrimet e njësisve në lidhje me pagat dhe shpërblimet e punonjësve, janë detyrimet që i përkasin muajit dhjetor 2022, e do të paguhet në fillim të muajit pasardhës.

Llogaria 16;17;18, “Hua afatshkurtra”, paraqitet në vlerën 0 lekë nga 133,307 lekë që ka qenë një vit më parë. Kjo llogari lidhej me tatimin në burim, për këtë janë bërë sistemet përkatëse në vitin 2022.

Llogaria 431, “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa” paraqitet në vlerën 7,836,211 lekë, nga verifikimi i llogarive analitike në secilën prej pasqyrave individuale rezultoi se vlera e konsoliduar paraqet saktë shumën individuale.

Llogaria 435 dhe 436 “Sigurime shoqërore dhe Shëndetësore”, paraqet detyrimin e njësisve, pjesë e pasqyrave të konsoliduara në lidhje me kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, të muajit dhjetor 2022. Për verifikimi e saktësisë dhe plotësisë të kësaj vlera nga grupi i auditimi u verifikua lista analitike për çdo njësi, pjesë e pasqyrave individuale dhe u verifikuan listë pagesat e muajit dhjetor 2022.

Llogari 44 “Institucione te tjera publike” në shumën 126,322 lekë, përfaqëson shumën e 2(dy) përqind të sigurimit vullnetar, e cila paraqitet vetëm në Pasqyrën individuale të DRSSH Shkodër. Krahasuar me një vit më parë është rritur në masën 3,172 lekë.

Llogaria 470 “Të ardhura për t'u marrë (Deb. për kontribute dhe për përfitime)”. Në fund të vitit 2022 është në vlerën 6,067,420,273lekë dhe përfaqëson debitorët për kontribute në shumën 859,278,954 lekë dhe kamatë 37,848,547 lekë, dhe debitorët për përfitime janë në shumën 5,170,292,772 lekë. Krahasuar me një vit më parë kjo vlerë është rritur në masën 14,426,167 lekë. Kjo llogari përmbledh shumën e lekëve të marra më tepër për debitorët nga MFE.

Llogaria 464 “Detyrime (Kreditore për përfitime të pa tërhequra) në fund të vitit 2022 është në vlerën 19,064,157,092 lekë, kjo llogari përfaqëson shumën e detyrimit të ISSH-së ndaj pensionistëve sipas llojit të përfitimeve. Në këtë llogari janë të përfshira edhe shpërblimet e pa tërhequra ndër vite, e cila në bilancin e vitit të mëparshëm është pasqyruar në llogarinë 480 “Të ardhura për t'u klasifikuar apo rregulluar” në vlerën 1,754,086,431 lekë, kjo shumë ka kaluar tek llogaria 464, veprim rregullues i konfirmuar dhe nga ana e MFE.

Llogaria 466 “Kreditorë për mjete në ruajtje (FSKDSH)” paraqitet në shumën 223,493,214 lekë dhe nga verifikimi i saktësisë së paraqitjes së kësaj shumë rezultoi se shuma është paraqitur saktë prej konsolidimit të PF individuale. Kjo shumë rezulton të jetë sa shuma e dërguar në “Aktrakordimin për muajin dhjetor dhe progresiv të vitit 2022”, të FSDKSH të dërguar me anë të shkresës nr. 364, datë 26.01.2023.

Kreditore të ndryshëm dhe Kreditorë për përfitime të pa tërhequra

Tabela nr.13: “Kreditore të ndryshëm

Referenca e Llogarive	Emërtimi	Lekë		Diferenca (2022-2021)
		Viti 2022	Viti 2021	
467	Kreditorë të ndryshëm	88,848,500	67,406,831	21,441,669
467/1	Kreditorë të ndryshëm	88,848,500	67,406,831	21,441,669

Burimi i të dhënave ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit

Llogaria 467 “Kreditorë të ndryshëm” paraqitet në fund të vitit 2022, në shumën 88,848,500 lekë, e cila përfaqëson kreditorë të ndryshëm, ku peshën kryesore e zënë shpenzimet e papaguara të Postës (komisionet), në fund të muajit dhjetor dhe shpenzimet utilitare(energja, uji, etj.). Krahasuar me një vit më parë kjo shumë është rritur në shumën 21,441,669 lekë, kjo pasi me rritjen e pensioneve, rritet shuma e përfitimeve dhe për rrjedhojë dhe komisioni i pagesës nga postës.

Të tjera pasive afatshkurtra

Tabela nr.14: “Të tjera pasive afatshkurtra”

Lekë

Referenca e Llogarive	Emërtimi	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca (2022-2021)
	2.Te tjera pasive afatshkurtra	161,201,951	1,754,601,084	-1,593,399,134
419	Kreditore, Parapagime	547,647	514,653	32,994
475	Te ardhura për t'u regjistruar vitet pasardhëse	160,654,303	-	160,654,303
480	Te ardhura për tu klasifikuar ose rregulluar		1,754,086,431	-1,754,086,431

Burimi i të dhënave ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit

Llogaria 419 “Kreditorë, parapagime” Kjo llogari, në fund të vitit 2022 paraqitet në shumën 547,647 lekë, e cila paraqet shumën e 2(dy) përqind të sigurimit vullnetar. Kjo shumë paraqitet vetëm në pasqyrat individuale të DRSSH-ve: B., Du. e Di.. Krahasuar me një vit më parë është rritur në masën 32,994 lekë.

Llogaria 475 “Të ardhura për t’u regjistruar në vitet pasardhëse” në fund të vitit 2022 rezulton të jetë 160,654,303 lekë, e cila paraqet interesat për investimin në Bono Thesari dhe Obligacione, ku investimi është bërë në vitin 2022.

Kjo shumë një vit më parë nuk ka qenë në pasqyrat financiare sepse investimi i tyre është bërë brenda vitit.

Llogaria 480 “Të ardhura për t’u klasifikuar ose rregulluar”,

Në këtë llogari përfshihen shpërblimet e pa tërhequra ndër vite, të cilat në bilancin paraardhës kanë qenë të pasqyruara në llogarinë 480 në shumën 1,754,086,431 lekë. Kjo shumë me konfirmimin e MFE (trajtuar dhe më lart në projekt raport) është xhiruar tek llogaria 464.

Pasivet afatgjata në pasqyrën financiare të konsoliduar, rezultojnë në fund të vitit 2022 dhe 2021 në shumën zero lekë.

C. Fondet Neto

Tabela nr.15 “Fondet neto”

Lekë

Referenca e Llogarive	Emërtimi	Viti 2022	Viti 2021	Diferenca 22-21
103	Fondi neto	36,964,924,994	31,249,203,915	5,715,721,080
101	Teprica Fondi akm./Def.i akumuluar	1,454,396,228	1,230,383,047	224,013,182
12	Rezultatet e mbartura	17,794,447,530	14,292,405,360	3,502,042,170
85	Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore	5,491,707,898	4,667,443,187	824,264,711
111	Rezerva	12,224,373,338	11,058,972,321	1,165,401,017

Burimi i të dhënave ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit

Llogaria 101 “Teprica (Fondi i akumuluar) deficiti i akumuluar”, tregon lëvizjet e aktiveve afatgjata: shtesat, blerjet, nxjerrjet jashtë përdorimit, konsumin dhe ndryshimin e gjendjes (llogaria 603). Kjo llogari është e pasqyruar në pasqyrën e Pozicionit Financiar si edhe Pasqyrën 7(P 7) “Gjendja dhe ndryshimet e Aktiveve Afatgjata me Kosto Historike dhe Vlerë neto”. Në fund të vitit 2022 paraqitet në shumën 1,454,396,228 lekë dhe në krahasim më një vit më parë është rritur me 224,013,182 lekë.

Llogaria 12 “Rezultate të mbartura” Në fund të vitit 2022 rezulton të jetë në shumën 17,794,447,530 lekë, e cila në krahasim më një vit më parë është rritur me 3,502,042,170 lekë, veprim i cili është bërë në zbatim të Vendimit nr. 18 date 27.12.2022 të KA “Për miratimin e Rezultatit Financiar të ISSH për vitin 2021”.

Llogaria 85 “Rezultati i Veprimtarisë Ushtrimore” paraqitet në shumën 5,491,707,898 lekë, dhe nga verifikimi rezultoi se kjo shifër është e njëjtë me atë të paraqitur në Pasqyrën e performancës në të dy vitet.

Llogaria 111 “Rezerva” paraqitet në shumën 12,224,373,338 lekë. Në vitin 2022 është rritur me 1,165,401,017 lekë, krahasuar me vitin 2021, shumë e cila është caktuar për plotësimin e normativës së Fondit Rezervë, Miratuar me Vendimin nr. 18 datë 27.12.2022 të KA “Për miratimin e Rezultatit Financiar të ISSH-së për vitin 2021”. Kjo në zbatim të nenit nr. 70 të Ligjit nr 7703, datë 11.05.1993” Për Sigurimet Shoqërore në RSH”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Instituti i Sigurimeve Shoqërore krijon një fond rezervë që të mbulojë të paktën 1 muaj shpenzimet për pensione”.

Pasqyra e konsoliduar e Performancës Financiare (F2)

Pasqyra e performancës Financiare përfshin të gjithë zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve të njohura gjatë periudhës kontabël.

Kjo pasqyrë për njohjen e elementëve të të ardhurave dhe shpenzimeve është mbështetur në kërkesat e pikës 8 të Udhëzimit të MFE nr.8, datë 09.03.2018, konkretisht:

- Shpenzimet janë njohur në çastin e ndodhjes së tyre dhe
- Të ardhurat në çastin e arkëtimit të tyre, pra me bazë cash.

Të ardhurat e realizuara nga 15 njësitë, pjesë e pasqyrës së konsoliduar gjatë vitit 2022 janë në shumën 168,528,421,338 lekë, ku të ndara sipas kategorive paraqiten si më poshtë:

Tabela nr.16 “Të ardhurat e realizuara”

Emërtimi	Lekë	
	2022	2021
I.Te ardhurat nga taksat e tatimet	-	-
II.kontribute sigurime shoqërore e shëndetësore	108,871,578,989	98,771,690,445
III. Të ardhura jo tatimore	852,304,538	761,388,515
IV.Të ardhura financiare	344,444,065	196,431,051
V.Grante korentë	58,460,093,746	52,967,791,796
Totali	168,528,421,338	152,697,301,807

Burimi i të dhënave ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit

Të ardhurat nga Kontributet e Sigurimeve Shoqërore dhe Shëndetësore për vitin 2022 paraqiten në shumën 108,871,578,989 lekë, të cilat janë rakorduar me akt-rakordim nr738 datë 27.01.2023 “Mbi rakordimin e të ardhurave të realizuara nga kontributet për Sigurimet Shoqërore nga DPT për vitin 2022”.

Tabela nr.17 “Kontributet sigurimeve shoqërore e shëndetësore”

Ref e llog	Emërtimi	Lekë	
		2022	2021
75	II. kontribute sigurime shoqërore e shëndetësore	108,871,578,989	98,771,690,445
750	Nga te punësuarit	37,541,456,107	33,689,551,590
751	Nga punëdhënësi	60,661,118,480	54,252,649,300
752	Nga te vet punësuarit	3,449,434,638	3,314,303,447
753	Nga fermerët	2,234,395,062	2,088,601,117
754	Nga sigurimet vullnetare	573,359,449	500,627,787
755	Kontribute nga buxheti për sigurime shoqërore	4,411,815,254	4,925,957,204
756	Kontribute nga buxheti për sigurime shëndetësore	-	-

Burimi i të dhënave ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit

Të ardhurat nga ndërmarrjet dhe pronësia paraqesin të ardhurat nga qiraja e ndërtesës për shumën 46,800 lekë dhe qiraja nga makineta e kafes e vendosur në ambientet e DAQ në shumën 25,560 lekë.

Tabela nr.18 “Të ardhura nga ndërmarrjet dhe pronësia”

Lekë

Ref e llog	Emërtimi	2022	2021
		1.Nga ndërmarrjet dhe pronësia	72,360
7100	Nga Ndërmarrjet publike jo financiare	-	-
7101	Nga Ndërmarrjet publike financiare	-	-
7109	Te tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia	72,360	46,250

Burimi i të dhënave ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit

Të ardhurat nga shërbimet administrative dhe të ardhurat sekondare paraqesin të ardhura, që lidhen me interesat kreditore të llogarisë bankare, konfirmuar kjo me anë të statement bankar.

Tabela nr.19 “Të ardhurat nga shërbimet administrative dhe të ardhurat sekondare”

Lekë

Ref e llog	Emërtimi	2022	2021
		163,036,713,439.58	148,029,812,370
711	2.Sherbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare	559,729,114	761,296,015
7110	Tarifa administrative dhe rregullatore	-	-
7111	Te ardhura sekondare e pagesa shërbimesh	350,686	315,944
7112	Takse për veprime gjyqësore e noteriale	-	-
7113	Te ardhura nga shitja e mallrave e shërbimeve	-	-
7114	Te ardhura nga biletat	-	-
7115	Gjoha, kamatëvonesa, sekuestrime e zhdëmtime	559,358,020	477,389,142
7116	Te ardhura nga transferimi pronës, legalizimi i ndërtimeve pa leje	20,408	-

Burimi i të dhënave ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit

Të ardhurat jo tatimore

Të ardhurat jo tatimore përfaqësojnë ndalesat debitore të pensioneve dhe janë rritur në masën 8,912,135 lekë. Shuma e paraqitur në PASH e konsoliduar, rezulton të jetë e saktë.

Tabela nr.20 “Të ardhurat jo tatimore”

Lekë

Ref e llog	Emërtimi	2022	2021	Diferenca
719	3.Te tjera te ardhura jo tatimore	292,503,064	283,590,929	8,912,135

Burimi i të dhënave ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit

Të ardhurat financiare të realizuara përgjatë vitit 2022 janë 344,444,065 lekë dhe paraqesin të ardhura nga interesat e depozitave dhe të ardhurat nga interesat e investimeve në Bono Thesari dhe Obligacione. Shumë kjo konfirmohet nga bankat e nivelit të dytë dhe Banka e Shqipërisë.

Tabela nr.21 “Të ardhurat Financiare”

Lekë

Ref e llog	Emërtimi	2022	2021	Diferenca
76	IV. Te ardhura financiare	344,444,065	196,431,051	148,013,014

Burimi i të dhënave ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit

Të ardhurat nga Granti korrent i brendshëm paraqiten në shumën 58,460,093,746 lekë përgjatë vitit 2022 dhe përfaqësojnë të hyra nga buxheti i shtetit si transfertë dhe grant buxhetor të transferuar nga MFE dhe MB, konfirmuar edhe me Akt-rakordimin me nr. 160, datë 09.01.2023.

Tabela nr.22“Të ardhurat nga shërbimet administrative dhe të ardhurat sekondare”

Lekë

Ref e llog	Emërtimi	2022	2021	Diferenca
720	1.Grant korrent i Brendshëm	58,460,093,746	52,967,791,796	5,492,301,950

Zëri Shpenzime

Tabela nr. 23 “Shpenzimet në Pasqyrën e Performancës të konsoliduar të ISSH,”

Lekë

Ref llog	Emërtimi	2022	2021	Diferenca
B	SHPENZIMET	163,036,713,440	148,029,812,370	15,006,901,070
600	I.PAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE	1,075,596,779	996,319,202	79,277,577
6001	Paga, personel I përhershëm	942,001,008	880,842,490	61,158,518
6002	Paga personel I përkohshëm	24,944,231	26,249,561	- 1,305,330
6003	Shpërblime	30,192,309	22,256,421	7,935,888
6009	Shpenzime te tjera për personelin	78,459,231	66,970,730	11,488,501
601	II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE	168,510,087	158,538,425	9,971,661
6010	Kontributi I Sigurimeve Shoqërore	157,812,285	147,694,251	10,118,034
6011	Kontributi I Sigurimeve Shëndetësore	10,697,802	10,844,175	- 146,373
602	III.BLERJE MALLRA E SHERBIME	1,265,626,591	1,219,178,336	46,448,255
6020	Materiale zyre e te përgjithshme	27,297,057	29,562,042	- 2,264,985
6021	Materiale dhe shërbime speciale (Posta)	688,507,901	541,595,993	146,911,908
6022	Shërbime nga te trete	337,504,087	451,227,030	- 113,722,943
6023	Shpenzime transporti	10,004,458	8,875,746	1,128,712
6024	Shpenzime udhëtimit	25,960,372	20,248,332	5,712,040
6025	Shpenzime për mirëmbajtje te zakonshme	113,062,852	96,584,548	16,478,304
6026	Shpenzime për qiramarrje	22,367,852	20,198,671	2,169,181
6027	Shpenzime për detyrime për kompensime legale	10,261,245	8,232,977	2,028,268
6029	Shpenzime te tjera operative	30,660,766	42,652,997	- 11,992,231
603	IV.SUBVECIONE	-	12,833,923	- 12,833,923
	V.TRANSFERIME KORRENTE	160,213,625,624	145,617,600,956	14,596,024,668
604	1.Transferime korrente te brendshme	-	-	-
605	2.Transferime korente me jashtë	1,828,288	1,774,192	54,096
6051	Transferime për Organizatat Ndërkombëtare	1,828,288	1,774,192	54,096
606	3.Transferime për Buxhetet familjare e Individë	160,211,797,336	145,615,826,764	14,595,970,572
6060	Transfertë te paguara nga ISSH e ISKSH	160,211,797,336	145,615,826,764	14,595,970,572
	VI.SHPENZIME FINANCIARE	-	-	-
	IX.SHPENZIME TE TJERA (INVESTIME)	313,354,359	38,175,450	275,178,909

Burimi i të dhënave ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit

Shpenzimet e paraqitura në Pasqyrën e Performancës Financiare të konsoliduar të ISSH-së, të realizuara nga 15 njësitë shpenzuese , gjatë vitit 2022 janë në shumën 163,036,713,440 lekë, ku të ndara sipas kategorive paraqiten si më poshtë:

Llogaritë e klasës 600 “Pagat dhe përfitimet e punonjësve” në shumën 1,075,596,779 lekë përbëhen nga:

- Llogaria 6001 “në shumën 942,001,008 lekë. Për këtë kategori, gjatë vitit 2022 është bërë dhe rakordimi me strukturën dhe numrin e punonjësve në ISSH.
- Llogaria 6002 “Pagat Personel i përkohshëm” në shumën 24,944,231 lekë. Për këtë kategori pagash janë bërë dhe rakordimet për numrin dhe kategorinë e punonjësve mes DRSSH-ve dhe ISSH.
- Llogaria 6009, “Shpenzime të tjera për personelin” paraqitet në shumën 78,459,231 lekë, shumë e cila përfshin pagesat për pjesëmarrje në komisionin e mjekëve të KMCAP në ISSH dhe në DRSSH.
- Llogaria 6003, “Shpërblime personeli” paraqitet në shumën 30,192,309 lekë, e cila përfshin shpenzimet për: “Shpërblime për rezultate në punë” (Honorare të bujkut), dhe Llogarisë “Të tjera shpërblime për personelin (Fondi i veçantë).
- Në llogarinë Shpërblime për personelin “Fondi i veçantë” janë të pasqyruara shpenzimet për pjesëmarrje në kontributin për fondin e sigurimit vullnetar suplementar të punonjësve të anëtarësuar në shoqëritë private të pensioneve bazuar në VKM nr. 24 datë 23.12.2014, “Për aderimin e punonjësve të Institutit të Sigurimeve Shoqërore në një fond të pensionit vullnetar” si edhe në bazë të shkresave të dala për shpërblimin e punonjësve me rastin e daljes në pension pleqërie, në rastin e një ndërhyrjeje kirurgjikale ose të një trajtimi të gjatë

shëndetësor dhe në rastin e një fatkeqësie (vdekjes) së një anëtari të familjes së punonjësit (bashkëshorti/ja, prindërit apo fëmijët).

Llogaria 601 “ Kontribute për Sigurime Shoqërore dhe Shëndetësore” paraqitet në shumën 168,510,087 lekë, e cila është llogaritur në përputhje me kërkesat e akteve ligjore në fuqi.

Llogaria 602 “ Mallra dhe shërbime të tjera” paraqitet në shumën 1,265,626,591 lekë, ku peshën specifike më të lartë e zë zëri “Materiale dhe shërbime speciale (Posta)”, në shumën 688,507,901, i cili llogaritet mbi shumën e përfitimeve të paguara nga agjentët pagues (Posta) sipas marrëveshjes mes tyre edhe zëri “ Shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme” , në shumën 113,062,852 lekë, i cili përfshin shpenzime për “ Mirëmbajtje e zakonshme e kompjuterëve, vegla, aparate” , si shpenzime të kontraktuara të mirëmbajtjes së sistemeve informatike PCAMS (sistemi i pensioneve), FMS (sistemi i administrimit financiar, DMAIS (sistemi i administrimit dhe digjitalizimit të arkivave), Sistemi i administrimit të personelit dhe të lëvizjes së informacionit të brendshëm. Shuma e konsoliduar e paraqitur në PASH rezulton të jetë e saktë (mbledhja nga PF-të individuale dhe pagesat nga banka).

Llogaria 605 “ Transferime për organizatat Ndërkombëtare” paraqitet në shumën 1,828,288 lekë, e cila përfaqëson shumën e kontributit vjetor që i paguhet ISSA-s, për anëtarësimin në këtë organizatë. Kjo shumë për vitin 2022 konfirmohet me anë të urdhërshirimit bankar.

Kategoria “Shpenzime financiare të tjera (Investime)” paraqitet në shumën 313,354,359 lekë, e cila përfshin:

- Investimin për Upgrade-in e sistemit të ISSH Llogaria 230;
- Investimet për rikonstruksione ndërtesa dhe inventar ekonomik, Llogaria 231.

Kjo shumë rezulton të jetë e paraqitur saktë në PASH e konsoliduar.

Llogaria 606 “ Transfertë në buxhetet familjare dhe individët”, paraqitet në shumën 160,211,797,426 lekë dhe përfshin:

- Shpenzimet për skemën e detyrueshme të pensioneve
- Shpenzimet për skemën suplementare
- Shpenzimet për Programet e veçanta të qeverisë.

C. Pasqyra e konsoliduar e Cash Flow

Pasqyra e fluksit të mjeteve monetare tregon hyrjet dhe daljet e mjeteve monetare në një njësi ekonomike gjatë periudhës, duke mundësuar dhënien e informacionit në lidhje me ndryshimet në mjetet monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare të një njësie ekonomike për një periudhë raportuese, duke treguar veçmas ndryshimet e aktiviteteve të shfrytëzimit, aktivitetet investuese dhe ato të financimit. Kjo pasqyrë, nga ana e ISSH-së është përgatitur sipas metodës direkte. Ku gjatë vitit 2022 rezulton se:

- Nga aktiviteti i shfrytëzimit:

Flukset hyrëse kanë qenë 109,028,255,859 lekë

Flukset dalëse në shumën (157,621,118,056)

- Nga aktiviteti Investues

Flukset hyrëse kanë qenë 7,424,490,000 lekë

Flukset dalëse në shumën 0 lekë

Në mënyrë të detajuar shumat përkatëse paraqiten si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 24 “Cash Flow,”

Nr. Rubrike	Përmbajtja	Lekë	
		Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi paraardhës
(b)	(c)	2022	2021
I	VEPRIMTARITE E SHFRYTEZIMIT	9,867,231,550	6,599,015,989

1	Akordim Fonde Buxhetore për shpenzime korrente (+)	58,460,093,746	52,967,791,796
2	Arkëtime e te hyra (Cash), gjate vitit ushtrimor	109,028,255,859	101,690,769,826
	Te Hyra nga Tatimet e Doganat tatimore e Doganore(+)		
	Te hyra nga Kontributet e Sig. shoq. e shëndet(+)	109,435,579,940	99,249,106,317
	Te hyra nga ardhurat jo tatimore (+)	292,946,518	-
	Te hyra, Sponsorizim nga te trete,(+)		283,953,123
	Te hyra, nga kredi e huamarrje afatshkurtër(+)		
	Te hyra nga Mjetet ne ruajtje(+)	-	1,961,279,336
		1,044,714,663	
	Te tjera, arkëtuar(+)	344,444,065	196,431,051
3	Pagesa për Detyrime e Shpenzime korrente	-	-
	Për detyrime e Shpenzime nga vitet e kaluara(-)	-	
	Për detyrime e Shpenzime te vitit ushtrimor(-)	-	-
		163,036,713,440	148,029,812,370
	Pagesat për mjetet ne ruajtje(-)	5,337,673,547	22,497,236
	Interesi I paguar(-)		-
	Tatime te paguara(-)		-
	Te tjera te paguara (-)	77,921,837	52,230,500
II	VEPRIMTARITE E INVESTIMEVE	7,424,490,000	-
			672,400,000
	Akordim Fonde Buxhetore për shpenzime Kapitale (+)	7,424,490,000	672,400,000
III	TRANSFERTA TE TJERA	-	-
	Derdhje e Transferime te te Ardhurave ne Buxhet(-)	-	
	Transferime ne buxhet te Fondeve te papërdorura(-)	-	
	Lëvizje e brendshme e transferta te tjera(+/-)	-	
IV	Rritja /Rënia neto e Mjeteve monetare	-	-
V	Teprica ne fillim te vitit ushtrimor	18,060,817,532	10,789,401,544
VI	Teprica ne fund te vitit ushtrimor	20,503,779,096	18,060,817,533

Burimi i të dhënave ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit

Sa më sipër rezulton se shuma e mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të mjeteve monetare paraqitet e njëjtë me atë të paraqitur tek pasqyra e pozicionit financiar, konkretisht si më poshtë:

Tabela nr.26 “Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të datës 31.12.2022”

	Lekë
Përshkrimi	Shuma në P. Pozicionit Financiar më 31.12.22
Mjete monetare ne Arkë	140,973.0
Mjete monetare ne Bankë	20,482,249,997.5
Vlera të tjera	21,388,125.5
Xhirime të brendshme midis njësive organizative	20,503,779,095.9

Burimi i të dhënave ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit

d. Pasqyra statistikore nr. 7.a dhe 7.b “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (me koston historike të tyre dhe vlerë neto).

Plotësimi i Pasqyrës së Statistikore “Gjendja dhe ndryshimet e AAGJ me kosto historike” është bërë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, Kapitulli III, pika 3.8.2 “Rregullat për plotësimin e pasqyrës statistikore mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (me koston historike të tyre)” dhe pikës 3.8.3 “Rregulla për plotësimin e pasqyrës statistikore mbi gjendjen dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (me vlerën neto të tyre)”.

Tabela nr. 26 “Ndryshimet e AAGJ-ve gjatë 2022”

Nr	Aktivet afatgjata	Kosto historike
I	Gjendja në fillim	1,239,255,528
II	Shtesa gjatë vitit	223,615,924
III	Pakësime gjatë vitit	349,609
IV	Gjendja në fund	2,751,070,524

Burimi i të dhënave ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit

e. Pasqyra statistikore nr. 8 “Numri i punonjësve dhe Fondi i pagave”.

Në këtë pasqyrë është dhënë informacion mbi numrin e punonjësve, fondin e pagave, kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, si dhe tatimin mbi të ardhurat.

Plotësimi i Pasqyrës së Statistikore “Numri i punonjësve dhe fondin e pagave” është bërë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018, Kapitulli III, pika 3.8.4 “Rregulla për plotësimin e pasqyrës statistikore mbi numrin e punonjësve dhe fondin e pagave”.

Tabela nr. 27 “Pasqyra statistikore nr. 8”

Nr.	Kategoria	Nr. mes	Pranuar të rinj	Larguar gjatë vitit	Gjendja në fund	Fondi i pagave	Ndihma	Kontribute	Tatim mbi të ardhurat
1	Drejtues	208	15	15	209	238,296,965	7,060,514	37,687,281	18,143,457
2	Spec.arsim të lartë	774	64	66	772	591,210,127	10,088,250	100,664,393	29,399,761
3	Teknikë	169	8	12	165	51,329,563	10,341,108	15,623,763	4,016,414
4	Nëpunës të thjeshtë	48	3	2	50	43,570,988	1,289,994	7,787,923	2,895,349
5	Punëtorë	34	3	4	33	17,593,364	160,897	3,000,185	397,108
6	Punonjës të përkohshëm	47	6	3	48	24,944,231	114,900	3,746,541	710,813
	Shuma	1,280	99	102	1,277	966,945,239	29,055,663	168,510,087	55,562,902

Burimi i të dhënave ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit

Pasqyra e pozicionit Financiar hartohet mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara për periudhën raportuese, ndërsa akt rakordimi me degën e thesarit paraqet shpenzimet faktike të kryera gjatë vitit ushtrimor.

Tabela nr.28 “Llogaritë analitike të llogarisë klasës 600”

Në lekë

Nr. llog.	Emërtimi	Bilanci 2022
600	Pagat dhe përfitimet e punonjësve	966,945,239
6010	Kontributi i Sigurimeve Shoqërore	157,812,285
6011	Kontributi i Sigurimeve Shëndetësore	10,697,802

Burimi i të dhënave ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit

Fondi i pagave referuar akt rakordimit me degën e thesarit, përfaqëson pagat e punonjësve për periudhën dhjetor 2021-nëntor 2022, ndërkohë që të dhënat e bilancit 2022 pasqyrojnë konstatimin e pagave bruto/borderotë e muajve janar-dhjetor 2022. Nga krahasimi i të dhënave midis pasqyrave F2 dhe F8 rezulton si vijon:

Tabela nr.29 “Llogaritë analitike të llogarisë klasës 600”

Në lekë

Nr. llog.	Emërtimi	Formati nr.2 i Bilancit viti 2022	Formati nr.8 i Bilancit viti 2022	Diferenca
600	Pagat dhe përfitimet e punonjësve	966,945,239	966,945,239	0

Burimi i të dhënave ISSH, përpunuar nga Grupi i auditimit

Drejtimi i auditimit nr. III.2.9.

Tabela nr.9.1: Të dhëna për burimet njerëzore të auditit të brendshëm për vitin 2022

Nr.	Emër Mbiemër	Pozicioni	Arsimi Bazë	Niveli i Diplomës	Vite pune gjithsej	Vitet e punës në DAB	Certifikimi	Trajnime nga NJQAB
1	P. B.	Drejtor	Fak. Ekonomik	Master	38	5	2019	40 orë/vit
2	A. B.	Kryetar Dege	Fak. Ekonomik	Master	35	11	2008	40 orë/vit
3	M. T.	Auditues	Fak. Ekonomik	Master	15	9	2009	40 orë/vit
4	Sh. B.	Auditues	Fak. Ekonomik	Master	20	9	2021	40 orë/vit
5	G. B.	Auditues	Fak Ek/Juridik	Master	13	9	2012	40 orë/vit
6	V.Gj.	Sp/Raporte	Fak. Juridik	Master	36	12	2011	40 orë/vit

Burimi: të dhëna nga DAB në ISSH, përpunuar nga grupi i auditimit.

Tabela nr.9.2: Planifikimi i angazhimeve të auditimit për vitin 2022

Nr.	Subjekte që do të auditohen	Datë Fillimi	Datë Mbarimi
1	ISSH (Drejtoria e Përgjithshme) D.F.	18.07.2022	06.08.2022
2	ISSH (Drejtoria e Përgjithshme) D.A.	18.07.2022	06.08.2022
3	DRSSH Sh.	10.01.2022	05.02.2022
4	DRSSH Du.	14.02.2022	05.03.2022
5	Drejtoritë e audituara gjatë vitit 2021	14.03.2022	26.03.2022
6	DRSSH Di.	04.04.2022	23.04.2022
7	DRSSH K.	02.05.2022	21.05.2022
8	DRSSH L.	30.05.2022	18.06.2022
9	DRSSH B.	27.06.2022	16.07.2022
10	DRSSH E.	05.09.2022	24.09.2022
11	DRSSH T.	01.10.2022	31.10.2022
12	DRSSH K.	07.11.2022	30.11.2022
13	DSSH Tr.	07.11.2022	30.11.2022
14	DRSSH V.	05.12.2022	24.12.2022
15	DSSH S.	05.12.2022	24.12.2022

Burimi: të dhëna nga DAB në ISSH.

Tabela nr.9.3: Realizimi i misioneve të auditimit për vitin 2022:

Nr.	Subjekte të audituara nga DAB	Realizimi i angazhimeve të auditimit									
		Total	Auditime të realizuara sipas llojit të tyre					Shërbi me Këshillimi	Angazhime	Statusi i Angazhimit	
			Përputh	Perf.	Financë	IT	Të kombinuara			përfu mduar	Në proc
1	Drssh Sh.	1					1			1	
2	Drssh Du.	1					1			1	
3	Drssh Sh.	1					1			1	
4	Te audituara në vitin 2021	1		1						1	
5	Drssh Di.	1					1			1	
6	Drssh L.	1					1			1	
7	Drssh K.	1					1			1	
8	Drssh B.	1					1			1	
9	Drejtoria e Financës Issh	1	1							1	
10	DAP ISSH	1		1						1	
11	Drssh K.	1					1			1	
12	Dssh Tr.						1			1	
13	Drssh T.	1					1			1	
14	Drssh V.	1					1			1	
15	Dssh S.	1					1			1	
16	Drssh E.	1					1				1
	Totali	16	1	2	-	0	13	0	0	15	1

Tabela nr.9.4: Gjetjet dhe rekomandimet për vitin 2022:

000/lekë

Nr.	Subjektet e Audituar	Gjetje në numër	Gjetje në vlerë (000 lekë)	Rekomandime për përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm	Rekomandime të karakterit masa organizative	Rekomandime për arkëtim të vlerave monetare	Rekomandime të tjera
1	Drssh Sh.	12	11,613.8	1	11	4	2
2	Drssh Du.	11	941,1	1	10	1	
3	Drssh Sh.	1					

4	audituarë në 2021						
5	Drssh Di.	7	72,9	2	5		
6	Drssh L.	7		2	5		
7	Drssh K.	9	97,8	2	6		
8	Drssh B.	9		1	8		
9	D. Financës ISSH	1			1		
10	DAP ISSH	7			7		
11	Drssh K.	9	102,1		10		
12	Dssh Tr.	1					
13	Drssh T.	18	16,256.7	1	10	3	
14	Drssh V.	8	2,047,9	1	7		
15	Dssh S.	1			1		
16	Drssh E.						
	Gjithsej	101	31,849,1	11	81	8	2

Burimi: DAB në ISSH, përpunuar nga grupi i auditimit.

Tabela nr.9.5: Të dhëna mbi procedurat, nr. e programeve dhe zbatimin e afateve të auditimeve për vitin 2022:

DRSSH	K.	V.	B.	Sh.	Du.
Autorizimi	✓	✓	✓	✓	✓
Deklarata e konfliktit të interesit	✓	✓	✓	✓	✓
Njoftim për fillimin e auditimit	26.05.2022	02.11.2022	30.06.2022	23.12.2021	31.01.2022
Vlerësimi i riskut	✓	✓	✓	✓	✓
Programi i auditimit	31.05.2022	08.11.2022	07.07.2022	06.01.2022	08.02.2022
Takimi fillestar/përmbyllës	✓	✓	✓	✓	✓
Testet individuale	✓	✓	✓	✓	✓
Projekt raporti nr. datë	12.07.2022	29.12.2022	19.08.2022	14.02.2022	28.03.2022
Dërgim i konfirmimit nga subjekti	21.07.2022	13.01.2023	01.09.2022	28.02.2022	13.04.2022
Raporti përfundimtar nr.datë	22.08.2022	25.01.2023	12.09.2022	07.04.2022	26.04.2022
Raporti i dërguar nga sub.	14.09.2022		14.10.2022	05.05.2022	nuk ka
Memo	po		po	✓	nuk ka
Rishikimi cilësisë së punës	✓	✓	✓	✓	✓

Burimi: DAB në ISSH, përpunuar nga grupi i auditimit.

Drejtimi i auditimit nr. II.2.10.

Tabela nr. 10.2.1 “Dosjet tejkallim afati”

Nr.	Dosjet me tejkallim afati	Numër ditë të tejkalluara
1	308137	7
2	306472	5
3	309954	17
4	305533	5
5	306364	3
6	P2565	72
7	P022	13
8	305745	6
9	303779	15
10	307579	12
11	306056	4
12	I311	3
13	304977	83
14	306048	7
15	305942	23
16	308151	4
17	307051	63
18	306532	6
19	307909	13
20	P2493	10
21	P56	7
22	P000086	6

23	P1131	18
24	305952	9
25	I0000110	6
26	P1908	2
27	P3648	10
28	307301	9
29	307102	13
30	P2459	6
31	P3448	4
32	P5069	14
33	P6054	17
34	307914	4
35	305769	64
36	307269	13
37	308079	7
38	P5112	9
39	Totali i dosjeve të audituara	148
40	Vonesa në % ndaj totalit	38/148 = 25 %

Për sa më sipër, është hartuar ky Raport Përfundimtar Auditimi.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT